Udhëzues Praktik për mbrojtjen e fëmijëve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Udhëzues Praktik

për mbrojtjen e fëmijëve

Terre des hommes
www.tdh.ch

with funding from
Austrian Development Cooperation

KOORDINIMI I PROJEKTIT DHE PËRGATITJA PËR BOTIM I VERSIONIT NË ANGLISHT NGA:
Aline Koller

NË BASHKËPUNIM ME:
Alketa Kupe, Alketa Zallemi, Anila Arapi, Blerta Mano, Entela Kaleshi, Mariela Simo, Merita Meçe, Valbona Dafa, Valbona Habili, dhe me ndihmën e vyer të pjesëtarëve të ekipit të "Terre des hommes" në Shqipëri.

PËRKTHIMI NË SHQIP NGA:
Erald Kanini, Ergys Bezhani, Marcela Bardho

REDAKTOR SHKENCOR:
Prof. Dr. Theodhori Karaj

REDAKTORE LETRARE:
Flutura Açka

GRAFIKA NGA: Bill Schulz

ILUSTRIMET NGA: Rosa Linke

PËRGATITJA PËR BOTIMIN NË SHQIP NGA:
© 2009 Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Terre des Hommes

Ky botim është realizuar në bashkëpunim të ngushtë mes "Terre des hommes", një OJF zvicerane e përfshirë aktivisht në zhvillimin e rrjetit për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri prej vitit 1993 dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Shqipëri.

SHUMË FALEMINDERIT:
Aline Koller

AUTOR:
Aline Koller, Konsulente për Mbrojtjen e Fëmijëve, Fondacioni Terre des hommes, Zvicër

shtypi: Tipografia g&k DOLLONJA
rr. Myrtezim Këlliçi, tel. 04 24 20 905, g&k_graphic@hotmail.com

Ky material për Mbrojtjen e Fëmijëve përmban:

I Mbrojtja e Fëmijëve – Udhëzuesi Praktik për profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Lexuesit e këtij materiali:
Punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, specialistët për mbrojtjen e fëmijëve, personi i kontaktit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, psikologët e shkollës, drejtorë, mësues, anëtarët e komitetit të prindërve, personeli shëndetësor, punonjësit socialë, animatorët e komunitetit si dhe profesionistët e joprofesionistët e tjerë, të cilët punojnë drejpërdrejt me fëmijët.

II Manuali për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkolla (mjet referimi i veçantë)

Lexuesit e këtij manuali:
Anëtarët e bordit të shkollës, drejtorët e shkollave, specialistët e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla, si edhe të gjithë partnerët e tjerë të shkollave të përfshirë në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve që bazohet në komunitet.

Si ta përdorim këtë material?
Udhëzuesi Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve është një libër trajnimi praktik e autodidakt, që ndihmon punonjësit që merren me mbrojtjen e fëmijëve dhe persona të tjerë, që kujdesen për fëmijët në shkollën tuaj, të rrisin nivelin profesional, duke përvetësuar

shprehi dhe kompetenca që lidhen me punën me fëmijët. Për më tepër, **Manuali për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkolla (botim më vete)** përmban një **udhëzues** që tregon si të strukturohet hap pas hapi zbatimi i standardeve për mbrojtjen e fëmijëve në shkollën tuaj, si dhe udhëzime se si të stabilizohet dhe fuqizohet roli i shkollës në një sistem të mbrojtjes së fëmijëve që bazohet në komunitet.

Përmbajtja

	Parathënie	12
	Hyrje	14
	SEKSIONI A	
	Pikëpamjet lidhur me veprimet në mbrojtje të fëmijëve	
1	**Metodologjia e veprimeve të kryera në mbrojtje të fëmijëve**	18
1.1	Hyrje	18
1.2	Parimet themelore lidhur me veprimet në mbrojtje të fëmijëve	19
1.3	Udhëzim hap pas hapi lidhur me veprimet në mbrojtje të fëmijëve	23
1.4	Metodologjia për analizën e thelluar të situatës	27
1.5	Hartimi dhe zbatimi i planit të veprimit	34
	Moduli Praktik 1	40
1	Frika dhe shpresa për këtë program trajnues	40
2	Është një problem që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve?	41
3	Modeli për analizimin e rastit	43
2	**Shprehitë profesionale dhe kompetencat për menaxhimin e rastit**	50
2.1	Hyrje	50
2.2	Koncepti “shqyrtim për ndërhyrje”	51
2.3	Perceptimi	51
2.4	Komunikimi	54
2.5	Nevojat dhe burimet	64
2.6	Menaxhimi i emocioneve	68
2.7	Drejtimi	73
2.8	Zgjidhja e konfliktit	78
2.9	Vetëvlerësimi	80
2.10	Motivimi dhe pjesëmarrja	83

Moduli Praktik 2 88
1 Sjellja ndër mend e kujtimeve të fëmijërisë 88
2 Unë, fëmijët dhe fëmijëria 89
3 Vetëvlerësimi i njohurive dhe shprehive profesionale 93
4 Vëzhgimi – “Këndvështrimi i ri” 95
5 Komunikimi 96
6 Shprehitë e prezantimit të rastit 98
7 Nevojat psiko-sociale 100
8 Menaxhimi i emocioneve dhe stresit 102
9 Drejtimi dhe animimi i grupit 103
10 Drejtimi dhe zgjidhja e konfliktit 105
11 Vetëvlerësimi 106
12 Motivimi dhe pjesëmarrja 106

3 **Ndihma psiko-sociale** 108
3.1 Nivelet e ndihmës psiko-sociale 108
3.2 Ndihma psiko-sociale nga sektorët kryesorë 111

SEKSIONI B
Ndërhyrjet psiko-sociale

4. Metodologjia dhe udhëzimet për ndërhyrjet psiko-sociale 120
4.1 Hyrje 120
4.2 Fëmijët jetojnë në një botë marrëdhëniesh 121
4.3 Atashimi dhe ndarja 122
4.4 Fazat e zhvillimit të fëmijës dhe pjesëmarrja e tij 123
4.5 Gjinia 124
4.6 Faktorët mbrojtës 127

5 **Ndërhyrjet e përqendruara te fëmijët** 130
5.1 Hyrje 130
5.2.1 Këshillimi 131
5.2.2 Diskutimet në grup 132
5.2.3 Kujdesi i fëmijëve për bashkëmoshatarët 133
5.2.4 Profili i burimeve individuale dhe pikave të forta (“vizioni optimist” për të ardhmen) 135

5.2.5	Aktivitetet në formë lojërash të strukturuara	135
5.2.6	Aktivitetet çlodhëse dhe aktivitetet bazë psiko-sociale në formë loje	137
5.3	Konkurenca dhe bashkëpunimi	157
5.4	Vlerësimi i aktiviteteve psiko-sociale me fëmijë	161
6	**Ndërhyrjet e përqendruara te prindërit**	164
6.1	Hyrje	164
6.2	Aktivitetet psiko-sociale me prindërit ose kujdestarët e tjerë parësorë	165
6.2.1	Diskutimet në grup në mbështetje të prindërve	165
6.2.2	Vizitat në familje	166
6.2.3	Aktivitete çlodhëse dhe shprehëse	167
6.2.4	Udhëzime se si të marrin ndihmën shëndetësore, ligjore dhe ekonomike	167
6.2.5	Përfshirja e prindërve në mbrojtjen e fëmijëve të tyre në shkollë dhe në shtëpi	167
6.2.6	Zhvillimi i shprehive pozitive të prindërimit	169
7	**Ndërhyrjet e përqendruara te mësuesit**	177
7.1	Hyrje	177
7.2	Metodologjia e trajnimit të mësuesve	177
7.3	Aktivitete psikosociale në klasë	180
7.3.1	Menaxhimi i klasës	180
7.3.2	Aktivitetet në klasë që synojnë objektiva specifike psiko-sociale	187
8	**Ndërhyrjet e përqendruara në komunitet**	202
8.1	Hyrje	202
8.2	Edukimi i qytetarisë dhe përkrahja e të drejtave të fëmijëve	202
8.3	Mjediset miqësorë për fëmijën	203
8.4	Ndërtimi i lidhjeve mes familjes, shkollës dhe komunitetit	204

9	**Udhëzime mbi aktivitetet në mbrojtje të fëmijëve për çështje specifike**	209
9.1	Udhëzime për abuzimin (Ai-iv)	209
9.2	Udhëzime për problemet sociale (Bi – Biv)	232
9.2.1	Puna e fëmijëve (Bi)	233
9.2.2	Gjakmarrja (Bxiii)	234
9.2.3	Diskriminimi i grupeve minoritare (Bxiv)	235
9.2.4	Migrimi i brendshëm/zhvendosja	236
9.3	Udhëzime për çështjet shëndetësore (Ci-iii)	238
9.3.1	Shëndeti mendor (Cii)	239
9.4	Udhëzime për çështjet psikologjike (Di-Diii)	243
9.4.1	Problemet me sjelljen (Di)	244
9.4.2	Problemet emocionale dhe trauma (Dii dhe Diii)	252
	Moduli Praktik 3	262
1	Pyetësor i shkurtër mbi planin e aktiviteteve psiko-sociale me fëmijët	262
2	Organizimi i aktiviteteve psiko-sociale me fëmijët	265
3	Organizimi i seminareve trajnues me prindër dhe mësues	276
4	Trajnimi i mësuesve për të përmirësuar shprehitë e menaxhimit të klasës	281
5	Seminar trajnues për mësuesit mbi profilin e pikave të forta dhe të dobëta	283
6	Reagimet sistemike (komplekse) dhe të integruara ë mbrojtje të fëmijëve- shembuj	288
7	Trajtimi i abuzimit të fëmijës me prindërit dhe mësuesit	291
8	Të flasësh me prindërit dhe mësuesit për praktikat abuzive	293

SEKSIONI C
Anekset

ANEKSI 1 Raporti i mbrojtjes së fëmijëve **(INSTRUMENTI 1)** 298
ANEKSI 2 Fletë bashkëshoqëruese për ndjekjen individuale të fëmijës nga mësuesit **(INSTRUMENTI 2)** 305
ANEKSI 3 Fletë bashkëshoqëruese për ndjekjen individuale të fëmijës në vizitat në familje **(INSTRUMENTI 3)** 307
ANEKSI 4 Lista e pyetjeve për shëndetin mendor 309
ANEKSI 5 Listë kontrolli për sjelljet e fëmijëve të moshës 6 deri në 18 vjeç 311
ANEKSI 6 Krijimi i një vizioni optimist për të ardhmen 315
ANEKSI 7 Fazat e zhvillimit të fëmijës 318
ANEKSI 8 Vizatimi, si një mjet për sesionet e këshillimit 323
ANEKSI 9 Shembull formulari për të marrë miratimin e prindërve 326
ANEKSI 10 Lista e shqetësimeve të prindërve për fëmijët 6 deri në 12 vjeç 328
ANEKSI 11 Lista e shqetësimeve të prindërve për fëmijët 12 deri në 18 vjeç (adoleshentët) 339

D **Referencat** 350
G **Fjalorth me përkufizimin e termave dhe koncepteve** 354

Parathënie

Parathënie për Udhëzuesin Praktik të Mbrojtjes së Fëmijëve
Ju jeni një psikolog shkolle, mësues, përgjegjës lënde apo drejtor shkolle dhe për këtë ndjeni, si kënaqësinë e madhe, ashtu edhe përgjegjësinë, të punoni me fëmijët në shkollën tuaj. Aftësitë tuaja janë një burim i çmueshëm për mbrojtjen e fëmijëve në komunitetin tuaj dhe prandaj shpresojmë se ky Udhëzues Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve, do t'ju shërbejë si një mjet mbështetës në punën tuaj të përditshme me ta.

Si ta përdorim këtë Udhëzues Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve?
Ky Udhëzues Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve është një libër **trajnues dhe autodidakt** për të gjithë aktorët dhe partnerët e shkollës, që punojnë me fëmijë. Ai mund të përdoret nga profesionistët përgjegjës për veprimet në mbrojtje të fëmijëve, për shembull, psikologët e shkollës, punonjësit socialë të shkollës, personeli mjekësor, animatorët e komunitetit, punonjësit e Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, si dhe nga joprofesionistët e tjerë, të cilët u ofrojnë drejtpërsëdrejti shërbime fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Të gjithë kapitujt plotësojnë njëri-tjetrin. Në fund të pjesës teorike së çdo kapitulli, do të gjeni një përmbledhje të mesazheve kryesore dhe pikat e kontrollit për t'u siguruar se mbani mend mesazhet kyçe mësimore të tij. Për të përforcuar zbatimin e teorisë në praktikën e punës së përditshme, kjo pjesë teorike shoqërohet nga module praktike trajnuese, që synojnë përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale.

Të gjithë anekset janë pjesë përbërëse e Udhëzuesit Praktik dhe gjenden në **SEKSIONIN C**. Në **SEKSIONIN D**, do të gjeni referencat si dhe një fjalorth me përkufizimet e termave dhe të koncepteve për terminologjinë e specializuar psiko-sociale dhe të mbrojtjes në **SEKSIONIN E**.

Filloni me një program nëntëjavor trajnimi për të përmirësuar shprehitë dhe kompetencat tuaja profesionale:

1. Merrni një bllok shënimesh dhe mbajeni atë si ditarin tuaj për mbrojtjen e fëmijëve. Në fund të çdo kapitulli, gjeni kohë të shkruani në ditarin tuaj. Kjo lehtëson kalimin e informacionit që lexoni në praktikën e punës tuaj të përditshme. Shkrimi në ditar thekson rëndësinë e përcaktimit të objektivave individuale, monitorimit të vetvetes dhe nënvizon rëndësinë e kontrollit të vetvetes.
2. Lexoni një kapitull në javë.

3 Nënvizoni me stilolaps në kapitull çështjet e rëndësishme. Reflektoni mbi përfshirjen e çdo nënkapitulli në punën tuaj të përditshme. Mbani shënime në ditarin tuaj ose shkruani drejtpërsëdrejti te Manuali, për të theksuar pikat që doni të mbani mend ose të shtoni sipas eksperiencës tuaj.

4 Më pas lexoni përmbledhjen në fund të çdo kapitulli dhe përpiquni t'ju përgjigjeni pikave të kontrollit në ditarin tuaj.

5 Vetëkontroll: Për ato pyetje që nuk ua dinit përgjigjen, ose për të cilat nuk jeni të sigurtë në jeni përgjigjur, kthejuni seksioneve përkatëse të kapitullit.

6 Plotësoni ushtrimet në modulin praktik dhe përcaktoni objektivat e javës së ardhshme.

7 Diskutoni objektivat dhe këndvështrimet tuaja javore me një punonjës tjetër për mbrojtjen e fëmijëve në sesionet e këshillimit apo me mbikëqyrësin tuaj.

Shkurtime të përdorur:

SMF Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve

Hyrje

Të gjithë mjetet mbi mbrojtjen e fëmijëve të paraqitura në këtë Udhëzues Praktik për Mbrojtjen e Fëmijëve, janë përgatitur midis periudhës 2006 dhe 2009 gjatë një procesi me pjesëmarrjen e thuajse 100 personave të fushës së mbrojtjes së fëmijëve dhe të arsimit. Në bashkëpunim me ekspertë vendas dhe të huaj, janë përshtatur për kushtet shqiptare mjete dhe përvoja të huaja të provuara në mbrojtjen e fëmijëve.

Versioni i parë i Udhëzuesit Praktik të Mbrojtjes së Fëmijëve është testuar nga më shumë se 50 punonjës së mbrojtjes së fëmijëve (psikologë shkollash, mësues, drejtorë dhe punonjës të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve) dhe ka frymëzuar punën e tyre në më shumë se 150 shkolla, në pesë rajone të Shqipërisë (Durrës, Fier, Tiranë, Korçë dhe Elbasan), gjatë një periudhe dyvjeçare.

Ju falënderojmë të gjithë ju, të cilët keni ndarë bashkëpunimin dhe komentet tuaja të çmueshme, si dhe materialet e trajnimit dhe burimeve që kanë ndihmuar në përmirësimin e Udhëzuesit Praktik dhe dobishmërinë e tij për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin shkollor shqiptar. Aty ku ka qenë e mundur, ne kemi përmendur emrat e autorëve, i kërkojmë ndjesë ndokujt që mund të mos i jetë përmendur puna.

Seksioni A

Pikëpamjet lidhur me veprimet në mbrojtje të fëmijëve

1 Metodologjia e veprimeve të kryera në mbrojtje të fëmijëve

Kapitulli i parë jep konceptet dhe procedurat që kanë të bëjnë me metodologjinë e veprimeve të kryera në mbrojtje të fëmijëve dhe menaxhimin e një rasti të vetëm.

1.1 Hyrje

Menjëherë, sapo të jetë identifikuar një rast që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve dhe ky t'i jetë raportuar specialistit të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve, duhet të hapet dosja e fëmijës dhe të bëhet vlerësimi i situatës. Nëse rasti i përket Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijës, është detyra e këtij të fundit të garantojë një ndjekje profesionale të problemit. Është e rëndësishme që, jo vetëm të bësh një kërkesë, por edhe t'i përgjigjesh asaj në mënyrë profesionale dhe të vlefshme.

Dy shembuj
Një mësuese i raporton SMF-së shqetësimet e saj për një vajzë 14-vjeçare në klasën e saj. Vajza nuk shkon rregullisht në shkollë, mbarëvajtja e saj ka rënë dhe shfaq sjellje agresiviteti me personelin pedagogjik. SMF-ja

mbledh informacion dhe bën vlerësimin e rrezikut. Bazuar në vlerësimin fillestar të rrezikut SMF-ja, e klasifikon rastin si Di3 (probleme me sjelljen, niveli i rrezikut 3) dhe Eiv3 (probleme me zhvillimin, niveli i rrezikut 3). Brenda 5 ditësh, SMF-ja bën një analizë të detajuar të situatës dhe përgatit një plan veprimi që do t'i dorëzohet Koordinatorit të psikologëve shkollorë. Objektivat e këtij plani veprimi, diskutohen me këtë të fundit dhe fëmijën, prindërit, mësuesen kujdestare dhe mësuesit. Gjatë muajve të ardhshëm, merren masa pozitive edukative në shtëpi dhe në shkollë, për të ndihmuar vajzën në këtë fazë të vështirë të zhvillimit. Pas tre muajsh, rasti mund të mbyllet. **Rasti që mund të trajtohet brenda mjedisit të shkollës, nuk ka nevojë për raportim.**

Infermierja e shkollës vëren gjatë një kontrolli mjekësor së një djalë 9-vjeçar ka të nxira në të gjithë trupin. Djali ka frikë kur e prekin dhe është shumë i turpshëm dhe i tërhequr. Kur e pyesin, thotë se ka rënë nga shkallët. Infermierja ia raporton shqetësimin e saj SMF-së dhe hapet dosja. SMF-ja kryen vlerësimin fillestar të rrezikut dhe me miratimin e Koordinatorit të psikologëve shkollorë, e klasifikon djalin si Ai2 (abuzim fizik, niveli i rrezikut 2). SMF-ja, me mbështetjen e Koordinatorit të psikologëve shkollorë, ia referon rastin menjëherë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. **Ky rast nuk është në mandatin e SMF-së së shkollës.**

1.2 Parimet themelore lidhur me veprimet në mbrojtje të fëmijëve

Hyrje
Sa herë që rasti i identifikuar është në përgjegjësinë e SMF-së, të gjitha veprimet e ardhshme duhet të ndërmerren bazuar në parimet e mëposhtme:

- **Pjesëmarrja e fëmijës dhe kujdestarëve të tij kryesorë**
  Bazuar në konsultimet me fëmijën dhe kujdestarët e tij kryesorë (prindërit, mësuesit e klasës, etj.), SMF-ja bën një identifikim të përbashkët të problemit, kërkon zgjidhje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme. Për të ndihmuar familjen dhe shkollën që të marrin

vendimet më të mira për fëmijën, theksi të vihet tek anët e mira të tij dhe në mundësitë aktuale për përballimin e vështirësive. Megjithëse nuk mund të arrihet qysh në fillim të përfshihen të gjithë aktorët për kryerjen e një analize të rastit apo në zbatimin e planit të veprimit, duhet parë me përparësi dhe të inkurajohet vazhdimisht bashkëpunimi me fëmijën dhe familjen e tij.

× **Konsultime më të gjera**
Merrni në konsideratë këndvështrimet e ndryshme dhe kontekstin në çdo aspekt të analizës së situatës. Shpesh, fëmijët (shokët, vëllezërit dhe motrat, edhe vetë fëmijët në nevojë), nuk merren në konsideratë, nuk bisedohet me ta, megjithëse ata mund të jenë një burim i rëndësishëm dhe mund të japin të dhëna specifike.

× **Bashkëpunimi me përfaqësuesit më të rëndësishëm**
Përfshini aktorët kyç në mbrojtjen e fëmijëve (familjen, mësuesit, miqtë, pediatrit, trajnuesit profesionalë, punonjësit socialë, infermierët, etj.) në analizën e situatës, që ndihmon në sigurimin e mbështetjes dhe në gjetjen e informacionit. Nuk është gjithmonë e lehtë t'i identifikosh këto burime, pasi disa individë mund të jenë të paaftë fizikisht ose emocionalisht për të marrë pjesë në këto ushtrime. Nga ana tjetër, disa individë mund të kenë interesa të veçanta.

Kujdesuni të parandaloni keqpërdorimin e drejtimit dhe pushtetit mbi fëmijën, për të vepruar gjithmonë në interesin më të mirë të fëmijës si dhe të konsultoheni me të para se të ndërmerrni ndonjë veprim.

× **Respektoni mirëqenien e njerëzve, fshehtësinë dhe jetën private**
Ndonjëherë mund jetë e papërshtatshme dhe e dëmshme të pyesësh njerëzit për të shkëmbyer informacionin, përvojat dhe shqetësimet e tyre, sidomos në fazën e parë të analizës së situatës. Për sigurinë e fëmijës, në disa raste, është e preferueshme të shmanget biseda mbi çështjet delikate qysh në hapat e parë të vlerësimit, si për shembull, në rastin e një fëmije të abuzuar apo të dhunës në familje. Cilësia e analizës së situatës, do të varet nga kapaciteti i "vlerësuesve" për të respektuar dhe trajtuar ndjenjat e njerëzve me ndjeshmëri, si edhe të dëgjojnë se për çfarë kanë nevojë apo të shprehin diçka që nuk munden me fjalë. SMF-të i kanë këto aftësi, për t'u dhënë kohën e duhur,

për të gjetur vendin e përshtatshëm, etj. Gjithmonë mbajeni të fshehtë informacionin delikat dhe menaxhojeni me maturi. Mos reagoni duke u bazuar në emocionet e tuaja apo të të tjerëve.

× **Respektoni kulturën dhe traditat**
Në disa kushte të veçanta, mund të jetë e papërshtatshme të diskutohen disa tema; disa individë mund të mos jenë të aftë dhe të lirë të shprehin ndjenjat e shqetësimet e tyre, sidomos dikush që s'është i familjes. Personi që drejton analizën, duhet të jetë i informuar mbi ndryshimet kulturore përsa lidhet me shprehjen dhe shfaqjen e ndjenjave, stresit psikologjik dhe mekanizmave përballuese. Kushtojini vëmendje të veçantë keqkuptimeve të mundshme kulturore dhe gjuhësore, kur punoni me grupe minoritare dhe me familje me arsimim të ulët.

× **Jepini vetes kohë dhe ndërtoni një marrëdhënie besimi me të tjerët**
Cilësia e informacionit të mbledhur dhe e masave të ndërhyrjes, varet shumë nga marrëdhënia e besimit që do të krijohet. Para se të kryhen diskutimet në grup dhe intervistat, është e rëndësishme të bëhet një kontakt i parë me njerëzit. Vlerësimet për mbrojtjen e fëmijëve, duhet të fillojnë me qetësi. Përpiquni që personi të ndjehet sa më mirë dhe shmangni me çdo kusht që analiza t'i ngjajë një hetimi.

× **Jini të qartë për objektivat e vlerësimit dhe llojin e të dhënave që duhen mbledhur**
Shpesh, personat në nevojë për mbrojtje, kontaktohen nga aktorë të ndryshëm, të cilët kryejnë vlerësimet e tyre. Bëni kujdes të veçantë për t'ua shpjeguar qartë njerëzve qëllimin dhe objektivat e këtij vlerësimi dhe interesin tuaj në të mirë të fëmijës. Mos premtoni asgjë në këtë fazë. Bëjini njerëzve komente mbi vlerësimin dhe mbajini të informuar për veprimet e mëtejshme.

× **Shmangni të dubluarit**
Për të shmangur të dubluarit në rrjetin shumëdisiplinor të mbrojtjes së fëmijëve në një komunitet, është e domosdoshme që SMF-të të shkëmbejnë rezultatet e vlerësimit me aktorë të tjerë të rëndësishëm. Nuk është gjithmonë e lehtë të shkëmbehet informacioni, sidomos

kur janë përdorur metoda dhe standarde të ndryshme për të mbledhur të dhëna. Kur rasti i një fëmije është ndjekur nga aktorë të ndryshëm (është i “mbingopur”), mund të jetë e nevojshme të përdoret një metodologji e ndryshme dhe të koordinohet sa më mirë informacioni dhe veprimet.

× **Menaxhimi i rastit shumëdisiplinor**
Shumica e rasteve për mbrojtjen e fëmijëve, kërkojnë një metodë të koordinuar shumëdimensionale, ku përfshihen disa sektorë dhe aktorë. Përpiquni që të koordinoni mirë veprimet e ndërmarra dhe aktorët e ndryshëm, që të ketë një koherencë në zbatimin e planit të veprimit. Gjithmonë duhet të keni në qendër të vëmendjes dhe veprimeve fëmijën dhe nisuni nga qendra, pra, fëmija, drejt periferisë.

× **Konfidencialiteti në menaxhimin e rastit**
SMF-ja duhet të respektojë gjithë kohën konfidencialitetin e informacionit të mbledhur gjatë punës së tij profesionale. Informacioni do të jepet vetëm me miratimin e fëmijës, të prindit apo kujdestarit ligjor, përveç rasteve kur mosdëshira e prindërve për të dhënë informacionin, rezulton të rrezikojë fëmijën apo të tjerë. Informacioni i vjetër konfidencial, do të griset ose shkatërrohet para se të hidhet në koshat e riciklimit apo koshat e mbeturinave.

SMF-ja diskuton informacionin konfidencial vetëm për qëllime profesionale dhe vetëm me personat që kanë të drejtën ligjore ta dinë. Është e rëndësishme, sidomos në rastet e çështjeve delikate, si atë të abuzimit me fëmijën dhe dhunës në familje, të jesh i kujdeshëm se kujt ia thua informacionin!

SMF-ja informon fëmijën dhe klientët e tjerë për kufijtë e konfidencialitetit në fillim të krijimit të një marrëdhënieje profesionale. Intervistojeni fëmijën vetëm dhe më pas me kujdestarët, nëse është e nevojshme.

SMF-ja respekton dëshirën e personit, i cili raporton shqetësimin për mbrojtjen e fëmijës, për të mbetur anonim!

1.3 Udhëzim hap pas hapi për procesin e menaxhimit të rasteve në shkolla

Në pjesën në vijim nënvizohen hapat që duhen ndërmarrë për rastet që bëjnë pjesë në mandatin e SMF-së (kategoritë: A3-4, B3-4, C2-4, D2-4, E2-4).

Hapat, veprimet dhe mjetet:

VEPRIMI	MJETI	ANEKSI
1 Identifikimi i rastit, sinjalizimi dhe raportimi	-	-
2 Mbledhja e informacionit	-	-
3 Vlerësimi fillestar i rrezikut dhe raporti mbi mbrojtjen e fëmijës	**Instrumenti 1:** Raporti për mbrojtjen e fëmijëve	**1**
4 Analiza e thelluar e situatës	-	-
5 Ndjekja individuale e rastit: monitorim dhe vlerësim	**Instrumenti 2:** Formulari individual për ndjekjen e rastit për mësuesit **Instrumenti 3:** Formulari individual për vizitat në familje	**1, 2**
6 Mbyllja e rastit	-	-

HAPI 1 **Identifikimi i rastit, sinjalizimi dhe raportimi**

SMF-ja duhet të informojë dhe trajnojë të gjithë personelin mësimor, prindërit dhe fëmijët, vullnetarët dhe të tjerët, të cilë kanë kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët brenda në shkollë, lidhur me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre për sinjalizimin e raportimin e rasteve. Të gjitha raportimet duhen dokumentuar dhe vendosur në dosje **(INSTRUMENTI 1)**. Kur personi, i cili raporton një shqetësim, nuk dëshiron të deklarohet e të bëhet i njohur, identitetin i tij mbahet gjithmonë konfidencial.

2 – 3 **Mbledhja e informacionit dhe vlerësimi fillestar i rrezikut**

Të gjitha rastet e raportuar nga SMF-ja, duhet të vlerësohen. SMF-ja krijon një sistem të thjeshtë dosjesh, referim të saktë dhe ndjek një metodologji të qartë klasifikimi dhe procedura të qarta për ndjekjen e rastit.

Dosjet dokumentohen si më poshtë: Shkurtimi për qytetin ndiqet nga shkurtimi për shkollën dhe numri i rastit.

- **SHEMBULL PËR RASTIN NUMËR NJË:** KO_TG_01
- **QYTETI:** Korça (KO)
- **EMRI I SHKOLLËS:** Themistokli Germenji (TG)
- **NUMRI I DOSJES SË RASTIT:** e para

Sapo të jetë hapur një dosje dhe të jetë mbledhur informacioni për të kaluarën, SMF-ja dokumenton dhe vlerëson rastet e mbrojtjes së fëmijëve bazuar në llojin e problemit, shpejtësinë e reagimit, rreziqet e mundshme, burimet ekzistuese dhe veprimet e mundshme. Nëse rasti nuk është në kompetencën e SMF-së, ai kontakton menjëherë mbikëqyrësin, i cili mund t'ia referojë rastin Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve ose strukturave të tjera lokale.

4 **Vlerësim i thelluar/analizë e situatës**

Vlerësimi i thelluar për një periudhë të gjatë kohore kryhet kur veprimet fillestare të ndërhyrjes mund të kenë filluar. Kjo ndihmon për të përcaktuar një strukturë logjike, plane strategjike dhe operacionale, si dhe një model veprimi. Plani i veprimit bazohet në përparësitë e identifikuara. Shumë raste kërkojnë një ndërhyrje komplekse dhe shumëdimensionale, që përfshin aktorë të ndryshëm. Është e rëndësishme që menaxheri parësor i rastit, të koordinojë dhe ndjekë ndërhyrjet për të siguruar koherencën.

5 **Ndjekja individuale e rastit**

SMF-ja koordinon zbatimin e planit të veprimit, ndjek dhe vlerëson ecurinë, si dhe i raporton në takimet e supervizimit të menaxhimit të rastit Koordinatorit të psikologëve. Veç kësaj, takimet e koordinimit mbahen me aktorët kryesorë të zbatimit të planit të veprimit, për të siguruar një reagim sa më përfshirës në mbrojtje të fëmijëve, sa herë që menaxheri parësor i rastit e sheh të arsyeshme.

Monitorimi
Monitorimi përfshin një sërë detyrash, që kryhen në faza të ndryshme të zbatimit të planit të veprimit. Monitorimi strategjik dhe operacional lejon, respektivisht, vlerësimin e objektivave dhe riplanifikimin e aktiviteteve dhe burimeve për të garantuar mbështetjen deri në fund të fëmijëve.

Vlerësimi
Vlerësimi synon të përcaktojë: **a)** nëse plani i veprimit i ka përmbushur objektivat; **b)** ndikimin e masave të ndërmarra mbi mirëqenien e fëmijës, dhe **c)** ndikimin afatgjatë dhe mbështetjen e nevojshme në të ardhmen.

6 **Mbyllja e rastit**
Kur arrihen synimet dhe objektivat e planit të veprimit, SMF propozon finalizimin e rastit dhe me miratimin e Koordinatorit të psikologëve, rasti mund të mbyllet.

Është e rëndësishme të jemi të vëmendshëm për çastin e duhur të mbylljes së rastit. Nëse ne presim shumë, mund të krijojmë një varësi të panevojshme. Çdo rast duhet të ketë një hapje dhe një mbyllje të qartë të dosjes. Gjithmonë duhen mbajtur shënime lidhur me historinë e fëmijës!

FIGURA 1



Procedurat e veprimeve të kryera në mbrojtje të fëmijëve

Procedura është si më poshtë **(FIGURA 2)**

FIGURA 2



1.4 Metodologjia për analizën e thelluar të situatës (menaxhimi i rastit, Hapi 4)

A **Hyrje**

Analiza e një situate, e njohur edhe si vlerësim, është procesi i mbledhjes së të dhënave sasiore dhe cilësore për njohjen e situatës së fëmijës në një çast të dhënë. Analiza e situatës ndryshon nga koncepti i ngushtë i "vlerësimit të nevojave" sepse: **a)** ka një objektiv më të gjerë që fokusohet në një kontekst më të gjërë të situatës dhe **b)** identifikon, jo vetëm nevojat dhe problemet, por, gjithashtu, kapacitetet dhe burimet. Analiza e thelluar duhet të ndërmerret përpara ose gjatë përpilimit të planit të veprimit; analiza të tjera të situatës, mund të ndërmerren më pas në mënyrë të vazhdueshme gjatë zbatimit të planit të veprimit, për të rivlerësuar situatën dhe për të riparë edhe një herë synimet dhe objektivat, nëse del e nevojshme.

Metodologjia e përdorur për të kryer vlerësimet e thelluara/analizën e situatës varet nga: **a)** mandati; **b)** burimet e disponueshme; **c)** kushtet; dhe **d)** lloji dhe faza e problemit të mbrojtjes së fëmijës.

Vlerësimi mund të shikohet si një proces mësimi dinamik, i ndryshueshëm dhe i strukturuar. Ka një pirje për një vlerësim subjektiv, duke humbur kështu objektivitetin, prandaj është e rëndësishme të ndiqet një metodë elastike dhe që të gjitha vendimet dhe veprimet të merren nën mbikëqyrjen e Koordinatorit të psikologut të shkollës dhe një mbikëqyrësi të emëruar.

Vlerësimi duhet të përqendrohet në çështjet më urgjente. Ekspertiza dhe eksperienca, janë kryesore në sigurimin e cilësisë së analizës së situatës. Vlerësuesit duhet të kenë një kuptim të qartë për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe ato psiko-sociale, si dhe të jenë në gjendje të parashikojnë nevojat dhe rreziqet afatgjatë dhe afatshkurtër në nivelin individual e atë kolektiv.

Bazojeni vlerësimin në parimet e përshkruara në **KAPITULLIN 1** dhe në konceptin "shqyrtim për ndërhyrje", përshkruar' në **KAPITULLIN 2**, pasi kjo do të mundësojë strukturimin e procesit.

Para se të filloni me vlerësimin, përcaktoni **një plan të qartë veprimi.**

Mjetet e përdorura në analizën e situatës, janë të ndryshme dhe plotësuese. Informacioni i mbledhur mund të variojë nga i përgjithshëm (ditëlindja e fëmijës) në individual (mbi fëmijën) dhe mund të përfshijë të dhëna sasiore dhe cilësore.

Kur bëhet një vlerësim, ka shumë rëndësi që fokusi të jetë fëmija. Çështjet e "fshehta" të mbrojtjes, mund të mos bëhen publike.

B **Plani i veprimit për fazën e vlerësimit:**

Hartimi i një plani veprimi, nënkupton që ju duhet të uleni dhe të pyesni veten, përpara se të pyesni njerëz të tjerë:

- × Si mund ta ndërtoj unë një plan veprimi, që të mund të vlerësoj situatën e këtij fëmije në kushtet aktuale?
- × Çfarë kërkoj unë?
- × Çfarë pyetjesh duhet të bëj dhe kujt duhet t'ia bëj?
- × Ku do ta dokumentoj vlerësimin?
- × Me kë mund të konsultohem (ekspert të ekipit të Tdh, Koordinatorin e psikologëve, ekspertë të tjerë të mbrojtjes së fëmijëve)?
- × Me kë duhet të bisedoj lidhur me këtë rast (në mënyrë të rezervuar)?

C **Mbledhja e informacionit:**

Që të mund të garantohet saktësia, janë të nevojshëm një ose disa takime me fëmijën dhe/ose kujdestarin. SMF-ja duhet të takohet me njerëz të tjerë të përfshirë në jetën e fëmijës (si, mësues, fqinjë, miq, mjekë, punonjës socialë, kolegë, etj.). Duhet bërë dallim i qartë midis: **a)** informacionit bazë të mbledhur për të kuptuar dhe dhënë një përshkrim të situatës së fëmijës (për shembull, emri, adresa, kujdestarët, statusi social-ekonomik, statusi arsimor, gjendja shëndetësore, etj.); dhe **b)** informacionit të detajuar që është i nevojshëm për të menaxhuar rastin konkret. Informacioni duhet mbajtur konfidencial në një dosje (letër ose elektronike), në një vend të sigurtë. Mos lini jashtë asnjë informacion konfidencial.

Ndër aktorët kyç dhe burimet që ndihmojnë për analizimin e situatës, përfshihen:

- × Fëmija;
- × Kujdestarët parësorë (prindërit ose të tjerë);
- × Mësuesit, punonjësit socialë;
- × Specialistë të mjekësisë, si mjekë ose personel tjetër mjekësor;
- × Shokët e fëmijës, motrat dhe vëllezërit e tij, fqinjët etj,;
- × Anëtarët e komunitetit.

Teknikat e përdorura për të mbledhur informacion, përfshijnë:

- Vëzhgimet;
- Intervistimi i individëve;
- Diskutimet me grupe të vogla me përbërje të ndryshme, lidhur me një çështje të veçantë;
- Pyetësorët;
- Leximi (për shembull, raportet paraprake të vlerësimit, dosjet etj.);
- Takime dhe mekanizma koordinimi.

Shembull burimi informacioni: Vëzhgimi i fëmijës

Dëgjo dhe vëzhgo fëmijën ose inkurajo prindërit, mësuesit ose njerëzit e tjerë, të cilët janë shumë afër fëmijës. Dëgjo çfarë thotë fëmija, si në-përmjet fjalëve, ashtu edhe prej sjelljes së tij. Vëzhgo çfarë bën fëmija, ndërkohë që i flet atij/asaj ose kur ai/ajo është duke luajtur me të tjerët.

Përqendrohu më shumë në pyetjet e mëposhtme:

- A është sjellja e fëmijës e përshtatshme me zhvillimin e tij?
- A po sillet fëmija ndryshe, krahasuar me sjelljen e moshës së tij? A ka ndryshuar ndjeshëm personaliteti, sjelljet apo botëkuptimi i tij? A mendojnë të rriturit se ky fëmijë ka nevojë për ndihmë?
- Bisedo me fëmijën rreth gjërave të përditshme dhe shiko se ç'për-gjigje jep ai. A po ju dëgjon dhe a po e kupton fëmija çfarë po i thua? A është të kuptuarit e fëmijës në përshtatje me moshën e tij?
- A duket fëmija i shqetësuar dhe i paqartë? A e ka të vështirë ai të përqendrohet apo t'u përgjigjet pyetjeve?
- Krahaso sjelljen e fëmijës me sjelljen e fëmijëve të tjerë. A është sjellja e njëjtë me atë të fëmijëve të tjerë?
- Vëzhgo fëmijën kur luan. A luan fëmija sipas moshës që ka? A është mënyra se si ai luan tipike edhe për fëmijët e tjerë, apo është e ndry-shme? A shfaq fëmija skena stresi të vazhdueshëm?

Kur flisni me fëmijët kini parasysh pikat e shënuara më poshtë:

- Krijoni një atmosferë miqësore dhe joformale, që fëmijët të ndjehen sa më rehat.
- Përdorni një gjuhë miqësore për fëmijën.
- Shmangni sugjerimet.

- × Krijoni ekipe me burra dhe gra kur punoni me djem e vajza, pasi disa fëmijë preferojnë të flasin me njerëz të të njëjtit seks.
- × Nëse nuk e keni të lehtë me natyrën e rastit dhe një kolegu juaj ka më shumë përvojë, mund t'ia kaloni rastin një SMF-je tjetër.

Gjashtë hapat që duhen përdorur në mbledhjen e informacionit:
Vlerësimi siguron që përmes mbledhjes së të dhënave, kuptimi i situatës të bëhet më i qartë. Të dhënat që në krye nuk duken sikur janë të rëndësishme, mund të rezultojnë të dobishme më vonë. Është e rëndësishme të kesh një këndvështrim sa më të gjerë që të jetë e mundur për situatën, para se të futesh në detaje. Kushtoji rëndësi përzgjedhjes së burimeve të informacionit. Njerëzit shpesh gjykojnë bazuar në perceptimin apo interpretimin e tyre për situatën, prandaj është e rëndësishme të shohësh informacionin në varësi të atij personi apo vendi nga vjen. Burimet duhet të jenë sa më të larmishëm që të jetë e mundur.

Analiza e situatës mund të ndahet në gjashtë faza, duke përfshirë aktorët dhe teknikat e renditura më poshtë dhe duke vijuar me ndërtimin e një plani veprimi.

Përmbledhje e gjashtë hapave

1. Rishikoni informacionin për fëmijën përpara raportimit të problemit.
2. Rishikoni informacionin për situatën aktuale të fëmijës, si dhe ndikimet dhe rreziqet e menjëhershme në situatën aktuale të fëmijës.
3. Identifikoni problemet psiko-sociale dhe ato të mbrojtjes, si dhe aktorët.
4. Sistemoni informacionin.
5. Përcaktoni rezultatet e dëshiruara.

1 Rishikoni informacionin për fëmijën para krizës:

- × Feja, gjuha, traditat, niveli arsimor;
- × Rrethi i mbështetjes shoqërore dhe familjare;
- × Gjinia;

- Historiku i familjes;
- Problemet shëndetësore të mëparshme;
- Probleme të mëparshme psiko-sociale dhe mbrojtjeje;
- Ekspozimet ndaj rreziqeve, nevojat, burimet, anët pozitive.

2 Rishikoni informacionin për situatën aktuale të fëmijës, ndikimet e menjëhershme, si dhe rreziqet për mirëqenien e fëmijës.

- Natyra e problemit, kur dhe si ndodhi;
- Situata, përsa i përket nevojave, rreziqeve, përparësive, burimeve, si: ushqimi, uji, shëndeti, higjiena, streha, veshmbathje, siguria, mbështetja psikologjike, etj.

3 Identifikoni problemet psiko-sociale dhe ato të mbrojtjes, si dhe aktorët.

- Me çfarë problemesh të veçanta po përballet fëmija dhe familja e tij/saj?
- Cilat pika të forta, burime ose faktorë mbrojtës mund të aktivizohen?
- Cilët janë mekanizmat tipikë në përgjigje të këtij problemi specifik?

Përfshirja e prindërve/kujdestarëve kryesorë:

- A kanë dijeni rreth problemit?
- Çfarë duan ata për fëmijët e tyre?
- Identifikoni gjërat e përbashkëta që ju doni me qëllim që fëmija të jetë i sigurtë.
- Si mundet prindërit të bëhen pjesë e planit të ndërhyrjes?
- Çfarë lloj prindërish duan të jenë ata?
- Çfarë nevojash ka familja? Ç'faktorë rreziku apo rreziqesh aktuale u kanosen?
- Kush janë pikat e forta dhe burimet brenda familjes?

Përfshirja e fëmijëve:

- × Njohja e vështirësisë dhe qetësimi (rehatimi) i fëmijës.
- × Çfarë ka ndodhur?
- × Cili është shqetësimi i tij/saj kryesor?
- × Cila është frika e tij/e saj më e madhe?
- × Cila është nevoja e tij/e saj më e madhe?
- × Cilat janë pikat e tij/të saj më të forta si edhe burimet?
- × Çfarë do ai/ajo që të ndodhë?

4 Sistemoni informacionin

SMF-ja në fund të çdo sesioni, duhet të rishikojë dhe të diskutojë të dhënat e mbledhura dhe të regjistrojë informacionin në mënyrë sistematike. SMF-ja krijon një sistem të thjeshtë dosjesh për të gjithë informacionin, që ka datën dhe burimin e informacionit si dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm. Më pas dokumenti futet në dosjen e fëmijës. Procedurat e brendshme duhet të jenë të thjeshta dhe të qarta, që të mund të lehtësojnë ndjekjen dhe kontrollin e jashtëm.

5 Përcaktoni rezultatet e dëshiruara

Është e rëndësishme të takoheni me aktorët parësorë dhe dytësorë për të diskutuar dëshirat e tyre për fëmijën, përpara se të përcaktoni qartë një qëllim, çka mundësisht të përqafohet dhe nga të tjerë. Rezultatet që dëshirohen të arrihen, duhet të diskutohen edhe me fëmijën. SMF-ja siguron se të gjitha veprimet synojnë arritjen e qëllimit dhe nuk janë **të improvizuara.**

Duhen marrë parasysh këto elementë:

- a Pjesëmarrja e fëmijës;
- b Familja;
- c Komuniteti;
- d Shkolla;
- e Shteti/Qeveria.

Çfarë dëshiron fëmija që të arrihet? Çfarë urojnë prindërit, mësuesit apo kujdestarët e tjerë për fëmijën? Ç'lloj mbështetjeje të brendshme dhe të jashtme ka dhe çfarë lloj vështirësish pritet të kalohen? A janë këto rezultate në harmoni me ligjet e shtetit dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve? Gjeni një rezultat që u përgjigjet nevojave themelore të fëmijës, të mbështetur edhe nga fëmija, edhe nga kujdestarët e tij. Duhet të gjeni një arsye të përbashkët, të krijoni një vizion, të keni një qëllim të njëjtë për arritjen e asaj mbi çka do të punoni. Objektivat duhet të jenë realiste dhe të arritshme.

6

Procesi i vendimmarrjes

Procedurat e brendshme

Mblidhni informacion të mjaftueshëm mbi rastin, analizoni situatën me kujdes dhe merrni një vendim, që jep përgjigjen më të përshtatshme. Për çdo rast, fëmijët dhe prindërit duhet të jenë plotësisht pjesë e procesit të vendimmarrjes. Duhet të dëgjohen të gjithë aktorët të lidhur, në njëfarë mënyre, me problemin dhe zgjidhjen. Para se të ndërtoni planin e ndërhyrjes, mbani parasysh pasojat për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Procesi i vendimmarrjes duhet të udhëhiqet nga faktorët e mëposhtëm:

FËMIJA	PROBLEMI (-ET)	RËNDËSIA	RREZIQET	BURIMET	VEPRIMET E MUNDSHME DHE PASOJAT

Zgjedhja e një mundësie

- × Cila është vlera e çdo **mundësie**?
- × A janë realiste dhe të arritshme?
- × Cilat janë pasojat e menjëhershme, afatshkurtëra, afatmesme, afatgjata për çdo veprim ose mosveprim të ndërmarrë?
- × A i përgjigjet zgjidhja problemeve parësore!
- × Ç'strategji apo varg veprimesh do të sjellin rezultatin që kërkohet?
- × Ç'parime duhen patur parasysh?

- Çfarë roli luajnë emocionet në përzgjedhje?
- Si kuptohet kompleksiteti i problemit në të gjithë gjerësinë e tij?
- A është gjetur zgjidhja duke reflektuar bashkë me fëmijën, prindërit apo kujdestarët kryesorë?
- A është kjo zgjidhje e përshtatshme për moshën dhe a i jep mundësi fëmijës të provojë përvoja pozitive?

Çfarë konkluzionesh dalin nga informacioni?
Pasi keni përcaktuar objektivin me aktorët parësorë, ekzistojnë një sërë strategjish për ta arritur atë. Lexo studimet lidhur me këtë çështje, shih statistikat, mendo për rastet e ngjashme me çka jeni ndeshur gjatë përvojës tuaj të mëparshme dhe kontakto një koleg, i cili mund të ketë përvojë në zgjidhjen e rastit tuaj.

1.5 Ndërtimi dhe zbatimi i një plani veprimi (HAPI 7)

A Hyrje

Është e rëndësishme që në çdo pjesë të punës psiko-sociale të mos bëhesh palë e problemit për ata që janë në nevojë. Qysh në fillim të ndërhyrjes, duhet të kesh të qartë se ku do të mbërrish. Aktivitetet e ndërhyrjes të lidhur me menaxhimin e rasteve, përfshijnë shumë aktorë. Çdo aktor kontribuon ose lehtëson problemin e fëmijës, ndaj duhet marrë parasysh mendimi ose veprimi i çdo aktori. Aktorët kryesorë janë: fëmijët, familja dhe/ose kujdestarët. Te aktorët dytësorë mund të përfshihen familja, personeli mësimor ose të tjerë.

B Objektivat dhe rezultatet

Pasi merret një vendim për të arritur një objektiv dhe rezultatet e dëshiruara, është detyra e Specialistit të Mbrojtjes së Fëmijëve të ndërtojë dhe koordinojë një plan të detajuar ndërhyrjeje me boshte të orientuara sipas grupeve (fëmija, prindërit, mësuesit, kolegët etj.)

Duke mbajtur parasysh qëllimin dhe objektivat e planit të përgjith-

shëm të veprimit – që mund të përfshijë disa drejtime – rezultati i pritshëm i punës psiko-sociale është që fëmija të trajtohet individualisht dhe të ndërmerren veprime konkrete për t'iu përgjigjur nevojave të tij.

Plotësimi i nevojave për mbrojtje individuale, mund të bëhet shumë i komplikuar, kështu që është e rëndësishme të jetë i strukturuar dhe elastik. Pa një strukturë, SMF-ja mund të mbingarkohet dhe të bëhet i padobishëm. Sistemet vepruese dhe të përgjegjshme të menaxhimit, janë të nevojshme, por duhen përdorur shkathtësisht, për të lejuar ndryshimet përkatëse. Veprimet e pastrukturuara mund të kenë një ndikim negativ dhe të çojnë në menaxhim të gabuar të rastit. Të gjitha reflektimet dhe masat e ndërmarra, duhet të synojnë kryerjen e një veprimi të koordinuar mirë për interesin më të mirë të fëmijës.

Planifikimi duhet të bazohet në:

- × Promovimin e të drejtave të fëmijëve;
- × Inkurajimin e veprimeve të ndërsjellta, por pa ndërhyrje;
- × Nivelet e larta të pjesëmarrjes së fëmijës dhe familjes së tij;
- × Sigurinë që duhet parë me përparësi;
- × Qëllimin/objektivat e arritshme.

c **Ndihma që mund të ofrohet nga Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve përfshin:**

- × Orientimin e fëmijës në vende që janë miqësore me të;
- × Ndërmjetësimin në konfliktet familjare;
- × Nxitjen dhe lehtësimin e ndjekjes së shkollës;
- × Ndihmën në vendosjen e kontakteve me shërbimet shëndetësore;
- × Mbështetjen për të përdorur ndihma të tjera të shtetit;
- × Dhënien e këshillave edukative personelit të shkollës dhe prindërve;
- × Mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës.

Një nivel i lartë i përfshirjes së fëmijës dhe familjes, është shumë i rëndësishëm për të krijuar mekanizma që ndihmojnë veten dhe nuk krijojnë varësi.

- × Mbështetjen e iniciativave të fëmijës;
- × Inkurajimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të tjera (për shembull, grupet e të rinjve, klubet sportive etj);
- × Organizimin e sesioneve të shkurtra trajnuese për prindërit dhe kujdestarët e tjerë (për shembull, ofrimin e kujdesit, fazat e zhvillimit të fëmijës, aftësitë pozitive prindërore).

Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve, nuk zhvillon aktivitete të mirëfillta klinike psikologjike ose psiko-terapeutike me fëmijët apo prindërit. Mbështetja e ofruar nga SMF, konsiston kryesisht në dëgjimin dhe dhënien e informacionit, komunikimin mbështetës, këshillim dhe udhëzim.

Një nga sfidat më të mëdha që ndeshet në punën psiko-sociale, është fakti se problemet janë të shumta, komplekse, të rrënjosura thellë dhe jo gjithmonë të lidhura me krizat ekzistuese apo shqetësimet e shprehura (problemet e fshehura). Përpiquni të veproni sa më shpejt të jetë e mundur, para se një **problem** të shkaktojë probleme të tjera.

D **Krijimi i një mekanizmi referimi**

Një përparësi në menaxhimin e rastit, është identifikimi i partnerëve të mundshëm. Ky aktivitet duhet të iniciohet gjatë një analize të thelluar të situatës. Qëllimi i identifikimit të partnerëve, është gjetja e burimeve në rrjetin për mbrojtjen e fëmijëve. Është një proces i vazhdueshëm, pasi aktorët ndryshojnë me kalimin e kohës. Megjithatë, procesi i referimit duhet formalizuar dhe standardizuar, për të garantuar vlefshmëri. Krijoni një udhëzues referimi (shih **ANEKSIN 7** në Manualin e Mbrojtjes së Fëmijëve për shkollat), që të përfshijë informacionin e mëposhtëm për çdo organizatë partnere:

- Emrin e organizatës, adresën, telefonin, personin e kontaktit;
- Aktivitetin kryesor, aktivitetet shtesë;
- Llojin dhe moshën e përfituesve;
- Orari zyrtar – orari i hapjes dhe i mbylljes.

I jepni, sa më shumë që të jetë e mundur, përparësi referimit në shërbimet shtetërore (për shembull, spitaleve, shkollave, institucioneve dhe policisë). Formalizoni marrëveshje të qarta bashkëpunimi, nëse është e mundur. Përveç kësaj, është e rëndësishme të verifikohet dhe nxitet nga ana e partnerëve tuaj respektimi i standardeve tuaja në shkolla për cilësinë dhe politikën e mbrojtjes së fëmijëve.

Mos zëvendësoni rolin dhe funksionin e shërbimeve shtetërore!
Çdo program për ndërhyrje në mbrojtje të fëmijëve, nuk duhet të zëvendësojë rolin dhe funksionin e shërbimeve ekzistuese shtetërore. Kjo çon në një marrëdhënie, ku institucionet shtetërore bëhen të varur ose joaktivë. Jini vigjilent për këtë. SMF-ja nuk duhet të ofrojë shërbime, deri në atë

pikë sa të marrë apo minojë pozicionin dhe autoritetin e shërbimeve të NMF-së ose strukturave të tjera shtetërore. Parimi bazë praktik është të punosh në bashkëpunim me shërbimet e tjera shtetërore, të përdorësh pushtetin e tyre legjislativ dhe proceset në ndihmën e fëmijëve dhe, njëkohësisht, t'u ofrosh ndihmën shërbimeve të tyre kur është e nevojshme.

Është e rëndësishme të mbani mend pikat e mëposhtme:

- × SMF nuk ka pushtet legjislativ të ndërhyjë për zhvendosjen e fëmijëve.
- × Vendosni kufij të qartë dhe mësoni se çfarë është dhe nuk është në mandatin tuaj.

F Shembull i një plani veprimi

Përshkrim i shkurtër i situatës

Një fëmijë raporton te ju se është rrahur nga prindi dhe ka frikë se do të rrihet prapë. Vitet e fundit, qysh nga vdekja e babait të fëmijës, familja ka jetuar në kushte të vështira. Bazuar në vlerësimin, rasti u klasifikua si **A(i)3** dhe **B(x)3**.

Drejtimet e planifikuara për ndërhyrje:

PROBLEMI QË KA LIDHJE ME MBROJTJEN	**A(i)**	**B(x)**
RREZIKU	3	3
VEPRIMI I MENJËHERSHËM	Vizita në familje	Vizita në familje
QËLLIMI	Ndalimi i ndëshkimeve të ardhshme	Lehtëso varfërinë

PROBLEMI QË KA LIDHJE ME MBROJTJEN	A(i)	B(x)
PLANET	Monitorim i vazhdueshëm dhe punë lidhur me aftësitë prindërore	× Ndihmë për të kontaktuar shërbimet sociale në bashki/ komunë si edhe për trainimin e nënës për të gjetur punë; × aktivizo mekanizmat e mbështetjes të rrethit familjar dhe komunitetit
KOHA/ PËRGJEGJËSIA	× Vizitë në familje një herë në javë nga SMF-ja × Rishikim i veprimit për një javë nga SMF-ja	Për tri javë dhe rishikoji pas dy muajsh
TREGUESIT / REZULTATI	Aftësitë pozitive të mamasë janë përmirësuar	Janë ulur problemet social-ekonomike në familje

Përmbledhje

Kur trajtoni një rast të vetëm kini parasysh:

× Punoni me mjete të bazuara në evidenca, si dokumente, raporte;
× Shënoni çdo informacion dhe çdo vendim të ndërmarrë;
× Vlerësoni çdo rast individualisht dhe reagoni sipas rastit; asnjë rast nuk është i ngjashëm me tjetrin;
× Përcaktoni synime të arritshme dhe realiste që e trajtojnë problemin brenda kontekstit të mjedisit të fëmijës;
× Përcaktoni një çast daljeje nga ndërhyrja dhe punoni për ta arritur atë;
× Fokusohuni në përgjigje të menjëhershme, sesa të përpiqeni të ndryshoni një problem kronik;
× Krijoni dhe përdorni sistemet e referimit, qeveritar, jo qeveritar;
× Fuqizoni mekanizmat ekzistuese për mbrojtjen e fëmijës dhe burimet vetëmbrojtëse te vetë fëmija;
× Kuptoni se jo të gjithë problemet e mbrojtjes mund të zgjidhen;
× Pëqendrohuni te fëmija dhe më pas punoni drejt periferisë;

- × Mos zëvendësoni rolin dhe përgjegjësitë e aktorëve të tjerë, si prindërit ose mësuesit;
- × Bëni mbledhje të rregullta koordinimi, për të siguruar pjesëmarrje dhe qartësimin e planit të veprimit;
- × Bëjani të qartë çdo aktori përgjegjësitë e tij/saj.

Parimet thelbësore në lidhje me aktivitetet e punës sociale, janë:

- × Respekt për interesin më të mirë të fëmijës;
- × Respekt për statusin emocional të personit;
- × Respekt për fshehtësinë e fëmijës dhe konfidencialitet;
- × Respekt për të drejtën e personit për të mos u përgjigjur;
- × Respekt për besimin fetar dhe mjedisin kulturor të personit;
- × Qartësi (me të rriturit dhe fëmijët) mbi objektivat;
- × Respekt për këshillimin e fëmijës dhe udhëzimet e intervistimit.

Pika kontrolli

Përpiquni t'u përgjigjeni pesë pikave të mëposhtme. Për të parë nëse përgjigjet tuaja janë të sakta, kthehuni në kapitujt përkatës.

1. Cilat janë gjashtë hapat e procedurës për veprimin në mbrojtje të fëmijëve?
2. Cilat janë çështjet kryesore që duhen pasur parasysh, përsa i përket konfidencialitetit të rastit?
3. Shpjegoni parimet kryesore që duhet të udhëheqin reflektimin dhe veprimet e ndërmarra në mbrojtje të fëmijëve?
4. Çfarë lloj ndihme mund t'i ofrohet Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve?
5. Çfarë janë ndërhyrjet me takt? Përse ato janë në favor të fëmijëve në shumicën e rasteve?

Moduli Praktik 1

Ushtrimet praktike të Modulit të parë, synojnë që t'ju pajisin me shprehitë e vlerësimit të nivelit të rrezikut të shqetësimeve të fëmijëve, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e tyre si dhe me shprehitë e zbatimit të metodologjisë së menaxhimit të rastit.

1 Shpresa dhe frika nga ky program trajnues

Qëllimi

× Të arrini rezultate objektive nga programi i trajnimit i propozuar në këtë Udhëzues Praktik.

Objektivat

× T'ju ndihmojë të arrini atë që shpresoni dhe prisni nga ky program trajnimi.
× T'ju ndihmojë të largoni ndonjë frikë apo shqetësim të lidhur me programin e trajnimit.

Kohëzgjatja

× 10 minuta

Materiali

× Ditari juaj për mbrojtjen e fëmijëve.

Procesi

1 Mendoni se çfarë rezultati prisni të arrini me këtë program trajnues.
2 Shkruani në ditarin tuaj me pak fjalë kyçe atë çfarë ju prisni të arrini.
3 Pasi të keni shkruar objektivat tuaja, identifikoni se cilat objektiva janë realiste dhe mund të arrihen me anë të këtij trajnimi brenda

kohës së planifikuar dhe cilat jo. Është e rëndësishme të qartësohen qysh në fillim këto objektiva, për të shmangur më pas pakënaqësitë dhe zhgënjimet.

4 Përsëritni të njëjtin ushtrim për frikën. Përpiquni t'u jepni zgjidhje ose përgjigje shqetësimeve, nëse është e mundur.

5 **PËR SHEMBULL:** Nuk kam kohë. Para se të filloni, reflektoni, kur dhe ku mund t'i gjeni njëzet, tridhjetë apo gjashtëdhjetë minuta për të punuar për detyrat e tua profesionale? Zgjidhni vendin dhe kohën. Përmbajuni programit.

6 **PËR SHEMBULL:** Nuk kam disiplinën e duhur për të punuar duke u bazuar vetëm në aftësitë e mia profesionale. Kërkojini dikujt tjetër ndihmë për ta kryer bashkë këtë program! Me siguri që ka dhe të tjerë që kanë të njëjtën vështirësi si ty!

7 Në fund të këtij programi trajnimi, kthejuni faqes së parë të ditarit tuaj për mbrojtjen e fëmijës për të parë nëse i keni arritur objektivat dhe nëse e keni larguar frikën/shqetësimet.

2 A është ky një shqetësim për mbrojtjen e fëmijës

Skenari I rasteve

Lexoni dhe mendoni për çdonjërin nga skenarët e mëposhtëm. Shfrytëzoni pyetjet për të parë se në çfarë niveli do ta kategorizonit ju çdonjërën prej situatave, ku:

1 = PAK SHQETËSUESE; 7 = SHUMË SHQETËSUESE.

Renditini ato sipas problematikës nga **1** deri te **7**.

Për çdonjërin nga skenarët e mëposhtëm, bëjini vetes pyetjet në vijim:

× A është ky një problem mentaliteti apo shqetësim që lidhet me mbrojtjen e fëmijës?
× Kush është shkaku i shqetësimit?
× Cila është viktima e mundshme?
× A mund të bëhet ndonjë gjë? Si? Çfarë? Pse?
× Për kë jeni të shqetësuar? Pse jeni të shqetësuar për ta?
× A duhet të ndiqni procedura për raportimin e shqetësimeve të brendshme dhe të jashtme?

SKENARE	RENDITE 1-7
SKENARI 1: "Z. Bardhyl" është një nga mësuesit më të mirë dhe më të vjetër. Ai ka ftuar në shtëpinë e tij disa prej fëmijëve të cilëve u ka dhënë mësim. Njëri prej fëmijëve ju rrëfen se ai bën imazhe pornografike me fëmijët.	.....
SKENARI 2: Dy fëmijë jetojnë me pjestarët e një familjeje të madhe. Juve ju ka rënë në sy se ata trajtohen si shërbëtorë dhe nuk i lënë të shkojnë në shkollë. Fqinjët i kanë parë të rrihen këta fëmijë.	.....
SKENARI 3: Në një prej vizitave që ju bëni në shkollë, një adolescent ankohet se drejtori i shkollës e ka prekur atë dhe djemtë e tjerë në mënyrë të papërshtatshme. Kur ia thoni drejtorit këtë ai nervozohet dhe ju kërkon t'ia thoni se cili prej djemve ua tha. Ai thotë emrin e djalit që mendon se jua tha dhe ju paralajmëron se ai sajon gjithnjë historira, pasi nuk është mirë mendërisht.	.....
SKENARI 4: Një anëtar i personelit pedagogjik, kërkon disa ditë pushim se do martohet. Ju e uroni atë. Më pas merrni vesh se nusja e tij është katërmbëdhjetë vjeçe.	.....
SKENARI 5: Jeni SMF e re në shkollë. Një kolege ju thotë diçka që ju shqetëson. Ajo thotë se "nëse do që të mbijetosh këtu, duhet të bësh seks me Koordinatorin e psikologëve. Ai përpiqet me të gjitha të rejat. Përndryshe, të nxin jetën."	.....
SKENARI 6: Njëri prej nxënësve në shkollë, ju tregon se ka pranë një familje që e lidh fëmijën me zinxhirë në shtëpi. Ata thonë se fëmija është i pushtuar nga shpirti i keq dhe nuk ka mënyrë tjetër për ta kontrolluar. Fëmija që jua tregon këtë, ka muaj që e di dhe, megjithëse familjes së atij vetë i vjen keq, nuk mund të bëjnë asgjë apo të ndërhyjnë.	.....
SKENARI 7: Ka thashetheme se fëmijët e rrugës në qytetin tuaj, nxiten që të bëjnë seks me turistët. Keni parë disa herë burra, të cilët i çojnë fëmijët në lokale për pije ose akullore.	.....
SKENARI 8: Një anëtar i personelit pedagogjik në shkollë po rreh një fëmijë. Ai përdor një shkop për të goditur fëmijën, sepse nuk ka bërë detyrat.	.....
SKENARI 9: Gjatë një vizite në familje, ju shihni babain tek rreh fëmijën e vogël me rrip lëkure. Fëmija është shumë i stresuar dhe është gjakosur në shpinë dhe këmbë.	.....
SKENARI 10: Gjatë një vizite në klasë, vëreni se disa fëmijë janë me rroba të pista dhe duken të palarë.	.....
SKENARI 11: Një mësues dëgjon një thashethem se pjesëtari i ri i personelit pedagogjik, i cili është bërë mësues kujdestar, e ka lënë punën e parë në rrethana të çuditshme. Thashethemet flasin për sjellje të papërshtatshme me fëmijë nën moshë në fshatin ku punonte më parë.	.....

SKENARE	RENDITE 1-7
SKENARI 12: Gjatë një vizite në familje shihet që fëmijët kanë të enjtura dhe shenja në trup e në duar. Fëmijët duken sikur janë rrahur. I ati thotë se në Bibël shkruhet se “kush kursen drurin, llaston fëmijën”.	.....
SKENARI 13: Një fëmijë në komunitetin tuaj, i cili ka vështirësi në mësime, është lënë në kujdesin e gjyshes. Fëmijës nuk i jepet asnjë mundësi të shkollohet apo të fitojë shprehi të pavaruara për jetën.	.....
SKENARI 14: Një mësues të thotë se një koleg në klasë, u kërkon para nxënësve që të kalojnë klasën me nota të mira.	.....
SKENARI 15: Një nxënës në gjimnazin tuaj ju thotë se e ka parë mësuesen e shkencave sociale tek po puthte një nxënëse të vitit të dytë në një lokal afër shkollës.	.....
.....	A ju vete mendja për një skenar tjetër që do e rendisnit te 3
.....	Mendoni për një skenar tjetër që do e rendisnit te 5
.....	Mendoni për një skenar tjetër që do e rendisnit te 7

3 Model për analizimin e rastit

Qëllimi

- Të lidhen konceptet teorike të zhvillimit të fëmijës, mbrojtjes së fëmijës dhe analizës së rastit të vetëm.

Objektivat

- Të inkurajohet përdorimi i modeleve dhe koncepteve psiko-sociale në punën e përditshme me fëmijët.
- Të zbatohet një model sistemik (kompleks) dhe ekologjik për analizën e rastit të vetëm.

Çështjet kyçe mësimore

- × Fëmijët me të cilët punoni kanë anë pozitive dhe aftësi të natyrës psikologjike dhe sociale.
- × Perceptimi juaj për fëmijën, mund të jetë i ndikuar nga përvojat e fëmijërisë suaj.
- × Duke u përpjekur të përqendrohemi më shumë te anët pozitive dhe tërësia e aftësive, sesa në vështirësitë e fëmijës, ne mund të ndikojmë pozitivisht në procesin e zhvillimit, të përforcojmë aftësitë ekzistuese dhe të zhvillojmë aftësi të reja.

Kohëzgjatja

- × 45 minuta

Materialet

- × Ditari juaj për mbrojtjen e fëmijëve
- × Lapsa me ngjyra.

Procesi

1. Lexoni rastin e studimit te **3 a**.
2. Vetëm pasi t'ju jesh përgjigjur pyetjeve në **3 a**, shko më tej dhe lexo **3 b**.
3. Kur t'i jesh përgjigjur **3 b**, vetëm atëherë kalo te **3 c**.
4. Pasi të mbarosh nga **3 a** në **3 c**, plotëso analizën e plotë të situatës në **3 d**.

3 a **Studimi i rastit: Alketa**

Imagjinoni një mësues që vjen te ju me informacionin e mëposhtëm:
Vëzhgimet e mësueses: Mësuesja ka vënë re se Alketa rri shpesh vetëm gjatë pushimeve të orëve të mësimit, mungesat e saj në shkollë, janë bërë më të shpeshta, megjithatë ajo vazhdon të jetë e mirë në mësime, prandaj mësuesja nuk është marrë me të. Mësuesja po mendonte të bisedonte me mamanë e Alketës, e cila duket shumë miqësore në takimet me prindër.

Por një ditë mësuesja vuri re se Alketa ishte shumë e paqartë gjatë orës së mësimit, kishte vështirësi në përqendrim, dukej në një gjendje shumë të keqe dhe shumë melankolike. Ajo rrinte shumë më e tërhequr se zakonisht nga fëmijët e tjerë dhe duart i dridheshin. Kur mësuesja iu drejtua asaj, ajo sikur kishte frikë nga njerëzit.

Cila është çështja kryesore që duhet trajtuar?

.....

Çfarë hapash do të ndërmerrnit? Ju lutem, mendojeni dhe shkruajeni në ditarin tuaj.

3 b **Tani që mësuesja ka mbledhur më shumë informacion për Alketën vjen te ti për një takim të dytë.**

JETA FAMILJARE: Alketa është një vajzë 15 -vjeçare. Ajo ka 6 vëllezër dhe motra. Babai i saj është i papunë dhe e kalon një pjesë të mirë të kohës në lokalet e lagjes. Mamaja e saj punon sanitare. Ajo nuk paguhet shumë, por të paktën familja ka të ardhura të qëndrueshme. Alketa është një nxënëse e mirë dhe dëshiron të bëhet një ditë mësuese. Shpesh ajo mungon në shkollë, pasi i duhet të kujdeset për motrat dhe vëllezërit e vegjël. Familja e saj jeton në një shtëpi të vogël, vetëm dy dhoma për tetë vetë. Alketa ka marrëdhënie të mira me nënën e saj dhe kujdeset me dashuri për motrat e vëllezërit. Me raste, babai vjen në shtëpi i dehur dhe e rreh të ëmën, por asnjëherë fëmijët. Në ato çaste, Alketa është e frikësuar dhe gjithmonë bie në gjumë duke qarë.

Cila është çështja kryesore për t'u trajtuar?

.....

Çfarë hapash do të ndërmerrnit? Ju lutem mendojeni dhe shkruajeni në ditarin tuaj.

3 c **Ju e ftoni Alketën për një takim me ju, që të mund të flasë për problemet e saj dhe ky është informacioni që keni marrë:**

Alketa është një vajzë e ndrojtur, tip i mbyllur, por me karakter shumë të fortë dhe një vajzë e sigurtë në vetvete. Edhe pse situatat familiare nuk janë të lehta, ajo është një njeri i përgjegjshëm dhe plot shpresë për të ardhmen e saj. Ajo do të jetë mësuese e gjuhës shqipe për të huajt një ditë ose të ikë jashtë shtetit për studime. Asaj nuk i mbetet shumë kohë për të bërë detyrat e shtëpisë, pasi i duhet të bëjë punët e shtëpisë dhe të kujdeset për vëllezërit dhe motrat e vogla. Por ajo ka një metodë të mirë të mësuari dhe është e aftë t'i planifikojë gjërat më parë. Një ditë, gjatë rrugës për në shkollë, ajo u sulmua nga dy djem. Ata e kishin ndjekur atë për shumë kohë, duke u tallur me mënyrën se si ajo ishte

veshur. Dy djemtë i kërkuan lekë dhe e kërcënuan me thika. Ajo vrapoi gjatë gjithë rrugës për të arritur sa më shpejt në shkollë. Ndjehej e frikësuar dhe e shqetësuar. Ajo mezi mbante të qarët dhe s'dinte si të kthehej shëndoshë e mirë në shtëpi.

Cili është shqetësimi kryesor që duhet trajtuar?

.....

Çfarë hapash do të ndërmerrnit?

3 D **Bazuar në tre burimet e informacionit që keni më sipër, plotësoni modelin e plotë të analizës së situatës.**

Analiza e situatës:

1 Emri i fëmijës: Alketa
2 Mosha e fëmijës: 15
3 Gjendja mendore e Alketës?
   - a E qetë
   - b E shqetësuar
   - c E frikësuar
   - d E ndrojtur
   - e Melankolike/E tërhequr
   - f Probleme në sjellje
   - g Pasive
   - h E lumtur
   - i Të tjera

4 Vëzhgimet paraprake:
   - a Reagimet fizike:
   - b Ana mendore kognitive/Të menduarit:
   - c Emocionet:
   - d Sjellja:

5 Dëmtimet fizike që mund të ketë:
JO ⁘ **PO** ⁘
PËRMENDI: .....

6 Çfarë shënimesh janë marrë dhe çfarë veprimi është bërë, nëse ka dëmtime fizike?
- × Fakte:
- × Thënie nga fëmija, raportuesi apo prindi
- × Fotografi
- × Raport mjekësor
- × Veprimi:
- × Dërgimi në spital
- × Të tjera …

7 Kërcënime të drejtuara ndaj fëmijës dhe familjes?
JO ⁘ **PO** ⁘ / **JEP DETAJE:** .....

8 A është fëmija i frikësuar nga ndonjë prind apo tjetër njeri?
JO ⁘ **PO** ⁘ / **JEP DETAJE:** .....

9 Çështje të tjera familjare dhe psiko-sociale
- **a** Dhunë në familje
- **b** Abuzim me alkoolin
- **c** Ndarje e prindërve/Konflikt në familje
- **d** Varfëri
- **e** Vdekja e një prindi/kujdestarit
- **f** Probleme mendore të një prindi/kujdestari
- **g** Sëmundje të prindit apo të një pjesëtari të familjes
- **h** Histori të kaluara të abuzimit… arsyeja e detajuar dhe organizatat e përfshira:

10 Çështjet sociale
- **a** Fëmija nuk ka çertifikatë lindjeje
- **b** Fëmija nuk ndjek shkollën
- **c** Çështje punësimi
- **d** Detaje të tjera

11 Cilat janë nevojat e tanishme të Alketës:
- × Materiale:
- × Sociale:
- × Psikologjike:

12 Si mund të përforconi aftësitë ripërtëritëse të Alketës?

Identifikoni faktorët mbrojtës

Kush janë kujdestarët parësorë të Alketës? Citoni tre njerëzit më të rëndësishëm në jetën e saj dhe vizatoni rrjetin social të saj.

BURIMET E BRENDSHME (KOGNITIVE DHE EMOCIONALE):

.....

BURIMET E JASHTME: .....

13 Çfarë duhet bërë për të përforcuar zhvillimin psiko-social të Alketës?

SYNIMI: .....

OBJEKTIVI: .....

Strategji për të përmbushur objektivin (çfarë veprimesh do të ndërmerrni? Me kë? Kur? Si?

.....

.....

Kjo është një histori e trilluar, që shërben si studim rasti.

Ajo duhet të tregojë:

1. Se sa komplekse janë zakonisht situatat dhe sa e nevojshme është të reflektohet në mënyrë kritike;
2. Se përshtypja jonë e parë, shpesh na drejton në informacionin e fshehur;
3. Se na nevojitet informacion nga burime të shumta, përpara se të nxjerrim përfundime;
4. Se duhet të pyesim gjithnjë fëmijën dhe të inkurajojmë angazhimin e tij;
5. Si të punojmë duke u bazuar në anët pozitive dhe aftësitë ekzistuese të fëmijës, me qëllim që të ndihmojmë atë.

3e **Rast studimi individual**

1 Tani, mendoni për një fëmijë me të cilin po punoni e që këto javë ka qenë një rast i vështirë për ju. Shkruani emrin e fëmijës në një rreth, në mes të faqes së letrës.

2 Mendo për aftësitë psikologjike që zotëron fëmija (përdorni një laps me ngjyrë për të shënuar këto aftësi).

3 Pasi të mbarosh së menduari, klasifikoi aftësitë psikologjike në dy kategori: aftësi kognitive dhe emocionale.

4 Tani përcaktoni rrjetin social të fëmijës (përdor një laps me një ngjyrë tjetër). Vizatoni rrjetin social të sigurisë, duke lidhur me vijë të gjithë personat e përfshirë me njëri-tjetrin në formën e rrjetës së merimangës. Përdorni lapsa me ngjyra të ndryshme për të treguar: kontaktin e shpeshtë, kontaktin konfliktual, kontaktin e rëndësishëm. (Vini re: kontaktet më të shpeshta mund të mos jenë gjithmonë ato më të rëndësishmit. Nga ana tjetër, ndikimi i kontaktit konfliktual, mund të varet në shkallë të madhe nga shpeshtësia e kontaktit).

5 Qarkoni 3 kujdestarët më të rëndësishëm të atij rrjeti social (ky mund të jetë një bashkëmoshatar, një prind, një anëtar tjetër i rrethit familjar, një mësues etj., bazuar në moshën e fëmijës dhe strukturën e tij sociale.)

6 Lexoni kapitujt Dy dhe Tre të Manualit për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkolla.

7 Përgatit një raport mbi fëmijën, bazuar në informacionin që keni mbledhur.

8 Caktoni një objektiv dhe zgjidhni një strategji për të përforcuar aftësitë mbrojtëse të fëmijës, për një periudhe jo më pak se dy javë. Mbani shënim sa herë punoni me këtë fëmijë, çdo gjë që vëzhgoni dhe reflektojeni këtë gjë te fëmija, për të përforcuar tek ai sjelljet pozitive. Ndiqni vëzhgimet tuaja dhe i raportoni kur bëni analizën e rastit tuaj. Tregoni vëmendje ndaj ndërveprimeve mes jush dhe reagimeve të fëmijës, mjedisit dhe masave të ndërmarra. Analizojini kur të nxirrni përfundimet e raportit tuaj.

Përmes këtij ushtrimi ju mund të shmangni dalngadalë perceptimin tuaj të gabuar dhe të përqendroheni në sjelljet ose çështjet problematike, tek anët pozitive dhe aftësitë e fëmijës.

2 Shprehitë dhe kompetencat profesionale për menaxhimin e rastit

Kapitulli i dytë përqëndrohet në përmirësimin e shprehive dhe kompetencave të profesionistëve, të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e rastit.

2.1 Hyrje

Ndërtimi dhe zbatimi i planit të veprimit në mbrojtje të fëmijëve, mund të krahasohet me procesin e zgjidhjes së problemeve. Për këtë arsye, përpiquni të mendoni në atë mënyrë që të çon drejt zgjidhjes, sa herë që planifikoni veprime dhe qëndroni fleksibël për t'iu përshtatur ndryshimeve. Jeta e një fëmije nuk është një problem statik, por si peshku në ujë, fëmija është gjithmonë në lëvizje dhe pluskim, i ndikuar nga fluksi i personave të rinj që hyjnë në jetën e tij apo nga fluksi i personave të tjerë që largohen, duke qenë kështu i ekspozuar ndaj përvojave dhe ngjarjeve të reja në jetë, që kërkojnë përshtatje dhe aftësi për t'u përballuar.

2.2 Koncepti i “skema e ndërhyrjes” [1]

Siç dhe është theksuar në kapitujt e mëparshëm, para se të ndërmerret apo jo një veprim, ne duhet të kemi parasysh pasojat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës.

Gjatë procesit të organizimit dhe zbatimit të një plani veprimi në mbrojtje të fëmijëve, **tre hapat** e mëposhtëm do t’ju orientojnë në procesin e reflektimit, të vendimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve:

- **VËZHGIMI:** Të jeni të informuar për tre filtrat: neurofiziologjikë (5 shqisat), social-kulturore dhe ato të përvojës jetësore.
- **ANALIZIMI:** Nevojat (materiale, sociale, psikologjike), burimet (të brendshme dhe të jashtme) të të gjithë njerëzve të përfshirë dhe identifikimi i faktorëve mbrojtës ekzistues apo pikave të forta.
- **NDËRMARRJA E VEPRIMIT:** Krijimi i një plani veprimi, që përcakton qartë synimin, objektivat dhe strategjinë me hapa të detajuar mbi mënyrën si të përmbushim objektivin dhe si të arrijmë një rezultat të kënaqshëm.

2.3 Perceptimi

A Hyrie

Përpara se Specialisti i Mbrojtjes së Fëmijëve të ndërmarrë ndonjë veprim, është e rëndësishme të pyesë: “Si e shikoj unë këtë situatë?” Njohuritë dhe përvoja juaj, mënyra juaj e të kundruarit të realitetit dhe ndodhive në jetë, do të ndikojnë në interpretimin tuaj të situatës së fëmijës dhe, për rrjedhojë, edhe mbi vendimet dhe veprimet tuaja.

Është e rëndësishme të jeni të ndërgjegjshëm për mënyrën tuaj të perceptimit, vlerat dhe besimet tuaja dhe mbase, për t’i ndryshuar dhe modifikuar këto të fundit asisoj, që të jeni në gjendje të reagoni më ndryshe dhe sa më përshtatshëm në situata të caktuara që do të ndeshni si dhe të përmbushni detyrën tuaj në interesin më të lartë të fëmijës.

Konteksti ose mjedisi ka gjithashtu ndikimin e vet në perceptimin tuaj. Për të pasur një vizion të plotë të situatës, detajet nuk janë të mjaftueshme. Jini vigjilent dhe përpiquni të krijoni një ide sa më përfaqësuese të situatës.

1 Vëzhgimi, dëgjimi dhe komunikimi, tre kushtet paraprakë të çdo ndërhyrjeje. Udhëzues për instruktorin, Terre des hommes, 2006, Gjenevë.

Dhe, para së gjithash, jini të hapur, përpiquni të zbuloni dhe vëzhgoni, jo gjithmonë e kuptoni menjëherë situatën. Ndiqni me kujdes ndjenjat tuaja, emocionet dhe reagimet kur punoni për një rast.

Kini parasysh:
Mënyra se si e sheh botën, ndikon në botëkuptimin tuaj dhe, si rrjedhim, edhe në mënyrën se si do të reagoni për situatën.

- × Përballë një situate, është e rëndësishme të gjeni kohën e nevojshme për të vëzhguar dhe më pas të merrni një vendim dhe të reagoni.
- × Është e rëndësishme të MOS filloni me pyetjen PSE? kur analizoni një situatë, sepse ajo të çon në interpretime, në vend që të kuptohen faktet.

B Shqyrtimi i ndërhyrjes (FIGURA 1)

Grackat që duhen shmangur:

1. Të shikosh dhe të veprosh = veprim pa u menduar …;
2. Të shikosh dhe të analizosh = vetëm teori, pa veprim, pa ndryshim;
3. Të analizosh dhe veprosh = zbatimi i modeleve që nuk përshtaten me situatën.

Këshilla për përdorimin e 5 pyetjeve
Për të analizuar një situatë, mund të ndihmojnë pyetjet e mëposhtme:

- × Kush?
- × Çfarë?
- × Kur?
- × Ku?
- × Pse? (e fundit! Sepse të çon në interpretime dhe jo në vëzhgimin e fakteve).

FIGURA 1



C

Tre filtrat e perceptimit [2]

Në vend që të shikojmë se çfarë ekziston në realitet, ne interpretojmë, pandehim, përgjithësojmë, gjykojmë, projektojmë përvojat tona, emocionet tona, dëshirat dhe frikën tonë. E perceptojmë realitetin nëpërmjet filtrave tanë, sikur secili prej nesh të kishte syze me ngjyra pak të ndryshme. Pasoja e kësaj është se nuk jemi në kontakt me REALITETIN! Ne jemi të prirur të filtrojmë vëzhgimet nëpërmjet skemave tona mendore. Nuk mund të SHIKOJMË se çfarë ka atje, sepse mendojmë se e DIMË para se të shikojmë!

FIGURA 2



2 Movement, Games and Sport Manual. Lausanne, Terre des hommes, 2006.

Strategji të suksesshme dhe të dështuara

STRATEGJITË E SUKSESSHME (VARIANTET KRIJUESE)	STRATEGJITË E DËSHTUARA (VARIANTET PA ZGJIDHJE)
× Nuk kam shikim objektiv. × I shikoj jetën, gjërat, njerëzit me syzet e mia me ngjyra. × Gjërave që vëzhgoj, u jap atë kuptim që ato kanë për mua. × Jam njëqind për qind krijues i realitetit që mendoj se vëzhgoj. × Ajo që është e vërtetë për mua, nuk është domosdoshmërisht e vërtetë dhe për të tjerët. × Kam prirjen të mendoj se di, ndërsa në realitet, unë nuk di. × Gjithmonë mund të zgjedh t'i shikoj gjërat nga një këndvështrim tjetër. × Është më e lehtë të modifikojmë perceptimin tonë për të tjerët, sesa të ndryshojmë të tjerët.	× Ajo që shikoj, është e vërtetë për të gjithë. × Ajo çka di, është e vërtetë për këdo. × Çfarë ndjej, është e vërtetë për këdo. × Çfarë mendoj është e vërtetë. × Gjërat janë vërtet siç i shoh. × Nëse ti nuk i shikon gjërat në mënyrën time, atëherë do të thotë se ti i sheh gabim.

2.4 Komunikimi

A **Hyrie**

Kur kryhen ndërhyrje, ju duhet të punoni me aktorë të ndryshëm ose mjedise të larmishme, nivele të ndryshme arsimore, njohuri të mirë të rastit e të fëmijës. Është e rëndësishme që SMF-ja të analizojë mekanizmat e tij/saj të komunikimit dhe ta përshtasë stilin e tij/saj të komunikimit në përputhje me nivelin e personave me të cilët punon.

Komunikimi kërkon që mezazhet të dërgohen dhe të merren me të njejtën përgjegjësi. Nëse ka ndonjë keqkuptim, nuk është faji as i njërit, as i tjetrit. Dëgjimi aktiv është një mjet i fuqishëm për SMF-në, sepse ai bën të mundur që të gjithë aktorët e tjerë të kuptojnë shqetësimet dhe ndjenjat e SMF-së për rastin.

Njeriu nuk dëgjon vetëm me veshë, por edhe me sy, shpirt, trup dhe zemër.

B Komunikimi universal



Çfarë ju duhet për të komunikuar?

- × Të jeni (zemra) = kapaciteti për të përjetuar ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve, besimi, çiltërsia, respekti.
- × Të shihni (me sy) = vëzhgimi.
- × Të dëgjoni (veshët) = vëmendje, përqendrim.
- × Të flisni (goja) = qartësia, saktësia.

C Strategji të suksesshme dhe të dështuara

STRATEGJITË E SUKSESSHME (VARIANTET KRIJUESE)	STRATEGJITË E DËSHTUARA (VARIANTET PA ZGJIDHJE)
× Mund të flas vetëm për veten = Unë-mesazhi (Jo: ne …). × Ndodh të kesh mundësi dhe ndjenja të ndryshme dhe ta respektosh ende tjetrin. × Pa respektuar tjetrin, nuk mund të ketë komunikim të vërtetë. × Ne gjithmonë komunikojmë, në mënyrë verbale, ose joverbale. × Mesazhi i vërtetë mund të jetë i ndryshëm nga ai që thuhet me fjalë: 25 për qind është verbal dhe 75 për qind joverbal. × Informacioni i dhënë nga qëndrimi dhe sjellja, është zakonisht më i drejtë, sesa ai i shprehur me fjalë. × Para se të jap një përgjigje, unë marr mesazhin. × Dëgjimi është po aq i rëndësishëm sa edhe shprehja e mendimeve të mia dhe unë kam 50 për qind përgjegjësi për çdonjërën prej tyre.	× Kur përballem me një mendim të ndryshëm, diskutoj, justifikohem, gjykoj, jap këshilla, ndjehem i kërcënuar, etj. × Nëse dua që të tjerët të më dëgjojnë, duhet të bërtas më shumë se të tjerët. × E di ku qëndron problemi yt. × Nuk kam kohë të të dëgjoj. × Po UNË, UNË, UNË?

D

Të dëgjuarit aktiv

Zakonisht, mendojmë se dëgjojmë vetëm me veshë, por dëgjojmë edhe me sy, mendje, trup dhe zemër. Të gjitha cilësitë e një dëgjuesi të mirë të shënuara më poshtë, ndihmojnë folësin të shprehë mendimet dhe ndjenjat e vërteta, dhe kjo ndërton një marrëdhënie mirëbesimi.

Kjo është një teknikë që mund të përdoret në rrethana të veçanta; për diskutim problemesh, zgjidhje konfliktesh, situata të vështira (trauma, trishtim, zemërim, etj.).

1 Të ulurit ballë për ballë

× Gjej një vend të qetë dhe çlodhës.
× Përdor shprehje të mira për ta inkurajuar personin.
× Krijo siguri tek personi tjetër.

2 Shikimi

× Mbaj kontakt me sy
× Vëzhgo gjuhën e trupit.
× Vëzhgo shprehjet e fytyrës.

3 Dëgjimi

× Dëgjo me kujdes.
× Kupto dhe riformulo.
× Kërko sqarime.
× Mbështete me komente.

4 Respekti

× Trego interes të vërtetë.
× Ji i sjellshëm dhe i respektueshëm.
× Përqendrohu.

5 Ndjenja

× Ji i durueshëm dhe tolerant.
× Ji i ndjeshëm.
× Ruaj konfidencialitetin.
× Beso se te çdo njeri ka diçka të mirë.

E Strategji të suksesshme dhe të dështuara

STRATEGJITË E SUKSESSHME (VARIANTET KRIJUESE)	STRATEGJITË E DËSHTUARA (VARIANTET PA ZGJIDHJE)
× Të besosh ✔✔✔✔✔ × Të njohësh ✔✔✔✔✔ × Të ndihmosh në identifikimin e emocioneve të thella ✔✔✔✔ × Të riformulosh ✔✔✔ × Të marrësh mesazhin ✔✔ × Të jesh i pranishëm, ta kuptosh tjetrin, të krijosh besim ✔ × Të mbash kontaktin me sy të dëgjosh me qetësi …	× Të ndërpresësh, të jesh i paduruar, egocentrik × Të sigurosh, të minimizosh, të mohosh × Të analizosh, të interpretosh, të krahasosh × Të shpjegosh, të japësh këshilla, të sugjerosh zgjidhje × Të vuash, të reagosh emocionalisht × Të pyesësh në mënyrë të pasjellshme × Të mohosh, të përligjësh, të luftosh × Të kritikosh, të gjykosh

F Fëmijët dhe komunikimi

Në kulturën tonë fëmijët nuk lejohen të shprehin atë që ata mendojnë. Të rriturit mendojnë se fëmijët duhet vetëm të shohin por jo të dëgjojnë! Ka vetëm pak ambiente miqësore për fëmijët ku ata mund të shprehen lirshëm dhe hapur.

Kini parasysh se fëmijët duan t'i bëjnë të rriturit të lumtur duke thënë atë që mendojnë se të rriturit duan të dëgjojnë. Kjo ndodh sepse fëmijët nuk mund të jetojnë të pavarur dhe kanë nevojë për prindërit që të mbijetojnë. Ata kanë nevojë për dashurinë dhe pranimin e të rriturve.

Megjithëse, ne kujtojmë se fëmijët nuk e dinë se çfarë ndodh përreth tyre, ata kuptojnë më shumë se çfarë mendojmë ne! Për shembull, Anila në rastin e përmendur më poshtë, e kuptoi se mamaja e saj donte që ajo të ishte një vajzë e mirë dhe ajo nuk mund të rrezikonte të humbiste dashurinë e saj, duke i thënë diçka të keqe për veten. Veçanërisht në situata të dhimbshme, fëmijët tremben mos lëndojnë prindërit, kështu që nuk flasin.

Nëse fëmijët nuk flasin hapur për dhimbjen e tyre, i mbajnë këto ndjenja në vetvete. Në të ardhmen këto ndjenja mund të shfaqen në të qëndruarit në vetmi, sjellje të çuditshme, agresivitet ose tërheqje.

G

Udhëzime për të dëgjuar dhe folur me fëmijët që janë psikologjikisht të stresuar[3]

Së pari, “bisedat mbështetëse” kanë rëndësi për të ndërtuar “raporte pune” mirëbesimi me fëmijën dhe familjet e tyre. Ato duhet të jenë baza nga ku do të nisin veprimet e tjera të ndërhyrjes.

Sigurisht, udhëzimet duhet të përshtaten sipas moshës së fëmijës. Edhe çështja e konfidencialitetit është e rëndësishme.

Si të gjitha udhëzimet, edhe këto nuk janë të plota. Të gjithë ne duhet të fitojmë përvojë me fëmijët që janë psikologjikisht të stresuar, që të mund t’i ndihmojmë të rriten pozitivisht. Ndaj, i shkruani mendimet tuaja, përvojat dhe vëzhgimet për t’i pasuruar këto udhëzime.

Dëgjimi i mirë i një fëmije të stresuar, arrihet në katër drejtime kryesore:

1. Të sillesh si dëgjues, si njeri që përjeton ndjenjat e fëmijës, kështu që tensioni emocional i fëmijës do të lehtësohet gradualisht.
2. Të thellosh kuptimin dhe njohjen e asaj që fëmija përjeton, ashtu siç fëmija i sheh gjërat me sytë e tij.
3. T’i japësh fëmijës ndjesinë se është “kuptuar”, se ndjenjat e tij/saj janë kuptuar. Mbase ai/ajo nuk ndjehet më vetëm, ndoshta ndjehet më i sigurtë dhe i lehtësuar.
4. Nëse je një dëgjues i mirë, të dëgjosh duke mbajtur një qëndrim të ëmbël, mund të sillesh si modeli i një personi të rëndësishëm në jetën e fëmijës, i cili mund të mos e ketë kuptuar nevojën e fëmijës për t’u dëgjuar, ngushëlluar.

Dëgjimi dhe biseda e ngrohtë, përfshijnë:

- × Njohjen e mënyrave se si fëmijët reagojnë ndaj humbjes, ndodhive stresuese, dhunës, shkatërrimit të familjes dhe ndodhive të tjera stresante.
- × Dëshirën e çiltër për të ndihmuar fëmijën dhe familjen në rrethana të tilla, pa qenë nevoja të marrësh rolin e prindërit apo të krijosh varësira.
- × Përqendrimin, qëndro gati për çdo nevojë të fëmijës.
- × Pranimin e gjithçkaje që thotë fëmija.
- × Gjuhën e thjeshtë: Përdor gjuhë të thjeshtë, bëj pyetje të shkurtra, si dhe shpjegimet të jenë të shkurtra dhe të thjeshta.

3 Ky seksion është bazuar në këto burime: Udhëzime mbi dëgjimin dhe bisedat me fëmijët të depresuar psikologjikisht. Save the Children Norvegji.

- Konfidencialiteti: Fëmija duhet të dijë se nuk do të zbulohet identiteti i tij/saj, do të mbahen sekretet, por se ka dhe një kufi për konfidencialitetin.

Kur fëmijët gënjejnë për veten

Shkaku kryesor që fëmijët gënjejnë për të kaluarën e tyre është se kanë arsye për ta bërë këtë gjë.

Nuk është e pazakontë për fëmijë të pashoqëruar, të thonë gënjeshtra për veten dhe të kaluarën e tyre. Kjo ndodh shpesh sepse fëmija ka frikë se mos e kthejnë me forcë, nga një gjendje relativisht e mirë materiale, në familjen e tij ku ai e di se jeton në varfëri. Mund të ndodhë që familja e ka keqtrajtuar apo braktisur atë, dhe natyrisht që ai/ajo nuk ka dëshirë të kthehet mbrapsht, ose dhe mund të ndihet i pasigurt nga mënyra se si do ta presin.

Fëmijët që thonë gënjeshtra mund të dallohen, sidomos kur e kanë për herë të parë. Nëse dyshon për këtë, ose e di me siguri kush janë ata, lëri të mendojnë se ti e di që ata kanë frikë të thonë të vërtetën, se është e kuptueshme, dhe ftoji të diskutojnë nga se kanë frikë. Mos u bëj presion që të thonë të vërtetën, mos shfaq mëri, as mos bëj rolin e hetuesit. Përkundrazi, mund të përsërisësh me një gjuhë të thjeshtë disa nga arsyet e sipërpërmendura, sepse fëmijët kanë në përgjithësi frikë të thonë të vërtetën, për shembull, “mbase ti ke frikë nga kjo apo ajo gjë”. Lëri fëmijët të kuptojnë se kur të mendohet një plan ndërhyrjeje, dëshirat e tyre do të merren në konsideratë (në pajtim edhe me Konventën e të Drejtave të Fëmijës).

Lotët

Gjatë bisedave të ngrohta, ka gjasa që fëmija të fillojë të qajë kur tregon çfarë i ka ndodhur. Në këto çaste ka rëndësi t’u vihet veshi mirë fjalëve të tyre. Qetësojeni fëmijën, duke e përkëdhelur dhe duke ia shtrënguar lehtë dorën. Ndonjëherë fëmijët ndjehen shumë të vetmuar dhe papritmas shpërthejnë, në këtë çast kanë nevojë të mbështeten diku. Ji i ndjeshëm ndaj gjuhës trupore të fëmijës. Për disa fëmijë, të cilët kanë kaluar gjëra shumë të rënda, është kërcënuese t’i prekësh, mund të prekësh lehtë një pjesë të rrobave për të krijuar lidhje.

Gjatë pushimeve që do të ketë fëmija, mund t’i thuash gjëra si: “më vjen keq të dëgjoj këto që po thua”.

Duhet ta dini se lotët shpesh i shqetësojnë njerëzit, shumë mendojnë se e kanë bërë fëmijën të qajë. Në të vërtetë, këta lot kanë qenë aty për një kohë të gjatë, por në formë "ngrirjeje të thellë". Shpërthimi në lot në praninë e një dëgjuesi të ndjeshëm dhe miqësor, është pjesë thelbësore për çlirimin e tensionit të fëmijës dhe në këto rrethana ato nuk janë të dëmshëm. Ajo çka nuk pranohet, është të lësh një fëmijë të qajë, të qeshësh kur ai qan apo ta tallësh në ndonjë farë mënyre. Ajo që pranohet plotësisht, është forca terapeutike në çaste të tilla. Mos komento mbi lotët, por mund të ndihmosh fëmijën, duke ia fshirë ato, një formë tjetër kjo për të krijuar kontakt dhe t'i japësh mbështetje.

Gjatë kësaj faze, fëmija ka nevojë për kohën e vet, do të qajë, do të flasë, do të bëjë pak pushim. Pasi të jetë ulur pjesa më e madhe e tensionit, zakonisht ndodh që fëmija e rifiton ekuilibrin e tij.

Mos ndërpre

Kur ndërpret një fëmijë, shpesh bën që ky i fundit të heshtë dhe të fillojë të dyshojë nëse ka thënë gjënë e duhur. Prit derisa fëmija të ketë një qetësim natyral dhe atëherë sqaroji pikat që kërkon të kuptosh më qartë: "këtë doje të thoje?", "po pastaj çfarë ndodhi?" etj.

Ndjenja e fajit

Nëse mendon se është koha e duhur dhe nëse fëmija të ka dhënë arsye të dyshosh, se ai/ajo mund të ndjehet fajtor në disa drejtime ose veprime, fillo të kërkosh me kujdes për këtë. Për shembull, dikush mund të thotë: "Duket sikur ti mendon shumë për të shpëtuar veten, kurse të tjerët jo?" ose "ndoshta ti mendon se, nëse nuk do të kishe bërë diçka, gjërat do të ishin ndryshe."

Kjo mund t'i japë fëmijës mundësinë të ketë një perceptim më real të ndjenjave të tij/saj të fajit, mbase mund të ndihmohet të shikojë krejt ndryshe veprimet e tij/saj.

Ndjenja e zemërimit

Zemërimi dhe dëshira për hakmarrje, mund të shprehen shpesh. Prano gjithmonë, mos bëj moral. Ndonjëherë, shprehja e një urrejtje të thellë dhe dëshira për të vrarë, janë i vetmi mjet mbrojtës që i ka mbetur fëmijës. Nuk do të thotë se ai/ajo do të kërkojë ta zbatojë. Por, po qe shumë e thellë, edhe mund të ndërhyjë në aftësinë e tij/saj për të përballuar dhimbjen dhe përvojën e hidhur.

Mungesa e shprehjes së ndjenjave ose mohimi
Ndonjëherë fëmijët mund të duken shumë të pikëlluar, emocionalë, apatikë, por nuk shprehin asnjë ndjenjë. Për t'i bërë të besojnë se ti je në anën e tyre, për t'i ndihmuar të shprehin atë që ndjejnë, mund t'u drejtohesh me fjalët si: "Them, se po të më kishte ndodhur mua kjo gjë, unë do të ndjehesha …"

Nxit vetëshërimin
Kur është e mundur, lëvdoji fëmijët sinqerisht për akte trimërie, inkurajoji përpjekjet e tyre për vetëshërim. Shpesh fëmijët mund të tregojnë akte të pabesueshme kurajoje dhe logjike.

Ndryshimi i perspektivës
Kur duket se pjesa më e ngarkuar e intervistës ka mbaruar, mund të fillosh të ndihmosh fëmijën të shohë ndodhitë që ai/ajo ka përjetuar në një këndvështrim më të gjerë dhe të tregosh se si e perceptojnë të tjerët atë situatë.

Si të veprosh nëse fëmija nuk do që të bashkëpunojë me ty?
Fillimisht, të jesh gati ta dëgjosh apo t'i japësh ndihmë në çdo kohë. Mos impono ritmin tënd mbi fëmijën, jepi kohë të fitojë besimin te ti!

Pjesëmarrja e fëmijës është e rëndësishme në ndërhyrjet e gjata. Ki durim.

Bën përjashtim vetëm ai rast kur ekziston një rrezik i menjëhershëm për sigurinë dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës!

Kur një fëmijë merr inisiativën të kërkojë shërbime psiko-sociale, SMF-ja duhet të kuptojë detyrimin për të respektuar të drejtat e fëmijës për të nisur, për të marrë pjesë ose për t'i ndërprerë me dëshirën e tij shërbimet. Kur inisiativën për shërbime psiko-social e merr një palë tjetër, SMF-ja duhet të sigurojë që fëmija të marrë pjesë vullnetarisht në to.

Është e vështirë të vendosësh rregulla të prera dhe të menjëhershme; çdo bisedë që bëhet me fëmijën që ka kaluar një përvojë stresuese, duhet t'i shërbejë nevojave të fëmijës dhe jo ta fusë atë në një situatë më të rëndë se e mëparshmja. Ji i sinqertë dhe i vërtetë (ashtu siç je, në të vërtetë), fëmijët janë të ndjeshëm ndaj kësaj.

H **Intervistimi i fëmijës: Gjërat që duhen mbajtur parasysh para, gjatë dhe pas intervistës:**

Para se të intervistoni një fëmijë, sigurohuni se:

- × Keni caktuar objektivat personale për ato që doni të arrini.
- × Kini parasysh se si përvojat e mëparshme mund të ndikojnë në perceptimin tuaj.
- × Të keni një dhomë të këndshme dhe të rehatshme (sigurohuni se nuk do të ndërpriteni apo t'ju tërheqë vëmendjen dikush), uluni përballë fëmijës që të keni kontakt me sy me të.
- × Të përdorni një intervistë të strukturuar ose gjysëm të strukturuar.
- × Të mbani mend e të ndiqni rrjedhën e bisedës (dëgjoje fëmijën dhe lëre të drejtojë bisedën).
- × Kini parasysh ndryshimet kulturore.

Gjatë intervistës:

Një intervistues i mirë ka dy cilësi:

- × Është dëgjues i mirë;
- × Është vëzhgues i mirë.
  - × Krijoni një marrëdhënie besimi (shpjegoji fëmijës kush je, merr miratimin e tij/saj dhe dëshirën për të marrë pjesë, shpjego se ç'është konfidencialiteti dhe çfarë janë kufijtë e tij.
  - × Kushtojini rëndësi, jo vetëm asaj që thuhet, por edhe mënyrës se si thuhet dhe shprehet (toni i zërit, mënyra e të folurit, gjestet, shprehjet).
  - × Një dëgjues i mirë nuk përqendrohet vetëm te fëmija, por edhe te vetja.
  - × Kushtojini rëndësi faktit se intervista është një proces ndërveprimi dhe se ju po ndërveproni me fëmijën (në mënyrë verbale dhe jo verbale), kini parasysh se mund ta lehtësoni procesin për interesin më të mirë të fëmijës.
  - × Kontrolloni reagimet e tuaja.
  - × Ndërsa fëmija flet, duhet të jeni të vetëdijshëm edhe për vlerat, standardet dhe nevojat e tuaja.
  - × Nëse merrni shënime, jini i saktë, ose regjistrojini, nëse fëmija e miraton.
  - × Jini i vetëdijshëm për aftësitë e tuaja të komunikimit (nëse po flisni me zë të lartë, qetë, shpejt, ngadalë, me fjali të shkurtra, pyetje të mbylluara apo të hapura).

- Bëni pyetje të shkurtra e të hapura, që të merrni sa më shumë informacion pa e ndikuar fëmijën.
- Kur ndeshni kontradikta në ato çka thotë fëmija, përpiquni ta kuptoni.
- Ndërkohë që intervista vazhdon, perceptimi/përshtypja juaj e parë ndryshon. Kini parasysh të nxisni te fëmija qëndrime pozitive dhe të forta, aftësitë e tij përtëritëse. Theksoni atë që thotë fëmija. Përdorni metodën e reflektimit (përsëritni çfarë thotë fëmija, për shembull: "Po thua se …"; përmblidhni dhe qartësoni ato çka thotë ai).
- Vëzhgoni sjelljet joverbale.
- Përshtateni veten me fëmijën, tregohuni i natyrshëm dhe origjinal.
- Menaxhojeni kohën (intervistat shumë të shkurtra ose shumë të gjata, ndikojnë në raportin mes jush).
- Menaxhoni periudhat e heshtjes; lejoni çaste heshtjeje.
- Falënderoni, vlerësoni dhe caktoni një intervistë tjetër.

Pas intervistës: Analizë kritike e informacionit

- A u ndje fëmija mirë dhe i sigurtë gjatë intervistës?
- A i arritët objektivat e caktuara më parë?
- A ka informacion të rëndësishëm që duhet shkruar në raportin për fëmijën?
- A ka nevojë të përshtatet apo ndryshohet plani i veprimit?
- Si ndjeheni pas kësaj interviste? Çfarë ndjenjash apo emocionesh keni?
- Përmblidheni intervistën, vendosni datën dhe vendoseni te dosja e fëmijës.

2.5 Nevojat dhe burimet e personit [4]

A **Hyrje**

Masat në mbrojtje të fëmijës, duhen marrë në bazë të nevojave e duke patur parasysh idetë e humanistit A. Maslov, i cili e sheh çdo njeri si aktor të jetës së tij dhe të aftë të bëjë zgjedhje e të ndërmarrë iniciativa. Prandaj, një fëmijë është i aftë të zhvillojë aftësitë e tij dhe të luajë një rol aktiv për të arritur mirëqenien e tij. Kur fëmijët janë të shoqëruar nga të rritur, të cilët dinë se si t'ia japin mbështetjen e tyre psikologjike dhe se si të krijojnë një mjedis inkurajues për fëmijën, fëmijët mund të zhvillojnë aftësitë e tyre ripërtëritëse dhe të tregojnë një aftësi më të madhe në përballimin e stresorëve të jetës. Kujdesi për mirëqenien psiko-sociale të fëmijëve, është një investim i madh në kapitalin njerëzor. Ai forcon të gjitha proceset e tjera të nevojshme për zhvillimin dhe stabilitetin e shoqërisë.

B **Burimet e një personi**

LIDHJET	AKTIVITETET	ASPEKTI
Familja	Shkolla	Besimet
Shokët/shoqet	Puna	Vlerat
Udhëheqës të komunitetit, udhëheqësit fetarë	Aktivitetet zbavitëse	Kultura
Idhujt	Aktivitetet ditore	Etj.
Mësuesit	Sporti	-

Këto tre dimensione formojnë ushqyesit themelorë psiko-socialë për zhvillimin e mirëqenies së fëmijës.

4 Movement, Games and Sport Manual. Lausanne, Terre des hommes, 2006.

c Nevojat e personit

Ç'kuptojmë me fjalën nevojë?
Nevoja është ajo që i duhet një personi që të rritet, zhvillohet dhe të bëjë një jetë të kënaqshme dhe të shëndetshme.

Nevojat bazë për mirëqenien psiko-sociale të fëmijës, janë parashtruar në Seksionin A të Manualit për Mbrojtjen e Fëmijëve. Ato ndahen në tre lloje, të treja të ndërvarura dhe njëlloj të rëndësishme: nevoja materiale, sociale dhe psiko-sociale. Nëse plotësohen nevojat materiale, ato do të ndikojnë në mirëqenien e fëmijës, ndonëse jo kurdoherë "në mënyrë të dukshme". Shumica e ndërhyrjeve ndikojnë mbi nevojat psiko-sociale dhe për to lipset edhe mbështetja e organizmave shtetërore dhe e OJF-ve, për të siguruar mbështetjen materiale, ligjore dhe mjekësore.

Mirëqenia psiko-sociale e fëmijës, zhvillohet duke inkurajuar kapacitetin e tij për të realizuar plotësisht potencialet e tij përmes tre nevojave themelore: individuale, sociale dhe ekzistenciale. Këto nevoja "të padukshme", si dhe nevojat materiale për ushqim dhe strehë, duhen plotësuar që fëmija të mund të rritet dhe të përparojë.

Nevojat psiko-sociale mund të ndahen në tre kategori:
- **Nevoja individuale:** zhvillim personal, pohim i identitetit, vetafirmim;
- **Nevoja sociale:** përkatësia në një grup social, afirmimi në grup, përgjegjësitë;
- **Nevoja ekzistenciale:** feja, besimi, kuptimi i jetës.

Aktivitete psiko-sociale synojnë në nxitjen e zhvillimit të fëmijëve:
- Dëshira **për të ekzistuar** (identiteti), duke plotësuar nevojat individuale. Këto lidhen me nevojat e tyre për dashuri, vetafirmim, siguri dhe mbrojtje. Nxitja e kësaj ane emocionale, ndihmon fëmijët të krijojnë besim te të tjerët dhe te vetvetja.
- Dëshira **për të vepruar**, duke plotësuar nevojat sociale. Këto janë nevoja që lidhen me kufizime, rregulla, kërkesa, urdhëra, autoritet, etj. Nxitja (e kushtëzuar) e kësaj ane normative, ndihmon në zhvillimin e shprehive sociale, si bashkëpunimi, pasurimi i dijeve, menaxhimi i shqetësimeve psikologjike, që vijnë si pasojë e situatave bllokuese, njohja me ligjet dhe mësimi i një profesioni.

× Dëshira **për të jetuar**, duke plotësuar nevojat **ekzistenciale**. Këto lidhen me nevojën për të patur një projekt dhe vizion për jetën, për të kuptuar qëllimin e jetës, rolin e tyre në botë. Inkurajimi i anës së kuptimit (besimit), ndihmon të zhvillohet ndjenja e përkatësisë dhe e përgjegjësisë së tyre për të përcjellë vlera universale.

Nevojat bazë

MATERIALE	PSIKOLOGJIKE	SOCIALE	SHPIRTËRORE
Të marrësh ushqim	Të të duan	Të kesh familje, miq	Të kesh një qëllim në jetë
Të kesh një strehë	Të të njohin	Të kesh profesion, të kesh aftësi	Të gjesh kuptimin e jetën tënde
Të jesh i mbrojtur	Të kesh identitet, vetëvlerësim dhe koncept për veten	Të jesh i integruar në shoqëri, t'i përkasësh një grupi, një komuniteti	Të besosh në diçka
Të marrësh kujdes mjekësor	Besim, atashim	Të jesh i pavarur dhe i përgjegjshëm si qytetar	-
etj.	etj.	etj.	etj.

D **Veprimet për mbrojtjen e fëmijës, bazuar në nevojat dhe burimet e fëmijës**

Për të ndihmuar të tjerët, duhet të kuptojmë personin, familjen ose grupin me të cilin punojmë. Pjesë e njohjes së një personi, është të njohësh funksionin e tij psiko-social (për më shumë informacion, shih seksionin A të Manualit për Mbrojtjen e Fëmijëve për shkollat), që është i zakonshëm për të gjithë njerëzit si dhe mjedisin e tyre kulturor dhe familjar, po ashtu edhe për historinë e jetës individuale.

Objektivi ynë me fëmijët është të ndihmojmë rimëkëmbjen e tyre ^ psiko-sociale dhe zhvillimin, duke stimuluar:

× Nevojat **individuale**: Dashurinë, ngrohtësinë, besimin te vetja, sigurinë, identitetin (ana psiko-sociale).
× Nevojat **sociale**: Të qenit pjesë e një grupi, që ka rregullat dhe kufizimet e veta, të mësosh si të jetosh dhe të bashkëpunosh me të tjerët, të marrësh role dhe përgjegjësi brenda komunitetit, etj. (ana sociale dhe normative).

- Nevojat **për mbijetesë**: Të kesh një projekt në jetë, rol, vlera dhe besime, etj. (ana shpirtërore).

Nëpërmjet identifikimit të nevojave dhe burimeve te një fëmije dhe të mjedisit të tij, krijojmë një bazë të domosdoshme për të trajtuar çështjet thelbësore, përmes një reagimi të përshtatshëm në mbrojtje të fëmijës.

METAFORË: "Historia e majmunit dhe e peshkut".
"Majmuni pa një peshk që po notonte. Ai nuk e dinte se peshku e pëlqente ujin. Atij iu dhimbs peshku dhe e hoqi nga uji, duke menduar se do të mbytej. Por peshku ngordhi. Majmuni qau dhe tha se vetëm donte ta ndihmonte",

E

Nga roli i ndihmuesit në atë të mbështetësit

- Të gjithë veprimet duhet t'i korrespondojnë nevojave të fëmijës;
- SMF-ja duhet të bëjë një plan veprimi për burimet ekzistuese dhe faktorët mbrojtës dhe më pas të përcaktojë dhe përforcojë burimet e tjera të mundshme;
- SMF-ja duhet të mbështesë iniciativat që ndërmerr një fëmijë dhe ta shikojë veten më shumë në rolin mbështetës, sesa në atë drejtues kur punon për fëmijët;
- SMF-të duhet të krijojnë një mjedis miqësor për fëmijën, të tillë që e favorizon procesin e të mësuarit të fëmijës përmes përvojave të tij (provë dhe gabim) dhe sipas ritmit të tij të të mësuarit.

Roli juaj me fëmijët
Ajo që ju jepni, është "ndihma e parë" psikologjike, këshillim dhe udhëzim. Ka një numër komponentësh në këtë punë; fillimisht, ju mund të jeni personi i parë që mund të njihni një problem të rëndë mendor. Së dyti, mund të ndihmoni fëmijët, adoleshentët dhe familjet e tyre, të rilidhen me rrjetin e tyre social, pjesën tjetër të familjes, fqinjët dhe komunitetet. Kur e ndjeni se fëmija mund të jetë duke përjetuar ndonjë lloj frike, mund t'i ofroni ndihmë. Ju mund t'i jepni të kuptojë se e njihni gjendjen e tij. Mund të jeni në një pozicion ku mund t'i ofroni mbështetje prindërve të fëmijës, familjes ose kujdestarëve, të cilët do ta ndihmojnë fëmijën. Gjithashtu, mund të jeni njeriu i parë që e kaloni kohën duke dëgjuar një fëmijë apo adoleshent të flasë për stresin e vet. Siç do të përmendet edhe më pas në këtë kapitull, ju mund të bëni ndërhyrje të thjeshta.

2.6 Menaxhimi i emocioneve[5]

A **Hyrje**

Është e rëndësishme që Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve të kuptojë funksionin e secilit prej katër emocioneve bazë dhe si t'i menaxhojë ata te vetja dhe me fëmijët. Çdo emocion është i dobishëm dhe ka një funksion të caktuar, të lidhur me situatën aktuale. E mira e do të mos grumbullohen emocione negative, ato duhen shprehur sa më parë që të jetë e mundur. Çdo emocion duhet të shprehet në mënyrën e duhur dhe në çastin e duhur. Është e rëndësishme të njihen këto emocione, të identifikohen nevojat që fshihen pas tyre dhe të shikohet se si mund të plotësohen ato, duke formuluar një kërkesë për personin e përfshirë apo dhe për vetë ju. Duke mos qenë në gjendje të flasësh për atë që po vuan, mund të çojë në sjellje të çuditshme, si mbyllja në vetvete, vetmia dhe agresiviteti. Çdo njeri ka mënyrën e vet të të shprehurit të emocioneve: duke shkruar, duke vizatuar, duke luajtur sporte të ndryshme, etj., por një mënyrë efikase është të flasësh me dikë që ke besim. Higjena emocionale është po aq e rëndësishme sa ajo fizike; fëmijët duhet të mësohen si të menaxhojnë emocionet e tyre.

B **Katër emocionet bazë**

Të gjitha emocionet janë të dobishme dhe gjëja më e mirë është t'i njohësh dhe t'i pranosh ato. Nuk duhet t'i mësojmë fëmijët vetëm me higjenën fizike, por edhe me atë psikologjike dhe emocionale. Të njohim emocionet tona bazë, funksionin e tyre dhe si të sillemi kundrejt tyre, është po aq e rëndësishme, si të lahesh apo ushqehesh siç duhet.

5 Manuali i lëvizjeve, lojërave dhe sporteve. Lozanë, Terre des hommes, 2006.

	PSE ËSHTË E DOBISHME?	SI TË JETOJMË NË MËNYRË TË SHËNDETSHME?	SHEMBUJ ME FËMIJË
FRIKA Nevoja për t'u bindur, për t'u qetësuar	Paralajmërim kur ka rrezik. Duhet të largohesh për të shmangur kërcënimin. Është mbrojtje.	Ta lësh veten të dridhesh, të mos rrish vetëm, të jesh në gjendje të flasësh me dikë, të jesh në gjendje të kërkosh ndihmë. Sa më shumë të bëjmë atë çka duhet për të mbrojtur veten nga frika, aq më shumë mundësi kemi që ajo të zhduket. Por, sa më shumë ta fshehim frikën, aq më shumë e vendosim veten në rrezik. Frika përbën çrregullim kur vuajmë, por mund të jetë edhe një reagim normal dhe afatshkurtër për t'iu përshtatur një situate.	Për shembull, frikë nga errësira: "Nga se ke frikë?" "Nga tigri poshtë shtratit". "Nuk ka tigra në vendin tonë". Prindërit përpiqen ta racionalizojnë frikën, por kjo nuk ndodh. Në vend që të pyetet "Nga se ke frikë", mund të pyetet "çfarë mund të bëj për të të bindur, për të të qetësuar?" Fëmija është aktor, ka burimet dhe e di për çfarë ka nevojë (për shembull, t'i lexosh një përrallë, të lesh dritën ndezur, etj.)
INATI Nevoja për t'u respektuar.	Mobilizimi i energjive për të ndryshuar gjërat. Përballimi i një kërcënimi, sulmi. Për shembull: dikush më shkel këmbën, i bërtas ose e shtyj që të lëvizë. Tre burimet bazë të inatit: × Irritimi; × Ndërhyrja në territorin tonë; × Kur vihet në diskutim liria. Një inat funksional, është ai që zgjidh një problem. Një inat i çrregullt, është dhuna e pavend.	Nëse nuk e shpreh inatin, do të grumbullohet në trup dhe do të shfaqet në forma të ndryshme. Inati i grumbulluar shfaqet në forma, si ankthi, melankolia, faji… Ai kthehet drejt të tashmes. Është e rëndësishme të shprehet në çast. Mënyra më e mirë për të përdorur zërin, një ulërimë, shkarkim energjish, duke respektuar tre gjëra: Mos lëndo njeri; Mos lëndo veten; Mos thyej asgjë.	Për shembull: "mos u inatos dhe mos bërtit në publik, mami dhe babi nuk e pëlqejnë." Ne i mësojmë fëmijëve si ta mbajnë inatin, por jo si ta shprehin në mënyrë të shëndetshme.

	PSE ËSHTË E DOBISHME?	SI TË JETOJMË NË MËNYRË TË SHËNDETSHME?	SHEMBUJ ME FËMIJË
TRISHTIMI Nevoja për t'u ngushëlluar	Të pranosh çka nuk mund të ndryshohet. Reagimi i përshtatshëm kur përballesh me humbjen. Ndihmon të pranosh gjërat që nuk mund të ndryshojnë. Përfshin një lëvizje tërheqjeje, ndjenjë vetmie, ndihmon në rindërtimin e jetës pas një humbjeje. Është pjesë e procesit të dhimbjes.	Ta lësh veten të qash, të qash me dënesë, të thuash se ndjehesh keq, të përqafohesh nga dikush… Trishtimi kthehet në të kaluarën. Është i çrregullt kur projektohet në të ardhmen. Ndarja është pjesë e jetës, çdo ditë afrohemi me dikë dhe ndahemi e vuajmë. Mund të zërë më shumë ose më pak kohë, në varësi të njerëzve, por më e rëndësishme është të njohësh hapat e ndryshëm dhe t'i pranosh, janë reagime normale dhe të shëndetshme!	Procesi i dhimbjes: **1** Mohimi: i pamundur **2** Rebelimi, inati: pse më ndodhi mua? **3** Frika, dyshimet: çfarë do të bëj? Frika nga braktisja. **4** Trishtimi: depresioni, tërheqja, vuajtja, nevoja e një pranie, të folurit, dashuria… **5** Pranimi: t'i japësh dhimbjes një kuptim, jetës një kuptim të ri, ta rindërtosh. Të heqësh dorë, është mënjanim. **6** Falja …
GËZIMI Nevoja që të tjerët të të duan dhe të pranojnë.	Ndaj me të tjerët, jep energji dhe gjallëri. Ajo tregon që ke arritur një objektiv, që po përjeton një sukses. Ajo përfshin një proces hapjeje. Është magnet lidhjesh, marrëdhëniesh.	E rëndësishme për të ngulitur përvojën pozitive, që ndihmon në projektet e së ardhmes. Festo me të tjerët dhe mos mendo se çdo të vijë pas, qëndro me të tashmen. Vazhdo ta ndash me të tjerët; Prano të kënaqesh me ato që ke arritur; Jeto çdo çast më vete: projektin, realizimin, suksesin dhe kënaqësinë e suksesit.	Shembull: kur një fëmijë ia ka dalë mbanë të bëjë diçka dhe është krenar, lëvdoje, thuajua të tjerëve, ji krenar për të! Mos i thuaj se mbase nuk do t'ia dalë herën tjetër dhe se kjo është punë fati … Kushtoji rëndësi dhe festo suksesin e tyre, sado i vogël qoftë…

C Strategji të suksesshme dhe të dështuara

STRATEGJITË E SUKSESSHME (VARIANTET KRIJUESE)	STRATEGJITË E DËSHTUARA (VARIANTET PA ZGJIDHJE)
× Cilatdo qofshin emocionet e mia, janë të mira dhe të dobishme. × Nuk i interpretoj emocionet e mia, i ndjej, i dëgjoj. × Çdo ndjenjë e pakënaqshme lidhet me një nevojë të paplotësuar. × Emocionet vijnë e ikin, asnjëherë nuk ngecim në një emocion. × Mirëpriti, bëje lidhjen e tyre me nevoja të caktuara dhe shpreh një kërkesë.	× Të jesh emocional, është dobësi. × Të jesh emocional, do të thotë të kesh plot probleme. × Një burrë nuk qan. × Jam i fortë, nuk ndjej asgjë. × Kam frikë, turp, jam i trembur nga emocionet e mia. × Le ta analizojmë, duhet ta kuptoj

D Menaxhimi i stresit

Si të kujdesem për veten?

Kjo është një punë e vështirë. Mund të jetë më e vështirë se sa e kujton, të jesh dëshmitar i vuajtjeve të njerëzve të tjerë, sidomos fëmijëve. Fëmijët kanë një mënyrë të tyren për të ndikuar në kokën dhe zemrën tonë. Veç kësaj, mund të merresh me një problem personal/profesional tëndin. Është e rëndësishme që të kujdesesh për veten, të mos e gjesh veten papritur nën tension, presion apo stres. Sigurohu që të bësh mjaft pushim dhe të hash si duhet, të flasësh me kolegët, miqtë, familjen kur gjërat të mërzisin dhe jepi vetes kohën dhe lirinë për të pasur reagimet e tua emocionale. Nëse mendon se po bëhesh i mërzitshëm, s'ke gjumë, melankolik, i hutuar, ose ngaqë punon me orë të zgjatura, bëj pushim. Për çfarëdo që bën, ji krenar për veten dhe për punën që bën.

Çfarë duhet të përmbush unë si SMF?

Si një person mbështetës psiko-social, mund bësh dallime në një sërë mënyrash.

× Mund të referosh raste të rënda për trajtim profesional.
× Mund të ripërcaktosh rrjetet sociale.
× Mund të ndihmosh që të ruhen proceset normale të zhvillimit.
× Mund të ofrosh trajtim për disa simptoma.
× Dhe, më e rëndësishmja, mund të ofrosh një lloj ngushëllimi. Kjo nuk është pak.

Vetëvlerësimi
Të njëjtat cilësi që përdor për të dëgjuar të tjerët, janë të rëndësishme për të dëgjuar edhe veten tënde: lirshmëria, mosparagjykimi, vëmendja dhe kurioziteti. Si SMF, është e rëndësishme të dëgjosh veten dhe përvojat, sepse, sa më i vetëdijshëm që të jesh për nevojat, aftësitë, pikat e forta dhe problemet e tua, aq më mirë do të jesh në gjendje të kuptosh dhe mbështesësh të tjerët.

Si ta përballoj stresin?
Ka shumë mënyra të provuara që përdoren për menaxhimin e stresit. Ato mund të ndihmojnë të ruash qetësinë, të jesh efikas në situata mjaft të tensionuara dhe të ndihmojnë të shmangësh problemet e një stresi të gjatë.

Këto shprehi i përkasin tre grupeve kryesore:
- **Shprehi të orientuara drejt veprimit:** Me të cilat ne kërkojmë të përballemi me problemin që shkakton stres, shpesh duke ndryshuar mjedisin ose situatën;
- **Aftësi të orientuara drejt emocioneve:** Që nuk na japin fuqi për të ndryshuar situatën, por me to ne mund të menaxhojmë stresin, duke ndryshuar interpretimin tonë mbi situatën dhe mënyrën si ndjehemi; si dhe
- **Aftësi të orientuara drejt pranimit të faktit:** Kur ka ndodhur diçka mbi të cilën ne nuk kemi asnjë lloj pushteti apo kontrolli emocional e duhet të përqëndrohemi për t'i mbijetuar stresit.

Në varësi të rrethanave të dhëna dhe kontekstit, reagimi më i mirë mund të jetë të përshtatet një stil i caktuar veprimi, emocional ose pranimi të realitetit.

Lexo disa shembuj se si të tjerët e trajtojnë stresin e punës:
- **DIANA**, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve: "Zakonisht kur ndjehem e stresuar pas një dite të vështirë në punë, një nga mënyrat për ta kaluar këtë situatë, është të dëgjoj pak muzikë të lehtë.
- **ALKETA**, këshilluese psikosociale: "Ka lloje të ndryshme stresi dhe mënyra të ndryshme për ta menaxhuar. Pas një dite stresuese në punë, zakonisht dal me shoqen time të ngushtë dhe flas me të. Edhe ajo është psikologe."
- **FLORA**, specialiste për të rinjtë e komunitetit: "Kur jam e stresuar në

punë, shkoj në shtëpi e fle. Kjo është e vetmja mënyrë për t'u qetësuar pas një dite të lodhshme."

- × **ANISA**, nxënëse: "Shkoj në shtëpi dhe palos rrobat në dollap."
- × **ANISA**, nxënëse: "Zakonisht kur jam e stresuar, shkoj në shtëpi dhe qaj, megjithëse e di se nuk është kjo zgjidhja."
- × **VALBONA**, koordinatore rajonale e projektit: "Kur jam e stresuar në punën time, preferoj të dal për një shëtitje, një shëtitje të gjatë …"
- × **MUSINEJA**, mësuese: "Shumë shpesh, për të menaxhuar stresin, lexoj dhe dal të qetësohem."
- × **LUMTURIA**, mësuese: "E menaxhoj stresin duke menduar pozitivisht."
- × **VALENTINA**, prind: "Bëj biskota dhe ushqime të tjera për fëmijët e mi."
- × **DRITA**, prind: " Ftoj miqtë për të pirë kafe së bashku."
- × **ERVINA**, prind: "Kujdesem për lulet."
- × **ARMANDA**, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve: "Përpiqem të lexoj diçka që ka nevojë për vëmendje."
- × **LINDITA**, avokate: "E menaxhoj stresin duke shkuar në internet dhe kërkoj informacion."
- × **BLERTA**, Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve: "Zakonisht diskutoj me kolegët e mi."
- × **DANIELS**, psikolog shkolle: "Flas me dikë që më kupton."
- × **VIOLETA**, mësuese: "Këndoj ose bërtas në varësi të nivelit të stresit."

2.7 Drejtimi

A **Hyrje**

Një menaxher i një rasti parësor, ka detyrën dhe rolin e koordinimit të një veprimi të integruar për mbrojtjen e fëmijëve. Për të përmbushur detyrën e vet të përkujdesit, nevojitet stili i një drejtuesi, i cili ka besim në vetvete, për të koordinuar aktorët dhe veprimet e ndryshme që janë pjesë e një plani veprimi shumëdimensional.

B

Tipat e drejtuesit

	DIKTATOR	LIBERAL	DEMOKRATIK
ORGANIZIMI Hapësirë Kohë Ndërhyrje Materiale	× Organizon çdo gjë vetë. × Nuk jep asnjë alternativë. × …	× Le të tjerët të organizojnë gjithçka vetë. × …	× Përfshin fëmijët dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm në zbatimin e masave të mbrojtjes. × Ju jep përgjegjësi.
ANIMIMI Instruksione Veprime Komente	× Thotë çfarë duhet të bëjnë ose jo. × Flet vetëm për suksesin, ose dështimin e veprimeve.	× Nuk jep asnjë udhëzim për aktivitetin. × Asnjë koment. × Pranon çdo dëshirë të fëmijëve ose të tjerëve.	× Shkëmben mendime me fëmijët për vështirësitë. × Jep të dhëna dhe bën komente për të përmirësuar progresin dhe të mësuarit.
LIDHJA Sjellja Cilësia Njohuria Lehtësimi i shkëmbimeve	× Është shumë i ngurtë. × S'u lejon asnjë liri fëmijëve ose të tjerëve.	× Nuk shkëmben asnjë mendim me fëmijët. × Nuk ndihmon kur ka probleme. × Nuk ndihmon për të gjetur zgjidhje. × Nuk është nxitës.	× Dëgjon fëmijët. × Vendos kufij dhe i mbështet. × Përshtatet ndaj problemit specifik. × Inkurajon çdo fëmijë dhe prindërit. × Bashkëpunon me animatorët e tjerë.

Nga të tre stilet e drejtimit, Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve duhet të përshtasë sjelljen e një drejtuesi demokratik. Sigurisht, këto janë udhëzime të përgjithshme dhe është e rëndësishme të përshtasësh stilin tënd të drejtimit në një grup, në situatën e dhënë dhe të jesh në ndërveprim të shpejtë me çastin dhe situatën e dhënë.

c Shprehitë dhe kompetencat[6]

Të rriturit, të cilët janë ngarkuar të punojnë me fëmijët dhe familjet, duhet të kenë aftësi në katër drejtime kryesore.

1 SHPREHITË PERSONALE

- **Menaxhimi i emocioneve:** Të kuptosh emocionet e dikujt, të pranosh ndikimin e tyre në raportet me të tjerët, në rezultatet në punë dhe të dish si t'i shfrytëzosh ato.
- **Vlerësimi i vetes:** Ka një ndjenjë të fortë dhe pozitive besimi.
- **Njohja e vetvetes dhe vetëreflektimi:** Vlerëso realisht pikat e forta dhe të dobëta të vetvetes, mëso nga përvojat e tua dhe integroji në veprime të reja.
- **Siguria:** Trego ndershmëri, siguri dhe integritet në veprimet që bën.
- **I hapur ndaj ideve dhe përshtatshmëri:** Ji i hapur ndaj ideve dhe mënyrave të reja të menduarit, përshtatu me situatat e reja dhe kapërce pengesat.
- **Kërkesa personale:** Syno të arrish më të mirën për veten.

2 SHPREHITË SOCIALE

- **Udhëheqja:** Merr një pozicion në grup dhe drejtoje për një objektiv të përbashkët.
- **Motivimi:** Transmeto një ndjenjë angazhimi e kënaqësie nëpërmjet humorit dhe shkëmbimit të ideve.
- **Pedagogjia:** Inkurajo fëmijët dhe të rriturit të zhvillojnë aftësitë e tyre nëpërmjet komenteve konstruktive.
- **Komunikimi:** Jep mesazhe të shkurtra, të përshtatshme dhe bindëse.
- **Ndjeshmëria:** Ndje dhe kupto emocionet e fëmijëve dhe trego interes ndaj problemeve të tyre.
- **Dëgjimi dhe gatishmëria:** Dëgjoji nevojat dhe sugjerimet e fëmijëve e përpiqu t'i zgjidhësh.
- **Zgjidhja e konfliktit:** Merr në konsideratë palët e ndryshme dhe zgjidhi pozitivisht problemet e tyre .
- **Autoriteti i brendshëm (i lindur):** Përcakto rregulla e kufij të qartë dhe masa edukative, nëse nuk respektohen.
- **Krijimi i raporteve:** Mbaj marrëdhënie të mira me të gjithë fëmijët dhe kujdestarët parësorë.
- **Bashkëpunimi:** Nxit punën në grupe për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme me fëmijët dhe mes fëmijëve e të rriturve.

6 Movement, Games and Sport Manual. Lausanne, Terre des hommes, 2006.

3 SHPREHITË METODOLOGJIKE

- **Parashikim dhe përshtatje:** Përshtatu sipas llojit të situatës.
- **Objektivat:** Përcakto objektiva që zhvillojnë aftësitë mendore, psiko-sociale dhe fizike.
- **Vizioni i plotë:** Ki gjithmonë parasysh strukturën e plotë të ndërhyrjes.
- **Avancimi:** Drejtoji vazhdueshëm fëmijët dhe kujdestarët parësorë drejt realizimit të objektivave të vëna, nëpërmjet ndërhyrjeve të mirëstrukturuara dhe të planifikuara.
- **Pjesëmarrja:** Organizo ndërhyrje të atilla, që fëmijët dhe familjet t'i ndjejnë si të tyret dhe të bëhen pjesë e tyre.
- **Struktura e të mësuarit:** Alterno çastet e eksperimentimit me çaste reflektimi dhe komente, që i lejojnë individët të kenë përvoja pozitive dhe në përputhje me moshën.
- **Kreativiteti:** Ndrysho metodat e strategjitë në lidhje me objektivat dhe përshtati në lidhje me aftësitë dhe kompetencat e fëmijëve dhe përfituesve të tjerë.
- **Siguria:** Gjithmonë krijo kushte të sigurta, që të shmangësh aksidentet, dhunën apo shqetësimet.

4 SHPREHITË TEKNIKE

- **Analizimi i situatës dhe përpunimi i planit të veprimit:** Përgatit, përshtat të menduarit kritik dhe përqendrohu gjithmonë te fëmija. Organizo një plan veprimi me objektiva afatshkurtra, të mesme dhe afatgjata; integro diskutimet me personelin pedagogjik me ato të prindërve, për të krijuar lidhje logjike me mbështetjen e dhënë.
- **Ndërhyrje të vlefshme dhe të dobishme:** Duhet të dish të drejtosh një numër ndërhyrjesh dhe mjetesh, për të ofruar shërbimin më të mirë për çdo individ në nevojë për mbështetje.
- **Parandalimi:** Lidh lojërat dhe ushtrimet me aktivitetet psiko-sociale për të mbështetur të drejtat e fëmijëve për kujdesin shëndetësor, arsimim dhe çështje të tjera të që kanë lidhje me fëmijët.

Dhjetë këshilla si të punosh me fëmijët

1 JINI TË PRANISHËM

× Jini në kohë dhe gjithmonë aty atëherë kur thoni se do të jeni. Fëmijët duhet të besojnë te drejtuesi i tyre;
× Gjeni kohën për fëmijët. Nëse ju përgjigjeni: “Nuk kam kohë për këtë”, kuptohet sikur gjërat e tjera janë më të rëndësishme;
× Jini të pranishëm me fëmijët, vëzhgoni me kujdes.

2 KINI NJË PËRQËNDRIM POZITIV

a Përqëndrohu në atë që pëlqen te fëmijët, jo në atë që nuk pëlqen;
b Mbaj shënim përparimet që vë re te fëmija.

3 LËVDOJI DHE KUSHTOJU VËMENDJE

a Një përshëndetje, buzëqeshje apo shkelje syri, janë shenja kujdesi;
b Jini specifik në mënyrë që marrësi i mesazhit ta dijë se po lavdëroni atë;
c Jini të sinqertë me lëvdatat, gjestet do të tregojnë nëse po gënjeni.

4 TREGONI RESPEKT

a Përdorni fjalët si “të lutem” ose “faleminderit”, njerëzit ndjehen të pranuar dhe të vlerësuar;
b Jini të thjeshtë dhe mos mendoni se drejtuesi di gjithçka;
c Pranoni gabimet, ata janë njerëz, kërkoni falje dhe vazhdoni;
d Delegoni përgjegjësitë, tregojuni njerëzve se besoni tek ata;
e Pranoni dallimet dhe karakteristikat individuale. Lërini njerëzit të jenë vetvetja, nuk mund t’i pëlqejmë të gjithë, secili ka veçantitë e veta;
f Inkurajo njerëzit të flasin me njëri-tjetrin kur ka ndonjë problem. Mos lejoni që të flitet pas shpinës së tjetrit.

5 DËGJONI DHE BËNI PYETJE

a Të dëgjuarit tregon interes te njerëzit;
b Të dëgjuarit dhe të pyeturit të ndihmon të kuptosh nevojat e të tjerëve.

6 TREGO ENTUZIAZËM

a Entuziazmi e bën më të lehtë motivimin e fëmijëve, bëjini detyrat argëtuese;

b Mendimet pozitive, buzëqeshjet dhe entuziazmi, na bën të ndjehemi mirë neve dhe të tjerët.

7 SHFAQ EMOCIONET E TUA

a Shfaq emocionet e tua, pozitive apo negative dhe inkurajo të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë;
b Bëj gjëra të këndshme për të tjerët, inkurajo emocionet pozitive.

8 CAKTO OBJEKTIVA

a Cakto me fëmijët objektiva për të ardhmen;
b Të arrish objektivat, është një ndjenjë e mrekullueshme, na jep një ndjesi realizimi.

9 JINI TË QARTË ME RREGULLAT

a Vendos kufij, mos ki frikë të thuash JO;
b Nëse thyhen rregullat, duhet të jepen masa (sanksione);
c Jini të ndershëm.

10 ZGJIDHNI KONFLIKTET MIDIS PALËVE

a Përdorni komunikimin, në vend që të akuzoni njëri-tjetrin;
b Inkurajoni njerëzit të flasin për ndjenjat dhe reagimet e tyre;
c Dëgjoni të gjitha palët të përfshirë në konflikt. Kjo tregon se po i trajtoni të gjithë në mënyrë të barabartë.

2.8 Zgjidhja e konfliktit

A **Hyrje**

Sa herë që njerëzit ndërveprojnë me njëri-tjetrin, ka ndryshime në vlera, botëkuptime dhe mënyrat e reagimit ndaj situatave. Ndaj është e domosdoshme që Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve të ndihmojë dhe ndërhyjë në këto çaste sfiduese.

B **Katër qëndrimet ndaj konfliktit**

Ka mënyra të ndryshme për të reaguar ndaj një konflikti:

1. Sulmi (agresiviteti);
2. Mbathja (frika);
3. Indiferenca (plogështia);
4. Menaxhimi.

C **Përkufizimi i konfliktit**

"Konflikti është ndryshimi në mendim, që përfshin vlerat mes dy ose më shumë personave të karakterizuar nga tensioni, ngarkesat emocionale, mosmarrëveshjet dhe polarizimi, kur lidhjet prishen ose mungojnë".

Disa pika të rëndësishme për t'u pasur parasysh:

1. Mos e keqpërdor termin "konflikt" … Bëj dallimin midis:
   - × ndryshimit të opinionit, për të cilin mund të flitet, por është pa problem (na lejohet të mendojmë ndryshe dhe të kemi opinionin tonë);
   - × një problem që mund të trajtohet duke diskutuar, por nëse shpërfillet, mund të kthehet në konflikt;
   - × një konflikt që është hapi i dytë pas një problemi.
2. Mos kini frikë nga konflikti, është pjesë e jetës; është një mundësi për të mësuar për veten dhe të tjerët dhe t'i ndryshosh gjërat për më mirë në të ardhmen …
3. Para se të bësh ndonjë lloj diskutimi, zbut emocionet sipas mënyrës tënde. Përpiqu të mos reagosh "në çast'' …
4. Kujto se çdo sjellje e keqe (që mund të çojë në konflikt), fsheh një nevojë të paplotësuar, kështu që përpiqu të kuptosh çfarë fshihet pas, kontekstin, vëzhgo, analizo, pastaj merr vendimin dhe vepro …

D **Fazat e negocimit për zgjidhjen e konfliktit mes fëmijëve**

1. Ndaji të dy fëmijët nga njëri-tjetri;
2. Dëgjoje çdo fëmijë veçmas (lëri të qetësohen nga emocionet);
3. Mbaj lidhje të mira, duke u përpjekur të kuptosh pozicionin e tyre;
4. Ndaje problemin nga ai personal;
5. Identifiko nevojat dhe dëshirat e secilit nëpërmjet diskutimit;
6. Krijo një mirëkuptim dhe objektiv të përbashkët;

7 Sugjero mendimet dhe propozo;
8 Vër në dukje përfitimin reciprok;
9 Bëj kontratë me gojë;
10 Lidhja vazhdon ose përfundon në mënyrë pozitive.

2.9 Vetëvlerësimi

A **Hyrje**

× Nuk mund ta prekësh, por ndikon në mënyrën si ndjehesh.
× Nuk mund ta shikosh, por është aty sa herë shikon veten në pasqyrë.
× Nuk mund ta dëgjosh, por është aty sa herë që flet për veten.
× Çfarë është kjo gjë e rëndësishme, por e mistershme?

B **Çfarë është vetëvlerësimi?**

Për të kuptuar vetë-vlerësimin, duhet të ndash termin në dy fjalë. Le t'i hedhim një sy fjalës "vlerësimi", fillimisht.

× "Vlerësim" është fjala e imagjinuar për të menduar se dikush apo diçka, është e rëndësishme, apo i jep vlera personit ose sendit.
× Dhe "vetja" do të thotë, e po ti vetë je vetja jote!

Pra, kur i lidh këto dy fjalë bashkë, është më e lehtë të kuptosh vlerësimin e vetvetes. Do të thotë, se sa shumë e vlerëson veten dhe sa i rëndësishëm mendon se je. Do të thotë, si e sheh veten dhe si ndjehesh për arritjet e tua. Vlerësimi i vetvetes – nuk është të mburresh sa i mrekullueshëm je. Është më shumë të dish të vlerësosh veten (i çmueshëm, në të vërtetë). Nuk do të thotë të mendosh se je perfekt, sepse askush nuk është i tillë, por të dish që ke vlera, që të tjerët të duan dhe të pranojnë.

C **Pse është i rëndësishëm vetëvlerësimi?**

Vetëvlerësimi nuk është si një palë atlete të bukura, që do të doje t'i kishe, por që nuk mund t'i kesh. Gjithkush ka nevojë të vlerësojë veten.

Vlerësimi pozitiv i vetvetes është i rëndësishëm, sepse të ndihmon të mbash kokën lart dhe të jesh krenar për veten dhe gjërat që bën. Të jep

guximin të provosh gjëra të reja dhe fuqinë për të besuar te vetja. Të bën që të respektosh veten, edhe kur gabon. Dhe kur respekton veten, të tjerët të respektojnë reciprokisht.

Të vlerësosh mirë veten, është një biletë drejt zgjedhjeve të mira për trupin dhe mendjen tënde. Nëse mendon se je i rëndësishëm, ka më pak gjasa të ndjekësh turmën, nëse ajo bën diçka të rrezikshme apo të pamenduar. Nëse vlerëson veten, e di se je i zgjuar dhe merr vendimet e tua. Vlerëson sigurinë tënde, ndjenjat, shëndetin, gjithë veten! Vlerësimi i vetvetes të ndihmon të kuptosh se duhet të kujdesesh për çdo pjesë tënden dhe ta mbrosh atë.

D **Si e zhvillojnë fëmijët vetëvlerësimin?**

Kur lind një fëmijë, ai ose ajo nuk e gjykon veten për mirë apo për keq. Ata nuk mendojnë "jam i mrekullueshëm!", kur ai ose ajo gromësin, ose "kjo pelena ma bën këmbën të duket keq". Apo kur sheh veten në pasqyrë. Në të vërtetë, janë njerëzit që e rrethojnë fëmijën, ata që e ndihmojnë të zhvillojë vetëvlerësimin ndërsa rritet. Është ndërveprimi social që i jep formë vetëvlerësimit. Fillimisht, është vetëm familja e fëmijës ajo që e ndihmon për vetëvlerësimin. Ata mund të nxisin fëmijën kur ai përpiqet të ecë apo ta lëvdojnë kur e ha ushqimin. Ata kujdesen për të dhe e ndihmojnë sa herë ka nevojë. Veprimet dhe fjalët pozitive, e mësojnë të gjykojë se është i rëndësishëm dhe të ndjehet mirë. Megjithëse në moshë të njomë, fëmija mëson se është i vlefshëm dhe se e duan.

Kur fëmija rritet, shumë njerëz të tjerë hyjnë në jetën e tij, të cilët ia zhvillojnë vetëvlerësimin, si mësuesit, trajnerët, shokët e skuadrës, të klasës dhe shokë të tjerë. Ata i ndihmojnë fëmijët të mësojë gjëra dhe **të gëzohen** (përforcim pozitiv). Ata mund t'i ndihmojnë të kuptojë si të bëjë gjërat për veten e vet dhe të **vërejë cilësitë e mira** (njohja sociale). Ata mund të **besojnë tek ai/ajo** (supozim) dhe ta **inkurajojnë** të provojë përsëri (duke i dhënë të drejtën të bëj gabime dhe të mësojë prej tyre), kur nuk bën diçka mirë. Këta njerëz dhe këto aktivitete, i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë vetëvlerësimin dhe të jenë fëmijë që e shikojnë veten pozitivisht dhe të ndjehen krenarë për veten dhe për çfarë janë në gjendje të bëjnë.

E **Disa fjalë mbi vetëvlerësimin e ulët**

Mbase e dini se një fëmijë, i cili ka vetëvlerësim të ulët, nuk e vlerëson veten shumë dhe duket sikur e kritikon shumë atë. Ose, mbase, edhe ju keni vetëvlerësim të ulët dhe nuk ndiheni mirë me veten apo mendoni se nuk jeni i rëndësishëm.

Ndonjëherë një fëmijë ka vetëvlerësim të ulët, nëse e ëma ose i ati nuk e inkurajojnë sa duhet apo i bërtasin në shtëpi. Të tjera herë, vetëvlerësimi i fëmijës mund të lëndohet edhe në klasë. Një mësues mund ta bëjë fëmijën të ndihet budalla ose ka ndonjë të "fortë" në klasë, i cili i thotë gjëra që e lëndojnë. Mbase ndonjëherë në punën tuaj si mësues, SMF ose animator, pa dashje, e bëni fëmijën të ndihet i pavlerë.

Vetëvlerësimi i këtyre fëmijëve, do të përmirësohet kur një mësues, këshillues ose monitorues, mund t'i inkurajojë ata, të jetë i durueshëm dhe t'i ndihmojë të jenë mirë me mësime. Kur fillojnë të ecin mirë, bën përpara edhe vetëvlerësimi i tyre.

F **Rritja e vetëvlerësimit të fëmijëve**

Sigurisht që është normale të kesh ulje-ngritje të ndjenjave, por jo të kesh vetëvlerësim të ulët. Të ndihesh sikur je i pavlerë, mund ta bëjë një njeri të trishtuar dhe ta pengojë atë të provojë gjëra të reja. Ajo të mban larg shokëve të rinj apo të ecësh mirë me mësime në shkollë. Të kesh vetëvlerësim të lartë, ndikon në rritjen e fëmijës, ai përballon vendime të vështira, sidomos nën presionin e shokëve; sa më shumë vetëvlerësim të ketë, aq më mirë për të. Është e rëndësishme që fëmijët ta dinë se vlera e tyre është e madhe.

Disa nga gjërat që mund të bësh për të rritur vetëvlerësimin:

- × Ki parasysh se trupi është i yti, pavarësisht nga forma, masa, ngjyra (integriteti fizik).
- × Ki parasysh se ka gjëra që nuk mund t'i ndryshosh te vetja, si ngjyra e lëkurës dhe numri i këmbës dhe ti duhet t'i pranosh dhe t'i duash këto gjëra, sepse janë pjesa jote.
- × Sill ndërmend gjërat që janë të bukura te ti, për shembull, "këmbët i kam të fortë dhe mund të bëj patinazh shumë mirë."
- × Kur dëgjon komente negative, në mendjen tënde thuaji vetes mendërisht të ndalojë. Zëri kritik brenda teje, do të humbasë fuqi.

- × Bëji vetes tre komplimente çdo ditë. Mos i thuaj vetes thjesht “sa i mrekullueshëm jam!”. Ji specifik për diçka të mirë te vetja, si “U tregova një shok i mirë me Klajdin sot” ose “Dola më mirë se ç’e prisja te testi”. Para se të flesh çdo natë mendo tri gjëra që të bënë të lumtur gjatë ditës.

Duke u përqëndruar në gjërat e mira që bën dhe në cilësitë që ke, mëson të duash dhe të pranosh veten, dhe ky është kushti kryesor për vetëvlerësimin e lartë. Edhe pse ke vend për përmirësime (kush nuk ka), duke kuptuar se je i çmueshëm dhe i rëndësishëm, ndihmon vetëvlerësimin tënd të shkëlqejë.

2.10 Motivimi dhe pjesëmarrja

Si mund të përmirësoni motivimin e fëmijëve dhe kujdestarëve parësorë, për të marrë pjesë në aktivitetet dhe ndërhyrjet që keni planifikuar?

A Motivimi

PËRKUFIZIMI: Motivimi është një gjendje e brendshme, që e bën një person të përfshihet në sjellje të veçanta. Ai pasqyron konkluzionet dhe përkushtimet që bëjnë individët rreth origjinës së veprimeve të tyre.

SHPJEGIM: “I brendshëm” do të thotë se motivimi bëhet i fuqishëm në saj të emocioneve, është gjendje personale. Nuk ka receta magjike për të rritur motivimin e një grupi të tërë.

MOTIVIMI I BRENDSHËM: Një përvojë e këndshme, që rezulton nga një veprim që është në përputhje me vlerat vetërregullese dhe që ka një pavarësi të madhe nga mjedisi i jashtëm.

MOTIVIMI I JASHTËM: Pasqyron një përvojë aktive, që rezulton nga një veprim që është në përputhje ose jo me vlerat e që rregullohet nga mjedisi i jashtëm.

B

Motivimi rrjedh nga:

- × Objektiva specifike;
- × Objektiva të vështira, por të mundshme;
- × Objektiva të formuluar pozitivisht;
- × Objektiva të kuptueshme;
- × Objektiva të pranuara nga personi;
- × Objektiva që mund t'i arrijë personi i interesuar;
- × Objektiva që i përgjigjen një nevoje dhe interesi.

Faktorë të tjerë:

11 Qeniet njerëzore jo gjithmonë caktojnë objektiva apo arrijnë të tregojnë vetveten.

12 Njerëzit janë të motivuar për të ruajtur apo përmirësuar vetëvlerësimin (ndjenjën e të qenit kompetent, të arritjeve, etj.) dhe sensin e të qenit me vlerë (të qenët i dobishëm dhe i rëndësishëm).

13 Njerëzit janë të motivuar për të ruajtur dhe përmirësuar vetëqëndrueshmërinë (harmonia e veprimeve gjatë gjithë kohës).

14 Koncepti mbi veten formohet prej shumë identitetesh dhe rolesh.

15 Sjellja lidhur me konceptin për veten, nuk bazohet vetëm në pritshmëri, por në besim dhe dogmë.

MOTIVIMI = KOMPETENCAT X VLERA

C

Pjesëmarrja

Përkufizim: Veprimi i marrjes pjesë ose i përfshirjes në diçka në mënyrë të barabartë dhe me përgjegjësi të njëjtë.

Një model interaktiv mësimor, kërkon që nxënësit të marrin pjesë dhe të përfshihen aktivisht në procesin mësimor. Pjesëmarrja në mësim nuk është njësoj me ndjekjen e mësimit. Ndjekja e mësimit është thjesht prania në klasë, por nuk kërkon pjesëmarrje aktive.

Pjesëmarrja kërkon që çdo i ri të përfshihet aktivisht në procesin mësimor, që i jep më shumë kuptim aktivitetit mësimor dhe përvojës. Megjithatë, pjesëmarrja nuk është vetëm të flasësh në aktivitetet e kryera në grup. Kontributet e bëra nga të rinjtë, duhet të lidhen me përmbajtjen dhe kuptimin e diskutimit ose aktivitetit.

PJESËMARRJA RRJEDH NGA INTERESI X NEVOJA

Shembulli i Elonës
Babai i Elonës është matematicien dhe ajo mendon se është e rëndësishme të jesh e mirë në matematikë (vlerë e lartë). Por ajo nuk ka qenë asnjëherë e zonja me shifrat (kompetencë e ulët) dhe nuk i pëlqenin mësuesit e saj të matematikës. Prandaj asaj nuk i pëlqen të shkojë në orët e matematikës, ka frikë se nuk do të japë përgjigjen e duhur dhe do të ngelë në klasë.

Shembulli i Klodianit
Klodiani sheh shumë stacione televizive italiane dhe disa prej të afërmve të tij jetojnë në Itali. Ai e kupton shumë italishten (kompetenca të larta), por nuk mendon se është e rëndësishme të flasësh gjuhë të huaja, prandaj nuk është i motivuar për të folur apo përmirësuar aftësitë e tij.

Shembulli Blerta
Blertës i pëlqen të këndojë dhe ka zë shumë të mirë (kompetencë e lartë) dhe dëshiron që një ditë të bëhet këngëtare (vlerë e lartë). Prandaj, ajo është e motivuar të ndjekë mësimet në lëndën e muzikës, madje shkon edhe në kurse private me këngëtare profesionistë.

Shembulli i Alketës
Alketa është shumë kureshtare të dijë për kontrollin e lindjeve dhe të kuptojë më mirë transformimin e saj fizik dhe seksualitetin (interes i lartë). Gjithashtu, ajo ka nevojë të tregojë dhe të ndajë me të tjerët ndryshimet e shumta që po kalon (nevoja e lartë), prandaj ajo merr pjesë aktivisht në diskutimet në grup të përqëndruara te kontrolli i lindjes dhe shëndeti i grave (pjesëmarrja e lartë).

Shembulli i Ardianit
Ardianit i pëlqen të marrë mbi vete rreziqe. Nuk ka shumë frikë dhe “luan” të fortin. Zakonisht ai del vetë nga situata të rrezikshme ose e ndihmon ndonjë shok të dalë prej andej. Kur ndonjë mësuese flet për sjelljet e rrezikshme në klasë (nevojë e lartë), Ardiani nuk tregon shumë interes (interes i ulët) për të folur dhe nuk merr pjesë në diskutim mbi temën (pjesëmarrje e ulët).

D **Çfarë mund të bësh për të nxitur dhe gjallëruar pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë?**

Si i merr vendimet?

1. Vetë;
2. Asnjë vendim;
3. Kërkoj këshilla, por vendos vetë;
4. Konsultohesh, e kërkon zgjidhjen bashkë me të tjerë (tryezë e rrumbullakët dhe udhëheqje demokratike).

Pjesëmarrje e vërtetë, do të thotë integrimi i aktorëve kryesorë në të gjithë procesin, nga fillimi deri në fund, që prej planifikimit të ndërhyrjeve deri te vlerësimi!

- × Të japësh përgjegjësi;
- × Të dëgjosh dhe t'u përgjigjesh dëshirave dhe nevojave të tyre;
- × Lidhja e interesit me objektivat psiko-sociale;
- × Vlerësimi i talenteve dhe kompetencave;
- × Integrimi i fëmijëve në zhvillimin e aktiviteteve;
- × Dhënia e zgjidhjeve, mundësive të shumta;
- × Përcaktimi i një strukture dhe ambienti të qartë.

Përmbledhje

Kur planifikoni dhe zbatoni ndërhyrje në mbrojtje të fëmijëve, SMF-ja duhet të zbatojë gjithmonë skemën e ndërhyrjes:

- × Jini të ndërgjegjshëm për ndikimin e perceptimit dhe interpretimit që i bëni situatës ju dhe të tjerët;
- × Përshtatni mënyrat tuaja të komunikimit, sipas grupit me të cilin po punoni;
- × Dëgjoni fjalët e thëna, por edhe heshtjen mes fjalive.
- × Jini të ndërgjegjshëm për nevojat tuaja dhe gjithmonë kontrolloni çfarë roli luajnë emocionet në vendimet tuaja.
- × Të gjitha veprimet e ndërmarra, duhet të jenë një përgjigje për nevojat thelbësore të fëmijës.
- × Shikoni më mirë në pikat e forta, burimet e fëmijës dhe pranë tij, sesa tek problemet.

- Kontrolloni dhe koordinoni me një stil drejtimi demokratik, duke përfshirë fëmijët dhe kujdestarët kryesorë në proces, sepse ata duhet të ndjehen të përfshirë, përgjegjës dhe kështu do të zhvillohet fryma e angazhimit.
- Një konflikt është hapi i dytë pas një problemi, që duhet të zgjidhet dhe diskutohet.
- Është e rëndësishme të pranohet konflikti, të përballet, që të mund të menaxhohet pa iu shmangur apo pa e sulmuar.
- Konfliktet e fëmijëve janë shpesh mënyra për të tërhequr vëmendjen për një nevojë të paplotësuar (dashuri, pranim, etj).
- Zgjidhja e konflikteve kalon nëpër etapa të rëndësishme, si pranimi i emocioneve të tjetrit, dëgjimi aktiv, shprehja e nevojave dhe e kërkesave, konsensusi, etj.
- Përpiquni gjithmonë të merrni masa ndërhyrëse të përshtatshme, në varësi të moshës dhe situatës, që i lejojnë fëmijës të përjetojë sukses dhe përforcojë vetëvlerësimin..

Pika Kontrolli

Të kuptojmë përmbajtjen

Përpiqu t'iu përgjigjesh pesë pyetjeve të mëposhtme. Për të kontrolluar nëse po iu përgjigjesh pyetjeve saktësisht, kthehu te kapitujt përkatës.

1. Cilat janë tre hapat në konceptin e skemës së ndërhyrjes?
2. Çfarë do të thotë: "Ka gjithmonë një mënyrë për të komunikuar?"
3. Si mund t'i ndihmojmë fëmijët të shprehin emocionet e tyre?
4. Cilat janë cilësitë e një dëgjuesi të mirë?
5. Cilat janë hapat që duhen marrë për të menaxhuar një konflikt serioz midis dy fëmijëve?

Moduli Praktik 2

Ushtrimet praktike të Modulit 2, do t'ju ndihmojnë të zhvilloni aftësitë tuaja sipas skemës së ndërhyrjes dhe shprehitë e domosdoshme për menaxhimin e rastit.

1 Sjellja ndër mend e kujtimeve të fëmijërisë

Qëllimi

× Të tregohet se sa domethënëse janë përvojat tona të fëmijërisë kur punohet me fëmijët.

Objektivat

× Të ndihmon të kuptosh se si përvojat tuaja të fëmijërisë mund të ndikojnë në punën tuaj me fëmijët.
× Të përqendrohesh te fëmija dhe të ndryshosh perspektivën.

Pikat kyçe mësimore

Perceptimet tona rreth fëmijëve, fëmijërisë dhe ndjenjat mbrojtëse, ndikohen nga përvojat tona personale kur kemi qenë fëmijë, kur jemi prindër si edhe nga puna, kultura, seksi, feja dhe gjendja e tanishme sociale.

Kohëzgjatja

× 15 minuta

Materialet

× Për këtë ushtrim, ju keni nevojë:
Një fotografi të fëmijërisë.

Procesi

1. Shikoni albumin e fotografive të fëmijërisë.
2. Zgjidhni dy fotografi dhe vendosini mbi tavolinë ose dysheme.
3. Zgjidhni një fotografi që, në njëfarë mënyre ju thotë diçka. Mos mendoni shumë për të zgjedhur, por bëni që fotoja t'ju zgjedhë ju.
4. Tani për disa çaste mendoni për foton që keni zgjedhur dhe pyesni veten:
   - × Cilat janë mendimet dhe ndjenjat e mia për këtë fotografi?
   - × Pse më pëlqen kjo foto? Pse jo?
   - × Si lidhet me përvojat e tjera të fëmijërisë?
   - × Si ndjehesha në çastin kur u bë fotoja?
   - × Çfarë po mendoja në çastin kur u bë fotoja?
   - × Kush ishte i pranishëm? Si ndikoi mënyra si u ndjeva?
5. Pyet një ose disa persona të ndryshëm që të njohin qysh fëmijë, për VETEN! Thuaju të tregojnë histori se si ishe, çfarë të pëlqente, çfarë jo, cili qe vendi yt i preferuar …

2 Unë, fëmijët dhe fëmijëria

Qëllimi

- × Të tregojmë se sa domethënëse mund të jenë kujtimet e fëmijërisë dhe përvojat tona personale, kur merremi me problemet e mbrojtjes së fëmijëve.
- × Të vësh në qendër fëmijën dhe të reflektosh se si ndihen dhe mendojnë fëmijët për të qenë të sigurtë dhe të mbrojtur.
- × Të vizualizosh dhe të trajtosh në mënyrë induktive një koncept psiko-social që lidhet me mbrojtjen e fëmijëve

Objektivat

- × Të theksohet ndërvarësia e faktorëve socialë dhe psikologjikë për t'i mbajtur fëmijët të sigurtë dhe të mbrojtur.
- × Te kuptohet se si përvojat tona personale ndikojnë në perceptimin dhe sjelljen tonë.

Çështjet kryesore për t'u mbajtur mend

- × Çfarëdo që na bëri ne të zgjedhim këtë kujtim, është e rëndësishme, sepse ka lënë një kujtim të fëmijërisë.

× Kujtimet dhe përvojat tona mund të ndikojnë në mënyrën se si ne mund të shohim fëmijët dhe fëmijërinë.
× Pjesa psikologjike dhe sociale e përvojës sonë, nuk mund të ndahen, ato janë në ndërveprim të përhershëm.

Kohëzgjatja
× 30 minuta

Pajisjet
Për këtë ushtrim ju keni nevojë për:
× 2 lapsa me ngjyra,
× Një fletë në ditarin tuaj për mbrojtjen e fëmijëve, të ndarë në dy kolona: psikologjike dhe sociale.

2 a Kujtoni fëmijërinë – çfarë ju bënte të ndiheshit i sigurtë dhe i mbrojtur?

Procesi
a Gjej një vend të qetë në natyrë ose në shtëpinë tënde, mbylli sytë dhe kujto një çast nga fëmijëria, kur ndiheshe i sigurtë dhe i mbrojtur. Gjallëroje këtë kujtesë me sa më shumë detaje dhe krijo një pikturë të qartë në mendjen tënde (erërat, ngjyrat, ndjenjat, njerëzit e pranishëm, etj).
b Hapi sytë kur ta kesh gjetur një kujtim të tillë.
c Vizato ose shkruaj kujtimin.
d Pastaj, pasi e ke shprehur kujtimin, mendo për një çast:
  × Çfarë të bëri të zgjedhësh këtë kujtim?
  × Ç'faktor kyç të bëri të ndihesh i sigurtë në këtë çast?
e Mendo nëse faktori kryesor mbrojtës në kujtesën tënde është natyra sociale apo psikologjike dhe shkruaj elementin kyç të kujtimit në kolonën përkatëse (për shembull, blu për faktorët socialë, dhe të kuqe për ato psikologjikë).
f Përsërit të njëjtin ushtrim për kujtime të ndryshme ose kërkoju njerëzve të bëjnë të njëjtin ushtrim.
g Shiko rezultatin e kësaj përzgjedhjeje kujtimesh; më shumë faktorët psikologjikë e socialë, që ju bënin të ndjeheshit të sigurtë? Pse? Ndërveprime?
h Për shembull, familja - mund të jetë dashuria (faktor psikologjik) ose rrjeti mbështetës (faktor social), etj.

i Shiko rezultatin e kësaj përzgjedhjeje kujtimesh; më shumë faktorët psikologjikë e socialë, që ju bënin të ndjeheshit të sigurtë? Pse? Ndërveprime?

j Për shembull; familje- mund të jetë dashuria (faktor psikologjik) ose rrjet mbështetës (faktor social) etj.

2a **Të shohim fëmijërinë tonë – Vija e jetës nga 0 deri në 18 vjeç**

Vizato vijën tënde të jetës, duke shënuar kulmet (çastet e sukseshme) dhe pikat e ulëta (çastet e e vështira) në jetën tuaj.

Cilat janë 3 ndodhitë që kanë patur rëndësinë më të madhe në jetën tuaj (0 deri në 18)?

1 .....

2 .....

3 .....

Cila fazë ishte më e vështira për ju? Çfarë nevojash ishin më të vështira për t'u plotësuar? (Besimi te njerëzit? Besimi në punën tuaj? Gjetja e një kuptimi ose qëllimi për jetën? Besimi në kapacitetet tuaja? Shprehja e emocioneve!, etj)

Rendisni burimet (burimet fizike, materiale, sociale dhe psikologjike) që keni:

	TË TRASHËGUARA NGA PRINDËRIT	TË ZHVILLUARA GJATË JETËS
FIZIKE	.....	.....
MATERIALE	.....	.....
SOCIALE	.....	.....
PSIKOLOGJIKE	.....	.....

2 c **Lidhjet e rrjetit tim të mbështetjes sociale**

Vizatoni rrjetin e mbështetjes sociale. Vendosni emrin tuaj në qendër të letrës në një rreth. Lidheni veten me njerëzit përreth jush. Përdorni ngjyra të ndryshme për të treguar: **a)** shpeshtësinë e kontaktit, **b)** afërsinë e kontaktit, **c)** mundësinë e konfliktit në kontakt me çdo person në rrjetin tuaj shoqëror.

2 d **Shkruani një autobiografi të shkurtër rreth fëmijërisë suaj. Tregojani pjesëtarëve të tjerë të familjes ose miqve më të ngushtë.**

3 Vetëvlerësimi i njohurive dhe shprehive profesionale

Procesi:

1. Plotëso tabelën e vetëvlerësimit më poshtë.
2. Zgjidh një kriter ku ke pikë më pak dhe përpiqu të përmirësosh aftësitë dhe kompetencat e tua.
3. Reflekto mbi një strategji përmirësimi.
4. Puno për katër javë dhe monitoro ecurinë tuaj në ditarin për mbrojtjen e fëmijëve.
5. Kur të kesh arritur një nivel të kënaqshëm të përmirësimit, zgjidh një kriter tjetër.

Data e vetëvlerësimit:

KRITERET E VLERËSIMIT	PIKËT
× Niveli i kuptimit teorik të çështjeve psikologjike.	.....
× Niveli i kuptimit teorik të çështjeve edukative.	.....
× Master në studimet psiko-sociale.	.....
× Njohuri dhe përvojë praktike në çështjet e shëndetit mendor.	.....
× Teoria rreth zhvillimit të fëmijës dhe si ndikon ky zhvillim në të mësuarit dhe sjelljen e fëmijës.	.....
× Njohuri në organizimin e shkollës dhe rolin e shkollës në një rrjet komunitar për mbrojtjen e fëmijëve.	.....
× Njohuri mbi metodat dhe procesin e të mësuarit dhe si t'i ndihmojmë fëmijët me vështirësi specifike të të mësuarit (si disleksia, diskalkula, hiperaktiviteti etj).	.....
× Njohuri mbi problemet e sjelljes të adoleshentëve dhe përvoja si t'i menaxhojmë ato.	.....
× Njohuri mbi teorinë e motivimit dhe zbatimin praktik të kësaj teorie në ambientin e shkollës.	.....
× Njohuri teorike mbi metoda të ndryshme efektive mësimdhënieje.	.....

KRITERET E VLERËSIMIT	PIKËT
× Njohuri lidhur me problemet në sjellje dhe teknikave të ndryshme lidhur me menaxhimin e kësaj sjelljeje në shkollë e në shtëpi.	
× Njohuri mbi procedurat e trajtimit të çështjeve të mbrojtjes së fëmijëve, siç janë abuzimi seksual, dhuna në familje, trafikimi, etj.	……..
× Njohuri mbi kështillime që u duhen dhënë mësuesve dhe prindërve për shkollimin.	……..
× Njohuri mbi teknikat se si të trajtoni abuzimin me drogat dhe substancat e tjera.	……..
× Të kuptuarit e mënyrës së parandalimit dhe menaxhimit të krizës.	……..
× Njohuri teorike dhe përvojë në intervistimin e fëmijëve.	……..
× Kuptimi i menaxhimit të stresit tuaj personal/ strategjitë e përballimit.	……..
× Përvoja juaj në menaxhimin e konfliktit dhe ndërmjetësimit.	……..
× Aftësitë tuaja në teknikat e vlefshme të komunikimit.	……..
× Stili juaj i drejtimit dhe i vetëkontrollit.	……..
× Vetëbesimi dhe vetëvlerësimi.	……..
× Motivimi, pro-aktiviteti, kreativiteti (të zbulosh mënyra të reja për të bërë gjërat).	……..
	……..

Komente: …….

Shënim: 1 bazë, 3 avancuar, 2 mesatare, 4 e shkëlqyer

4 Vëzhgimi – “Këndvështrim i ri”

Qëllimi

× Të bëhemi të ndërgjegjshëm për mënyrën se si perceptimi ndikon në kapacitetin tonë të analizës objektive së situatës dhe, më tej, në planin tonë të veprimit gjatë menaxhimit të një rasti.

Objektivat

× Të bëhemi të ndërgjegjshëm lidhur me perceptimet e ndryshme të një situate dhe mbi indikimin e interpretimeve tona.
× Të ndërgjegjësohemi lidhur me filtrat tanë të interpretimit.

Çështjet kryesore për t’u mbajtur mend

× Këndvështrimi juaj mbi botën, do të ndikojë në kuptimin që ju do të keni mbi situatën dhe mënyrën se si ju do të reagoni në këtë situatë.
× Përpara çdo situate, është e rëndësishme të gjeni kohën e nevojshme për të vëzhguar dhe më tej të ndërmerrni një vendim dhe një veprim.
× Është e rëndësishme të MOS filloni me pyetjen PSE? kur analizoni një situatë, pasi kjo shpie në interpretime, në vend që të kuptohen faktet.

Kohëzgjatja

× 30 minuta

Procedurat (ushtrimi 4a):

1 Shikoni në një gazetë dhe ndaloni te fotoja e parë ku ju shkojnë sytë. Shkruani përshtypjet e para.
2 Tani merrni foton dhe ngjiteni në krye të faqes së parë të ditarit tuaj. (Mund të jetë një pamje, fytyra të njerëzve nga kultura e mosha të ndryshme, objekte, kafshë, etj.)
3 Tregojua foton disa personave të ndryshëm (fëmijës tuaj, partnerit, kolegut në punë, fqinjit, mikut, etj.) dhe pyeti për përshtypjen e parë që kanë kur e shikojnë. Thuaju të japin një fjalë kyç, gjëja e parë që ju vjen ndërmend.
4 Më pas, krahaso përgjigjet e tyre me përshtypjen tënde të parë për foton.

5 Reflekto mbi “përshtypjet e ndryshme”. Përqëndrohu në përmbajtjen, ndryshimet dhe ngjashmëritë e përgjigjeve.

Procedurat (ushtrimi 4b, për këtë ushtrim të duhet një partner):

1 Zgjidhni një foto të dy.
2 Partneri të përshkruan foton. Mbyll sytë dhe dëgjo me vëmendje përshkrimin e fotos.
3 Personi që e përshkruan, përpiqet të japë pasqyrimin sa më të qartë pa gjykuar dhe pa bërë interpretim.
4 Mund të bësh pyetje për të krijuar në mendje një përfytyrim të fotos.
5 Në fund, personi përshkruan foton.
6 Diskutimi mbi ndryshimin midis përshkrimit dhe interpretimit të situatave.
7 Ndryshohen rolet dhe ti i përshkruan foton partnerit.

5 Komunikimi

Qëllimi

× Të reflektosh mbi rëndësinë dhe ndikimin e komunikimit në ndërveprimin me grupe të ndryshme njerëzish.

Objektivat

× Të analizosh dhe reflektosh shprehitë e tua komunikuese dhe ndikimet e tyre në menaxhimin e rastit.
× Të zhvillosh shprehitë e të dëgjuarit aktiv.

Çështjet kryesore për t’u mbajtur mend

× Njeriu nuk dëgjon vetëm me veshët, por edhe me sytë, shpirtin, trupin dhe zemrën e tij.
× Gjendet gjithnjë një mënyrë për të komunikuar!

Kohëzgjatja

× 45 minuta

Pajisjet

× Për këtë ushtrim të duhet një partner.

Procedurat

a Rrugë të ndryshme komunikimi në tri faza:
   1 A dhe B mendojnë për një problem të vogël, diçka që i shqetëson sot.
   2 Në një çast të dhënë, A dhe B fillojnë të tregojnë njëkohësisht problemin e tyre, të dy flasin, nuk dëgjojnë njëri-tjetrin.
   3 Tani, A tregon problemin e tij dhe B, me të gjitha mënyrat e mundshme jo verbale, i bën me dije se nuk i intereson të dëgjojë. (Dhe anasjelltas).

b Diskutoni së bashku për komunikimin universal; çfarë na duhet për të komunikuar mirë? Strategjitë e suksesshme dhe dështuese.

c Tani, A shpreh shqetësimin dhe B zbaton parimet e dëgjimit aktiv. Ndryshoni rolet.

d Diskutim për dëgjimin aktiv, për strategjitë e suksesshme dhe atë të dështuara.

10 raste të keqkuptimit me njëri-tjetrin: Midis

1 Çfarë unë ndjej
2 Çfarë unë mendoj
3 Çfarë unë dua të them në vazhdim
4 Çfarë besoj të them
5 Çfarë them
6 Çfarë besoj/pres të dëgjoj
7 Çfarë dëgjoj
8 Çfarë do të doja të dëgjoja
9 Çfarë besoj të kuptoj
10 Çfarë them se e kam kuptuar

Këto janë të paktën 10 raste

Për këtë arsye mesazhi original mund të jetë modifikuar!
(Zhak Salome)

6 Shprehitë e prezantimit të rastit

Të gjithë Specialistëve për Mbrojtjen e Fëmijëve, iu kërkohet të përfaqësojnë një organizatë ose organizëm të caktuar brenda rrjetit të komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve. Cilësia e shkëmbimet të informacionit për rastet e mbrojtjes së fëmijëve dhe vlefshmëria e masave ndërhyrëse, varet shumë në shprehitë e profesionistëve për të komunikuar me njëri-tjetrin dhe për të përdorur një nivel gjuhësor në përputhje me nivelin e auditorit.

Për të përmirësuar shprehitë tuaja për prezantimin e rasteve, ndiq hapat e mëposhtëm:

1 Para prezantimit tjetër të një rasti në mbledhjen e këshillimit me kolegët apo takim tjetër për menaxhimin e rastit, kërkoji një kolegu të të ndjekë dhe të të japë sugjerime.

Kërkoji një kolegu të përqendrohet në pikat e mëposhtme të vëzhgimit:

1 **Gjuha e trupit:**
Ku janë duart gjatë prezantimit? A ka prezantuesja kontakt me sy me pjesëmarrësit në prezantim? A qëndron ajo në mes të sallës? A bën lëvizje që përsëriten? Vështroji kokën, sytë dhe fytyrën në mënyrë të përgjithshme, vështroji krahët, duart dhe gjestet e saj, dhe në fund, vëzhgo këmbët.
2 **E folura:**
Si është toni i zërit, shpejtësia e të folurit, a përdoret një gjuhë e përshtatshme, a shpjegohen termat teknikë dhe a i përshtaten auditorit? Ndiq intonacionin e zërit, ritmin e të folurit dhe ritmin e fjalëve dhe heshtjen. Përqindja e fjalëve të folura nga prezantuesi dhe nga pjesëmarrësit.
3 **Organizimi, struktura dhe materialet mbështetëse;**
Sa i qartë është prezantimi? A ka një rrjedhë dhe organizim logjik? Sa të lehtë e kanë pjesëmarrësit për ta ndjekur? Sa e mirë është cilësia e materialeve të përdorura?
4 **Përshtypje e përgjithshme: motivimi, vetëbesimi:**
Cila është përshtypja e përgjithshme mbi prezantimin? A ishte i rrjedhshëm? A ishte e lehtë të përqëndroheshe dhe të dëgjoje? Çfarë ju tërhoqi vëmendjen?

TRI PIKA TË FORTA	TRI PIKA PËR T' U PËRMIRËSUAR
.....	.....
.....	.....
.....	.....

Pas prezantimit shfrytëzoni një çast dhe dëgjoni vëzhgimet e kolegut tuaj.

Udhëzime për kolegun tuaj që bën komentin:
Vëzhgimet duhet të jenë vetëm vizuale, të lira nga gjykimi dhe interpretimet, kështu që prezantuesi të mund ta shohë tjetrin apo veten si në pasqyrë. Qëllimi nuk është të jepni vlerësimin tuaj dhe as të gjykoni cilësinë e prezantimit… roli juaj është thjesht të shikoni dhe të reflektoni. Nuk ka rëndësi paraqitja, pranojeni dhe njiheni atë ashtu siç është. Mos mendoni për të! Mos bëni krahasimin me veten tuaj!

Kur ti dëgjon nga kolegu mendimet mbi paraqitjen, ulu përballë tij, dëgjo pa reaguar. Mos u përgjigj ose justifiko, por veç vlerëso dhe merr shënime në ditar. Në fund, falënderojë kolegun për mbështetjen e tij.

Udhëzime për prezantim:

PREZANTIMI I INFORMACIONIT	PREZANTIMI I VETES
Organizo shënimet dhe materialin prezantues që të mund të jenë të vlefshëm për ju.	Fol me zë të plotë dhe të qartë.
Shto te materiali shënime që do t'ju ndihmojnë të mbani mend pikat më të rëndësishme të diskutuara.	Mos pretendo se i di të gjitha; njih boshllëqet në njohuritë e tua. Nëse ka pyetje që nuk dini t'u përgjigjeni, procedoni në mënyrën e mëposhtme: × Drejtoja pyetjen pjesëmarrësve, ndoshta dikush nga ata e di. × Thuaji grupit që do të kërkosh informacion për çështjen dhe do t'i informosh në takimin tjetër.

PREZANTIMI I INFORMACIONIT	PREZANTIMI I VETES
Mbaj shënime të thjeshta dhe të qarta.	Ji i ndershëm me veten. Nëse je në ankth prej mbledhjes, përpiqu të qetësohesh dhe të vazhdosh më tej (frymëmarrja e thellë mund të ndihmojë!).
Shëno komentet e rëndësishme mbi informacionin dhe respekto ndryshimet në mendime.	Ridrejto diskutimin te mesazhi kyç që do të donit të transmetonit.
Përpiqu të respektosh kohën.	Dëgjo aktivisht.
Inkurajo pjesëmarrjen.	Reflekto dhe përforco çështjet kryesore.

7 Nevojat psiko – sociale

Qëllimi

× Të prezantohen tri kategoritë e nevojave njerëzore për t'u zhvilluar.

Objektivat e ushtrimit

× Të kuptohet përmbajtja e tri nevojave bazë të fëmijëve dhe marrëdhëniet mes tyre.

Çështjet kryesore për t'u mbajtur mend

× Kur punojmë me fëmijët, ne duhet të marrim parasysh nevojat e tyre fizike, sociale dhe psikologjike.

Materialet që nevojiten

× Një faqe në ditarin tuaj për mbrojtjen e fëmijës.

Procedura

1 Po përgatitesh për një udhëtim në hapësirë.
2 Shkruaj 10 gjërat më të rëndësishme për të marrë në këtë udhëtim.
3 Kur bëhesh gati për t'u nisur, del që anija kozmike është e rëndë? Duhet të përzgjedhësh 5 nga 10 gjëra për të marrë me vete. Zgjidh dhe shkruaj.

4. Bëhet përpjekja e dytë, por anija është prapë e ngarkuar, lejohen vetëm 3 gjëra për çdo udhëtar të hapësirës.
5. Tani vizato një tabelë me tri kolona për nevojat psikologjike, sociale dhe fizike në ditarin tuaj për mbrojtjen e fëmijëve.
6. Reflekto nëse tre artikujt më të rëndësishëm që zgjodhët për të marrë, janë të natyrës sociale, fizike apo psikologjike.
7. Shkruani 3 artikujt kyç në kolonën korresponduese (psikologjike, fizike apo sociale).
8. Shiko rezultatin; janë marrë më shumë nevoja psikologjike, sociale apo fizike? Pse? Ndërveprime?
   Për shembull: Familja – mund të jetë dashuri (faktor psikologjik) ose një sistem mbështetës (faktor social).

Ky ushtrim mund të bëhet me fëmijët edhe për të zhvilluar të kuptuarin **e tre kategorive të nevojave** dhe se si të bëhet **një ndarje midis nevojave dhe dëshirave**. Në varësi të moshës, fëmijëve mund t'u jepen karta me tema për t'u plotësuar – përshkrimi i temave, duhet të jetë në bazë të moshës së fëmijëve. Shembuj të letrave:

- Vjeshje të modës
- Armë për mbrojtje
- Familja ime
- Librat e shkollës
- Instrumenta muzikorë për festim dhe kërcim
- Flamuri shqiptar për të shënuar territorin
- Një çadër për t'u mbrojtur nga shiu
- Telefon
- Materiale për të ndërtuar një strehëz
- Ilaçe
- Para
- Një shok për të biseduar
- Tekste fetare ose libra lutjeje
- Lojëra për të luajtur
- magnetofon me CD për të dëgjuar muzikë dhe për të kërcyer
- Kompjuter personal dhe televizor
- Shokë shkolle

8 Menaxhimi i emocioneve dhe stresit

Qëllimi

× Të jesh i ndërgjegjshëm për rolin e emocioneve në menaxhimin e rastit.

Objektivat

× Identifikimi i dallimeve individuale në shprehjen e emocioneve.
× Të jesh i ndërgjegjshëm në interpretimin e gjesteve dhe shprehjeve joverbale.
× Të identifikosh mekanizmat e përballimit të secilit.

Çështjet kryesore për t'u mbajtur mend

× Jo të gjithë i shprehin njësoj emocionet, jo të gjithë i interpretojnë njësoj.
× Kjo punë mund të jetë e vështirë! Ji i ndërgjegjshëm për burimet tuaja, pikat e forta, por edhe për nevojat dhe kufijtë!

Kohëzgjatja

× 45 minuta

Pajisjet

× Për këtë ushtrim të duhen 3-4 partnerë.

Procedura:

8 a **Ushtrim model**

VARIANTI 1: Pjesëmarrësit qëndrojnë në rreth me fytyrë nga njëri-tjetri. Njëri qëndron në mes dhe i kërkon të gjithëve të rrotullohen rreth vetes me shpejtësi dhe të imitojnë dhe aktrojnë mbiemrat e mëposhtëm: I lumtur – i trishtuar – i frikësuar – i sëmurë – nervoz – hiper – agresiv – i lodhur/përgjumur – jo në humor – i turpshëm – i stresuar – i inatosur – i kënaqur etj.

VARIANTI 2: Të gjithë personat qëndrojnë në rreth me shpinë nga njëri-tjetri. Secili i thotë me zë të ulët në vesh një mbiemër personit që ka para. Personi në qendër nuk e di fjalën. Sapo të gjithë pjesëtarët e grupit ta kenë dëgjuar mbiemrin, grupi kthehet dhe përshkruan gjendjen emocionale të mbiemrit. Personi në mes duhet ta gjejë.

VARIANTI 3: Një artist "modelon" gjendjen e një personi nëpërmjet tipareve të jashtme dhe gjuhës trupore; të tjerët duhet të kopjojnë të njëjtën shprehje. Modeli përpiqet të gjej gjendjen e tij/saj të brendshme.

Lidhja me sjelljen agresive:
Përpunimi kognitiv i informacionit te fëmijët agresivë, përqëndrohet në gjestet agresive. Ata bëhen më shpejt agresivë edhe kur situata sociale nuk e lejon këtë interpretim nga këndvështrimi i një vëzhguesi të jashtëm objektiv. Prandaj, është e rëndësishme të modifikohet mënyra e vëzhgimit dhe përpunimit të informacionit, që ka të bëjë me fëmijët me prirje të sjelljes agresive. Kjo mund të arrihet mes interpretimit të figurave, komunikimit verbal ose joverbal (gjuhën e trupit), dramës dhe lojës me role, shprehjes artistike, etj.

8 b Reflekto mbi mënyrat e përballimit të emocioneve specifike (për fëmijët, për të rriturit): frika, inati, gëzimi dhe trishtimi.

8 c Reflekto mbi: Si e menaxhoj unë stresin lidhur me punën? Gjej mënyra për të zëvendësuar sjelljen e pashëndetshme me stres.

9 Drejtimi dhe animimi i grupit

Qëllimi
- × Të reflektoni stilin tuaj të drejtimit gjatë animimit të një grupi.

Objektivat e ushtrimit
- × Të zhvillohet kuptimi i tipeve të ndryshme të drejtimit dhe roli i tyre në dinamikën e grupit.
- × Të jemi të ndërgjegjshëm për vetëperceptimin dhe perceptimin e jashtëm gjatë punës me fëmijët.

Çështjet kryesore për t'u mbajtur mend
Për të gjallëruar pjesëmarrjen e fëmijëve dhe për të bërë që fëmijët të jenë të motivuar për të mësuar, duhet të zbatojmë një drejtim demokratik.

Materialet që nevojiten
- × letër dhe laps;
- × bllok i madh shënimesh;
- × të paktën, një partner.

Procedura
Secilit pjesëmarrës i kërkohet të reflektojë: Ç'lloj animatori jam unë? Si dhe të shkruajë një fjalë kyç, se si e shohin fëmijët atë (ndryshim i perspektivës).

Individualisht
"Si perceptoheni nga fëmijët, me të cilët punoni?" (vizatoni një imazh të vetes suaj dhe emërojeni me një mbiemër).

Shembull:
- × Imazhi: I rrituri që përqafon një fëmijë (mbiemri: i dashur)
- × Imazhi: Qortuesi (mbiemri: strikt)

Përmbledhje
1. Pjesëmarrësve u kërkohet të shkruajnë diçka, por pa ia treguar në fillim të tjerëve.
2. Çdo pjesëmarrësi i kërkohet të pikturojë (ilustrojë) ose të aktrojë (me pantomimë) mbiemrin e tij. Të tjerët hamendësojnë mbiemrin.
3. Tani të gjithë i zbulojnë njëri-tjetrit mbiemrat e tyre. Kjo përballje e imazhit të tyre të brendshëm me atë të jashtëm, do t'ju lejojë të shikoni: Si e perceptoj unë veten? Sa lidhet ky imazh me imazhin që kolegët kanë për mua (të gjesh mbiemrin)?

Udhëzim
Përballja e imazhit personal me imazhin e jashtëm: Shpesh ne reflektojmë te sjellja jonë, këndvështrimin tonë, ose e marrim atë nga reagimet e kolegëve tanë. Rrallëherë ne përpiqemi ta vemë veten në

pozicionin e fëmijës dhe ta shohim veten me sytë e tyre. Ky ushtrim do të na ndihmonte të përmirësonim kapacitetin për ndryshimin e perspektivës dhe, ç'është më e rëndësishmja, do të na kujtonte se mënyra jonë e të parit, nuk është ajo si na shohin fëmijët. Fëmijët na shohin dhe na perceptojnë në mënyra të ndryshme, por shpesh ne jemi "të famshëm" për shkak të ndonjë tipari të personalitetit tonë. Kjo veçmas, është e rëndësishme dhe duhet marrë në konsideratë kur shoqërojmë një fëmijë me ndonjë vështirësi të veçantë. Disa herë vetëm duke ndryshuar personin, i cili është përgjegjës për fëmijën, mund të ndihmojë shumë.
Nëse dëshiron të hedhësh një hap më tej në ballafaqimin e imazhit tënd, si e percepton ti atë dhe si e perceptojnë të tjerët, kërkoju fëmijëve me të cilët punon, të shkruajnë një mbiemër për ty dhe ta vendosin te "Kutia postare".

10 Drejtimi dhe zgjidhja e konfliktit

Situata: Vjedhja e një sendi gjatë aktiviteteve psiko-sociale!
Klodiani, 10 vjeç, shpreh shqetësimin se një fëmijë tjetër, Erioni, i ka vjedhur orën. Erioni është 14 vjeç dhe është shquar gjithmonë si fëmijë që shkakton probleme gjatë aktiviteteve. Dihet se Erioni ka qenë gjithmonë një fëmijë i vështirë dhe është akuzuar shumë herë për vjedhje të gjërave të vogla. Klodiani vjen duke qarë te ju me një shok të vetin dhe ju tregon se çfarë ka ndodhur.

Si do e menaxhoni këtë situatë ?

10 a Shkruani në ditarin tuaj se si një drejtues diktator do ta zgjidhte këtë situatë.

10 b Shkruani në ditarin tuaj se si një drejtues liberal do ta zgjidhte këtë situatë.

10 c Shkruani në ditarin tuaj se si një drejtues demokrat do ta zgjidhte këtë situatë.

- Cilat janë përparësitë e çdo stili drejtimi? Po të metat?
- Cilat janë pasojat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për çdo lloj stili drejtimi?

× Cilin stil zbatoni më shumë për zgjidhjen e konflikteve në praktikën e punës së përditshme?

Shikoni hapat për zgjidhjen e konfliktit në **KAPITULLIN 2.8 D**. Përpiquni të zbatoni modelin në situatën tjetër të konfliktit që do të ndeshni. Shkruani përvojat në ditarin tuaj për mbrojtjen e fëmijëve.

× Një animator "demokrat" mban parasysh nevojat dhe dëshirat e fëmijëve, pa larguar objektivin nga mendja.

× Drejtuesi demokrat luan rolin e tij kur shoqëron një fëmijë gjatë zhvillimit të tij fizik dhe psikologjik, duke mbajtur lidhje të forta (afektive) me të, duke e motivuar dhe duke caktuar kufij të qartë (normativë).

11 Drejtimi dhe zgjidhja e konfliktit

1 Shkruaj dhjetë gjëra që të pëlqejnë te vetja.
2 Shkruaj çdo natë tri gjëra që të pëlqyen në punën me fëmijët.
3 Zgjidh një fëmijë me të cilin e ke të vështirë të punosh. Shkruaj pesë cilësi të mira të këtij fëmije. Ndiqi këto cilësi për një periudhë kohe (përforcim pozitiv). Vëzhgo, reflekto dhe vlerëso ndikimin.

12 Motivimi dhe pjesëmarrja

1 Lexo shembujt e rasteve në faqen 85 dhe përpiqu t'u përgjigjesh pyetjeve të mëposhtme në ditarin tuaj.
   a Cilën strategji do të shfrytëzonit për të motivuar Elonën dhe Klodianin?
   b Cilën strategji do të shfrytëzonit për të gjallëruar pjesëmarrjen e Ardianit në aktivitetet tuaja?

3 Ndihma psiko-sociale

Kapitulli i tretë bën një përmbledhje të shkurtër të niveleve të ndihmës, si dhe të sektorëve kryesorë të përfshirë në rrjetin ndërdisiplinor të mbrojtjes së fëmijëve.

3.1 Nivelet e ndërhyrjeve psiko-sociale

Ndihma psiko-sociale mund të jepet në katër nivele të ndryshme:

1 **Të forcohet mjedisi mbrojtës në shtëpi, shkollë dhe në komunitet, për të parandaluar ose reduktuar problemet psiko-sociale.**
Një nga aspektet më të rëndësishme për të përmirësuar mirëqenien psiko-sociale të fëmijëve në shkollë, është të lehtësohen kushtet për mobilizimin e komunitetit të shkollës dhe të krijohet ndjesia e këtij të fundit për përgjegjësinë dhe rëndësinë që ka në zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve. Të gjitha aktivitetet duhet të bëhen duke u konsultuar me fëmijët, të rinjtë, adoleshentët dhe me pjesëmarrjen e tyre aktive.

Shembuj:
- × krijimi i hapësirave për aktivitete çlodhëse: është e rëndësishme të krijosh mundësi për lojëra jo të dhunshme, sporte dhe forma të tjera aktivitetesh çlodhëse. Krijoni mjedise të sigurta, ku fëmijët luajnë dhe ndërveprojnë me shokët e tyre;
- × Përkrahja e shkollimit të fëmijëve të vegjël;
- × Aktivitetet kulturore dhe traditat: aktivitetet kulturore, ritet dhe të gjitha llojet e festimeve, ndihmojnë komunitetin e shkollës të krijojë një ndjesi përkatësie dhe zotërimi;
- × Krijimi i mjedisit miqësor për fëmijët në shkollë dhe komunitet;
- × Krijimi i komitetit të prindërve dhe përfshirja e tyre në aktivitetet shkollore;
- × Fuqizimi i kështillit të nxënësve dhe krijimi i grupeve vëzhguese për mbrojtjen e fëmijëve;
- × Promovimi i punës, rritja e të ardhurave ose trajnime aftësimi për të rriturit dhe të rinjtë;
- × etj.

2 **Aktivitetet psiko-sociale bazë**
Është e rëndësishme që fëmijët të jenë në gjendje të përfshihen në aktivitete kuptimplotë, që mund të nxisin zhvillimin e tyre, duke përfshirë aktivitete të ndryshme parandalimi mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijës.

Shembuj:
- × Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në shkollë, në bashkëpunim me komunitetin e prindërve dhe partnerët e komunitetit, **për të përkrahur të drejtat e fëmijëve**, **mjediset miqësore për fëmijët** ose probleme të tjera që lidhen me ta;

- Organizimi i **aktiviteteve parandaluese psiko-sociale** për fëmijët mbi çështje specifike, si abuzimi me drogën, kontrolli i lindjes, menaxhimi i konflikteve, shprehja emocionale, si të merremi me ankthin para provimeve etj.
- **Trajnimi i mësuesve** mbi menaxhimin e klasës;
- **Trajnimi i prindërve** lidhur me shprehitë pozitive të prindërimit;
- etj,.

3 **Aktivitete të përparuara psiko-sociale**

Një numër më i vogël fëmijësh në mjedisin e shkollës, do të kenë nevojë për mbështetje më të përqendruar dhe individuale. Kjo lloj ndihme e përparuar psiko-sociale mund t'i ndihmojë fëmijët që kanë nevojë për ndërhyrje më specifike psiko-sociale.

Shembulli i ndërhyrjeve të 3 niveleve: familja, mësuesi dhe/ose këshillimi i fëmijës si individ ose/dhe në grup për shqetësime specifike.

4 **Referimi te shërbimet shëndetësore ose të tjera**

Ndërsa shumica e fëmijëve do ta marrin veten me ndihmën e familjes dhe mbështetjes së komunitetit, një numër i vogël fëmijësh, mund të kërkojnë më shumë mbështetje të specializuar, që të mund të mund të orientohen në jetën e përditshme dhe të përfshihen në komunitet. Nuk është në mandatin e SMF-së të kryejë psikoterapi afatmesme dhe afatgjata; këto raste duhet t'u referohen partnerëve lokalë.

Kujt t'i referohen fëmijët në nevojë për ndihmë shtesë psiko-sociale?

Për të mbështetur këto raste, duhet bërë lidhja me sistemin e kujdesit shëndetësor. Duhet të krijohen sistemet e referimit për t'u siguruar që fëmijët dhe familjet e tyre të marrin mbështetjen e duhur. Në kushtet ku shërbimet janë të pranishme, fëmijët në nevojë për kujdes shëndetësor mendor, duhet t'i referohen spitaleve ose klinikave shtetërore apo private. Është e rëndësishme të krijohen mekanizma referimi për shërbime të përshtatshme përgjegjëse para krizës. (Për më shumë informacion, shih **KAPITULLIN 1.5**).

Cilët janë kriteret për të referuar një fëmijë në shërbimet e shëndetit mendor?
Është e rëndësishme të jemi në gjendje ta drejtojmë një fëmijë me probleme të rënda emocionale te një profesionist i kësaj fushe. Nuk është gjithmonë e lehtë të kuptosh se është diçka serioze ta bësh këtë. Më poshtë janë disa kritere për të referuar një fëmijë dhe/ose familjen e tij te një psikiatër ose psikolog në spitalin lokal të rrethit.

1. A po mendon ky adoleshent/fëmijë për vetëvrasje?
2. A janë keqësuar simptomat?
3. A kanë zgjatur simptomat për një kohë të gjatë (disa muaj) pa asnjë përmirësim?
4. A ka probleme me të ngrënin fëmija/adoleshenti?
5. A ka probleme me gjumin fëmija/adoleshenti?
6. A ka probleme të kryejë aktivitetet e zakonshme?
7. A i sjell shumë mërzitje familjes sjellja e fëmijës?

3.2 Ndërhyrjet psiko-sociale sipas sektorëve

A **Përmbledhje**
Ky seksion do të përshkruajë shkurtimisht llojet e mbështetjes që mund të japë një Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve, për të ndihmuar që fëmijët të marrin ndihmë psiko-sociale nga sektorë të ndryshëm të rëndësishëm.

Arsimimi
- × (Ri)stabilizimi i shkollimit të sigurtë, formal a joformal, është ndërhyrja kryesore psikologjike, pasi inkurajon rutinën.
- × Bëni që shkollimi të mbështesë dhe t'u përshtatet nevojave psiko-sociale të fëmijës, për shembull, këshilloni një mësues të përshtasë kurikulën e orëve, për t'i dhënë më shumë mundësi për t'u shprehur, organizoni aktivitete të shkurtra kur fëmija ka vështirësi për t'u përqendruar etj,.

- Mbështesni mësuesit nëpërmjet trajnimeve, mbikqyrjes dhe materialeve për t'i dhënë mbështetje psiko-sociale fëmijëve, për shembull, duke bërë aktivitete çlodhëse, si aktivitete kulturore ose sportive apo trajnime për aftësim në jetë.
- Jepni mbështetje të strukturuar në grupet me fëmijë, të cilët po përjetojnë vështirësi, për shembull, përmes diskutimeve në grupe fokusi ose mbrojtje të organizuar në grupe "shokësh".
- Krijo grupe vëzhgimi shokësh, për të aktivizuar mbështetjen e mbrojtjes së fëmijëve në mjedisin e shkollës.
- Jip mbështetje psiko-sociale për mësuesit dhe edukatorët e tjerë, për shembull grupe mbështetës, sesionet e këshillimit mes shokëve, etj.
- Organizo aktivitete parandaluese psiko-sociale me fëmijët, prindërit dhe mësuesit në shkollë dhe komunitet.
- Organizo orë shtesë për fëmijët të cilët kanë vështirësi.

Shëndeti

- Jep mundësi shërbimi dhe trajtimi për një numër të vogël fëmijësh me çrregullime urgjente mendore dhe kujdestarëve të tyre.
- Minimizo dëmin ndaj fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre nga përdorimi i dëmshëm i alkolit dhe substancave.
- Jep informacion mbi menaxhimin e stresit, mbi kontrollin familjar, të ushqyerin, etj;
- Jep mbështetje psiko-sociale përmes shërbimeve të specializuara, si për shembull, shtëpitë e strehimit për gratë etj.

Sektorët shtesë:

- **Ndihma ekonomike**
  Jep informacion dhe udhëzim se si të merret ndihma ekonomike shtetërore.
- **Ndihma ligjore**
  Jep informacion e udhëzim se si të merret ndihma ligjore.
- **Mbështetja e komunitetit**
  Organizo dhe jepi mbështetje aktiviteteve të komunitetit, sidomos atyre që përqendrohen te fëmijët, si festivalet kulturore, aktivitetet sportive ose fushatat e parandalimit mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, mjedise miqësore për fëmijën dhe tema të tjera që kanë të bëjnë me ta.

B **Shërbimet sociale për femrat që janë viktima të dhunës shtëpiake**

Në vitet që vijuan pas 1990-tës, përveç zhvillimit ekonomik dhe politik, shoqëria shqiptare u përball me fenomene të reja sociale, si trafikimi i qenieve njerëzore, për shfrytëzim seksual ose punë. Ndryshimet rrënjësore politike, sociale, demografike dhe ekonomike që ndodhën pas komunizmit, bënë që vendi t'i përqasej një fenomeni që ekzistonte në shoqëri, por që nuk ishte trajtuar asnjëherë, si ai i dhunës shtëpiake, abuzimit seksual dhe të tjerë.

Si përgjigje ndaj fenomeneve sociale, donatorë të ndryshëm apo organizata lokale joqeveritare, filluan të ofronin shërbime sociale për grupet më të cënueshëm në Shqipëri, si gratë edhe fëmijët, viktima të dhunës në familje, duke pasur si synim kryesor mirëqenien e tyre dhe lehtësimin e procesit të riintegrimit në shoqëri.

Këto shërbime ofrohen falas, në varësi të nevojave dhe kërkesave për çdo rast specifik. Mbështetja mund të klasifikohet në shërbime këshillimi/orientimi dhe qendra rezidenciale.

Shërbimet këshilluese veprojnë në rrethet e Korçës, Elbasanit, Vlorës, Tiranës dhe Durrësit. Këto shërbime japin ndihmë këshilluese dhe psikologjike për femrat dhe fëmijët e abuzuar, si dhe viktimave të dhunës në familje. Personeli i specializuar ofron gjithashtu ndihmë ligjore, orientim në shërbimet sociale dhe mekanizma të tjerë të mundshëm.

Qendrat rezidenciale ofrojnë mbështetje për të gjithë femrat, të cilat kanë përjetuar ose janë në rrezik të ripërjetimit të abuzimit fizik, psikologjik, ekonomik dhe seksual, si dhe për rastet e dhunës në familje, ku zhvillimi i shëndetshëm i fëmijës është në rrezik.

Qendrat rezidenciale vepronë në qytetet e Elbasanit, Vlorës, Tiranës dhe Gjirokastrës. Këto qendra ofrojnë akomodim të sigurtë, mbrojtje, mbështetje ligjore dhe mjekësore, si dhe ndihmë psiko-sociale për gratë dhe fëmijët. Sigurohet konfidencialiteti për të gjithë përfituesit. Shërbimet ofrohen falas dhe janë të përkohshme. Çdo ofrues shërbimesh ka kriteret e veta (konfidenciale) për përfituesit. Një kriter i domosdoshëm, është vendimi i vetë gruas të dalë nga mjedisi i dhunshëm dhe të bashkëpunojë me personelin mbështetës të qendrës.

C **Ndihma ekonomike**

Çfarë lloj ndihme ekonomike shtetërore është e mundshme dhe ku duhet të drejtohen për t'i përfituar ato?

Shteti shqiptar ofron ndihmë ekonomike, përsa i përket familjeve që nuk kanë ose kanë të ardhura të pakta.

Ligji përcakton në mënyrë të qartë kriteret se si familjet mund të marrin ndihmën ekonomike (ligji nr. 9355 datë 10.03.2005, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 787 VKM nr. 338/3 etj.). Kërkohet një listë e gjatë me dokumenta për të aplikuar për ndihmë ekonomike. Ato i duhen dorëzuar administratorit lokal të Zyrës së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në Bashki/Komunë.

Përfituesit e ndihmës ekonomike, duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- × Familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- × Jetim të papunë mbi 25 vjeç.
- × Jetim nga 18-25 vjeç, të cilët nuk janë në institucione, shërbime sociale apo nën kujdes.
- × Prindër me trinjakë ose me më shumë fëmijë.

Dokumentat që kërkohen janë si më poshtë:

- × Deklaratë e situatës social-ekonomike të familjes, sipas formularit të dhënë një herë në vit.
- × Deklaratë mujore që duhet plotësuar dhe firmosur nga një person në moshë madhore në familje (të dorëzohet nga 1-15 të çdo muaji).
- × Çertifikatë familjare, vërtetim vendbanimi dhe ndryshimit nëse ka.
- × Çertifikatë pronësisë së tokës.
- × Dokumente që dëshmojnë zotërim pronësie apo se toka është në përdorim.
- × Vërtetim se personat në moshë madhore në familje nuk kanë punë dhe kërkojnë ndihmë ekonomike (njëherë në tre muaj).

Familjet që kanë jetuar në fshat para gushtit të vitit 1991, duhet të japin dokumenta shtesë:

- a Vërtetim se familja nuk ka tokë në pronësi.
- b Librezë pune që vërteton se u punësuan pasi u larguan nga fshati.
- c Çertifikatën e pronësisë së tokës.

Shteti jep ndihmë ekonomike në lekë për grupe të tjera që kanë statusin e njerëzve me aftësi të kufizuara (të lindur ose aftësi e kufizuar e fituar deri në moshën 21 vjeçare), personat e verbër, paraplegjikët dhe tetraplegjikët.

D **Ndihma ligjore**

Përsa i përket ndihmës ligjore, në përputhje me nenet e mëposhtme të legjislacionit shqiptar, parashtrohet se shteti duhet të ofrojë shërbime ligjore falas; **NENI 49** i Kodit të Procedurës Penale, Ligji mbi Azilin në Shqipëri, ligji nr. 9669, "Mbi masat e parandalimit të dhunës në familje", datë 18.12.2006.

Këshillimet ligjore duhet të jenë falas, nëse i pandehuri nuk mund të përballojë që të paguajë një avokat privat dhe janë të detyrueshme në rastet e minorenëve.

Megjithatë, kjo e drejtë nuk njihet nga të gjithë dhe shpesh policia nuk i informon të pandehurit për të. Ka vështirësi në marrjen e informacionit ligjor për qytetarët, sidomos për ata që jetojnë në zona rurale dhe që kanë mungesë interneti. Shërbimet ligjore të ofruara nga Shoqata e Juristëve, konsiderohen si të papërshtatshme, shpesh si rezultat i mungesës së profesionalizmit dhe mungesës së mekanizmave për të monitoruar cilësinë e shërbimit.

LIGJI
NR.9355, DATË 10.03.2005
PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE

NENI 1

Ky ligj ka për qëllim:

1 Të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

2 Të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

NENI 5

Përfitues të ndihmës ekonomike janë:

1. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme;
2. Jetimët mbi 25 vjeç, të papunë, të cilët nuk janë në institucione ose nën kujdestari;
3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë.

NENI 6

Përfituesit e shërbimeve shoqërore janë fëmijët, të rinjtë deri në moshën 25 vjeç, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar, gratë, vajzat në nevojë, si dhe të gjithë ata që janë në rrezik të bëjnë pjesë në grupet në nevojë.

Përmbledhje

Ndihma psiko-sociale mund të jepet në nivele të ndryshme. Planet e veprimit mund të kërkojnë krijimin e mekanizmave mbështetës, në një ose disa nivele të ndryshme të ndërhyrjes, si dhe të përfshijnë një ose disa sektorë të rëndësishëm.

Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve nuk bën vlerësim të plotë të situatës së familjes, përsa i përket **ndihmës ligjore dhe ekonomike**. Nuk është në mandatin tuaj! Lejoni që të merren strukturat e tjera shtetërore me këtë, si Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, së bashku me administratorët shoqërorë të bashkisë. Megjithatë, gjatë një vizite në familje, Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve mund të vlerësojë gjendjen ekonomike të familjes dhe ta drejtojë familjen te shërbimet respektive përkrahëse.

Nëse mendoni se një familje ka nevojë për përkrahje ekonomike, mund të bëni një vlerësim fillestar bazuar në kriteret e përgjithshme. Sigurohuni që:

- **a** Asnjë anëtar i familjes nuk ka të ardhura apo aktivitet ekonomik;
- **b** Asnjë anëtar i familjes nuk është në emigrim;
- **c** Familja nuk zotëron asnjë lloj prone (familjet fermere që kanë përfitime nga pronat, përveç ndihmës ekonomike);
- **d** Familja nuk ka makinë dhe nuk drejton aktivitet privat (bar, dyqane, etj.).

Mund të ndihmoni familjen, duke i informuar për kriteret dhe procedurat e aplikimit për të marrë ndihmën ekonomike. Familjet, më pas, duhet të shkojnë në Zyrën e Ndihmës Ekonomike dhe të kërkojnë administratorin shoqëror për të plotësuar dokumentat e nevojshëm.

Pas vlerësimit të parë të situatës së familjes, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, së bashku me administratorin shoqëror, do të kryejnë një vlerësim të plotë të gjendjes ekonomike të familjes.

Pika kontrolli

Përpiqu t'ju përgjigjesh pesë pyetjeve të mëposhtme. Për të parë nëse je përgjigjur saktë, kthehu te kapitujt përkatës.

1. Cilët janë katër nivelet e ndihmës psiko-sociale? Si lidhen me njëri-tjetrin?
2. Kur duhet ta drejtoni një fëmijë në shërbimet e shëndetit mendor?
3. Cilët janë sektorët kryesor për mbështetjen psiko-sociale? Çfarë shërbimesh ofron secili prej sektorëve?
4. Cilat janë shërbimet këshilluese për gratë? Cilat janë qendrat rezidenciale?
5. Si e vlerëson nëse një familje ka të drejtën për mbështetje ekonomike?

Seksioni B

Ndërhyrjet psiko-sociale

4 Metodologjia dhe udhëzimet për ndërhyrjet psiko-sociale

Kapitujt nga i katërti te i nënti, përmbajnë udhëzime të përgjithshme për ndërhyrjet psiko-sociale dhe ndërhyrjet specifike për çdo grup të synuar: fëmijët, prindërit dhe personelin pedagogjik, si dhe për këdo tjetër, i cili merret me problemet e mbrojtjes së fëmijëve, abuzimin e fëmijëve, punën e tyre, gjakmarrjen, diskriminimin e grupeve minoritare, migrimin e brendshëm, gjendjen mendore, problemet me sjelljen, gjendjen emocionale dhe traumat.

4.1 Hyrje

Me mbështetjen e familjes, miqve, shkollës dhe komunitetit, mund të ndihmohet një pjesë e mirë fëmijësh! Ne po punojmë për të ndihmuar fëmijët dhe familjet për nevojat e tyre psikologjike (mendore, emocionale, sjelljen) dhe ato sociale. Siç e dimë të gjithë, ndonjëherë dhimbja emocionale, mund të lëndojë më shumë dhe më gjatë se ajo fizike.

Lloji i ndihmës që ju do të planifikoni, varet shumë nga situata specifike e fëmijës, problemi i mbrojtjes së fëmijës dhe përparësitë që keni identifikuar, aktorët e disponueshëm, etj. Prandaj, s'ka asnjë përgjigje standarde për mbrojtjen e fëmijëve, e tillë që të mund të zgjidhë problemin konkret të fëmijës. Respektoni gjithmonë individualitetin e fëmijës, çdo qenie njerëzore është e vetme.

Pa kuptuar se ç'është një fëmijë i shëndetshëm, i lumtur, është e vështirë të masësh çrregullimin te një fëmijë i stresuar. Të dish se ç'është një fëmijë normal, do të thotë të kuptosh se si po ia del mbanë një fëmijë apo si të ndihmosh një fëmijë të ripërtërihet dhe të zhvillohet. Puna e rritjes së një fëmije, do të thotë të zhvillohen të gjitha kapacitetet: fizike, mendore (njohëse), sociale, emocionale dhe morale. Fëmijët përparojnë gjatë fazave të ndryshme, në çdo fazë kanë nevojë të mësojnë dhe përvetësojnë pjesën tjetër të aftësive që të mund të rriten.

Është e rëndësishme të kuptosh se një fëmijë është "ndryshe" dhe mënyrat se si ai e kupton botën, si e përthith informacionin dhe se si përshtatet ndaj streseve të jetës, janë shumë të ndryshme nga ato të të rriturve.

4.2 Fëmijët jetojnë në një botë marrëdhëniesh

Ngaqë fëmijët kanë një varësi të gjatë derisa rriten, siguria dhe mirëqenia e kujdestarëve të tyre kryesorë, është thelbësore për zhvillimin dhe rritjen e tyre të shëndetshme. Nga varësia absolute e të miturve, drejt përpjekjeve për pavarësi në adoleshencë, fëmijët kanë nevojë për mbështetje, figura të dashura që t'i ndihmojnë të zhvillojnë personalitetin dhe strukturën mendore për të ecur në jetë. Pa kujdesin dhe mbështetjen e vazhdueshme të prindërve ose kujdestarëve, fëmijët dhe rritja e tyre, mund të mos jetë e qëndrueshme, ato mund të shfaqin shenja shqetësimesh emocionale (për më shumë informacion teorik mbi teoritë e zhvillimit, referojuni Manualit për Mbrojtjen e Fëmijëve për shkollat).

Nuk ka asgjë më të rëndësishme për një fëmijë, që ai të mund të bëhet një i rritur i shëndetshëm, sesa dashuria, mbështetja dhe mirëkuptimi i njerëzve të rritur që përfshihen në jetën e tij. Në gjithë çfarë dimë nga kërkimet shkencore për fëmijët që jetojnë në situata stresante (familje me prindër të ndarë, që jetojnë në rrugë, mjedise të dhunshme), investimi emocional i një të rrituri të vetëm që kujdeset dhe është model për fëmijën, mund të jetë faktor vendimtar, që përcakton nëse fëmija do të arrijë ta marrë veten apo do të vuajë nga çregullimet.

Në përgjithësi fëmijët (dhe të rriturit), të cilët kanë marrëdhënie të mira me familjen dhe miqtë, kanë më pak shenja sëmundjesh apo proble-

mesh mendore. Në të vërtetë, ka të dhëna se rrjeti i mirë shoqëror, ndihmon për të patur një jetë më të gjatë. Kjo na kthen pas te pjesa "sociale" e konceptit psiko-social, për të cilën u fol në seksionin A. të Manualit. Kur një fëmijë përballet me vështirësi dhe lind nevoja për ndërmarrjen e veprimeve në mbrojtje të fëmijës, veprimet më thelbësore, që e lejojnë fëmijën të marrë veten dhe t'i kthehet normalitetit, do të ishin rivendosja apo vendosja e marrëdhënieve mbështetëse.

Sa më i vogël të jetë fëmija, aq më shumë varet mbarëvajtja e tij/saj nga mbarëvajtja e prindit. Nëse prindi është i qetë, fëmija do të jetë i qetë; nëse ai është i stresuar, fëmija do të vuajë. Sigurisht, kjo është e anasjelltë; kur fëmijët janë mirë, edhe prindërit ndjehen më mirë. Prandaj, duke ndihmuar njërin, kemi ndihmuar edhe tjetrin.

Për më tepër, të rriturit janë modelet e sjelljeve për fëmijën, duke treguar nëpërmjet sjelljeve dhe veprimeve të tyre se si fëmijët të sillen dhe reagojnë. Sa më e afërt të jetë lidhja mes fëmijës dhe të rriturit, aq më shumë mundësi ka që fëmija të krijojë për veten modelin e prindit. Sa më shumë të mbështesim prindërit, familjen ose kujdestarët e tjerë të fëmijës, aq më shumë do të jenë këta të fundit një model për fëmijët e tyre. Fëmijët, pëlqejnë dhe imitojnë të rriturit që interesohen për ta. Kështu, ne duhet të sigurohemi që fëmija të rrethohet nga të rritur, të cilët janë pozitivë dhe kujdesen për fëmijën.

UDHËZIMI 1: Trajtimi sistemik (kompleks) i integruar

¨Puna me fëmijët përfshin edhe familjen e kujdestarët kryesorë. Mirëqenia psiko-sociale e prindërve, ka një ndikim të drejtpërdrejtë mbi fëmijën prandaj duhet të trajtohet nëpërmjet ndërhyrjeve të përqendruara te prindi. Përpiquni të mbështesni me çdo mënyre kujdestarët dhe do të jeni më në gjendje të ndihmoni fëmijën, por gjithmonë vendosni fëmijën në qendër të ndërhyrjeve dhe mos zëvendësoni rolin e agjensive që kujdesen për të rriturit! Integroni dhe koordinoni shërbime të tjera ndihmëse, si shërbimin shëndetësor, shërbimet sociale dhe mbështetjen ligjore.

4.3 Atashimi dhe ndarja

Një nga funksionet më esenciale të fëmijërisë, është "krijimi i lidhjes me prindërit". Nëse një fëmijë nuk ka lidhje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me prindërit, ai nuk do të jetë në gjendje të ndërtojë lidhje të

shëndetshme me dikë nga i cili varet, dhe kjo mund të kompromentojë aftësinë e tij për të krijuar marrëdhënie pozitive me njerëz të tjerë gjatë ciklit të jetës. Ky është një nga rreziqet më të mëdha për fëmijët, të cilët kanë humbur prindërit dhe nuk mbështeten nga kujdestarët e tyre kryesorë.

Atashimi ka lidhje me ndarjen - ta ndjesh veten mirë si njeri i pavarur gjatë fazave të ndryshme të pjekurisë. Vetëm pas një fëmijërie me lidhje të sigurta, një njeri ndjehet i sigurtë në botë kur është vetëm. Sa herë që fëmijët ndjehen të kërcënuar, qoftë fizikisht apo emocionalisht, ata kanë prirjen të jenë në ankth prej ndarjes, disa herë bëhen "të ngjitur". Kur fëmijët i tremben ndarjes, nuk është shqetësim i vogël; për një fëmijë ndarja është çështje jete a vdekje, në kuptimin e vërtetë të fjalës, ose ajo u duket e tillë.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i atashimimit është se ju, si punonjës të përkujdesjes, keni nevojë të krijoni një raport besimi me këdo që përpiqeni ta ndihmoni. Pa një lidhje besimi, kontributi juaj do të dështojë. Sa më e mirë të jetë marrëdhënia juaj me fëmijën (ose familjen), aq më shumë shanse do të keni për ta ndihmuar.

UDHËZIMI 2: Krijimi i një lidhjeje
Gjëja më e rëndësishme kur punon me fëmijët, familjet dhe kujdestarët e tjerë, është krijimi i lidhjeve me ata. Pa një raport të mirë, nuk përmbushet asnjë punë afatshkurtër. Në planin afatgjatë, shpeshherë është prania e marrëdhënies së një personi të rritur të vetëdijshëm që kudeset për fëmijën, ajo çka ndikon më shumë në gjendjen emocionale të fëmijës.

4.4 Fazat e zhvillimit të fëmijës dhe pjesëmarrja e tij

Për këdo që punon me fëmijët, është e rëndësishme të kuptojë fazat e zhvillimit të fëmijës. Pa këtë, nuk mund të kuptohet siç duhet sjellja apo gjendja shpirtërore. Në të vërtetë, ky është standardi final, me të cilin masim çregullimin dhe shqetësimet.

A është ky zhvillimi i fëmijës që presim apo ka diçka që ndërhyn në procesin normal të zhvillimit? Kur mendojmë për stresorët, nuk mund të vlerësojmë plotësisht vështirësitë që ka fëmija, pa ditur se si është sjellë

ai para se të ndodhte ngjarja stresuese. Shumë zona funksioni ndryshojnë gjatë fëmijërisë. Kur flasim për progres zhvillimi, zakonisht ai ka të bëjë me fusha specifike. Për shembull, flasim për zhvillimin mendor (njohës) të fëmijës, atë emocional, social, moral dhe fizik. Nëse ndonjëra nga këto pika, mbetet pas ose përshpejtohet, mund t'i sjellë vështirësi fëmijës.

Kur punon me fëmijë, është e rëndësishme të kesh një ide në kokë për progresin e pritshëm. Nuk ke pse të dish periudhën e saktë kohore, por duhet të kesh një lloj ideje të përafërt se çfarë pritet të ndodhë. Për një informacion mbi çastet e zhvillimit të fëmijës, shiko Aneksin 7.

UDHËZIMI 3: Sjellje dhe aktivitete të përshtatshme për moshën!
Gjithmonë përpiqu të përforcosh sjellje dhe aktivitete të përshtatshme për moshën.

4.5 Gjinia

Përkufizimi i gjinisë
Gjinia është ndjenja e të qenurit femër ose mashkull dhe e të pasurit të një roli social, që i përshtatet asaj gjinie. Secili seks kryen rolet e veta gjinore të pranuara normalisht nga një kulturë, shoqëri ose komunitet i caktuar. Prandaj, nga pikëpamja sociale, gjinia është një status i ndërtuar ose i zhvilluar.

Çfarë është seksi?
Ne mund ta kuptojmë seksin si diçka anatomike ose ndërtimi trupor i të qenit burrë apo grua, djalë apo vajzë. Për shembull, një djalë ose vajzë kur lind ne e njohim me anë të organeve gjenitale.

Pse është e rëndësishme njohuria mbi gjininë
Njohuria mbi gjininë është e rëndësishme, pasi prek aktivitetet ditore dhe mirëqenien tonë. Rolet që luajnë burrat dhe gratë, janë të përcaktuara nga gjinia. Që do të thotë, fakti i të qenit mashkull ose femër, përcakton çfarë bëjnë ose me çfarë merren çdo ditë.

Si mund të jetë i rëndësishëm roli i gjinisë në familje lidhur me masat në mbrojtje të fëmijëve?
Suela, mamaja e 5 fëmijëve, është e sfilitur nga vështirësitë me të cilat përballet me dy vajzat adoleshente. Në të njëjtën kohë, i duhet të ushqejë djalin e vogël gjashtë muajsh. Ndjehet e lodhur dhe vetëm, burri punon me orë të zgjatura dhe largohet shpesh në udhëtime pune në qytete të tjera. Prej irritimit, ajo shpesh u bërtet vajzave dhe ndonjëherë e humbet kontrollin dhe u gjuan me sende. Burri vjen i lodhur në mbrëmje dhe ulet para televizorit me një birrë. Ai s'e kupton se si ajo nuk ia dalka dot mbanë "duke ndenjur në shtëpi" e duke u kujdesur për fëmijët.

Diskriminimi ndaj vajzave
Është e qartë se diskriminimi gjinor, është normal në Shqipëri. Nga perspektiva për mbrojtjen e fëmijëve, diskriminimi ndaj vajzave është i dukshëm në arsimim, por edhe në familje, kur flasim për abuzimin dhe dhunën.

Përfshirja e gjinisë në problemet e mbrojtjes së fëmijëve
Së pari, vajzat dhe djemtë janë më në nevojë për lloje të ndryshme problemesh mbrojtëse. Vajzat, për shembull, e marrin veten më shpejt se djemtë pas një ndodhie stresuese. Nja vajzë, e cila ka qenë e abuzuar seksualisht, nuk ndjehet mirë të flasë me një burrë për detajet e abuzimit, etj.

Suela mund të ndihmohej po qe se ndihmohet burri i saj të ndryshojë mendimet e tij mbi:
- × ndarjen e punëve të shtëpisë;
- × nevojat që ka fëmija për zhvillim dhe mbarëvajtje. Nëse një burrë mendon se të ushqyerit e fëmijës është punë e gruas, ai mund të mos jetë në dijeni për nevojat dhe mbarëvajtjen e fëmijës, gjë që ka ndikim negativ te fëmija.

Burrat mund të ndihmohen të ndryshojnë vlerat e tyre nëpërmjet:
- × trajnimit dhe informimit mbi **edukimin** dhe **zhvillimin e fëmijës**;
- × këshillimit për strategjitë pozitive të prindërimit.

Gratë mund të ndihmohen nëpërmjet:

- × dhënies së informacionit mbi agjencitë që merren me problemet e grave;
- × fuqizimit të tyre ekonomik nëpërmjet aftësimit dhe dhënies së informacionit;
- × ofrimit të trajnimeve mbi fitimin e shprehive pozitive të prindërimit dhe shprehive të menaxhimit të stresit.

UDHËZIMI 4: Ndërmarrja e veprimeve në përputhje me gjininë

Merrini parasysh gjininë kur organizoni një plan ndërhyrjeje!

4.6 Faktorët mbrojtës

Është gjithashtu e rëndësishme të kihet parasysh se çdo fëmijë ka burimet personale dhe sociale, që i shfrytëzon në çaste të ndryshme të jetës së vet. Ndërhyrjet duhet të bazohen në burimet e brendshme dhe të jashtme, që fëmija të mund të zhvillojë mekanizma mbrojtjeje për mbarëvajtjen e tij dhe/ose ta ndihmojë fëmijën t'i shfrytëzojë këto burime në rrethana stresuese.

KARAKTERISTIKAT MBROJTËSE TË FËMIJËS (TË BRENDSHME)

- Ndërmerr hapa pozitivë për të zgjidhur problemet, për shembull, flet me të tjerët për ndjenjat.
- Merr përgjegjësinë e veprimeve të veta.
- Ka shpresa për të ardhmen.
- Respekton veten dhe të tjerët.
- Ka aftësinë të luajë/ndërveprojë me të tjerët dhe vetëm.
- Përfiton nga kushtet e mira fizike dhe mendore, ka mendim pozitiv për veten, ndjenjë të lartë vetëvlerësimi, mekanizma përballues, rregullim të emocioneve dhe shprehi sociale, etj.

FAKTORËT MBROJTËS MJEDISOR (TË JASHTËM)

- Ekzistenca e lidhjeve të sigurta me kujdestarët/prindërit.
- Prindër, të cilët janë model i pështatjes së mirë në jetë dhe model i sjelljeve të duhura.
- Kujdestarë që ofrojnë ngrohtësi dhe mbështetje dhe te të cilët fëmijët mund të besojnë.
- Njerëz që u vendosin kufij fëmijëve, me qëllim që këta të mos përfshihen në rreziqe.
- Njerëz që nxisin fëmijën të mësojë si t'i bëjë vetë gjërat dhe ku të kërkojë ndihmë kur ka probleme.
- Prania e familjes mbështetëse, miqve dhe mbështetja e komunitetit, përfshirë dhe grupet fetare.
- Vendosja e një rutine për shembull, ndjekja e shkollës.
- Gëzimi i së drejtës për strehim, higjienë dhe kujdes mjekësor.
- Gëzimi i së drejtës për arsimim dhe/ose mundësive ekonomike.
- Mjedise miqësore për fëmijën, duke stimuluar mundësitë për të mësuar dhe zhvilluar.

Të mbajmë mend:
Mos e shpërfill rrjetin “informal” për mbrojtjen e fëmijëve në “lagje”. Rrjeti mbështetës informal, social, përfshin aktorë të rëndësishëm që ndodhen pranë fëmijëve. Këta mund të jenë një shok, gjyshja, prindi, mësuesi, kafsha etj., apo cilido me të cilin fëmija ka krijuar marrëdhënie besimi. Këto mund të jenë burime dhe mekanizma të rëndësishëm, ku mund të mbështetesh për të marrë masa në mbrotje të fëmijëve!

Ndërhyrja psiko-sociale synon nxitjen e 12 aftësive të mëposhtme:

1. Atashim i sigurtë me kujdestarët;
2. Lidhje të forta me shokët dhe shprehi sociale;
3. Besim në vetvete dhe te të tjerët;
4. Ndjenja e përkatësisë;
5. Vetëvlerësimi, zhvillimi i konceptit për veten dhe zhvillimi i identitetit;
6. Aftësia për të gjetur dhe për të përdorur mundësitë;
7. Optimizmi për të ardhmen;
8. Vetefikasiteti;
9. Të qenit i aftë për të përjetuar ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve, ndryshimi i mënyrës së të parit të gjërave;
10. Zgjidhja e problemeve dhe të menduarit e orientuar drejt gjetjes së zgjidhjeve;
11. Aftësia përshtatëse, mekanizmat për t’u përballuar me streset e jetës;
12. Shprehja e emocioneve dhe rregullimi i tyre.

UDHËZIMI 5: Mendoje fëmijën si një aktor që ka mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm mbrojtës, që mund të aktivizohen dhe përforcohen.

Përmbledhje

Pesë udhëzime për t'i patur parasysh kur ndërtoni një plan veprimi dhe masat konkrete ndërhyrëse me fëmijët dhe familjet.

- **UDHËZIMI 1:** Përdor një mënyrë trajtimi sistemike (komplekse, tërësore) të integruar;
- **UDHËZIMI 2:** Krijo marrëdhëniet e besimit;
- **UDHËZIMI 3:** Zbato veprime të përshtatshme për moshën e fëmijës;
- **UDHËZIMI 4:** Kushtoji rëndësi çështjeve të gjinisë;
- **UDHËZIMI 5:** Mendoje fëmijën si aktor dhe bazohu në burimet ekzistuese të tij.

Pika kontrolli

Përpiqu t'ju përgjigjesh pesë pyetjeve të mëposhtme. Për të parë nëse je përgjigjur saktë, kthehu te kapitujt korrespondues.

1. Si ndikon zhvillimi i shëndetshëm i fëmijës në kuptimin e çrregullimit të një fëmije të stresuar?
2. Jep një shembull se si mbarëvajtja e fëmijës është e ndërvarur nga mbarëvajtja e kujdestarëve parësorë dhe anasjelltas.
3. Pse është e rëndësishme të përfshijmë meshkujt në kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve? Si mund të përforcojmë përfshirjen e tyre në mbrojtjen e fëmijëve?
4. Fëmijët e së cilës moshë do të nxitnit të merrnin pjesë në mbrojtje të vetes së tyre?
5. Rendit pesë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm mbrojtës.

5 Ndërhyrjet e përqendruara te fëmija

Seksioni i mëposhtëm ndalet te ndërhyrjet individuale dhe në grup, me dhe për fëmijët. Të gjitha veprimet e propozuara, synojnë krijimin e mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve në mjediset pranë tyre, si dhe forcimin e mekanizmit të vetëmbrojtjes te fëmija.

5.1 Hyrje

Fëmijët dhe loja

Fëmijët krijojnë lidhjen me botën përmes lojës. Edhe pse të rriturit mendojnë se lojërat janë një humbje kohe, në të vërtetë, ato janë pjesë përbërëse e zhvillimit normal të fëmijës. Nëpërmjet lojës, fëmijët mësojnë si të përballen me mjedisin dhe realizojnë zhvillimin e tyre mendor, emocional e shoqëror. Për shembull, duke luajtur me blloqe, ata zhvillojnë aftësitë e tyre motorike. Pikërisht nëpërmjet lojërave, ata mësojnë si të negociojnë, shkëmbejnë përvojat dhe respektojnë rregullat. Duke luajtur me fëmijë të tjerë, ata mësojnë si të komunikojnë mirë dhe si të diskutojnë problemet me të tjerët. Loja është në fakt "puna" e fëmijëve, është puna që zhvillon mendjen dhe trupin e tyre dhe kështu rriten mirë.

Për më tepër, fëmijët shprehin me anë të lojës atë çka nuk mund ta shprehin me gojë. Ata zhvillojnë aftësi për mendimin simbolik në një moshë të hershme dhe kjo shprehet nëpërmjet lojës. Sa herë që një fëmijë vizaton një pikturë të shtëpisë, ose luan me kukulla ose "aktron", ai shpreh aftësi të të menduarit simbolik. Në të njëjtën kohë, me anë të lojës fëmijët shprehin edhe shqetësimet, pra është mënyra më e mirë për të kuptuar se ç'po iu ndodh.

Historitë që tregojnë fëmijët zakonisht, na shpjegojnë se si e kuptojnë botën dhe se si ndjehen.

Për të gjitha ndërhyrjet e përqendruara te fëmijët, ki parasysh si të komunikosh me ta.
Siç kemi vërejtur edhe më parë, fëmijët komunikojnë në mënyra të ndryshme, ata nuk mund të bisedojnë si të rriturit. Kur flet me ta, duhet të ulesh në nivelin e tyre. Ulu pranë tyre ose përkulu që të mos flasësh në distancë. Shpesh fëmijët reagojnë ndaj tonit të zërit më shumë se ndaj fjalëve, kështu që përpiquni të flisni me zë të ëmbël.

Inkurajoni fëmijën të bëjë pyetje. Dhe kur ju bëni pyetje, bëjini të hapura, kështu do të merrni më shumë informacion. Mos kritikoni apo gjykoni fëmijët për reagimet e tyre. Jini të ndershëm kur i jepni informacion fëmijëve, por as mos i mbysni me fakte të rriturish.

Ka mënyra të ndryshme për të bërë ndërhyrje për mbrojtjen e fëmijëve. Pjesa e mëposhtme do të japë disa ide. Specialistët për Mbrojtjen e Fëmijëve, duhet të përcaktojnë me fëmijën dhe kujdestarët parësorë, metodat më të përshtatshme për çdo rast individual. Sa herë të jetë e mundur, krijo një lidhje me fëmijën nëpërmjet aktiviteteve me lojëra!

5.2.1 Këshillimi

SMF-ja mund të ofrojë këshillime mbi shprehitë analitike dhe shprehitë lidhur me zgjidhjen e problemit. Këshillimet mund të bëhen individualisht, në grup ose në ambjente familjare.

- **Nxisni fëmijët të flasin për përvojat dhe vështirësitë**
  Fëmijëve u duhet dhënë mundësia të diskutojnë për përvojat e tyre në një mjedis të sigurtë dhe të përshtatshëm. Organizoni aktivitete që u japin mundësi fëmijëve të diskutojnë për përvojat e tyre. Kjo mund të përfshijë një sërë metodash, si verbale dhe joverbale, dhe ndërmerrni projekte të ndryshme (për shembull, vizatime, histori, muzikë, dramë dhe regjistrim audio e videosh) me individë dhe grupe.

- **Jepni informacion për mekanizmat e përballimit të stresit.**
  Aktivitetet duhet t'u mësojnë fëmijëve si të përdorin shprehitë për zgjidhjen e problemit në situata stresante. Inkurajoni fëmijët të

zhvillojnë metoda reale dhe pozitive, që rrisin aftësinë e tyre për të menaxhuar ankthin dhe vështirësitë në jetën e përditshme.

5.2.2 Diskutimet në grup

Diskutimet në grup mund të bëhen në mjedise të vogla, me të gjithë klasën ose një grup të veçantë fëmijësh. Ata mund të përqendrohen në parandalimin e sjelljeve të rrezikshme, abuzimin me drogën, kontrollin e lindjes, dhunën mes shokëve apo probleme të tjera, të lidhura me mbrojtjen e fëmijëve.

- **Punoni veçanërisht me adoleshentët.**
  Lejojini pjesëmarrje me një kohë më të gjatë me bashkëmoshatarët në grupet e tyre të diskutimit ose në një formë gjysëm të mbikëqyrur të këtyre grupeve. Kjo mund të bëhet duke organizuar grupe diskutimi në vende të hapura, në klube sporti apo në shtëpi. Inkurajoni më shumë ndjenjën e tyre të përgjegjësisë për veprimet që bëjnë, sesa ushtrimin e një kontrolli më të madh prej kujdestarëve.

Shembuj pyetjesh për disuktimet në grup mbi përballjen me rreziqet:

- Cilat janë rreziqet me të cilat përballesh në shkollë?
- A mendon se siguria jote fizike është në rrezik? Kur? Pse?
- Cili është burimi i rrezikut? Kush është përfshirë?
- Çfarë të shqetëson kur largohesh nga shtëpia apo shkolla?
- A ke ndonjë shqetësim për prindërit? Po për motrat dhe vëllezërit? Miqtë?
- A jeni në dijeni të ndonjë incidenti/problemi që ka kërcënuar miqtë tuaj?
- Çfarë mund të bëhet për këtë?
- Si mendoni se mund të përmirësohet situata? Si i përballni ju dhe miqtë tuaj këto rreziqe?
- Çfarë shërbimesh dhe aktivitetesh janë të disponueshme për t' ju ndihmuar të largoni këto rreziqe? Si mund t'ju ndihmojnë?
- Si mendon se mund të ndihmosh për të zgjidhur situatën?
- Kujt do t'i drejtoheshe nëse do të ishe i shqetësuar për sigurinë e një shoku apo tënden?

Shembuj pyetjesh për diskutimet në grup mbi parandalimin e dhunës:

1. Përmendni disa vende ku ndjeheni të sigurtë dhe vende të tjera ku nuk ndjeheni të sigurtë (bëni një listë në bllok).
2. Çfarë do të thotë "dhunë" për ju? Ose, cili është përkufizimi i dhunës sipas jush?
3. Më thoni një shembull të një rasti dhune që keni parë në shkollë?[1]
4. Çfarë e shkakton dhunën? (Dëgjoni nëse përmënden: alkooli, droga, ngacmimet (dhuna e ushtruar) nga moshatarët, të qenit i abuzuar në të kaluarën; nxitini nëse është e nevojshme).
5. Pse disa njerëz janë viktima të dhunës?
6. Çfarë mund të bëhet për të shmangur dhunën?
7. Çfarë mund të bësh për të ndihmuar dikë që është viktimë e dhunës?
8. Disa njerëz shkaktojnë dhunë. Janë të dhunshëm me të tjerët. Çfarë mund të bësh për të ndihmuar ata që shkaktojnë dhunë?
9. Çfarë mund të bëjnë të tjerët për të ndaluar dhunën?
   a. Prindërit.
   b. Personeli shkollor.
   c. Policia dhe organet e detyrimit ligjor.
   d. Të tjerë.
10. Po të ishit në gjendje të bënit diçka për të ulur dhunën në shkollën tënde, çfarë do të ishte kjo?

5.2.3 Kujdesi i fëmijëve për bashkëmoshatarët

- × **Diskutime në grup**
  Fëmijët me probleme të ngjashme përpiqen të ndihmojnë njëri-tjetrin nëpërmjet sesioneve interaktive në grup.
- × **Mbështetja individuale mes bashkëmoshatarëve**
  Në disa raste udhëzohet të përfshihen shokët, këshilli i nxënësve, anëtarë të grupeve të vëzhgimit apo të krijohet një sistem "shoqërimi dysh" (me motrën a vëllain më të madh), për të zbutur ankthin dhe përmirësuar mbrojtjen e një fëmijë në mjedisin e shkollës.

1 Bëni kujdes kur të përgjigjen. Nëse pjesëmarrësit fillojnë të flasin për dhunën personale në familje, duhet t'iu kujtosh se po flisni për shkollën. Fol më vonë individualisht pas sesionit. Nëse dëgjon shembuj dhune, duhet t'i raportosh. Mos lejo që të kthehet në një vend ku tregohen histori të frikshme dhune, por një forum ku identifikohen zgjidhjet. Mendo për zgjidhje por mos thekso aktin e dhunës.

Sistemi i "shoqërimit dysh" (me motrën/vëllain e madh) ka rezultuar, në shumë situata, një metodë e vlefshme për të angazhuar nxënësit të mbrojnë të tjerët.

SHEMBULLI 1: Një nxënës ka vështirësi në shkollë dhe për këtë caktohet një nxënës tjetër ta ndihmojë me lëndën. Rezultati: Rritet niveli në shkollë.
SHEMBULLI 2: Një nxënës sapo ka ardhur në atë zonë. Një vëlla apo motër e madhe caktohet të prezantojë nxënësin e ri me lagjen dhe ta ndihmojë në procesin e integrimit. Rezultati: Hidhet hapi i parë për rrjetin shoqëror të shokëve.
SHEMBULLI 3: Një nxënës ka frikë të shkojë vetëm në shtëpi pas shkolle. Caktohet një vëlla/motër e madhe për ta shoqëruar fëmijën. Rezultati: Zhduket ankthi.

Grupet e vëzhgimit të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve
Anëtarët e kështillit të nxënësve dhe/ose një grup tjetër i caktuar nxënësish të të gjitha moshave dhe klasave, mund të trajnohet për problemet psiko-sociale dhe të formojnë "grupin vëzhgues të shkollës". Kjo skuadër do të mbështetet nga një anëtar i komitetit të prindërve, personeli mësimor dhe me mbështetjen e Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve. Ata ndihmojnë në identifikimin e fëmijëve në nevojë, në organizimin e aktiviteteve parandaluese në shkollë, në lidhje me problemet e mbrojtjes së fëmijëve dhe në ndihmën ndaj fëmijëve në nevojë, si integrimi i një të sapoardhuri apo sistemi i shoqërimit me një më të rritur.

Dhjetë pyetje që mund të diskutohen për të organizuar grupin e vëzhgimit të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve:

1. Nëse do të ishe përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, çfarë lloj ndryshimesh do të bëje për të përmirësuar sigurinë e fëmijës në komunitetin e shkollës?
2. Nëse mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve që janë në sistem, do të merrnin një çmim, cili do të ishte ai?
3. Nëse do të ishe moderator, ç'pyetje tjetër do t'i bëje grupit?
4. Çfarë do t'i thoje një miku të mirë apo familjes për mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve në shkollën tuaj?
5. Pandeh sikur mbrojtja e fëmijëve në shkollë të fliste, ç'do të thoshte për veten?

6 Nëse do të ndryshoje një gjë për mbrojtjen e fëmijëve në shkollën tuaj, çfarë do të ndryshoje dhe cila është arsyeja kryesore kur diçka ka nevojë për ndryshim?
7 Çfarë do të donte rrjeti i mbrojtjes së fëmijëve në shkollën tuaj për të qenë i sigurtë dhe që fëmijët të ishin të sigurtë?
8 A mund të thuash pesë gjëra pozitive rreth shkollës tënde, sado të vogla të jenë ato?
9 Nëse do të ishit ju të përgjegjshëm për përmirësimin e "mbrojtjes së fëmijëve" brenda shkollës, cilat janë pikat më të rëndësishme ku do të përqendroheshit?
10 Çfarë duhet të dish për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë që të pranosh ose refuzosh të marrësh pjesë në një grup vëzhgimi?

5.2.4 Profili i burimeve individuale dhe pikave të forta ("vizioni optimist" për të ardhmen)

Përpuno me fëmijën një profil të burimeve individuale dhe pikave të forta dhe përcakto një "vizion optimist" për të ardhmen. Përdor Intrumentin në **ANEKSIN 6** ose metoda të ngjashme për të punuar me fëmijët në një projekt individual, asisoj që ai/ajo të përjetojë vetefikasitetin dhe të zhvillojë ndjenjën e shpresës për të ardhmen.

5.2.5 Aktivitete në formë lojërash të strukturuara

SMF-ja mund të ofrojë aktivitete në formë lojërash individuale ose në grup, që organizohen për të ndihmuar fëmijët të shprehin ndjenjat e tyre në mënyrë krijuese, në praninë e një të rrituri. Loja është mjet jetësor për të ndihmuar fëmijët të eksplorojnë dhe zhvillojnë në mënyrë të sigurtë përvojat e tyre. Vizatimi dhe shprehja në mënyrë krijuese e vetvetes, si aktivizimi në lojë, mund të ndihmojë të krijohet një ide mbi nevojat, shqetësimet, idetë dhe mendimet që kanë fëmijët, dhe të sigurohet

informacion si me anë të përmbajtjes ashtu edhe të procesit (këto teknika mund të përdoren, gjithashtu, si mjete rivlerësimi).

- **Përdor lojëra dhe teknika shprehëse**
  Shumë pak fëmijë janë në gjendje të ulen dhe të flasin drejtpërsëdrejti. Ndonjëherë ata shprehin shqetësime jo drejtpërsëdrejti, por nëpërmjet lojës. Disa aktivitete që mund të ndërmerren përfshijnë:

  - **ART:** Vizatimi, modelimi me argjilë, duke bërë një person ose familje dhe më pas fëmija krijon një histori për ta. Krijimi i pikturave murale me temë nga grupi ose komuniteti.
  - **TEATRI:** Teatër në rrugë, kërcim dhe vallëzim. Fëmijët tregojnë histori, të rriturit i ritregojnë me një fund të lumtur.
  - **SHFAQJE ME KUKULLA:** Ndërveprim i lirë me kukulla dhe lojë me role.
  - **LOJËRA NË GRUP/SHKËMBIME BRENDA GRUPIT:** Lojëra rrëshqitëse, me top ose sporte.
  - **NDËRTIME LODRASH DUKE PËRDORUR MATERIAL TË RICIKLUAR:** Kanaçe, letra, letra higjenike, etj.
  - **LOJË ME PERSONAZHE:** Lojë me personazhe për strategjitë përballuese.
  - **TË SHKRUARIT:** Ditare me ngjarje dhe emocione, poema, tregime.
  - **TEKNIKA QETËSIMI:** Ushtrime për të marrë frymë thellë, lojëra aktive, qetësim muskujsh, etj.

Kini parasysh parimet e mëposhtme kur të përdorni teknikat e sipërpërmendura:

- Lejoni fëmijët të bëjnë interpretimin e tyre, nëpërmjet aktiviteteve të lojërave, por jini të gatshëm të bisedoni me ta nëse loja ju çon në mënyrë të natyrshme drejt bisedës.
- Uluni në nivelin e fëmijës, luani edhe në dysheme, po qe e nevojshme.
- Imagjinojeni veten në situatën e fëmijës dhe shiheni botën nga sytë e tyre.
- Përfshini prindërit dhe mësojuni të kuptojnë se si fëmijët shprehin ndjenjat dhe frikën nëpërmjet lojës.

5.2.6 Aktivitetet çlodhëse dhe aktivitetet bazë psiko-sociale në formë loje[1]

A Hyrie

Aktivitetet bazë psiko-sociale përdoren si pjesë e procesit, dhe jo si objektiva finalë Ata synojnë zhvillimin e aftësive jetësore, përforcimin e aftësive ripërtëritëse dhe nxitjen e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve, si individë, anëtarë të komunitetit të shkollës dhe qytetarë. Nga këto aktivitete çlodhëse dhe psiko-sociale, pritet që fëmijët të përmirësojnë gjendjen e tyre **fizike, mendore** dhe **sociale**.

Aktivitetet psiko-sociale bëjnë të mundur që fëmijët të eksplorojnë perceptimin e tyre për botën dhe këndvështrimin për realitetin. Është e rëndësishme që fëmijët të konsiderohen si aktorë të projekteve të tyre dhe të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur në aktivitete planifikimi, animimi dhe vlerësimi, si dhe në rutinën ditore të aktiviteteve psiko-sociale brenda mjedisit shkollor. Personeli i animimit që punon me fëmijë, duhet të pranojë rëndësinë që ka fjala e fëmijëve, t'i aktivizojë ata aktivisht, të nxisë dhe t'u japë hapësirë kontributit të tyre dhe t'i bëjë zotër të aktiviteteve.

Kur dhe ku duhet të kryhen aktivitetet psiko-sociale?
Aktivitetet bazë psiko-sociale në shkollë ose komunitet, mund të organizohen ose animohen nga qeveria e nxënësve, grupet e vëzhgimit të nxënësve ose klasat individuale, me mbështetjen e një mësuesi, Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve, prindërve, anëtarëve nga komiteti i prindërve apo vullnetarë të tjerë. Aktivitetet psiko-sociale duhet të jenë pjesë e rutinës së përditshme në shkollë. Këto aktivitete do të organizohen për një grup të veçantë fëmijësh (aktivitete për një grup të caktuar) dhe mund të organizohen nga Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve. Një mësues mund të përfshijë në planin javor një aktivitet me objektiv psiko-social për të nxitur dhe zhvilluar besimin dhe bashkëveprimin në klasë. Një grup nxënësish mund të organizojë aktivitete çlodhëse për nxënësit e tjerë gjatë kohës së pushimit ose pas shkolle.

1 Movement, Games and Sport Manual. Lausanne, Terre des hommes, 2006.

Seksioni i mëposhtëm përshkruan **metodologjinë, planifikimin/ organizimin, animimin** dhe **vlerësimin** e aktiviteteve me lojëra psiko-sociale.

B

Kategoritë e aktiviteteve
Ka lloje të ndryshme aktivitetesh bazë psiko-sociale. Ato mund të ndahen në tre kategori. Për çdo aktivitetet, do të gjeni një shembull në faqen në vazhdim.

a **Aktivitetet fizike**
Ku përfshihen lojëra dhe sporte të lira. Nëpërmjet veprimit të drejt-përsëdrejtë, fëmijët përjetojnë kënaqësi dhe siguri të menjëhershme (shih shembullin në faqen 151).

b **Aktivitetet artistike krijuese**
Ku përfshihen muzika, drama dhe punimet me dorë. Nëpërmjet interpretimit të skenarëve të ndryshëm dhe bërjes apo dizenjimit të gjërave, krijohet një mjedis kreativ i të mësuarit (shih shembullin në faqen 152).

c **Aktivitetet edukative**
Përfshhen lojërat me rregulla, leximi dhe leksionet mbi higjenën, shprehitë themelore shëndetësore dhe jetësore. Nëpërmjet strukturës dhe udhëzimit, mund të formohen ose përforcohen shprehitë sociale (shih shembullin në faqen 152).

Aktivitet fizik

Rrugë kryesore dhe rrugë dytësore (Çlodhje/Nxemje)
Ky është një aktivitet fizik në vijim të temës së bashkëpunimit, për çka flitet në aktivitetet e mëparshme.

Synimi: Të inkurajohen fëmijët që të punojnë së bashku.

Objektivi:

- × Fëmijët duhet të punojnë së bashku për të arritur një qëllim të përbashkët.
- × Fëmijët të gjallërohen fizikisht.
- × Fëmijët të çlodhen dhe shtensionohen.
- × Fëmijët të argëtohen.

Metodat

1. Njëri nga fëmijët është ndjekësi, ndërsa tjetri është i ndjekuri (macja dhe miu).
2. Fëmijët e tjerë formojnë katër rreshta paralelë, secili fëmijë qëndron larg tjetrit sa largësia e një krahu, aq sa gishtërinjtë e tij të prekin me gishtërinjtë e fëmijës pranë (krahët e shtrirë, gishtat prekin ato të tjetrit).
3. Secili fëmijë duhet të rrijë pas fëmijës përpara, në të njëjtën largësi si nga fëmija në krah dhe nga ai përpara – si një rrjetë. Shembull (× = një fëmijë).

× × × × × **FËMIJËT ME FYTYRË NGA: RRUGA KRYESORE**
× × × × ×
× × × × × **FËMIJËT ME FYTYRË NGA: RRUGA DYTËSORE**
× × × × ×

4. Animatori thotë **RRUGA KRYESORE**, dhe të gjithë fëmijët drejtohen në atë anë, me gishtërinjtë që prekin sa largësia e një krahu.
5. Macja duhet të ndjekë miun lart e poshtë rrugës, pa shkëputur krahët që formojnë rreshtat në asnjë anë – ato vetëm mund të hyjnë e të dalin në cepat e rrjetës.
6. Animatori mund ta ndryshojë drejtimin në çdo kohë dhe të thërrasë **RRUGA DYTËSORE**, në këtë çast fëmijët duhet të kthehen djathtas dhe macja duhet të ndjekë miun si më parë.
7. Sa herë që animatori thërret në **RRUGË KRYESORE** apo në **RRUGËN DYTËSORE**, fëmijët duhet të bëjnë një gjysëmrrotullim, duke ruajtur të njëjtin pozicion, por duke ndryshuar drejtimin.
8. Zëvendëso macen dhe miun me fëmijë të tjerë, që secili të mund ta provojë.

Përpiqu që të ruash ekuilibrin mes aktiviteteve të lira dhe atyre të drejtuara prej teje. Konkretisht, jepu fëmijëve mundësinë të luajnë dhe të shprehen lirshëm, por përfshiji ata edhe në ushtrime më të vështira nën drejtimin tënd.

Aktivitete artistike krijuese

Statujat dhe fotografitë
(Aktivitet kryesor – psikologjik – edukativ) 5-18 vjeç
Ky aktivitet vijon nga loja "Ngriva" dhe ka rezultat nëse bëhet menjëherë pas tij. Ai bazohet tek ushtrimet "Imazhi" të ideuara nga Augusto Boal. Lutemi, shihni për këtë "Lojërat për aktorë dhe joaktorë" te Seksioni i Referencave.

Synimi:
- × Të inkurajohen fëmijët të punojnë së bashku.
- × T'u mësohet se ç'është drama dhe roli në dramë.
- × Të eksplorohet një ide, temë apo qëndrim në mënyrë vizuale/joverbale.

Objektivi:
- × Fëmijët të punojnë së bashku për të arritur një qëllim të përbashkët.
- × Fëmijët të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të mësojnë si të deshifrojnë imazhet pa fjalë.
- × Fëmijët të lëvizin fizikisht dhe të përdorin imagjinatën e tyre pa folur.
- × Fëmijët të mësohen të pranojnë idetë që të tjerët u ofrojnë.

NR. FËMIJËVE: Grup prej 5 ose 7 vetash.

Metodat:
1. Në varësi të faktit nëse doni që fëmijët të eksplorojnë një temë (për shembull, '"Miqësia") apo thjesht të argëtohen, gjej një fjalë të thjeshtë që atyre do t'u thoshte diçka.
2. Në qoftë se jeni në vazhdim të lojës "Ngriva", shqipto fjalën tënde si fjalën e fundit në lojë, për shembull, "Miqësia". Në të kundërtën, kërkoju fëmijëve të ngrinë "Miqësinë". Lojën "Ngriva", mund ta luani dhe në fillim.

3 Kur fëmijët janë në çastin e Ngrirjes, nëse janë në një pozicion jo të rehatshëm, thuaju ta ndryshojnë pak pozicionin.
4 Kërkoju të mbajnë në kujtesë pozicionet e tyre të fundit dhe ku ata janë në lidhje me pozicionin e të tjerëve.
5 Thuaji një grupi ta ndalojë ngrirjen dhe të pushojnë pak.
6 Fëmijët e tjerë tani janë të lirë të vijnë rrotull imazhit të ngrirë dhe ta shikojnë atë nga të gjitha anët, por PA PREKUR GJË!
7 Kërkoju fëmijëve të tregojnë se çfarë shohin, duke u bërë pyetje të hapura. Për shembull, "Çfarë po ndodh këtu!" Çfarë po bën Meri!" "Ç'do të thotë kur dikush mban në duart e veta duart e tjetrit." etj. Dhe në fund, "Çfarë ju pëlqeu në figurën që ka krijuar grupi?"
8 Vepro kështu me të gjitha grupet, duke bërë vlerësimin e punës së secilit grup dhe duke diskutuar atë që shikoni.

Alternativat

Ju mund të ndaleni këtu, ose ta shfrytëzoni si një pikë nisjeje për dramën dhe lojën aktoriale, duke shfrytëzuar si më poshtë:

1 Merr një imazh të ngrirë dhe kërkoju fëmijëve të ngrijnë për një çast në të ardhmen, ose një orë, ose dy minuta në të shkuarën. (Po të doni ju mund të përdorni gjuhën e një regjistruesi videoje – "Shko përpara, ndalo, kthehu prapa).
2 Ngrije veprimin në çfarëdo kohe, fut edhe zë po të duash – "Nëse Meri do të fliste në këtë çast, çfarë do të thoshte ajo?" ose, "Meri, çfarë je duke menduar këtu?" etj., në varësi të nivelit të pozicionit të grupit.
3 Në qoftë se jeni duke eksploruar një temë të vështirë, përpiquni të eksploroni rrugën nga një imazh (shokët duke u ndeshur) në imazhin tjetër (ku shokët pajtohen), duke diskutuar për secilën skenë.
4 Kur të mbaroni, diskutoni me fëmijët mbi këtë aktivitet.

Është e rëndësishme që në fund të këtij ushtrimi, të zhvilloni një aktivitet fizik, pasi ai ka kërkuar shumë përqendrim.

Aktivitet edukativ

Zip, Zap, Zop (Nxemje) mbi 8 vjeç

Synimi:

× Të thyhet akulli mes pjesëmarrësve të rinj.
× Të inkurajohen fëmijët të punojnë së bashku.

Objektivi:

× Fëmijtë të vënë në lëvizje trupin e tyre.
× Fëmijët të shfrytëzojnë kontaktin me sy.
× Të rritet shkalla e ndërgjegjësimit të grupit.

Metodat:

1 Të gjithë formojnë një rreth, ku secili të shikojë shokët pa dalë nga rrethi.
2 Bashkojmë pëllëmbët e duarve me gishtat përpara.
3 Imagjinoni sikur doni të kaloni një rrymë të padukshme elektriciteti përgjatë rrethit, ku të doni, prapa, përpara apo përmes rrethit.
4 Për të percjellë elektricitetin, ju duhet të thoni ose ZIP ose ZAP! ose ZOP! Duke treguar me duart tuaja të bashkuara njeriun të cilit doni t'ia përcillni
5 ZIP! për t'ia përcjellë elektricitetin personit që ndodhet në të majtë apo të djathtën tuaj.
6 ZAP! për t'ia përcjellë një personi që ndodhet dy vetë më larg (në rreth apo në krah të fqinjit tënd).
7 ZOP! për t'ia kthyer atë personit që ta nisi (ZOP, si të ishte pasqyrë).
8 Ju duhet të krijoni kontakt me sy me personin që dëshiron të bësh ZIP? ZAP ose ZOP!
9 Veprimi ZOP vë në punë të gjithë trupin. Duart ngrihen lart, gjunjët lëvizin dhe teksa bëni veprimin, ju duhet të thoni fjalën ZOP!

Udhëzime:

1 Mos lejoni që të njëjtët fëmijë t'i përsërisin njëri-tjetrit ZIP apo ZAP më shumë se tri herë, përndryshe ata do të luajnë vetëm me njëri-tjetrin, duke lënë pa luajtur të tjerët.
2 Vëre theksin te kontakti me sy dhe te gjuha e trupit.

Përmbledhja e rregullave:

- × Kontakt me sy! Vënie në lëvizje e trupit!
- × ZIP pranë vetes, ZAP larg teje!
- × JO MË SHUMË se 3 ZIPE ose ZAPE me të njëjtin person!
- × Ti nuk mund të ZOP-osh një ZOP!

A

Metodologjia për aktivitetet psiko-sociale

"Më fol për diçka por do ta harroj; më trego për të dhe mbase do ta mbaj mend; më përfshi mua dhe do ta kuptoj."

Metodat zbavitëse dhe eksperimentale

Nëpërmjet metodave zbavitëse dhe eksperimentale ju mund të bëni që në mënyrë progresive fëmijët të kalojnë në një nivel të ri të të kuptuarit. Lojërat edukative janë pjesë përbërëse e universit të fëmijës, ato janë të nevojshme për zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe psikologjik. Lojërat mund të jenë krejtësisht çlodhëse, si edhe mjete të vlefshme për të stimuluar zhvillimin në fusha të caktuara.

Ka klasifikime të ndryshme të lojërave. Ky manual bazohet në sistemin e klasifikimit universal, që rrjedh nga psikologjia gjenetike. Klasifikimi i ndan lojërat në katër kategori, respektivisht:

- × **LOJËRA ME USHTRIME:** Që lejojnë lëvizjen dhe manipulimet e thjeshta (krismat, lojërat me tinguj, etj.)
- × **LOJËRA SIMBOLIKE:** Që lejojnë të besosh dhe të imitosh; lojëra me personazhe, teatër (kukulla, makina lodra, kafshë, mjekë, etj.)
- × **LOJËRA MONTIMI:** Që lejojnë fëmijën të kombinojë elementë, ndërtime (lojërat me bashkim pjesësh, etj.)
- × **LOJËRA ME RREGULLA:** Që mësojnë fëmijën me rregulla dhe udhëzime, që duhet të ndjekin (arsyetimi logjik, përpunimi i strategjive).

Të gjitha këto lojëra mund të luhen lirshëm (për shembull, vetë fëmijët të zgjedhin kategorinë e lojës që iu intereson, si dhe kur duan ta luajnë pa praninë e një të rrituri) ose të organizuara (si, me një animator, edukator, mësues, etj.). Idealja është nëse gjendet një raport i drejtë mes tyre.

Shembulli i dhënë në manual përqendrohet në kategorinë e lojës, lojërat me rregulla, që kërkojnë nga fëmija që të ndjekë udhëzimet, të respektojë rregullat dhe të punojë me strategjitë, të gjithë këta elementë të rëndësishëm të procesit të shoqërizimit.

Të gjitha lojërat kërkojnë aktivizimin e trupit dhe të shqisave. Në mënyrë që fëmija të mësojë, këto lojëra kanë nevojë për praninë e një të rrituri për t'i udhëzuar. Faqet vijuese i adresohen kujtdo që organizon dhe animon aktivitetet zbavitëse dhe psiko-sociale me fëmijët për të ndihmuar në zhvillimin e shprehive psiko-sociale të fëmijëve.

Mjedisi shkollor është një mjedis mësimor, ku nëpërmjet lojërave, nuk transmetohen vetëm njohuri, por arrihen dhe objektiva më të mëdha edukative. Aktivitetet psiko-sociale me lojëra, mund të përdoren për të ndihmuar fëmijët të bëhen aktorë aktivë në komunitetin e shkollës dhe qytetarë të përgjegjshëm.

Aktivitetet psiko-sociale me lojëra, janë një mjet i fuqishëm pasi e përfshijnë të gjithin fëmijën:

a koka është komanda, sepse duhet të mendojnë, të vlerësojnë strategjitë dhe të marrin vendime të shpejta;
b trupi është lëvizja, stimulohen shqisat;
c zemra është është pjesa më e rëndësishme në kontrollin e emocioneve dhe në zbatimin e vlerave thelbësore.

a **Çdo aktivitet ose lojë e nxit fëmijën të zhvillojë kapacitetin e tij intelektual.**
   - × Aftësinë për t'u përqendruar, për të vëzhguar, për të parashikuar, etj.
   - × Aftësinë për të menduar, për të zbatuar një strategji, për të marrë një vendim, etj.

b **Çdo aktivitet përfshin lëvizjen, çka zhvillon aftësitë fizike:**
   - × Fizike: Fleksibiliteti/forca/durimi/rezistenca/shpejtësia;
   - × Koordinimi: Orientimi/reagimi/diferencimi/ritmi/drejtpeshimi.

Këto kategori janë të sugjeruara nga specialistët, të cilët, sipas studimeve, përcaktuan pesë shprehi kryesore koordinimi si dhe pesë shprehi motorike. Nga pikëpamja fizike, zhvillimi i përgjithshëm i drejtpeshuar i fëmijës, varet nga të praktikuarit e lëvizjeve sa më të larmishme që të jetë e mundur, nga zotërimi i shprehive të koordinimit, baza e të gjithë sporteve, si dhe nga shprehitë specifike fizike, pa nënvlerësuar asnjërën prej tyre.

c **Çdo aktivitet ndihmon në zhvillimin e shprehive psiko-sociale, që çojnë drejt menaxhimit më të mirë të emocioneve dhe lidhjeve sociale, për një kooperim më të mirë me fëmijën.**
   - × Shprehitë personale: Vetëvlerësimi, entuziazmi, krijimtari, përgjegjësi, ndershmëri, vendosmëri, etj.
   - × Shprehitë sociale: Besimi te të tjerët, respekti, ndjeshmëria, komunikimi, angazhimi, kooperimi, etj.

DUART	KOKA	ZEMRA
Shprehitë fizike	**Shprehitë mendore**	**Shprehitë shoqërore**
× Forca	× Krijimtaria	× Intuita
× Shpejtësia	× Vëzhgimi	× Përgjegjshmëria
× Fleksibiliteti	× Parashikimi	× Ndershmëria
× Durimi	× Vendimi	× Respektimi i rregullave
× Rezistenca	× Përqendrimi	× Respekti
× Orientimi	× Strategjia	× Bashkëpunimi
× Reagimi	× Zgjidhja e problemit	× Komunikimi
× Ritmi		× Ndjeshmëria
× Drejtpeshimi		× Besimi
		× Entuziazmi
		× Gëzimi
		× Vetëvlerësimi
		× Vendosmëria

Këto aftësi mund të zhvillohen nëpërmjet lojërave të bazuara në konkurencë ose bashkëpunim (për më shumë informacion shih **KAPITULLIN 5.3**). E dimë se bota ku jetojmë është fokusuar në konkurencë dhe se fëmijët spontanisht e vendosin veten në situata konkurente të shëndetshme, ose jo. Ky udhëzues do të ilustrojë se si të rriturit e ngarkuar për zhvillimin e aktiviteteve, mund të nxisin situata ku fëmijët bashkëpunojnë për të mësuar se si të respektojnë njëri-tjetrin dhe të punojnë së bashku. Bashkëveprimi është një nga vlerat bazë të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Prandaj, është përgjegjësia jonë si të rritur, të gjejmë drejtpeshimin mes lojërave konkurente dhe bashkëvepruese.

Të mësuarit përmes përvojës

Metodologjia e sugjeruar frymëzohet nga metoda “Të mësuarit përmes përvojës”. Kolbi ka përpunuar konceptin e ciklit të mësimdhënies së përbërë nga 4 hapa:

FIGURA 1 **CIKLI I TË MËSUARIT NGA KOLBI**

Procesi i të mësuarit mund të nxitet nëpërmjet përvojës personale, dhe më pas, përmes reflektimit. Nëse objektivi i një animatori është të theksojë anën shplodhëse (zbavitëse) të lojës, atëherë ai, ose ajo, do të drejtojë në mënyrë klasike, duke dhënë udhëzime dhe duke i lënë fëmijët më pas të luajnë dhe të shkarkojnë tensionin. Kjo është një mënyrë deduktive, që zbatohet shpesh në shkollë.

Megjithatë, nëse synimi i animatorit është të theksojë një metodë të mësuari të veçantë, ai mund të përdorë një metodologji tjetër, një mënyrë induktive, që integron dhe zhvillon tre nivelet; mendore (koka), fizike (trupi), emocionale (zemra).

HAPI 1 **Përvojë konkrete**

Për të përforcuar të mësuarit, është e nevojshme një përvojë konkrete fizike (trupi) dhe emocionale (zemra).

HAPI 2 **Vëzhgimi dhe reflektimi**

Përvoja e trupit dhe e mendjes ndiqet nga një reflektim verbal (mendja), që ndodh në çastin e diskutimit ose korrigjimit. Në praktikë, loja ndahet në pesë faza kryesore, që ndiqen nga koncepti i shpjeguar më sipër, në një cikël të vazhdueshëm:

1. **SHPJEGO:** Prezanto një aktivitet për shembull, lojë, shumë shkurt.
2. **SHEMBULL:** Demonstroje së bashku me një tjetër ose një grup të vogël, ndërsa të tjerët ju shikojnë.
3. **EKSPERIMENTI A:** Fëmijët praktikojnë dhe/ose luajnë në grupe të vogla, pa konkurrencë.
4. **SHPJEGO:** Ndalo aktivitetin (lojën), shpjego çdo gjë që ka nevojë për korrigjim dhe nënvizo qëllimin e lojës.
5. **EKSPERIMENTI B:** Fëmijët praktikojnë ose luajnë përsëri, gjatë kësaj kohe, e duke pasur ndërmend objektivin, ata mësojnë!

Disa pyetje kryesore që mund të bëjnë animatorët gjatë fazës së çlodhjes janë:

- × A kishte vështirësi gjatë lojës? Mund të shpjegosh arsyen?
- × Çfarë të ndihmoi të arrije objektivin? Çfarë nuk të ndihmoi? Cilat qëndrime ndihmuan apo vështirësuan ecurinë e lojës? Ju lutem, i përshkruani.
- × Çfarë mësove për veten dhe të tjerët? Ju lutem, i përshkruani.
- × Si u ndjetë gjatë lojës? Mund të shpjegosh arsyen?

Tri fazat e ciklit të aktivitetit:

FIGURA 2

NXEMJA	AKTIVITETI KRYESOR	ÇLODHJE
PERGATITJA	**AKTIVITETI O SE LOJA**	**SA ËSHTË KUPTUAR PËRMBAJTJA**
Hyrie	Arritja e objektivës kryesore	Pyetje Qetësim

HAPI 3 **Teoria dhe konceptet**

Për të bërë që fëmijët të hedhin një hap tjetër në procesin e të mësuarit, përvoja lidhet me njohurinë teorike ose konceptet dhe përpunohet më tej.

SHEMBULL: Gjatë një aktiviteti, fëmijët stërvisin të menduarit strategjik. Ata reflektojnë pse të menduarit strategjik mund të jetë i rëndësishëm dhe se ku i zbatojnë ata këto aftësi në jetën e përditshme. Ose: Klasa ka zhvilluar një lojë bashkëpunimi. Tani diskutojnë pse bashkëpunimi është një vlerë e rëndësishme kur punon dhe jeton së bashku me të tjerë. Ata identifikojnë gjithashtu se në cilat anë të tjera të jetës është i rëndësishëm bashkëpunimi.

HAPI 4 **Zbatimi**

Tani fëmijët përpiqen të zbatojnë shprehitë që mësuan në situatat e jetës së përditshme.

SHEMBUJ: Çdo fëmijë përpiqet të zbatojë të menduarit strategjik në jetën e përditshme dhe e shkëmben atë me anëtarët e tjerë të grupit të diskutimit në sesionin tjetër ose:

Fëmija cakton objektiva se si të përforcojë bashkëpunimin në klasën e vet. Nga grupi i fëmijëve nën drejtimin e mësuesit, zbatohen, ndiqen dhe vlerësohen hapa konkretë.

Pesë parimet metodologjike

1 OBJEKTIVAT

- × Komunikoju fëmijëve në fillim të leksionit objektiva të qarta;
- × Përcakto objektiva të qarta fizike;
- × Përcakto objektiva të qarta psiko-sociale;
- × Objektivat i përshtaten grupmoshës (jo shumë e lehtë, as shumë e vështirë);
- × Objektivat mund të përmbushen në kohën e disponueshme dhe shikohen si sjellje të qarta.

2 TRE HAPAT E TË MËSUARIT

- × Gjatë aktiviteteve përdor tre hapa të mësuari: Eksperimenti 1, korrigjimi, eksperimenti i 2-të.
- × Bëj korrigjime individuale dhe kolektive, gjatë dhe pas aktivitetit.
- × Jepu kohë fëmijëve të përsërisin dhe përmirësojnë ushtrimet dhe lëvizjet.
- × Ji kërkues dhe korrigjo fëmijët derisa të arrijnë cilësinë e pritshme.

3 SHKALLËZIMI

- × Gjatë leksionit rritet vështirësia e ushtrimeve.
- × Ka një lidhje logjike midis ushtrimeve.
- × Fëmijët mund të mësojnë në mënyrë të shkallëzuar (graduale).

4 PJESËMARRJA

- × Përdor grupe të vogla me sa më shumë material të jetë e mundur.
- × Ndaje grupin në grupe më të vegjël, që fëmijët të mund të jenë gjatë gjithë kohës aktivë.
- × Fëmijët janë gjithmonë aktivë në ushtrime, u lihet pak kohë për pushim.
- × Fëmijët kanë mundësi të luajnë çdo rol në lojë.

5 LARMI

- × Ndaje në mënyrë të barabartë kohën e të mësuarit dhe ndryshimin e ushtrimeve.
- × Ndryshoje organizimin midis aktiviteteve individuale, në çift, grupe të vogla dhe të mëdha.
- × Ushtrimet kanë kohëzgjatje të përshtatshme (jo shumë të gjata, që fëmijët të mos mërziten/as shumë të shkurtra, ku të mos kenë kohë të mësojnë).
- × Fëmijët janë të motivuar dhe argëtohen gjatë aktiviteteve.
- × Sugjero ushtrime origjinale dhe lojëra të reja.

D **Objektivat e aktiviteteve psiko-sociale**

Ky seksion përmban objektivat pedagogjike të aktiviteteve psiko-sociale (mendore, psikologjike dhe fizike). Aktivitetet zakonisht s'duhet të kenë më shumë se dy objektiva.

Shprehitë zhvillohen përmes kokës – zemrës – duarve.

TË MENDUARIT	TË NDJESH	TË BËRIT
Shprehitë mendore: × vëzhgimi × parashikimi × vendimi × përqendrimi × strategjia × kreativiteti	**Shprehitë personale:** × entuziazmi × gëzimi × vetëvlerësimi × vendosmëria × përgjegjësia × ndershmëria × respektimi i regullave **Shprehitë sociale:** × respekti × bashkëpunimi × komunikimi (verbal dhe joverbal) × ndjeshmëria × besimi	**Shprehitë koordinuese:** × orientimi × reagimi × ritmi × drejtpeshimi **Shprehitë fizike:** × forca × shpejtësia × fleksibiliteti × durimi × rezistenca **Shprehitë e lojërave me top:** × të japësh dhe të marrësh × triblimi × mbrojtja × vizioni anësor × lokalizimi i mirë

Objektiva dhe shembuj të mençur:

× **SPECIFIKE** të përshkruara me shumë saktësi
× **TË MATSHME** sjellje të vëzhgueshme
× **TË PËRSHTATSHME** që i përshtaten grupit (as shumë të lehta, as shumë të vështira)
× **REALISTE** të mundshme për t'u arritur
× **TË ARRITSHME** të mundshme për t'u arritur në kohë

Shembull: Loja e shtrigës:

× **QËLLIMI:** Shtrigat duhet të magjepsin të gjithë lojtarët, duke i prekur/lojtarët duhet të lirojnë personat e magjepsur, duke i përqafuar.
× **RREGULLAT:** Të ecin jo të vrapojnë/të qëndrojnë në heshtje, të mos flasin.
× **ROLET:** Një shtrigë për pesë lojtarë.

× **MATERIALE:** Nuk ka nevojë për material/të përcaktohen kufijtë e vendit të lojës.



Objektiva e lojës së shtrigave

Stërvit shprehitë mendore:

× Strategjia e shtrigave: Të punojnë së bashku, të magjepsin të gjithë lojtarët/strategjia midis viktimave: Të mbrojnë dhe lirojnë veten.

Stërvit shprehitë psiko-sociale:

× Respekti dhe besimi: Kontakti fizik.
× Ndershmëria dhe përgjegjshmëria; respekti për rregullat.
× Bashkëpunimi.

Stërvit shprehitë fizike:

× Reagimi.

Fakti i thjeshtë i pjesëmarrjes në këto lojëra, nuk do të bëjë që fëmija të zhvillojë shprehitë e përmendura. Një animator duhet të ketë aftësi të forta personale dhe sociale, si dhe një metodologji të mirë për të arritur këto objektiva.

E

Modeli i veprimit me tre faza

Objektiva e aktiviteteve psiko-sociale është të zbatohen modele veprimi me tre faza: **a) PLANIFIKIMI – b) ANIMIMI – c) VLERËSIMI**. Animatorët duhet të dinë si të planifikojnë një aktivitet me tre pjesë dhe ta zbatojnë në lloje të ndryshme aktivitetesh përfshi lojëra psiko-sociale dhe aktivitete të tjera rikrijuese.

Modeli i veprimit me tri faza:



Planifikimi dhe organzimi i aktiviteteve (shembull)

Fleta e planifikimit të aktivitetit

1. Organizimi

FLETA E PLANIFIKIMIT TË AKTIVITETIT – BESIMI DHE KOMUNIKIMI JOVERBAL
EMRI I AKTIVITETIT (I JUAJI OSE I FËMIJËVE): Treni i vogël i verbër
DATA, ORA DHE PROGRAMI I AKTIVITETIT: 1.45 – 2 pasdite
NUMRI DHE MOSHA E FËMIJËVE: 20 fëmijë, 9 vjeç
PAJISJET: S'ka nevojë për materiale
OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT (CILAT SHPREHI DO TË ZHVILLOSH?):

PSIKO-SOCIALE: Të zhvillosh komunikimin joverbal dhe besimin. Lojtarët që mbajnë sytë e mbyllur, duhet të përqendrohen dhe të besojnë ata me sytë e hapur, të cilët janë përgjegjës për grupin. Ndershmëria është e rëndësishme vetëm për ata me sytë e mbyllur.

FIZIKE: Koordinimi i trupit në hapësirë.

PËRSHKRIMI (për çfarë aktiviteti bëhet fjalë? Si do t'ua shpjegosh fëmijëve?) Lojtarët rreshtohen njëri pas tjetrit në grupe nga katër ose pesë, me duar të vendosura te supet e personit që kanë përpara. Ai që është në fund, lokomotiva, i mban sytë e hapur, të tjerët, vagonat, i mbajnë sytë e mbyllur. Lojtari i fundit drejton trenin, duke dhënë udhëzime joverbale nëpërmjet prekjes:

- × për të shkuar drejt, shtyp me të dyja duart njëkohësisht supet e lojtarit përpara, i cili bën të njëjtën gjë, derisa mesazhi arrin te personi i parë, i cili fillon të lëvizë.
- × për të shkuar djathtas, shtyp supin e djathtë;
- × për të shkuar majtas, shtyp supin e majtë;
- × për të ndaluar i heq të dyja duart nga supet (kontakti i pushimit);

Qëllimi i lojës është të ecësh rrotull në një vend të caktuar dhe trenat të mos përplasen me njëri-tjetrin.

PËRSHKALLËZIMI: Për ta bërë lojën më të vështirë, mund të vesh një pengesë ku çdo tren i vogël të kalojë pa e prekur. E njëjta lojë mund të bëhet me shpejtësi ose me trena më të gjatë e me më shumë lojtarë.

REKOMANDIME: Animatori duhet të këmbëngulë te përqendrimi, saktësia e mesazheve dhe butësia e kontaktit. Për të kompensuar mungesën e shikimit, tentohet të forcohet kontakti fizik. Vështirësia është në vonesën e kohës midis dhënies së komandës dhe fillimit të lëvizjes. Prirja është të merret mesazhi, te kuptohet dhe të kryhet lëvizja para se komanda të transmetohet. Presioni nuk duhet të jetë i vazhdueshëm, por të kalojë sa më shpejt dhe qartë nga lojtari i fundit te lojtari i parë, i cili i bindet. Shpesh, kur luhet për herë të parë, trenat përplasen me kinse me njëri-tjetrin, megjithëse synimi është që kjo të shmanget. Është mirë që t'i kujtosh fëmijëve se kjo lojë është për të fituar besimin te të tjerët dhe ata te ty. Meqë rolet janë të ndryshëm (mesi, fillimi, fundi), është e rëndësishme të ndryshosh pozicion, që të gjithë të kenë role të ndryshme.

Diskutim

- × Cili ishte roli yt i preferuar? Mund ta shpjegosh?
- × Cili pozicion ishte më i lehti? Mund ta shpjegosh përse?
- × A ishte e vështirë të besoje symbyllurazi?
- × A kishte ndryshim midis lokomotivave? Mund ta shpjegosh?
- × Cila ishte mënyra më e mirë për të shmangur trenat e tjerë? Çfarë strategjjish përdore? etj.

	KOHA	AKTIVITETET	ORGANIZIMI
Nxemja/ prezantimi	5 min	× Mirëseardhja & prezantimi me lojën × Formimi i grupeve × Rregullat e lojës × Prova e parë me sy të hapur për të parë nëse pjesëmarrësit i kuptuan rregullat.	× Udhëzime dhe rregulla për lojën × Pajisjet: materialet për të rregulluar fushën
Pjesa kryesore	10 min	× Treni i verbër fillon të lëvizë (niveli I) × Diskutimi i shkurtër (I) × Përshkallëzimi (niveli i vështirë I I)	-
Qetësimi, diskutimi	5 min	× Diskutim i shkurtër mbi përvojat dhe objektivat mësimore të lojës.	× Fleta e përgatitjes së aktiviteteve me pyetje për diskutim dhe objektiva

Hapat e ardhshëm:

Teoria dhe konceptet: Grupi i fëmijëve kërkon të gjejë se çfarë të shtyn të besosh te një person? Më pas, çdo fëmijë shkruan emrat e 5 personave, te të cilët ai ka patur besim gjatë jetës së tij. Ata reflektojnë mbi karakteristikat e këtyre personave që i shtyjnë të besojë.

ZBATIMI: Tani fëmijët përpiqen të jenë njerëz të besueshëm.
Listë e përgjithshme kontrolli për organizmin e aktiviteteve psikosociale

Mjete

- Burime materiale dhe fizike (pajisje).
- Fleta planifikimi aktivitetesh për mënyrën e kryerjes së tyre.
- Formularë të dhënies së pëlqimit nga prindërit (shiko shembullin në aneksin 9).
- Rregullat kryesore për aktivitetet, këto duhet të vendosen nga vetë fëmijët.
- Formularë, si dosje fëmijësh, lista me grupe, programe.
- Udhëzime mbi takimet me personelin e animimit për të shkëmbyer mendime mbi procedurat dhe zbatimin.
- Kodin e sjelljes që duhet firmosur nga i gjithë personeli i animimit.
- Përcakto një dokument me "standarde minimale të sjelljes", bashkë me personelin dhe fëmijët. Kjo duhet të përfshijë rregullat, për shembull, detyrat e pastrimit, magazinimi i pajisjeve dhe përgjegjësia për kutinë e ndihmës së shpejtë. Përfshi emrat e personave, të cilëve u duhen raportuar problemet që kanë të bëjnë me sigurinë, mbrojtjen e fëmijës dhe ndihmën e shpejtë. Shpërndaje listën gjatë aktiviteteve që ta kenë të gjithë.

Standardet minimale të sigurisë që duhen mbajtur parasysh kur organizohen aktivitete.

- Terreni nuk duhet të ketë objekte të rrezikshme, gota, mbeturina etj.
- Duhet të ketë vend të mjaftueshëm për fëmijët që të vrapojnë.
- Duhet të ketë ujë, që fëmijët të lajnë duart dhe të pinë.
- Duhet të ketë tualet, një për vajza, një për djem.
- Duhet të ketë sipërfaqe të forta (dyshekë sporti, tavolina, dysheme me çimento), ku fëmijët të ulen të vizatojnë.
- Duhet të ketë fikëse zjarri dhe të mirëmbahen.
- Duhet të ketë ngrohësa dhe ventilatorë, nëse është e nevojshme.
- Duhet të ketë kuti të ndihmës së shpejtë, si dhe person të trajnuar dhe përgjegjës për të. Për të shmangur rrezikun e mbipërdorimit, kutia nuk duhet të ketë ilaçe (qetësues dhimbjesh) si paracetomol, anadin apo nurofen, nuk duhet të ketë locione, spraj ose kremra që të djegin. Çdo ilaç që i jepet fëmijës, duhet dhënë nga prindi ose mjeku.
- Çdo fëmijë duhet të ketë gotën e tij dhe ujë të pijshëm.

Animimi

Ki parasysh që animatori është një person që ofron ndihmë në kreyrjen e aktivitetete Përgjegjësitë që i besohen atij, janë shumë. Prandaj, ai duhet të luajë rolet e mëposhtëm:

1. Të respektojë orarin.
2. Të ruajë vetëkontrollin.
3. Të jetë shembull i asaj që thotë.
4. Të jetë i disponueshëm për fëmijët.
5. Të dijë kufizimet dhe aftësitë e tij.
6. Të vlerësojë veten.
7. Të jetë i qëndrueshëm në përfshirje.
8. Të jetë i durueshëm gjatë gjithë kohës.
9. Të jetë proaktiv dhe të mbrojë fëmijët.
10. Të mësojë gjatë gjithë kohës.
11. Të jetë i komunikueshëm.
12. Të respektojë rregullat.
13. Të ketë dialog të përhershëm me fëmijët.
14. Dëgjon fëmijët dhe përshtat metodat sipas nevojave të tyre.
15. Udhëzon fëmijën të marrë vendime.
16. Mëson fëmijët të respektojnë të tjerët, mjedisin dhe pronën private.
17. E do fëmijën.
18. Ndihmon në krijimin e një mjedisi miqësor për fëmijën.
19. Kontrollon aktivitetet, njohurinë dhe aktivitetet e kërkuara.
20. Merr përsipër kujdesin fizik, mendor, emocional, social dhe moral për fëmijën.

Vlerësimi i aktiviteteve psiko-sociale

Vlerësimi nga fëmijët

Çdo sesion duhet të ndiqet nga një çast i vogël vlerësimi me fëmijët, për të verifikuar nëse u përmbushën objektivat. Komentet individuale dhe të grupit, mund të mblidhen me metoda të ndryshme dhe argëtuese. Sigurohuni që objektivat e caktuara të jenë realiste dhe përcaktoni qysh më parë se si do t'i matni, nëse i përmbushët ato apo jo. Për më tepër informacion mbi aktivitetet psiko-sociale me fëmijët, lexo dhe **KAPITULLIN 5.4**.

Vetëvlerësimi
Plotëso vetëvlerësimin pas çdo sesioni dhe cakto objektiva personale për t'i përmirësuar.

Vlerësimi nga shokët
Për të përmirësuar aftësitë dhe kompetencat tuaja profesionale, mund të shërbejnë shumë mirë komentet e shokëve.

Mbikqyrja
Mbikëqyrësit duhet të japin mendimin teknik rregullisht për të nxitur zhvillimin profesional dhe për të rritur cilësinë e aktiviteteve.

5.3 Konkurenca dhe bashkëpunimi

Seksioni i mëposhtëm nënvizon përparësitë dhe jopërparësitë e konkurencës dhe bashkëpunimit. Gjithashtu prezanton karakteristikat e lojës konkuruese dhe asaj bashkëpunuese. Prezanton edhe se si një lojë konkuruese mund të modifikohet dhe transformohet në lojë bashkëpunuese.

Konkurenca:
PËRKUFIZIMI POZITIV: "Është forca e brendshme e çdo qenie njerëzore që e shtyn drejt rritjes".

Ky lloj konkurimi pozitiv është përqendruar te **DETYRA**. Synimi është të bëhet diçka, të arrihet një **objektiv**.

Ai kërkon tre elementë themelorë:
- Respekt për tjetrin.
- Synimin për të qenë i shkëlqyer.
- Pranimin e përgjegjësisë dhe lirisë vetjake (për të qenë i përgjegjshëm për fitoren, duhet të jesh i përgjegjshëm për dështimin dhe gabimet e mundshme.)

Përkufizimi negativ
"Është nevoja për të qenë më i mirë, më i fortë se të tjerët dhe t'i eleminosh këta të fundit".

Ky lloj konkurimi negativ është përqendruar te **PERSONI**.
Synimi është të eliminohen, të ulen të tjerët.

Rrënjët e kësaj lloj konkurence janë:
- × Mungesa e vetëvlerësimit;
- × Nevoja për t'u njohur;
- × Frika nga dështimi.

PËRPARËSITË	JOPËRPARËSITË
Kënaqësia e të përpjekurit	Fitorja e më të mirit
Tejkalimi i mundësive	Frika nga dështimi
Respekti për kundërshtarin	Agresiviteti

Përkufizimi i bashkëpunimit

Përkufizimi
"Është kapaciteti për të punuar me të tjerë në një aktivitet/lojë/projekt, ku çdo njeri ndihmon për të arritur objektivat, në varësi të aftësive të tij dhe ku çdo person respektohet për veçanërinë e tij."

Ka pasur shumë kërkime për bashkëpunimin dhe një nga zbulimet është që fëmijët mësojnë më shumë kur punojnë në grup. Bashkëpunimi ndihmon të mësosh!

Një aktivitet ose lojë konsiderohet si BASHKËPUNUESE, kur:
1. Jep kënaqësi dhe argëtim,
2. Ka ndërvarësi pozitive të fëmijëve, njerëzit dinë se kanë nevojë për njëri-tjetrin për të arritur objektivat.
3. Pranohet tjetri dhe pa paragjykime.
4. Ka përgjegjësi individuale dhe përfshirje kolektive.
5. Zhvillohen shprehi psiko-sociale:
   - × besimi
   - × vetëvlerësimi
   - × komunikimi
   - × drejtimi

- ndjeshmëria
- negocimi
- vendimmarrja
- komente pozitive

Një aktivitet ose lojë bashkëpunuese në grup ndjek parimet e mëposhtme:

- Aktiviteti ose loja ka si objektiv motivimin;
- Të gjithë kanë nevojë për njeri-tjetrin për të përmbushur objektivat;
- Të gjithë pranohen dhe vlerësohen për aftësitë e tyre;
- Nuk ka gjykim apo kritizëm;
- Të gjithë marrin pjesë aktivisht;
- Të gjithë përjetojnë sukses;
- Askush nuk përjashtohet apo eliminohet nga loja;
- Askush nuk ka lindur për të qenë i veçuar;
- Kushdo është përgjegjës për veten dhe grupin.

Aftësia për të bashkëpunuar kërkon njohuri për veten dhe tjetrin, besim te vetja dhe tjetri, si dhe komunikim të mirë (vëzhgim, dëgjim dhe shprehi) me tjetrin.

Nga konkurimi te bashkëpunimi

PËRJASHTIMI	→	**INTEGRIMI**
FITUES-HUMBËS	→	**NJË GRUP I VETËM**
SYNIMI INDIVIDUAL	→	**SYNIMI KOLEKTIV**

Shikoni shembullin e aktivitetit më poshtë.

FLETA E PLANIFIKIMIT TË AKTIVITETIT – LOJËRA NË GRUP II

EMRI I AKTIVITETIT (I JUAJI OSE I FËMIJËVE: Ishulli i peshkaqenit

DATA, ORA DHE PROGRAMI I AKTIVITETIT: 11.50 – 12.30

NUMRI DHE MOSHA E FËMIJËVE: 6 vjeç e sipër

PAJISJET: Materiale për të shënuar zonën e lojës

OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT (CILAT AFTËSI KËRKON TË ZHVILLOSH?):

PSIKO-SOCIAL: Të zhvillosh mënyrat e bashkëveprimit, respektin për të tjerët dhe besimin me anë të kontaktit fizik.

FIZIKE: Të përmirësosh ekuilibrin dhe pikat e forta, në varësi të strategjive të përdorura, si dhe rezistencën meqenëse loja përfshin vrapimin.

PËRSHKRIMI (për çfarë aktiviteti bëhet fjalë? Si do t'ua shpjegosh fëmijëve?) Loja ka nevojë për një zonë të caktuar, një tapet të vogël ose diçka që mund të zvogëlohet (litar, qese, etj). Nëse grupi është shumë i madh, ndaje në disa grupe të tjera me nga 6 në 10 lojtarë, të cilët luajnë njëkohësisht. Çdo grup ka nevojë për vendin e vet për të luajtur.

Animatori tregon një histori. Fëmijët janë në breg të detit duke luajtur në det (fëmijët bëjnë sikur notojnë). Kur peshkaqeni (imagjinar) vjen, roja e plazhit (animatori) fërshëllen njëherë (ose përplas duart) dhe të gjithë notojnë për te ishulli i sigurisë (tapeti), pa lënë asnjë këmbë në ujë. Por ishulli sa vjen e zvogëlohet. Kur animatori fërshëllen përsëri, fëmijët kthehen në ishull dhe asnjëri nuk duhet të rrijë jashtë. Nëse një ose më shumë fëmijë, rrinë jashtë (qoftë edhe një këmbë), i ha peshkaqeni, i gjithë grupi duhet të bëjë një ushtrim të përbashkët, si për shembull, të vrapojë tri herë rreth vendit. Fëmijët duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin që të qëndrojnë të gjithë të sigurtë në tapet.

REKOMANDIME: Niveli i vështirësisë varet nga numri i lojtarëve në çdo grup dhe zona e tapetit. Kjo menaxhohet nga animatori, duke vlerësuar aftësitë e lojtarëve. Animatori duhet të japë udhëzime të qarta, asnjë pjesë e trupit të lojtarëve nuk duhet të jetë jashtë ishullit. Është interesante të shikosh se si përparojnë strategjitë. Shpesh është prirja për të mos menduar për të tjerët. Për shembull, disa fëmijë do të ulen në tapet pa menduar t'i hapin vend të tjerëve. Egoizmi dhe altruizmi mund të jenë temat e diskutimit. Është e rëndësishme t'u kujtosh fëmijëve udhëzimet dhe t'i inkurajosh të flasin me njëri-tjetrin, për të gjetur strategji të vlefshme. Lojtarët duhet të pranojnë se do të prekin njëri-tjetrin dhe do të preken. Respekti dhe besimi janë aspektet e rëndësishme dhe animatori duhet t'i theksojë këto të fundit.

DISKUTIM PËRMBLEDHËS

- Cilat ishin qëndrimet e ndryshme të grupit? Ndihmuan njëri-tjetrin? Refuzoi njeri të bashkëpunonte? Mund të shpjegosh?
- etj.

5.4 Vlerësimi i aktiviteteve psiko-sociale me fëmijë

Për të verifikuar ecurinë, krijo një dosje për çdo fëmijë të përfshirë në aktivitete. Plotëso formularët respektivë bashkë me fëmijën. Monitoro fëmijën, duke përdorur metodën përfshirëse ku fëmija nënvizon perceptimin e vet për ecurinë e arritur dhe propozon objektiva zhvillimi që dëshiron të përmbushë.

Për të matur rezultatet e aktiviteteve psiko-sociale, mund të përdoren treguesit e mëposhtëm:

Fëmijët kanë arritur një mirëqenie fizike dhe janë në formë të mirë fizike:

- × Fëmija fle mirë;
- × Fëmija është i pastër;
- × Fëmija është i ushqyer;
- × Fëmija është i sigurtë, jo i frikësuar;
- × Fëmija kryen detyra të përditshme;
- × Fëmija shfaq aftësi të përshtatshme motorike.

Fëmija ka arritur një gjendje mirëqenieje shpirtërore dhe është më i qëndrueshëm ndaj rreziqeve:

- × Fëmija merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet shkollore;
- × Fëmija ka marrëdhënie të mira me prindërit;
- × Fëmija beson në vlerat shpirtërore;
- × Fëmija bën plane për të ardhmen;
- × Fëmija ka imagjinatë dhe ëndrra;
- × Fëmija mund të rregullojë emocionet;
- × Fëmija ka ndjenjë të lartë vetëvlerësimi
- × Fëmija mund të përballet me stresorët.

Fëmijët kanë një mirëqenie sociale dhe kanë fituar aftësi sociale:

- × Fëmija luan me fëmijë të tjerë (shkëmben lodrat, shfaq qëndrime proshoqërore, etj.).
- × Fëmija ka imazh pozitiv për vetveten (njohuri për veten) dhe vetëvlerësim;

- Fëmija është në gjendje të marrë vendime;
- Fëmija ka arritur gjendje pavarësie;
- Fëmija ka zhvilluar strategji për zgjidhjen e problemeve.

Përmbledhje

Ndërhyrjet e përqendruara te fëmijët synojnë të ndërtojnë mekanizmat mbështetëse për mbrojtjen e fëmijëve në mjediset e afërta të fëmijës dhe të përforcojnë mekanizmat vetëmbrojtjes te fëmija nëpërmjet aktiviteteve në formë lodrash, bazuar në të mësuarit eksperimental individual ose në grup.

Aktivitetet me lojëra psiko-sociale me fëmijët:

- Zhvillojnë aftësitë e fëmijës në mënyrë të plotë: koka (mendja), zemra (vlerat dhe ndjenjat), trupi (fiziku);
- I duhen përshtatur grupit të fëmijëve (nevojave të zhvillimit dhe t'i përshtatet gjinisë);
- Planifikohen sipas modelit me tri faza; planifikimi është po aq i rëndësishëm sa animimi dhe vlerësimi.
- Kanë objektiva të qarta për çdo aktivitet (për shembull, drama për të përmirësuar vetëvlerësimin dhe aftësitë e komunikimit).
- Duhen ndarë në tri pjesë (nxemja me ritualin e mirëseardhjes, pjesa kryesore me përshkallëzim, që kalon përmes të mësuarit, çlodhjes dhe komentet). Kjo strukturë është e rëndësishme për të ndihmuar fëmijët të përmirësojnë aftësitë e tyre.
- Organizohen lojëra argëtuese bashkëvepruese me një mision të përbashkët, integrimin e të gjithëve, suksesi i përbashkët, etj.
- Sigurohet një ekuilibër midis tre llojeve të aktiviteteve (fizike, krijuese, edukative), për t'ju përgjigjur interesave dhe nevojave të ndryshme.
- Planifikohen hapa progresivë, nga aktivitetet më të thjeshta tek ato më të vështirat.
- Përkrahet pjesëmarrja e të gjithëve (puna në çifte ose grupe të vogla që të gjithë të përfshihen dhe të kenë mundësi të mësojnë).
- Ndiqet procesi i të mësuarit të Kolbit.

Pikë kontrolli

Përpiqu t'ju përgjigjesh pesë pyetjeve të mëposhtme. Për të kontrolluar nëse përgjigjet janë të sakta, kthehu te kapitujt korrespondues.

1. "Loja është punë". Komento të lutem.
2. Cilat janë pesë llojet e aktiviteteve psiko-sociale që mund të organizohen për fëmijët?
3. Çfarë është sistemi i "shoqërimit dysh"? Çfarë janë grupet e vëzhgimit për mbrojtjen e fëmijëve?
4. Si mund t'i vlerësosh aktivitetet psiko-sociale me fëmijët?
5. Cilët janë tre hapat në organizimin e aktiviteteve psiko-sociale me fëmijët?

6 Ndërhyrjet e përqendruara te prindërit

Kapitulli i gjashtë përshkruan në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet që bëhen me dhe për prindërit, si dhe kujdestarët e tjerë parësorë. Të gjitha veprimet e propozuar, synojnë në krijimin e mekanizmave mbështetës për mbrojtjen e fëmijëve në mjedisin familjar të fëmijës dhe në përforcimin e rolit të familjes në mbrojtjen e fëmijëve të tyre.

6.1 Hyrje

Kujdestarët kryesorë janë njëri nga partnerët tanë më të rëndësishëm për zbatimin e planit të ndërhyrjes. Shpesh, ne kuptojmë se problemi i fëmijës e ka origjinën më shumë te njerëzit që e rrethojnë, sesa te vetë fëmija. Prandaj, reagimet sistemike (komplekse) për të ndihmuar prindërit që merren me stresin e tyre dhe për të zotëruar shprehitë pozitive të prindërimit, përbëjnë shpesh kyçin për të përmirësuar jo drejtpërdrejtë mbarëvajtjen e fëmijës. Ofro informacion mbi metodat e përballimit të sistuatave stresante, bëji prindërit të vetëdijshëm për praktikat e dëmshme abuzive dhe formo shprehi të reja pozitive të prindërimit. Gjithashtu, krijimi i një mjedisi të sigurtë, ku prindërit të shkëmbejnë me prindërit e tjerë përvoja të ngjashme, ka dhënë rezultate të mira.

Niveli i ulët arsimor i nënës, statusi i ulët shoqëror dhe ekonomik i familjes, lidhen me një sërë problemesh të mbrojtjes së fëmijëve. Mbështetja e nevojave sociale të një familjeje, mund të mos jetë në kompetencë të SMF-së. Prapëseprapë, SMF-ja mund të udhëzojë dhe ndihmojë prindërit se si të përfitojnë nga mundësitë për rritjen e të ardhurave, që ndihmojnë anëtarët e familjes të zhvillojnë ndjenjën e pavarësisë, vetëvlerësimit dhe kontrollit të jetës së tyre.

6.2 Aktivitetet psiko-sociale me prindërit ose kujdestarët e tjerë parësorë

6.2.1 Diskutimet në grup në mbështetje të prindërve

Shkëmbimi i përvojave me të tjerë, është një mënyrë për të përballuar jetën. Shkëmbimi i përvojave në formën e diskutimeve në grupe, mund të jetë një nga mënyrat më të mira për të inkurajuar prindërit të tregojnë historinë e tyre dhe të ndajnë me të tjerët problemet e tyre. Të dëgjuarit thyen izolimin e një personi dhe nxit prindërit të shkëmbejnë mendimet, ndjenjat dhe besimet e tyre.

Pse mund të jenë të vlefshme diskutimet në grup?
Të shprehurit ndihmon personin që:

- × Të ndjehet i lehtësuar;
- × Të mendojë më qartë mbi çfarë ka ndodhur;
- × Të ndjehet i pranuar, i dashur dhe vlerësuar nga personi (at) që e dëgjojnë;
- × Zhvillon konfidencën;
- × Ndërton vetëvlerësimin;
- × Kërkon mundësi ose zgjidhje për të marrë vendime më të mira;
- × Parandalon ndjenjat e këqija që shfaqen në formën e një sjelljeje të çuditshme, agresive apo faji.

Të shprehurit shërben si një bazë për:

- × Mirëkuptimin;
- × Ndërtimin e marrëdhënieve;
- × Ndërtimin e besimit;
- × Shpirtin bashkëpunes (veprimin në grup)
- × Ndryshimin personal;
- × Zhvillimin;
- × Veprimin.

Ofro informacion për mekanizmat e përballimit të stresit. Mekanizmat përballues, mund të përfshijnë:

- **FRYMËMARRJEN E THELLË.** Ul tensionin dhe rrit qetësimin e kontrollin.
- **BISEDA.** Bisedat me familjet dhe shokët ndihmojnë në përcaktimin dhe qartësimin e ndjenjave.
- **TË FOLURIT ME VETE.** Një mënyrë që të nxitësh veten në kohë të vështira.
- **MBLEDHJE INFORMACIONI.** Që të kuptohet dhe të trajtohet sa më mirë situata.
- **PLANET E EMERGJENCËS SË FAMILJES.** Të jesh i përgatitur për emergjenca të ardhshme.

Ofro informacion mbi problemet specifike të zhvillimit të fëmijës, si ankthi dhe sjellja agresive te fëmijët dhe si të trajtohen ato. Në anekset 10 dhe 11, do të gjeni informacion se si të punoni me prindërit e adoleshentëve për problemet specifike të zhvillimit të tyre dhe si të identifikohen problemet lidhur me adoleshencën.

6.2.2 Vizitat në familje

Të flasësh për problemin është vetëm gjysma e zgjidhjes. Vizitat në familje janë të rëndësishme për t'iu ofruar familjeve mbështetje këshilluese individuale dhe për të diskutuar mbi zgjidhjet e ndryshme, duke bërë plane pozitive dhe duke nxitur pjesëmarrjen. Ato mundësojnë diskutimin e hapur dhe të ndershëm të problemeve dhe çështjeve. **ANEKSET 4** dhe **5** mund të shërbejnë si mjete mbështetëse për të identifikuar natyrën e problemit, përsa i përket zhvillimit të fëmijës.

Rregulla për vizitat në familje:

- Përpiqu të kontaktosh me anëtarët e familjes në mjedisin e tyre familjar (aty ky ata jetojnë);
- Vëzhgo ndërveprimet midis anëtarëve të familjes, përpiqu të identifikosh konfliktet e mundshme apo kontradiktat për çka të kanë folur më parë;
- Vlerëso kushtet ekonomike;
- Përpiqu ta bësh vizitën sa më joformale të jetë e mundur, por, në të njëjtën kohë, mos bëj rolin e një miku, mbaj pozicionin tënd profesional;

- × Përpiqu të vëzhgosh, kuptosh dhe dëgjosh vështirësitë dhe vetëm atëherë jep këshilla;
- × Në rastet e dhunës së mundshme familjare, mos e vizito asnjëherë familjen vetëm.

6.2.3 Aktivitete çlodhëse dhe shprehëse

Aktivitetet çlodhëse dhe shprehëse për fëmijët, mund të jenë të ngjashme me ato të përmendura në **KAPITULLIN 5**. Por nëse jeni në dijeni të të rriturve që shfaqin simptoma të rënda, duhet t'i referoni te psikologu, ose struktura të tjera shtetërore, siç janë shërbimet sociale

6.2.4 Udhëzime se si të marrin ndihmën shëndetësore, ligjore dhe ekonomike

Disa prindër mund të mos jenë në dijeni të ndihmave të mundshme mjekësore, ligjore apo ekonomike. Ndihmoji të gjejnë këto burime për t'iu përgjigjur nevojave sociale të familjes. Gjithashtu, pajisi nënat me informacione mbi çështjet e grave, shtëpitë e strehimit për gratë e abuzuara, etj. Për më shumë informacion mbi ndihmën psiko-sociale të disponueshme sipas fushës, lexo **KAPITULLIN 3.2**.

6.2.5 Përfshirja e prindërve në mbrojtjen e fëmijëve të tyre në shkollë dhe në shtëpi

Seksioni i mëposhtëm nënvizon rolin dhë rëndësinë e përfshirjes së prindërve në jetën shkollore dhe si rrjedhim në mbrojtje të fëmijëve.

Prindërit dhe strukturat prindërore në shkollë, kanë një rol thelbësor në jetën shkollore dhe edukimin e fëmijës. Por, përfshirja e prindërve nuk është gjithmonë e thjeshtë. Bashkëpunimi me prindërit mbetet një sfidë për psikologët e shkollave, mësuesit dhe drejtorët.

Të gjithë veprimet në mbrojtje të fëmijëve, duhet të kenë një natyrë sistemike (tërësore) dhe shumëdimensionale dhe të përfshijnë komunitetin, prindërit dhe shkollën, për të krijuar një mjedis të plotë dhe koherent për fëmijët, çka u jep atyre një ndjenjë sigurie dhe rregullsie.

Si mund të inkurajosh prindërit të përfshihen në jetën shkollore?

- × Duke i ftuar prindërit të jenë pjesë në aktivitetet psiko-sociale dhe çlodhëse;
- × Duke mbajtur komunikim të drejtëpërdrejtë me prindërit;
- × T'i ftosh prindërit që të japin mësim me raste sipas përvojës së tyre dhe t'i vesh aftësitë e tyre në shërbim të shkollës, më qëllim që ata t'i ndjejnë punët e shkollës si të tyret dhe të marrin pjesë më shumë në procesin e edukimit të fëmijës së tyre.
- × T'i mbështesësh në krijimin e strukturave të komitetit të prindërve që të jenë efektive dhe të vlefshme;
- × Të organizosh ditën e vizitave të prindërve në shkollë;
- × Të shkëmbesh mendime për problemet dhe bashkëpunimin mbi çështjet mësimore;
- × T'u japësh këshilla edukative prindërve;
- × Të organizosh diskutime në grup mbi të drejtat e fëmijës, për zhvillimin dhe mbrojtjen e tij;
- × Të angazhosh prindërit në "grupe vëzhgimi të shkollës për mbrojtjen e fëmijëve";
- × Të përfshish prindërit në grupet shumëdisiplinore të task forcës në shkollë mbi çështje specifike të tilla, si për shembull, krijimi i një mjedisi miqësor për fëmijën;
- × Të trajtosh problemet e fëmijëve dhe problemet arsimore në organizmat përkatëse të shkollës;
- × Të ngresh çështjet mbi mbrojtjen e fëmijës në komunitet;
- × Të organizosh dhe nxitësh takime informale, si takime javore, marrje pjesë në aktivitetet me fëmijë (inaugurime, festime dhe festa kombëtare).

Këshilla

- × Mbaj parasysh dallimet kulturore për të shmangur tensionin me prindërit;
- × Mbaj marrëdhënie të ndershme me prindërit, nëpërmjet kontaktit dhe dhënies së saktë të informacionit;
- × Ji i hapur ndaj iniciativave të prindërve dhe shfaq përshtatshmëri në

përfshirjen e prindërve në komunitet;
- × Ndërto ura lidhëse midis shkollës dhe familjes së fëmijës.
- × Mos përqendro të gjithë informacionin në një ose dy prindër, ose vetëm në anëtarët e komitetit të prindërve, por, nëse është e mundur, shkëmbejeni me sa më shumë njerëz të jetë e mundur.

6.2.6 Zhvillimi i shprehive pozitive të prindërimit [1]

Nuk është e lehtë të jesh prind! Të gjithë prindërit përballen me sfida dhe vështirësi kur rrisin një fëmijë. Prindërit mund t'i kërkojnë këshilla Specialistit për Mbrojtjen e Fëmijëve gjatë vizitave në familje ose sesioneve individuale këshilluese apo diskutimeve në grup. Është e rëndësishme që me teknika të thjeshta të mësosh prindërit se si të ndihmojnë fëmijët të përballen me frikën dhe stresin. Përmirësimi i shprehive pozitive të prindërimit, bën pjesë në planin e ndërhyrjes. Seksioni i mëposhtëm do të trajtojë disa nga temat më të zakonshme për të ndihmuar prindërit: si të sillen me fëmijët që nuk binden, çfarë qëndrimi duhet mbajtur ndaj punës dhe jetës familjare, si të shmangen grackat dhe 10 rregullat e arta të prindërimit pozitiv.

Ekuilibri mes punës dhe jetës familjare

Në realitetin e sotëm të stresuar, puna le shumë pak hapësirë për jetën familjare. Çfarë ndodh nëse prindërit nuk janë në gjendje të ekuilibrojnë punën me jetën familjare?

Hapi i parë drejt arritjes së këtij ekuilibri, është të kuptosh rëndësinë që këto dy gjëra kanë në jetën tonë dhe mënyrën se si ato ndikojnë te njëra-tjetra. Nuk mund të thuash thjesht se, njëra është më e rëndësishme se tjetra, dhe as nuk mund t'i përcaktosh si role mashkullore dhe femërore.

Megjithëse puna shërben për të marrë të ardhura, ajo u jep të rriturve edhe aktivitet, sfida, shoqëri, mbështetje sociale dhe vetëvlerësim. Po ashtu, familja jonë na lejon të përjetojmë nevojën e rëndësishme humane për intimitet, çlodhje, argëtim dhe interesa, që nuk kanë të bëjnë me punën.

1 Ky seksion bazohet te burimi: Tri P-të, Program Pozitiv mbi rolin e Prindit (www.pfsc.uq.edu.au/02_ppp/ppp.html).

Mirëqenia jonë shpirtërore mund të kërcënohet nga stresi i punës, prodhimtaria e ulët, mungesat dhe aksidentet në punë. Në aspektin familjar, stresi i punës ndikon te modelet e komunikimit në familje, që reduktojnë ndarjen e roleve dhe rritjen e mosmarrëveshjeve. Stresi i punës së një partneri ka fuqinë të rrisë nivelin e stresit të partnerit tjetër dhe mund të çojë në sjellje të rrezikshme për shëndetin, si duhani dhe alkooli. Studimet tregojnë se rreth 40 për qind e burrave, të cilët punojnë me kohë të plotë, mendojnë se puna ndikon negativisht në jetën familjare.

Ndikimet e konfliktit në këto marrëdhënie, shkaktojnë reagime negative psiko-sociale, si te meshkujt dhe te femrat. Gratë mund të vuajnë nga melankolia, burrat abuzojnë me alkool dhe të dyja sekset përjetojnë çrregullime seksuale dhe probleme shëndetësore.

Problemet e sjelljes te fëmijët janë rezultate të mosmarrëveshjeve dhe vështirësive në marrëdhënie, në mungesën e të ardhurave të mjaftueshme financiare (papunësia), që çon në strese të mëtejshme.

Nga e gjithë kjo shohim se bota e punës dhe familjes, kanë fuqinë të ndikojnë seriozisht në cilësinë e jetës sonë dhe të atyre që na rrethojnë. Kuptohet, të zgjedhësh një partner, të vendosësh të bësh fëmijë, të gjesh një punë dhe të përballesh me punën, kërkon të kuptosh rëndësinë që kanë ato për mirëqenien tonë dhe përpjekjet e vazhdueshme për të ruajtur një ekuilibër të shëndetshëm.

Pra, si mund të arrijmë një ekuilibër midis punës dhe familjes?
Përpiqu t'i vlerësosh mirë përparësitë . Vendos çfarë është e rëndësishme dhe **jepi përparësi fëmijëve të tu**, që zhvillimi i tyre emocional të mos vihet në rrezik. **Ndihmo partnerin** të përballet me streset e pashmangshme të jetës. Fol me të për problemin dhe kërko zgjidhje realiste, të sigurtë dhe mos lejo që stresi i tij të ndikojë te ty.

Zhvillo aktivitete që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve dhe janë çlodhëse, që nuk rrisin stresin e të tjerëve. Ushtrimet e rregullta dhe dieta e shëndetshme, të ndihmon t'i shikosh gjërat më mirë. Përpiqu të ulësh stresin me anë të praktikave sa më të mira në punë, siç është shfrytëzimi sa më i vlefshëm i kohës. Kjo të ndihmon të fitosh kontroll. Sfido mendimet e këqia për veten, që mund të rrisin stresin.

Një fleksibilitet më i madh në organizimin e punës, mund të jetë i mundshëm, në varësi të natyrës së punës tënde. Nëse nuk është e mundur, bisedo me partnerin për **ndarjen e punëve familjare**, të cilat mund të lehtësojnë barrën.

Më në fund, sfida për të ekuilibruar punën dhe familjen, kërkon më shumë se përpjekjet individuale. Përveç vetë familjes, nëse ne si shoqëri dëshirojmë të përqafojmë anët pozitive të ndryshimit, na duhet të mendojmë seriozisht rreth rëndësisë së familjeve tona, vendit të tyre si edhe të punës në jetën tonë. Kjo kërkon politika dhe strategji, që t'i kushtojnë rëndësinë e duhur familjes, parimit të barazisë gjinore dhe më shumë fleksibilitet në lehtësimin e punës për gratë.

Si të merresh me fëmijët që nuk binden
Shumica e prindërve i japin ndonjëherë ndonjë dackë fëmijëve. Por kërkimet na tregojnë se, sa më shumë të qëllosh fëmijën, aq më shumë probleme me sjelljen do të ketë ai. Të goditurit mund të shërbejë si model agresioni, një sjellje që ne duam që fëmija jonë të jetë në gjendje ta kontrollojë.

Pra, a është abuzim me fëmijën po t'i japësh rastësisht një dackë për sjellje të keqe? Jo, nuk është. Ajo që prindërit duhet të kenë parasysh, është se çdo ndëshkim i rëndë, i paparashikueshëm i dhënë në çaste inati, si dackat, mund të jenë shumë të dëmshme për fëmijën. Çdo gjë që provokon inat, frikë dhe ndëshkim, mbart te fëmija rrezik.

Ndonëse një dackë e vetme, e rastësishme, për një sjellje të padëshiruar, nuk ka gjasa të bëjë që fëmija juaj të bëhet një i rritur agresiv, ajo është një mënyrë negative për t'u marrë me sjelljen e keqe. Dhe për fëmijët me probleme më të rënda në sjellje, kërkimet kanë treguar se dackat nuk janë shumë efikase.

Pra, si të merremi me sjelljen e keqe?
Së pari, **kjo është diçka normale**. Fëmijët janë humanë, jo engjëj dhe duhet që ta jetojnë të gjithë jetën brenda kufijve. Për fëmijët, këta **kufij duhet të jenë të drejtë dhe të përshtatshëm** dhe për sigurinë e tyre, duhet të mësojnë t'i pranojnë. Megjithatë, procesi i të mësuarit kërkon kohë. Mosbindja e një fëmije, nuk duhet konsideruar si problem në rast se nuk ndodh vazhdimisht, si për shembull, kur fëmija ndjek **më pak se gjysmën e udhëzimeve të dhëna**.

Prindërit do të hasin fillimisht mosbindjen, kur fëmija fillon të ecë. Bëhen të lëvizshëm dhe fillojnë të mësojnë pavarësinë dhe sigurinë. Fillojnë t'u rezistojnë prindërve. Kur u thua "jo", u duket si një lloj sfide. Është e rëndësishme të merresh me mosbindjen, **në mënyrë të sigurtë**

dhe vendimtare. Megjithatë, keqpërdorimi ose mbipërdorimi i dackave, do të shkaktonte dëme. Është si në rastet kur nuk i fut dot ndonjë dackë shefit kur t'i ngre nervat, prandaj përpiqu të gjesh një zgjidhje konstruktive ndaj konflikteve me fëmijët.

Gjej alternativa praktike dhe të vlefshme

Si fillim, sigurohu që të mos **japësh shumë udhëzime**. Kujtohu se sa herë i jep fëmijës një udhëzim për të bërë diçka, ka shumë mundësi të mos bindet. **Ji i qartë** për ato që thua dhe **sigurohu se fëmija të kuptoi** vërtet se çfarë i kërkohet. Nëse fëmija është i zënë duke parë televizor, duhet të pranosh se ka shumë gjasa të të shpërfillë, derisa të fitosh me qetësi dhe durim vëmendjen e tij.

Me fëmijët më të vegjël, kur shikon një problem në sjellje, lëre atë që po bën dhe afroju fëmijës dhe përkulu deri në nivelin e syve të tij. **Tërhiqi vëmendjen**, duke e thirrur në emër, duke i mbajtur dorën fort dhe thuaj "jo" me zë të qetë, ndërsa vrenjti vetullat dhe lëviz kokën nga një anë në tjetrën.

Me fëmijët më të rritur duhet t'i thoni specifikisht çfarë do që të mos bëjë dhe çfarë duhet të bëjë në vend të saj, **propozo alternativa**. **Mos ndrysho qëndrim** ndaj sjelljes jo të mirë dhe merr një **masë të logjikshme**, nëse fëmija juaj nuk bën atë që i kërkohet. Kur është e mundëshme, ndalo atë veprim apo atë lodër që shkakton problemin dhe shpjego pse po e bën këtë, "Alketa, ti nuk ke bërë atë që të kam thënë. Do ta fik televizorin për 10 minuta."

Mbi të gjitha, mos harro ta lëvdosh dhe shpërblesh fëmijën kur sillet mirë!

Gracka e prindit

A ndjehesh shpesh i inatosur, i turpëruar dhe në siklet nga sjellja e fëmijës tënd? A të duket sikur fëmija yt të irriton shpesh? A të është dashur ta kërcënosh dhe t'i bërtasësh që fëmija të bindet? A zihesh shpesh me prindërit e tu për mënyrën se si të sillesh me fëmijën?

Nëse përgjigja për disa prej këtyre pyetjeve është po, atëherë mund të kesh rënë në grackën e prindit.

Grackat e prindit janë mënyra të qëndrueshme të ndërveprimit me fëmijën, partnerin ose me mendimet tuaja të brendshme që e bëjnë edhe më të vështirë detyrën e rritjes së një fëmije. Ajo i shtohet stresit të përditshëm, që shumë prindër përjetojnë, duke dobësuar efikasitetin e punës me fëmijët problematikë.

Të gjesh strategji se si të edukosh fëmijën pa qenë nevoja të bërtasësh, pa krijuar konflikte stresuese dhe irritime, kjo kërkon **të mësosh si të motivosh pozitivisht fëmijën** nëpërmjet inkurajimit kur sillen mirë dhe punës në grup me partnerin mbi çështjet familjare.

Rezultati i një pune të tillë, çon në lehtësimin e ngarkesës së prindërve dhe kthimin e argëtimit dhe kënaqësisë në jetën familjare.

Pra, cilat janë ato "gracka" që mund të shfaqen në familjen tënde?
Gracka e kriticizmit ka lidhje me ngecjen në përpjekjen e shpeshtë e të panevojshme për pushtet mbi fëmijën, që e shtyn prindin të reagojë ndaj sjelljes me kritika të tepruara "Arian, lëre vëllain të qetë", kërcënim "Po e bërë dhe një herë, të piu e zeza", britma dhe më në fund rrahje. Kjo lloj disipline, shpesh dështon, pasi prindi krijon inat të furishëm, që çon në fyerje dhe armiqësi të mëtejshme midis prindit dhe fëmijës. Nëse këto lloje betejash përsëriten shpesh, është mirë të gjendet një mënyrë tjetër për të përmirësuar situatën.

Gracka e indiferencës ndodh në kombinimin me grackën e kriticizmit, ku prindërit nuk merren me fëmijën kur ata sillen mirë dhe luajnë të qetë. Nëse sjellja e mirë merret e mirëqenë dhe nuk inkurajohet aktivisht, kjo do të përsëritet më pak në të ardhmen dhe ka mundësi të zëvendësohet me sjelljen e keqe, ndaj të cilës tregohet më shumë vëmendje. Një parim bazë i qëndrimit pozitiv të prindit, është lëvdimi dhe shpërblimi i veprimeve që do të doje të shikoje më shpesh te fëmija.

Gracka për hir të fëmijëve ndodh kur prindërit kanë lidhur një martesë jo të lumtur. Ata në vend që të gjejnë rrugë të reja për të zgjidhur konfliktet dhe irritimet martesore, qëndrojnë në të njëjtën situatë, duke menduar se kjo është më mirë për hir të fëmijës. Kërkimet tregojnë se shpesh fëmijët që jetojnë në familje ku ka shumë konflikt dhe stres midis prindërve, zhvillojnë më shumë probleme emocionale të sjelljes, sesa ata që rriten në familje të qëndrueshme, pavarësisht nëse familja e qëndrueshme është me një prind apo të dy.

Gracka e prindit të përkryer është rezultati i dëshirës njerëzore për të qenë më shumë i përkryer, sesa thjesht kompetent. Nuk ka asnjë prind të përkryer dhe aspirimi për t'u bërë i tillë, do të çojë vetëm në zhgënjim, brejtje ndërgjegjeje, faj, dhe ndjenjë paaftësie. Më mirë është të kuptosh që roli i prindit përmban elementë shprehish të mësuara si edhe një marrëdhënie të vazhdueshme dashurie midis individëve.

Gracka e martirit është kur prindërit angazhohen më tepër se ç'duhet me detyrën e tyre si prindër, saqë fillojnë të neglizhojnë nevojën e tyre për intimitet, shoqëri, çlodhje, jetë private dhe argëtim. Në këto raste, një marrëdhënie mes prindërve do të çalojë, ajo dhe mund të përfundojë në zhgënjim dhe inate. Roli i prindërve është cilësor, kur të rriturit bëjnë një jetë të drejtpeshuar.

10 këshillat kryesore për prindërit

1. Kur fëmija do të tregojë diçka, lëre atë që po bën dhe kushtoji rëndësi fëmijës. Është e rëndësishme të kalosh kohë me fëmijën tënd, duke bërë gjëra që ju pëlqejnë të dyve.
2. Jepi fëmijës ngrohtësi fizike, fëmijët i kanë qejf përqafimet, përkëdheljet dhe mbajtjen e duarve.
3. Foli fëmijës për gjërat që është i interesuar dhe ndaj gjërat e ditës tënde me fëmijën.
4. Lëvdoje fëmijën kur bën një gjë që të pëlqen të shikosh më shpesh, për shembull, "faleminderit që e bëre këtë që sapo ta kërkova".
5. Fëmijët kanë më shumë gjasa të sillen keq kur janë të mërzitur, kështu që angazhohu më shumë me ta në aktivitete, si jashtë dhe brenda shtëpisë.
6. Mësoji fëmijës shprehi të reja, duke i demostruar vetë fillimisht, më pas jepi mundësi t'i mësojë. Për shembull, flisni me mirësjellje me njëri-tjetrin në shtëpi. Më pas nxit fëmijën të flasë ashtu, (si, të thotë "të lutem" ose "faleminderit") dhe lëvdoje fëmijën për përpjekjet që bën.
7. Vendos kufij të qartë për sjelljen e fëmijës. Ulu dhe bëj një diskutim familjar mbi rregullat në shtëpi. Mësoji fëmijës pasojat, nëse thyhen rregullat.
8. Nëse fëmija sillet keq, qëndro i qetë dhe jepi udhëzime të mos sillet më keq, thuaju fëmijëve se si të sillen (për shembull, "boll u zutë, luani mirë me njëri-tjetrin"). Lëvdoje fëmijën kur reagon mirë. Në rast të kundërt, merr masën e duhur.
9. Tregohu realist në kërkesat e tua. Të gjithë fëmijët sillen keq ndonjëherë dhe sherret janë të pashmangshme. Dëshira për të qenë prind i përkryer, mund të sjellë irritim dhe zhgënjim.
10. Kujdesu për veten. Është e vështirë të jesh një prind i qetë dhe i çlodhur kur je në stres dhe ankth apo në melankoli. Përpiqu të gjesh kohë çdo javë për t'u shtensionuar dhe për të bërë diçka që të pëlqen.

Listë kontrolli mbi shqetësimet e prindërve[2]

Lista e kontrollit me shqetësimet e prindërve, është një instrument që ofron një kuadër për të nisur një dialog për mënyrën se si mund të mbështetet më mirë zhvillimi social dhe emocional i fëmijës dhe adoleshentit. Ky instrument inkurajon familjen që ka paqartësi apo shqetësime për zhvillimin e fëmijës, të "kërkojë" dhe të gjejë një numër udhëzimesh se ku dhe si të kërkojnë ndihmë.

Në të gjitha këta instrumente, theksi vendoset në pikat e forta, po ashtu dhe te shqetësimet. Informacioni nën "çfarë të presësh", jo vetëm që ofron udhëzime për zhvillimin e shëndetshëm të rolit të prindit, por u ofron prindërve informacion mbi sjelljen e fëmijës së tyre dhe detyrat që u dalin përpara.

Instrumenti ofron mundësi për t'i identifikuar shqetësimet në një fazë të hershme. Informacioni në zërin "kur të kërkosh ndihmë", përfshin çështje që mund të trajtohen duke siguruar informacion shtesë, si dhe ato që sinjalizojnë nevojën për vlerësim dhe shërbim të mëtejshëm. Aty ka vend ku familjet të shkruajnë për shqetësimet e tyre.

Ky instrument mund të përdoret nga SMF-ja për të filluar bisedën me prindërit individualish apo në grup. Në aneksin 10 dhe 11 mund të gjeni listën e kontrollit me shqetësimet e prindërve për adoleshentët dhe fëmijët.

Përmbledhje

Një udhëzues i vogël për prindërit

Mesazhe kyç mbi shprehitë e prindërimit:

- × Mbaj gjallë rutinën familjare në shtëpi, kjo do t'i japë fëmijës një ndjenjë sigurie dhe kontrolli;
- × Nxite fëmijën të ndjekë rregullisht shkollën;
- × Krijo mundësitë që fëmija juaj të luajë me fëmijë të tjerë dhe me ju;
- × Ji më i dashur dhe i kujdesshëm;
- × Dëgjo me kujdes shqetësimet e tyre;
- × Jepi fëmijëve informacionin e duhur për situatën ku ndodhen;
- × Gjej mundësi që fëmijët të ndikohen pozitivisht mbi çka u ndodh;
- × Përpiqu të jesh i durueshëm, përkrahës dhe mirëkuptues;

2 Përshatur nga burimi:
http://www.brightfutures.org/

- × Nëse e sheh se e ke të vështirë për t'ia dalë mbanë diçkaje, fol me dikë tek i cili beson dhe që mund të të mbështesë;
- × Mendo para se të reagosh!
- × Nëse nuk mund të mendosh, bëj pushim, largohu nga ajo situatë, numëro nga 10 në 1 ose fol me dikë tjetër;
- × Nëse kërcënon ashpër fëmijën tënd (për shembull, "do të të rrah") më vonë shpjegoji se ishe i inatosur prej sjelljes së tij, jo me të;
- × Sigurohu që fëmija të kuptojë pse-në, për çdo veprim që bën, dhe shpjegoja;
- × Fëmijët punojnë më shumë nëse i lëvdon. Lavdëroji për çdo gjë që bëjnë më shumë se ç'i kritikon kur bëjnë gabim;
- × Më mirë reflekto se çfarë e bën fëmijën të sillet ashtu, sesa të reagosh ndaj sjelljes së tij;
- × Fol me një person të besuar ose profesionist.

Është e vështirë të jesh prind dhe të gjithë kemi nevojë për mbështetje!

Përmbledhje

Përpiqu t'ju përgjigjesh pesë pyetjeve të mëposhtme. Për të kontrolluar nëse përgjigjet janë të sakta, kthehu te kapitujt korrespondues.

1. Ju lutem, thoni llojet e ndryshme të ndërhyrjes që synojnë aftësimin e prindërve dhe kujdestarëve parësorë.
2. Pse janë të vlefshme diskutimet e përqendruara në grup? Kur sugjerohet të zhvillohen ato?
3. Çfarë duhet pasur parasysh kur kryen vizitë në familje?
4. Si mund të përfshihen prindërit në jetën e fëmijëve?
5. Cilat janë mesazhet kyç mbi rolin pozitiv që do të donit t'ua transmetonit prindërve?

7 Ndërhyrjet e përqendruara te mësuesit

Kapitulli shtatë përshkruan përmbledhurazi ndërhyrjet që bëhen, me dhe për mësuesit, me personelin tjetër pedagogjik. Të gjithë veprimet e propozuara, synojnë krijimin e një mekanizmi mbështetës në klasë dhe përforcimin e kujdesit të personelit pedagogjik në mbrojtje të fëmijëve.

7.1 Hyrje

Mësuesit kanë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar që fëmijët të zhvillohen shëndetshëm dhe t'i përballojnë pozitivisht situatat e vështira. Në disa raste mund të jetë sfidë e madhe t'i përgjigjesh nevojave individuale të fëmijës në klasë dhe shpesh mësuesit ndjehen të mbingarkuar me detyrat arsimore, sociale dhe personale, që u kërkohen të zbatojnë në klasë dhe t'i zhvillojnë me nxënësit e tyre. Seksioni i mëposhtëm jep një ide se si mësuesit mund të krijojnë një mjedis mësimor pozitiv dhe nxitës në klasë dhe se si Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve, mund të ndihmojë personelin pedagogjik të bëjë detyrën e vet si edukator dhe mësues.

7.2 Metodologjia e trajnimit të mësuesve

Në seminaret mbi drejtimin e orës së mësimit, është e rëndësishme të kuptohet koncepti i të mësuarit. Të mësuarit është një proces kompleks, gjatë së cilit përfshihen shumë njerëz, ata do të mësojnë gjëra të reja duke modifikuar besimet dhe sjelljen e tyre. Të mësuarit ka të bëjë me motivimin. Një person që vlerëson detyrat e veta dhe ka sensin e kompetencave individuale, është i motivuar. Megjithatë, nëse një person nuk e

kupton detyrën si (në rastin e temës së trajnimit për menaxhimin e klasës) të vlefshme apo të dobishme, ose nuk ka kompetencat e nevojshme, ai/ajo do të humbasë motivimin. Metodat e përdorura gjatë trajnimeve për të rriturit, janë të rëndësishme për transmetimin e informacionit nga trajneri te i trajnuari. Të mësuarit mund të shihet, qoftë si dhënie informacioni (mësimdhënia) ose si mësim përmes përvojës (të mësosh, duke bërë ushtrime praktike përmes pjesëmarrjes).

Të mësuarit përmes përvojës, do të thotë që trajnuesi ta përshtasë informacionin në njohuritë ekzistuese, duke ndihmuar për një njohje më të thellë. Në këtë kuptim, të mësuarit është një proces i vazhdueshëm, ku njohuritë e reja lidhen me përvojat e kaluara. Metoda gjithëpërfshirëse, u jep dhe trajnerëve mundësinë për të mësuar nga ata që trajnohen.

Në trajnimin gjithëpërfshirës:

- × të trajnuarit kryejnë aktivitetet e tyre;
- × trajnerët i përqendrojnë temat mbi vështirësitë e hasura në aktivitet e përditshme të të trajnuarve.

Metoda e trajnimit me tri etapa, e bazuar në metodën e të mësuarit mbi bazën e përvojës: **1)** sesionet e trajnimit në grup për të gjithë mësuesit apo një grup të përzgjedhur, **2)** sesione këshillimi individual për çdo mësues, **3)** vizita në klasë për ata mësues që kanë nevojë për më shumë ndihmë dhe mësimi i teknikave. Në përputhje me konceptin se, të mësuarit është një pasqyrim përvojash, mësuesit janë çdo ditë të përfshirë në zgjidhjen e situatave edukative. Tematika dhe procedurat e trajnimeve, duhet të bëjnë që mësuesit të fitojnë ndjenjën e sigurisë dhe të besimit, që ata të përfshihen në procesin kompleks të mësimit.

Ndërsa hapat e parë, sesionet në grup, janë shtylla e procesit të të mësuarit, është e rekomandueshme që theksi të jetë te hapi i dytë, shtimi i kohës për trajnimet individuale, sa më e shpeshtë që të jetë e mundur. Kjo jep mundësinë që i trajnuari të përpiqet të vërë në praktikë çfarë ka mësuar nën mbikëqyrjen e trajnerit ose mbikëqyrësit të trajnuar. Dihet se njerëzit janë të ngadaltë në ndryshimin e mënyrës së sjelljes dhe në përdorimin e metodave të reja. Të mësosh shprehi të reja dhe t'i përmirësosh ato, kërkon angazhim personal si dhe përforcimin e shprehive nëpërmjet komenteve dhe udhëzimeve pozitive. Rekomandohet, gjithashtu, zhvillimi i sesioneve të këshillimit me mësuesit e tjerë, ku mësuesit mbështesin njëri-tjetrin dhe bëjnë komente pa praninë e mbikëqyrësit apo trajnerit.

Hapi i tretë dhe i fundit, shumë i rëndësishëm, është zbatimi i asaj që është mësuar nga trajnimet. Rekomandohet që, sa herë të jetë e mundur, të trajnuarit të zbatojnë në praktikë atë çfarë ata kanë mësuar dhe, mundësisht, t'ua transmetojnë kolegëve të tjerë. Kjo i mundëson të trajnuarit të grumbullojnë më mirë çfarë kanë mësuar, dhe më e rëndësishmja, t'ia përhapin njohuritë e marra një rrethi më të gjerë. Kjo gjithashtu, jep një mundësi që personeli mësimor të zhvillojë ushtrime specifike, që janë të përshtatura nga ana kulturore dhe kontekstuale. Hapi i tretë duhet të ndiqet nga trajneri ose personeli mbështetës pedagogjik.

Të trajnuarit duhet të kenë parasysh se ka dy metodologji të ndryshme mësimore: njëra, thjesht, për të trajnuar pjesëmarrësit që të përdorin mjete të veçanta, dhe tjetra, për të trajnuar pjesëmarrësit, jo vetëm të mësojnë, por edhe të trajnojnë të tjerë. Përsa i përket qëndrueshmërisë, trajnimi i trajnerëve (TIT) është më përfitues. Një psikolog shkolle mund të grupojë personat e kontaktit nga çdo shkollë, prej nga ata janë përgjegjës dhe këta mësues të përzgjedhur mund t'ua transmetojnë teknikat e sapomësuara kolegëve të tjerë të shkollës së tyre.

Metoda me tri etapa, e përshkruar më lart, kërkon shumë kohë, por ia vlen, sepse ka rezultat.

Për të trajnuar të rriturit, nuk mjafton të jesh ekspert i fushës, por kërkohen aftësi specifike mbi temën. Arti i të qenurit një trajner i mirë, nuk qëndron në ÇFARË, por te SI. Për këtë mund t'ju vlejnë këshillat e mëposhtme:

- Vlerëso me kujdes nevojat e trajnimit, që t'iu përgjigjesh nevojave dhe objektivave të pjesëmarrësve.
- Krijo gjatë sesioneve një atmosferë jokonkurruese, që pjesëmarrësit të ndjehen të sigurtë për të shprehur veten, që ata të përpiqen të provojnë gjëra të reja, qoftë dhe duke bërë gabime.
- Njihu me përvojat dhe njohurinë që të trajnuarit mund të kenë dhe fillo të dëgjosh atë çfarë ata dinë.
- Ki parasysh që trajneri ka shumë për të mësuar nga trajnuesit.
- Nëse është e mundur, organizo kurse rezidenciale ose kurse jashtë mjedit të punës; kjo ndihmon procesin e të mësuarit dhe të jetuarit në grupe sjell përfitime.

Seksioni i mëposhtëm paraqet teknika dhe instrumenta të ndryshme psiko-socialë, që mund t'u transmetohen mësuesve, dhe ata t'i venë në zbatim në klasë dhe gjatë punës së tyre me fëmijët.

Është e rëndësishme të nënvizohet se këto teknika psiko-sociale, nuk janë ngarkesë shtesë, ato ndihmojnë të pakësohen vështirësitë ndërpersonale, që mund të hasen gjatë punës me fëmijët dhe për ta bërë procesin e të mësuarit sa më miqësor dhe të këndshëm për fëmijët.

7.3 Aktivitete psiko-sociale në klasë

Është e rëndësishme të kujtosh se fëmijët, të cilët shfaqin probleme me sjelljen, mbase po përjetojnë vështirësitë e rritjes. Nxiti mësuesit të mendojnë për nxënësit në klasë dhe për problemet që përballin. Cili është roli i mësuesit për t'i ndihmuar?

Shpesh mësuesit janë personat e duhur që ndihmojnë fëmijët, me kusht që, mes mësuesit dhe nxënësit, të mos ketë ndonjë konflikt. Mësuesit mund të mësohen se:

- × Si të organizojnë aktivitete psiko-sociale në klasë;
- × Kur dhe si të përdorim mënyra të tjera, si të shkruarit, vizatimin, të treguarit, vallëzimin ose dramën, për të shprehur ndjenjat dhe për t'i ndihmuar fëmijët të interpretojnë ngjarjet e shkuara.

Kini parasysh: Prapa qëndrimeve të fëmijëve, ka gjithmonë një shkak, ku mund të zbulosh nevojat e tyre të vërteta!

Inkurajo aktivitete psiko-sociale në klasë
Aktivitetet çlodhëse dhe shprehëse nuk kanë pse bëhen vetëm individualisht. Mësuesit duhet të nxitin dhe të kryejnë aktivitete psiko-sociale para, gjatë ose pas orëve të mësimit. Kapitulli 5.2.6 jep një metodologji për aktivitete të tilla.

7.3.1 Menaxhimi i klasës

A **Përdorimi i metodave që nxisin pjesëmarrjen e fëmijëve**

Shpeshherë mësuesit ua kërkojnë fëmijëve zbatimin e detyruar të disiplinës dhe si rezultat provokojnë mungesën e saj. Kjo ndodh, sepse ata e përdorin pushtetin që kanë për të ndrydhur fëmijët, pa iu dhënë të kuptojnë arsyen përse. Dënimi fizik ose i rëndë (gjuajtja me pëllëmbë,

rrahja e nxënësve, poshtërimi me fjalë apo ndëshkimi fizik), nuk krijojnë marrëdhënie të mira, nuk i lejojnë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre për jetën dhe të nxjerrin mësime. Nxënësit mund të jenë më të vëmendshëm, nëse marrin pjesë aktivisht në procesin e mësimit, sesa kur marrin thjesht njohuri prej mësuesve. Kjo mund të bëhet më mirë nëpërmjet përdorimit të metodave të pjesëmarrjes së nxënësve.

Parimet e përdorimit të metodave të pjesëmarrjes së nxënësve.

- × Mëso prej nxënësve dhe bashkë me ta.
- × Mëso në mënyrë progresive.
- × Lidh mësimin me përvojën e fëmijëve (veprimi).
- × Përdor mënyra të përshtatshme dhe miqësore.
- × Ec me hapin e nxënësve, përfshihu me ta dhe brenda grupit mësimor dhe mëso prej tyre.

Disa metoda që nxisin pjesëmarrjen, për t'u përdorur me nxënësit janë:

1 PUNA NË ÇIFT

Inkurajoni nxënësit që shquhen, për të ndihmuar ata që kanë vështirësi në ndonjë lëndë. Nëse një nxënës e ka mbaruar më herët detyrën e tij, shtyje të gjejë një nxënës tjetër që ka nevojë për ndihmë. Lëvdoi në sy të të tjerëve me fjalë pozitive kur ndihmojnë njëri-tjetrin, për të nxitur qëndrimet prosociale dhe bashkëpunimin. Mësuesit mund të caktojnë edhe kolegë të tyre që t'u vijnë në ndihmë nxënësve që kanë vështirësi.

2 PUNA NË GRUP

Mund të lidhni notat e një grupi, me notat e të gjithë klasës, duke treguar rëndësinë e të punuarit bashkë. Vlerësimi në grup, i nxit nxënësit të bashkëpunojnë. Gjithashtu, mbarëvajtja në mësime rritet, kur shfrytëzohen si duhet aktivitetet bashkëvepruese.

3 AKTIVITETET SHPREHËSE

Tregimi i historive, këngët dhe vallet, diskutimet pas ndodhive të ndryshme, mund t'i ndihmojnë nxënësit të shkëmbejnë përvoja, të analizojnë dhe gjejnë zgjidhje për mësimet e marra.

Pse duhet të përdoren metodat që nxisin pjesëmarrjen e fëmijëve?

- × Këto metoda janë të lehta për t'u përdorur nga mësuesit, ato nxitin të mësuarit, duke u dhënë mundësinë nxënësve të provojnë, analizojnë dhe gjejnë zgjidhje për mësimet e marra.
- × Ato nxitin vetëvlerësimin, motivimin, kënaqësinë, besimin dhe sigurinë tek vetja, ndjenjën e përkatësisë.
- × Ato nxitin pjesëmarrjen vullnetare dhe komunikimin e lirë.
- × Gjithashtu, motivojnë nxënësit të mësojnë, sepse edhe ora e mësimit bëhet më argëtuese!
- × Metodat që nxisin pjesëmarrjen e fëmijëve i vënë fëmijët në qendër të procesit mësimor, që do të thotë se mësimet mund të njehsohen me nivelin e nxënësve dhe të lidhen me përvojat e tyre.

B **Hartimi i rregullave efikase**

Të gjithë mësuesit kujdesen për nxënësit. Ata duan që ata të jenë të bindur dhe të respektojnë rregullat.

SKENARI 1: Të bërtiturit, rrahja dhe vënia në vështirësi e fëmijëve për t'i ndëshkuar ata dhe për të mbajtur nën kontroll klasën, por …

Nxënësit jetojnë me frikën e mësuesve. Shpesh nxënësit janë të mbushur me ndjenja negative ndaj mësuesve dhe madje nuk e pëlqejnë shkollën. Nuk e kuptojnë pse duhet të binden dhe bëjnë atë që thotë mësuesi, vetëm kur ai ndodhet pranë. Është e vështirë për ta të mësojnë përgjegjësinë e veprimeve të tyre.

SKENARI 2: Të tregosh mirësjellje dhe kujdes, duke iu dhënë fëmijëve dashurinë për të cilën kanë nevojë, por …

Nxënësit mund të përfitojnë, sapo mësuesit i humbet kontrolli mbi klasën. Nxënësit mund ta pëlqejnë mësuesin, por nuk mësojnë mësimet ose nuk i respektojnë rregullat dhe njeri-tjetrin.

Ka mënyra të ndryshme për të mbajtur klasën nën kontroll, duke krijuar një mjedis të sigurtë mësimor dhe një marrëdhënie të mirë midis mësuesve dhe nxënësve. Një nga metodat e tilla, është të vendosësh rregulla me nxënësit, t'i bësh të qarta pasojat dhe t'i zbatosh ato hap pas hapi. Hapat për vendosjen e rregullave efikase (përshtatur nga Kreidler, Ë.J., 1984)

1 **Vendosini bashkë rregullat e klasës.**
Filloni me klasën tuaj. Shpjegoni se do t'i vendosni rregullat bashkë. Do të jetë përgjegjësia e të gjithëve. Pyesni nxënësit të mendojnë për rregullat që ata munden, rregullat që mendojnë se janë të nevojshme për të gjithë klasën dhe që të gjithë të mësojnë në një mjedis sa më të mirë. Bëj një listë me rregullat e propozuara. Më pas, kthejuni listës bashkë me nxënësit dhe nënvizoni ato që janë më të rëndësishme për klasën.

2 **Zgjidh 10-15 rregullat më të rëndësishme.**
Shkruaji në terma specifikë. "Bëj gjënë e duhur në kohën e duhur", është shumë e mjegullt. "Mos bëj zhurmë", është specifike. Nëse është e mundur, vendosi rregullat në mënyrë pozitive. Të thuash "Fol pa bërë zhurmë", është më mirë sesa "Mos bëj zhurmë'.

3 **Tani, analizo çdo rregull.**
Është shumë e rëndësishme që nxënësit të kuptojnë arsyen përse rregullat janë për të mirën e nxënësve, dhe jo vetëm për mësuesit.

4 **Bashkë me klasën, përcaktoni tri ose katër masa kur thyhet një rregull.**
Masat duhet të lidhen me rregullat dhe sjelljen e çdokujt. Për shembull, nëse rregulli thotë "Mbaje klasën të pastër", pasoja logjike është se ai/ajo që hedh letrën poshtë, të qëndrojë në klasë gjatë pushimit për ta pastruar.

5 **Përcakto nivelin e masave nga e mesmja te më e forta.**

RREGULLI	PASOJA
Ji i përpiktë.	× Paralajmërim. × Nxënësi t'i kërkojë falje mësuesit dhe klasës. × Nxënësi të qëndrojë në klasë gjatë pushimit për kohën që ka humbur. Duhet të studiojë mësimin e humbur. × Nxënësin e thërret drejtori.

6 Kur klasa e miraton listën përfundimtare të rregullave dhe masave ndëshkimore, vendoset në vend të dukshëm një listë e madhe. Rishikoni shpesh rregullat dhe masat ndëshkimore, derisa gjithsecili t'i mësojë përmendsh.

7 Duhet t'i tregoni klasës se jeni serioz në respektimin rregullave. Kjo nuk do të thotë se ju duhet të ngrini zërin ose të përdorni ndëshkime të rënda. Duhet t'i tregoni se kërkoni që ata t'u binden rregullave dhe, nëse nuk e bëjnë, do të vuajnë masat ndëshkimore. Mos pranoni justifikime. Mund të merreni me rastet e veçanta gjatë pushimit, dhe duhet të jepni masat. Jini të qëndrueshëm! Masat e marra duhen dhënë qartë para klasës (jo t'i përshpëriten vetëm një fëmije), si paralajmërim për të gjithë dhe për të treguar se të gjithë trajtohen njëlloj.

Megjithëse kjo kërkon shumë kohë, ia vlen. Ti si mësues do të zbulosh që nuk ke pse inatosesh dhe irritohesh, thjesht, merr masat ndëshkimore, siç është vendosur. Fëmijët do të shikojnë se masat janë rezultat i veprimeve të tyre dhe jo rezultat i humorit tënd të keq.

Kini parasysh
Objektivi i rregullave dhe disiplinës, duhet të jenë që gjithmonë fëmijët të përfitojnë dhe ata duhet të ndihmohen të kuptojnë arsyen përse janë vendosur rregullat. Me anën e vendosjes së rregullave dhe dhënies së masave ndëshkimore, mësuesit kanë klasën nën kontroll dhe krijojnë një mjedis të sigurtë mësimor.

Disiplina e ashpër përdor frikën për të kontrolluar klasën, ajo nuk nxit bashkëpunimin, mirëkuptimin ose marrëdhëniet e mira me mësuesin.

Nëse fëmija vazhdon të thyejë rregullat, edhe pasi janë dhënë masa ndëshkimore, juve do t'ju duhet të ndërmerrni hapa të tjerë:

Vetëm për vetëm
Mos e humb durimin para klasës. Thjesht bëjua të qarta masat ndëshkimore dhe më pas foli fëmijës në mënyrë individuale gjatë pushimit.

Kontratat e sjelljes

Kur një fëmijë ka vështirësi të ndjekë një rregull të caktuar, kalo kohë me fëmijën për të kuptuar pse i thyen rregullat. Fol me nxënësin rreth zgjidhjeve të mundshme. Si mund ta ndihmoni të respektojë rregullat? Ju mund të bëni një marrëveshje dhe shkruajeni në letër. Kjo do të shërbejë si kujtesë për fëmijën. Kur shikoni se sjellja po përmirësohet, lëvdojeni nxënësin, edhe sikur ky ndryshim të jetë shumë i vogël. Kjo do ta nxisë atë të përmirësohet më tej.

"Objektivi i sjelljes gjatë ditës, është një praktikë e përdorur për të ndihmuar nxënësit të mendojnë çdo ditë se si të sillen mirë. Në fillim, mësuesit e prezantojnë këtë praktikë, duke u kërkuar nxënësve të hartojnë një listë me sjellje të caktuara në klasë: si të ngresh dorën, të dëgjosh të tjerët kur përgjigjen, të presësh radhën tënde, të flasësh me zë të ulët (për shembull, të përdorësh ton të ulët në klasë, sepse zëri i lartë përdoret jashtë kur luan) dhe të mbash pastër vendin tënd.

Këto sjellje shpesh shkruhen në shirita të gjera dhe ngjiten çdo ditë në tabelën e njoftimeve "Objektivi – Si të sillemi sot'. Gjatë ditës mësuesi duhet të vendosë një shenjë te kartela e kontrollit të sjelljes, sa herë që nxënësi sillet në mënyrë të veçantë. Në fund të ditës, mësuesi u thotë nxënësve se kush ka patur një sjellje model.

Për nxënësit më të rritur, të cilët kanë nevojë për më shumë sfida, kjo teknikë mund të përshtatet duke shënuar të gjitha sjelljet e lavdërueshme dhe duke e mbajtur të fshehtë nga grupi deri në fund të ditës.

Është e rëndësishme t'i bësh nxënësve komente konstruktive. Disa mësues mund të kenë gjetur një metodë për t'i ndihmuar nxënësit të sillen pozitivisht në shkollë dhe në shoqëri. Çdo të premte, mësuesit shkruajnë një raport të shkurtër mbi ecurinë e nxënësve, duke përshkruar sjelljen, përpjekjet, mbarëvajtjen në klasë dhe plotësimin e detyrave të shtëpisë, duke nxjerrë dhe një notë mesatare.

Para se të largohen nga shkolla, nxënësit mbledhin raportet dhe takohen me të rriturit e caktuar për të diskutuar komentet. Gjatë këtij takimi, nxënësit dhe të rriturit punojnë së bashku për të zgjidhur problemin dhe për të sugjeruar zgjidhjet nëse del e nevojshme.

Kërko ndihmë nga kolegët

Disa fëmijë kanë nevojë për më shumë vëmendje dhe mirëkuptim. Në këtë kohë, kërko ndihmën e kolegëve të tu, qoftë në mënyrë individuale ose në grup, për të mbështetur në punën tënde për të përmirësuar sjelljen e nxënësve.

Mund të jetë e dobishme për mësuesit të vijnë në takimet e grupeve të përgatitur me informacionin e mëposhtëm mbi sjelljen e nxënësit:

- Deklarimi i problemeve të sjelljes.
- Sjellje alternative të pranueshme.
- Përpjekjet e bëra për përmirësime në klasë; çfarë funksionon dhe çfarë jo.
- Konsiderime të veçanta për shëndetin.
- Mekanizmat e shfrytëzuar për të përmirësuar sjelljen, arritjet.

Duke përdorur këtë informacion si udhëzues, ekipi mund të vendosë të angazhojë edhe një koleg tjetër, që të shërbejë për të parë në klasë, të mbledhë më shumë informacion se si mund të ndihmohet nxënësi të zhvillojë sjellje më pozitive. Së fundi, ky informacion do të formojë bazat për planin e ndërhyrjes në klasë.

Përfshirja e prindërve

Disa prindër janë kandidatë të shkëlqyer për të ndihmuar në klasë. Përveç ndihmës në klasë, prindërit mund të përfshihen edhe në dhënien e ndihmës së veçantë. Për shembull, mësuesit mund t'i ftojnë prindërit të shërbejnë si lektorë mbi aktivitete si puna më dru, gatimi ose shah.

Për të ndihmuar nxënësit të organizohen më mirë për detyrat e shtëpisë, mësuesi duhet të përgatisë një fletë detyrash. Në të duhet të shënohet çdo lëndë dhe të lihet hapësirë ku nxënësit të shënojnë, nëse detyra e tyre është bërë ose jo. Gjatë gjithë ditës, kjo fletë shihet periodikisht për të siguruar se nxënësit janë duke shënuar detyrat. Pasi nxënësit shfaqin pavarësi në plotësimin e detyrave, numri i kontrolleve ulet.

Nga prindërit kërkohet që ta kontrollojnë dhe ta firmosin letrën. Përveç kësaj, prindërit bien dakord që puna e papërfunduar në shtëpi, të plotësohet në shkollë, edhe sikur kjo të kërkojë më shumë kohë.

7.3.2 Aktivitete në klasë që synojnë objektiva specifike psiko-sociale

Fëmijët komunikojnë nëpërmjet:

- × Lojës.
- × Qëndrimeve që mbajnë gjatë lojës me fëmijët e tjerë.
- × Muzikës, kërcimit dhe këngës.
- × Të shkruarit, të vizatuarit dhe dramës.
- × Tregimit të historive.
- × Kontaktit fizik.
- × Diskutimeve.

Të gjitha aktivitetet e përmendura më poshtë, mund të kryhen nga mësuesit në sesione të shkurtra ditore ose në një orë të caktuar gjatë javës. Të gjitha ushtrimet e bëra, mund të përdoren edhe nga SMF-ja gjatë sesioneve individuale ose në grupe. Këto grupe mund të përqendrohen në objektiva specifike, gjatë një periudhe të gjatë kohe për të përmirësuar progresivisht aftësitë në këtë fushë.

Në Aneksin 23 mund të gjeni një shembull plani individual se si mësuesi mund të përgatisë objektivat psiko-sociale, që janë pjesë e objektivave të tij edukative në klasë. Gjithashtu do të gjeni një formular për vetëvlerësim në Shtojcën 24, që mësuesit të vlerësojnë aftësitë e tyre për menaxhimin e klasës dhe të përcaktojnë objektiva personale. Këto mjete synojnë të jenë një mbështetje, që mësuesit të përmirësojnë rolin e tyre profesional dhe të kalojnë me sukses shumë sfida që ndeshin në punën e tyre të përditshme me fëmijët.

Seksioni i mëposhtëm prezanton aktivitete me objektiva specifike psiko-sociale. Për çdo objektiv kryesor, mund të gjeni në shtojcë fletën përkatëse.

A Komunikimi, besimi dhe shprehja

Detyra me shkrim

Kërko nga nxënësit të shkruajnë për një temë që lidhet me jetën e tyre. Mund të përdorësh këtë ushtrim për të nxitur aftësinë e tyre për t'u shprehur dhe për t'i ndihmuar si të përmirësojnë aftësitë e tyre në të shkruar.

Temat e mundshme:
Ngjarja më e rëndësishëm e jetës sime.
Gjëja më e bukur që më ka ndodhur.
Jam më i lumtur/trishtuar kur…
Një ëndërr.
Çfarë është paqja për mua?
Si do ta përshkruaja veten.
Javën e kaluar u ndjeva … sepse …
Shoku im më i mirë.
Personi që besoj më shumë, dhe pse.

Nxënësit mund të sugjerojnë gjithashtu tema të ndryshme. Mund t'i kërkosh nxënësve të ndajnë me ty dhe të tjerët atë që kanë shkruar. Kjo mund të bëhet me gjithë klasën ose në grupe të vegjël. Nxënësve ju duhet dhënë mundësia, nëse duan apo jo t'ua lexojnë të tjerëve. Gjatë kësaj kohe, është e rëndësishme që të nxisni nxënësit të dëgjojnë tjetrin me respekt. Jepni shembullin tuaj, duke u treguar nxënësve se ç'do të thotë të dëgjosh. Përgjigjet tuaja për shkrimin e nxënësve, duhet të vlerësohen pavarësisht prej mendimeve dhe ndjenjave që ata kanë. Nuk ka rekomandime të gabuara apo të sakta për këto çështje.

Bëj kujdes t'i ndash komentet e tua mbi përmbajtjen e shkrimeve nga aftësitë e tyre për të shkruar. Nëse kjo pjesë do të shërbejë si leksion për artin e të shkruarit, fillimisht afirmo atë çfarë ata kanë shkruar, vlerëso mendimet dhe ndjenjat e shprehura, dhe më pas udhëzoji për probleme të gramatikës dhe drejtshqiptimit.

Vizatimi
Kërkoju nxënësve të vizatojnë. Mund t'i lejosh të vizatojnë çfarëdo që kanë në mendje ose jepu një temë si ajo e sugjeruar më sipër. Kjo mund të bëhet si aktivitet me tërë klasën ose me grupe të vogla fëmijësh, të cilët kanë nevojë për vëmendje të veçantë.

Pyetjet ku duhet t'i inkurajosh nxënësit të përgjigjen.
"Më trego për vizatimin tënd."
"Çfarë ka ndodhur këtu?"
"Kush është ky në këtë vizatim?"
Ku je ti në këtë vizatim?
Si ndjeheshe atëherë?
Si ndjehesh tani?

Mos jep interpretimin tënd mbi vizatimin; lejo nxënësin të shpjegohet. Prano vlerat e mendimeve të tyre, ndjenjave dhe përvojave dhe trego vlerësim që ata e ndajnë me ty (dhe të tjerët). Nëse nuk kupton diçka, pyet. Mos prit që nxënësit të kenë të njëjtat mendime me ty.

Drama, kënga, vallëzimi

Të gjitha këto tema mund të shprehen me anë të këngës, vallëzimit dhe aktrimit. Këngët dhe vallet tradicionale, mund të luhen dhe të shpjegosh kuptimin e tyre, mund të jetë një kujtues i mirë i përkatësisë dhe trashëgimisë. Këngët dhe vallet e reja, mund të krijohen nga fëmijët për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre.

Diskutimet javore në klasë

1. Fillo duke caktuar një orar gjatë javës për diskutimet në klasë.
2. Fillo takimet e para, duke shpjeguar rregullat për diskutimin.
   - × Është vendi ku nxënësit shkëmbejnë idetë dhe opinionet e tyre.
   - × Të gjithë ata që duan të shkëmbejnë opinione, duhet të lejohen ta bëjnë këtë.
   - × Asnjë nuk duhet të kritikojë apo të tallet me tjetrin.
3. Prezanto një temë: “Sot mendoj se është e rëndësishme të flasim për lojën gjatë kohës së pushimit. Kam vënë re se ka shumë argumentime dhe diskutime. A ka dëshirë ndonjëri të flasë rreth tyre me ne?” Përdor një temë që i përshtatet të gjithë klasës.
4. Lejoji nxënësit të shkëmbejnë ndjenjat dhe mendimet, dhe më pas, kur të jetë e përshtatshme, pyet për zgjidhjet e mundshme.
5. Mos iu trego çfarë duhet të bëjnë. Përpiqu t’i ndihmosh t’i gjejnë vetë zgjidhjet. Kjo bën të mundur rritjen e pavarësisë, përgjegjësisë dhe kreativitetit të tyre.
6. Kur ndjehesh mirë me diskutimin, përpiqu t’i lejosh nxënësit të krijojnë një program për takimet. Lër një hapësirë në dërrasën e zezë, ca fletë letre në klasë ose “kuti postare”. Gjatë javës, nëse ata kanë ndonjë temë që duan të diskutojnë, shkruaje në program. Nxënësit do të fillojnë të diskutojnë temat, duke e ditur se shokët e tyre të “komunitetit” dhe mësuesi do t’i ndihmojnë të gjejnë zgjidhjen.

Gjithashtu, mund të filloni diskutime të rregullta me një numër të vogël nxënësish për një arsye të caktuar. Mund të përdorni të njëjtat hapa me këtë lloj grupi. Një kohë e mundshme për diskutimin, mund të jetë koha e

pushimit, dreka, aktivitetet zbavitëse ose pas shkollës, në varësi të programit dhe rregullave të shkollës.

Diskutime për ndodhitë urgjente

Mund të jetë gjithashtu e rëndësishme të bëhen diskutime në klasë për ndodhitë "urgjente". Këto janë diskutime të paprogramuara. Mund të ketë shembuj të ndryshëm, nëse një nxënës është sulmuar duke ardhur në shkollë ose një vajzë në shkollë është fyer nga ndonjë mësues, probleme me alkoolin dhe duhanin gjatë orëve të pushimit, etj. Është e rëndësishme të flasësh me nxënësit e shqetësuar për këto raste. Nëse i lejoni të shprehin ndjenjat mbi ngjarjen para se të fillosh ditën normale, do t'i ndihmosh të qartësojnë mendimet dhe të ndjehen më të lirshëm, duke bërë të mundur të përqendrohen te temat e tjera.

1. Diskuto ngjarjen aktuale. Çfarë ndodhi? Kush ishte përfshirë? Përpiqu të jesh faktik dhe të japësh informacionin e saktë dhe moho fjalët që ti e di se nuk janë të vërteta. Mos ua fshih informacion nxënësve.
2. Identifiko si përfundoi ngjarja. Bëji fëmijët të mendojnë për të mirat që njerëzit mund të bëjnë gjatë ngjarjes.
3. Shpjego tani situatën. Përsëri, ji sa më faktik që të jetë e mundur. Nëse ngjarja ndodh përsëri, diskuto me klasën mënyrat e ndryshme si mund të ruajnë veten.
4. Fol për reagimet e fëmijës ndaj ngjarjes, përfshi reagimet e tyre fizike, mendimet dhe ndjenjat. Fol për mënyrën si ndjehen. Thekso shkëmbimin e reagimeve të ndryshme, kjo i ndihmon fëmijët të mos ndjehen shumë vetëm me frikën dhe trishtimin e tyre.
5. Siguroji se tani janë të sigurtë (nëse janë) dhe se jeni bashkë për të mbështetur njëri-tjetrin. Nëse është e nevojshme, thuaj fjalë ngushëlluese dhe më pas fillo mësimin e ditës. (përshtatur nga Alexander, D.W., 1999).

Këndo një këngë

LUAJ "PREK NGJYRËN BLU": Dikush i bie daulles dhe të tjerët ecin rreth vendit me shpejtësi. Kur daullja pushon, udhëheqësi thërret "prek ngjyrën blu", prek hundën, ose këpucën, ose ndonjë ngjyrë ose rrobë që kanë veshur të tjerët (ndryshoji udhëzimet herë pas here). Secili duhet të prekë ngjyrën ose objektin e një personi tjetër, jo veten. Më pas daullja fillon përsëri.

PASOJE SHKOPIN: Uluni në një rreth me karriget afër njëra-tjetrës. Njëri zgjidhet të qëndrojë në qendër dhe të mbyllë sytë. Jepi një shkop (rreth 12 cm) personit të ulur pranë. Shkopi duhet të kalohet nëpër rreth nga e majta ose e djathta, të gjithë të tjerët mund të lëvizin duart teksa e kalojnë. Fëmija në qendër hap sytë dhe mendon për tre persona që mund ta kenë. Nëse e gjen personin, apo pas tre gabimesh, personi që e ka shkopin shkon në qendër dhe loja fillon përsëri.

PASQYRA: Çdo person zgjedh një partner (nëse mbetet ndonjëri pa partner, duhet të punojë mësuesja me të). Qëndrojnë përballë njëri-tjetrit. Mësuesja thotë: "Preke shokun në sup". Kushdo që prek i pari, është numri 1 dhe tjetri numri 2. Numri 1 fillon të bëj lëvizje me dorë, këmbë dhe kokë dhe numri 2 ndjek çdo lëvizje, si të ishte numri 1 në pasqyrë. Ky ushtrim duhet bërë në heshtje. Pas pak udhëheqësi i thotë numrit 2 të bëjë lëvizjet dhe numri 2 të luajë si të ishte pasqyra.

Më pas bëj një diskutim të shkurtër. Ishte e lehtë të bëje pasqyrën? Ishte argëtuese? A të dha ushtrimi ndjenjë pozitive për partnerin? Nëse e bën ushtrimin përsëri me grupin në një sesion tjetër, mund t'i kërkoni të gjejnë një partner që nuk e njohin mirë dhe jo të zgjedhin shokun e ngushtë.

DËGJIMI A/B: (Është e dobishme për udhëheqësin të ketë diçka që bën zhurmë dhe të shpjegojë që është sinjali që të gjithë të pushojnë së foluri njëherazi). Çdo person zgjedh një partner (nëse mbetet ndonjëri pa partner, duhet të punojë me udhëheqësin). Ulen ballë për ballë. Udhëheqësi thotë "Prek shokun në sup". Kushdo që prek i pari është numri 1 dhe tjetri numri 2. Udhëheqësi pyet të gjithë të mendojnë për diçka interesante mbi të cilën do të flasin.

FAZA E PARË: Të gjithë në grup flasin njëherazi, çdokush përpiqet ta bëjë partnerin të pushojë dhe ai dëgjon. Pas një minute drejtuesi i ndalon të gjithë dhe u kërkon të ngrenë dorën dhe të thonë se si ishte (shumicës i duket nervozuese dhe flasin me zë edhe më të lartë, disa pushojnë së foluri).

FAZA E DYTË: Numrit 1 i kërkohet të flasë dhe numrit 2 të rrijë pa folur apo pa lëvizur, tregon se nuk është i interesuar fare për ato që thotë numri 1. Pas një minute drejtuesi i ndalon dhe u kërkon të ndërrojnë rolet. Pastaj i ndalon të gjithë dhe i pyet si ishte (shumicës i duket e mërzitshme të mos dëgjohen). Pyeti që të thonë nga e kuptuan se personi nuk ishte i interesuar, çfarë vuri re folësi?

FAZA E TRETË: Numrit 1 i kërkohet të flasë dhe numrit 2 të dëgjojë me vëmendje. Pas një minute, drejtuesi i ndalon dhe u kërkon të ndërrojnë rolet. Më pas i ndalon të gjithë dhe u kërkon të ngrenë dorën të tregojnë si ishte (shumicës do t'i duket e këndshme ta dëgjojnë), pyeti nga i kuptuan që tjetri po i dëgjonte, çfarë vuri re folësi. Do vini re se të gjithë ishin më të qetë.

TELEFONI: Grupi formon skuadra me nga 6 persona. Çdo fëmijë qëndron rreth një metër larg nga shoku i skuadrës. Personi i parë i grupit, shkon te drejtuesi që i jep një mesazh me 12 fjalë të shkruara qartë në një copë letër. Kthehen mbrapsht dhe ia përsërisin personit tjetër të skuadrës së tyre, i cili ia thotë tjetrit dhe kështu me radhë, derisa arrihet tek i fundit në skuadër, të cilin e pyesin se çfarë thotë mesazhi. Zakonisht bëhen gabime. Uluni dhe diskutoni së bashku: Pse u transformua mesazhi? Çfarë mund të bëjmë për t'u siguruar që mos të bëhen më gabime? Si mund të dëgjojmë më mirë? Pas diskutimit, drejtuesi mund t'i kërkojë skuadrës ta provojë përsëri me një mesazh të dytë dhe të shikojë nëse rezultatet janë më të mira.

B **Shprehja e emocioneve**

Jam i lumtur/jam i trishtuar

Uluni në një rreth. Çdokush sipas radhës flet për fqinjin e tij, duke filluar me drejtuesin që tregon çfarë të bëjnë. Mund të thonë: 'Jam i lumtur ose i trishtuar'. Nëse thonë: "Jam i trishtuar", duhet ta thonë me fytyrë të lumtur. Nëse thonë: "Jam i lumtur", duhet ta thonë me zë të trishtuar, madje edhe të qajnë.

Fytyrat që buzëqeshin/fytyrat e trishtuara
Fëmijët vizatojnë fytyra me gjendje të ndryshme emocionale. Letrat i mbajnë në një kuti të vogël. Çdo mëngjes ata nxjerrin një fytyrë që përfaqëson gjendjen që ndjehen atë ditë. "Humori" mund të ndryshojë gjatë ditës dhe nxënësit mund të ndryshojnë fytyrat. Kjo ndihmon për t'u komunikuar të tjerëve ndjenjat e tyre. Gjithashtu, u mëson nxënësve të respektojnë gjendjen shpirtërore të të tjerëve dhe i jep mësuesit një ide se fëmija nuk ndjehet mirë për një periudhë të gjatë kohore dhe mund të përpiqet ta ndihmojë. Ata që janë të lumtur, të tregojnë cili është shkaku i lumturisë së tyre.

C Zgjidhja e konfliktit

Një klasë ku mbretëron paqja, është ajo që përkrah komunikimin e mirë, bashkëpunimin midis nxënësve dhe mësuesve, pranimin e diversitetit, mënyrat pozitive që fëmijët të shprehin emocionet dhe aftësitë për të zgjidhur konfliktin pa dhunë. Aktivitetet për bashkëpunim dhe zgjidhjen jo të dhunshme të konfliktit.

JAM DAKORD, NUK JAM DAKORD: Etiketo katër letra: "Jam shumë dakord", "Jam dakord", "Nuk jam fare dakord", "Nuk jam dakord". Vendos një letër në secilin prej katër mureve të klasës (nëse jeni jashtë, vendos karrige në të katër anët, duke lënë hapësirë të njëjtë). Shpjego se mesi i klasës konsiderohet zonë neutrale ose "nuk e di". Udhëzo pjesëmarrësit që, kur të lexohet një pohim (si "Të rriturit i dinë gjërat më mirë se fëmijët"), ata duhet të vendosin nëse janë dakord ose jo dhe sa dakord, dhe të shkojnë në vendin e përshtatshëm në dhomë. Pasi të gjithë pjesëmarrësit të kenë zgjedhur vendin e tyre, pyet anëtarët nga çdo anë të japin arsyet për zgjedhjen e tyre dhe përpiqu t'i bindësh të tjerët të bashkohen me anën e tyre. Kur shumë prej tyre të kenë shprehur mendimet, lexo një pohim tjetër dhe fillo nga e para.

Pika për diskutim:
Mund të jemi ose jo dakord. Theksoni tolerancën dhe rëndësinë e të respektuarit të opinioneve të njerëzve. Mund të biem dakord ose jo mbi çështjet, t'i diskutojmë dhe të mësojmë nga njëri-tjetri. Mospajtimet tona nuk do të thotë se duhet të çojnë në zënka apo sherre. Miqësia mund të bazohet në respekt reciprok, jo thjesht opinione të njëjta.

NYJA: Gjithsecili qëndron në një rreth, sup më sup me sy të mbyllur. Mbajini krahët të shtrirë dhe lëvizni së bashku përpara drejt mesit dhe i valëzoni krahët për t'i përzierë. Merrni dorën e një personi tjetër te e juaja dhe kur secili të ketë kapur dy duar, t'i hapë sytë. Tani, pa lëshuar duart, përpiquni të zgjidhni duart. Grupi punon së bashku për të zgjidhur nyjen.

Fillimisht kjo detyrë duket e pamundur. Ajo kërkon nga të gjithë durim dhe bashkëpunim për t'i zgjidhur duart. Askush nuk mund ta zgjidhë i vetëm problemin, ose e gjejnë zgjidhjen së bashku, ose ndahen. Disa pjesëmarrës marrin zakonisht udhëheqjen për zgjidhjen e problemit, të tjerët, thjesht, i ndjekin. Kjo mund të jetë një pikë nisjeje për të diskutuar udhëheqjen dhe vetësigurinë.

SITUATAT E KONFLIKTIT: Kërko nga pjesëmarrësit të formojnë çifte dhe të rrinë përballë njëri-tjetrit, duke formuar dy rreshta. Jepu një situatë konflikti: "Njëri nga ju nuk mund ta gjejë stilolapsin. Dyshon se personi përballë e ka vjedhur". Thuaju pjesëmarrësve të luajnë konfliktin, ata duhet të jetë të fortë dhe të mbrojnë pozicionin me çdo kusht. Pas tri minutash, ndalojini të gjithë dhe pyet disa nga partnerët të shpjegojnë çfarë ka ndodhur. Më pas thuaju të bëjnë përsëri lojën me role, kësaj here përpiquni të gjeni një zgjidhje. Pyet nëse ndonjë e ka zgjidhur konfliktin. Merr shembuj të ndryshëm për mënyrën se si është zgjidhur. Tregoju se ku ndryshon nga loja e parë. Më pas jep një konflikt tjetër. Përdor shembuj që u përshtaten pjesëmarrësve. Mund t'i pyesësh për sugjerime se çfarë situate konflikti mund të shfrytëzohet.

Ka mënyra të ndryshme për të zgjidhur një konflikt. Duke shkëmbyer zgjidhjet dhe duke qenë të hapur për idetë e të tjerëve, ndihmojmë për të vendosur paqen në vend të dhunës. Vëreni theksin te ndonjë temë e përbashkët për zgjidhje, si dëgjime, lutja për falje, dhënia e kompensimit për humbjet, etj.

DHURATAT NË KLASË: Merr dy çanta; një çantë të bukur dhuratë dhe një qese të vjetër plastike. Në çantën dhuratë, vendos mbeturina. Në qesen e vjetër plastike, vendos një dhuratë të bukur (për shembull, një libër ushtrimesh). Vëri dy çantat para pjesëmarrësve. Pyeti kë dhuratë do të pëlqenin. Ngrije çantën e bukur dhe pyeti: "Kush e do këtë dhuratë?". Kërkoju pjesëmarrësve të ngrenë duart. Trego çantën e vjetër dhe pyet "Kush e do këtë dhuratë?". Lëri pjesëmarrësit të ngrenë duart. Zgjidh dy pjesëmarrës t'i hapin çantat para klasës.

Shpesh japim gjykime për gjërat dhe njerëzit se si duken nga jashtë. Duke bërë këtë, mund të humbasim mundësinë për të kuptuar dikë dhe mund të shkaktojmë konflikt ose të lëndojmë ndonjë duke supozuar. Vini re: Kjo mund të përdoret për të vënë në dukje paragjykime të veçanta, kundër atyre që janë të ndryshëm: njerëzit me aftësi të kufizuara, njerëzit që u përkasin grupeve etnike, rajoneve të ndryshme, etj.

E ULURA NË PREHËR: Të gjithë qëndrojnë në një rreth, sup më sup. Ktheji në krahun e djathtë dhe urdhëroi të hedhin një hap drejt qendrës së rrethit, për ta ngushtuar atë sa më shumë. Kur të gjithë të jenë së bashku në një rreth të vogël, jepu udhëzime për t'u ulur kur të kesh numëruar tre. Çdo person ulet në prehërin e personit pas.

Jemi të ndërlidhur dhe ajo çfarë bëjmë, ndikon te të tjerët. Mund të mbështetem te të tjerët dhe ata të mbështeten te mua dhe së bashku mund të bëhemi më të fortë. Nëse unë, apo dikush tjetër, bie, prekemi të gjithë. Nëse e mbajmë peshën së bashku, bëhet më e lehtë.

Një mënyrë tjetër për të vendosur paqe në klasë, është duke ndihmuar nxënësit të zgjidhin konfliktet. Mund t'i drejtosh drejt zgjidhjes së problemeve, duke i bërë të diskutojnë problemin, të gjejnë shkakun, të diskutosh se çfarë është provuar si zgjidhje dhe, më në fund, të mendosh për zgjidhje të reja që janë të drejta për çdokënd të përfshirë. Thekso rëndësinë e shmangies së dhunës, se ajo nuk sjell ndonjë zgjidhje të gjatë dhe të ndershme. Mund të prezantosh disa prej konflikteve në diskutimin javor të klasës dhe t'i nxitësh nxënësit të kalojnë nëpër këto faza për të gjetur zgjidhjen.

MESAZHI KYÇ: Mësuesit mund të vendosin paqe, duke i mësuar fëmijët e tyre të jenë tolerantë, bashkëpunues dhe t'i zgjidhin konfliktet pa dhunë.

D Lojëra bashkëpunimi

MAKINAT NJERËZORE: Grupi ndahet në skuadra prej tetë ose nëntë vetash, të cilët zenë vende në pjesë të ndryshme të dhomës. Çdo grup planifikon si t'i tregojë të tjerëve një makinë në punë duke përdorur trupat e tyre, si të ngrihet telefoni, ose kjo mund të jetë një makinë imagjinare që nuk është shpikur ende. Pas shtatë minutash, grupi kthehet dhe ulet. Çdo grup tregon me radhë makinën e vet, pa thënë se çfarë është. Të tjerët duhet ta gjejnë se ç'është.

DETEKTIVI: Grupi qëndron në rreth. Njëri shkon në qendër dhe i mbyll sytë. Ky është detektivi. Caktoni një nxënës tjetër si drejtuesi. Drejtuesi fillon të bëjë një lëvizje që përsëritet (si lëvizja e krahut në ajër) dhe të gjithë të tjerët e kopjojnë. Pas pak sekondash, drejtuesi ndryshon lëvizjet dhe të gjithë të tjerët e kopjojnë. Loja është më argëtuese, kur drejtuesi i ndryshon shpejt lëvizjet. Sapo lëvizja të ketë filluar, thuaji detektivit të hapë sytë. Detektivi ka tri ide se kush mund të jetë drejtuesi. Më pas drejtuesi shkon në qendër dhe bëhet detektiv. Kur i ka sytë e mbyllur, ish-detektivi cakton dikë që të jetë drejtuesi duke vazhduar lojën.

TAKSIA: Punoni në grup. Paralajmëroni grupin se asnjë nuk duhet të dëmtohet në lojë. I mbulohen sytë një fëmije, ai/ajo është taksia. Fëmija tjetër qëndron prapa, duke e kapur nga pas. Ai është shoferi. Shoferi nget taksinë rreth vendit i kujdesshëm për të mos përplasur asnjë.

PIKËT E MARRA NGA PREKJA E TOKËS: Grupi ndahet në skuadra me të njëjtin numër vetësh, shpjego se çdo pjesë e trupit (dora, këmba apo të ndenjurat), kur prekin tokën, shënojnë një pikë. Kur thua një numër, e gjithë skuadra duhet të plotësojë këtë numër sa më shpejt. Për shembull, janë pesë vetë në çdo skuadër; ti mund të thuash shtatëmbëdhjetë = dhjetë këmbë dhe shtatë duar që prekin tokën; pesë = të pestë duhet të qëndrojnë mbi një këmbë; njëzet e pesë = të gjithë ulen në dysheme dhe si duart ashtu dhe këmbët prekin tokën.

E Ushtrime për zgjidhjen e problemeve

ROJA E SIGURISË: Grupi ndahet në çifte. Një është roja e sigurisë dhe i është thënë se shefi i zyrës nuk do të takojë asnjë. Rojes i është thënë të mos largohet nga dera dhe nuk ka as telefon. Tjetri duhet të takojë shefin, sepse ka një mesazh të rëndësishëm. Këta njerëz duhet të bëjnë të pamundurën për të bindur rojen që t'i lejojë të futen. Pas 4 minutash, përdor sinjalin për heshtje, për t'u kërkuar të heshtin. Pyet nëse ndonjëri ia ka dalë mbanë; zbulo metodën e bindjes së përdorur nga nxënës të ndryshëm. Nëse ndonjë ka gënjyer, diskutoni nëse është mënyrë e mirë apo e keqe për ta bërë (nëse gënjen, roja nuk do të të besojë më asnjëherë tjetër), nëse i ofroni para, ai do të kërkojë përsëri në të ardhmen. A e ka zbuluar njeri pse roja nuk i le të futen (ata humbasin

punën, nëse marrin një vendim të gabuar)? Ka më shumë gjasa për t'ia dalë mbanë, nëse plotëson si nevojat e rojes ashtu dhe të tuat (për shembull, thuaji rojes të kyçë derën dhe të shkojë të pyesë shefin). Pas disa diskutimesh, ndrysho rolet, i dyti bëhet roja dhe fillojnë përpjekjet përsëri. Diskuto përsëri nëse ndonjëri ia doli mbanë dhe si.

KONFLIKTET PERSONALE: Trego historinë e një konflikti që ke pasur me dikë në jetën tënde (ti mund ta sajosh, nëse nuk do të thuash ndonjë ngjarje të vërtetë). Më pas të gjithë ndahen në grupe të vogla prej gjashtë vetësh dhe diskutojnë për pesë minuta; çdo grup nuk duhet të bëjë më shumë se dy sugjerime se çfarë mund të bëhet për t'i dhënë fund konfliktit. Harto një listë me këto sugjerime. Theksoji grupit se disa prej tyre mund të shfrytëzohen për të fituar kundrejt kundërshtarit (rezultatet humbas-fitoj); të tjerët do të përpiqen të gjejnë një mënyrë për të kënaqur të dyja palët (rezultat i kompromisit ose ku të dyja palët fitojnë); në rastin kur të dyja palët fitojnë, secila e fiton atë që do pjesërisht dhe bie dakord të heqë dorë prej pjesës tjetër. Tregoju se një rezultat i barabartë, është më i mirë, sesa ai ku njëri fiton dhe tjetri humb dhe pyeti pse (kënaqi të gjithë, dhe ka më shumë gjasa për t'i dhënë fund konfliktit, nëse përpiqesh për fito-humb, mund të jesh dhe ti humbësi). Thuaju se cilën nga sugjerimet pëlqen më shumë dhe falënderoji për ndihmën.

DUART NË IJË: Kërkoji dikujt të bëj përpara për ta demonstruar së bashku. Ti i mban dorën dhe ia shtyn për të prekur ijën e tij, duke thënë se kjo shënon një pikë për të. Më pas, pa e lëshuar, vendosi duart në ijën tënde dhe thuaj "Kjo shënon një pikë për mua". Grupi organizohet në çifte, thuaju kur do të japësh sinjalin "Fillo" dhe jepu 15 sekonda, dhe më pas thuaju "Ndal!" (numëroji sekondat, nëse nuk ke orë). Secili duhet të bëjë sa më shumë pikë që të jetë e mundur, pa folur. Kur diskutojnë, fillojnë të zihen me njëri-tjetrin dhe nuk marrin shumë pikë. Nëse dy fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin, do të shënojnë më shumë pikë, shiko se kush e bën këtë. Pas 15 sekondash, pyeti për pikët. Nëse një çift ka bashkëpunuar, pyeti si arritën kaq shumë pikë; nëse jo, mund të tregosh si të punosh me partnerin për të shënuar sa më shumë pikë.

F

Vetëvlerësimi

VETAFIRMIMI: Ushtrime vetafirmimi janë ato që e bëjnë secilin ta ndjejë veten mirë, duke fituar respektin dhe vëmendjen e të tjerëve.

EPITETET POZITIVE: Formoni një rreth. Të gjithë do të thonë me radhë emrin me një epitet që fillon me të njëjtën germë; duhet të jenë të cilësive pozitive. “Unë jam Erioni, ëndërrimtar”, “Unë jam Anila, e adhurueshme”, “Unë jam Dritani, i drejtë”.

SEKRETET NË RRETH: Me radhë çdo person duhet t’i tregojë grupit një histori të jetës së vet, që shumica nuk e ka dëgjuar më parë.

PREZANTIMI I NJËRI-TJETRIT: Uli në çifte. Jepu pesë minuta për t’i treguar njëri-tjetrit rreth vetes (çfarë u pëlqen, çfarë bëjnë më mirë, çfarë nuk pëlqejnë, arritjet dhe ëndrrat e tyre). Pas pesë minutash, bëj një rreth të madh. Shko përreth ku çdo person prezanton fqinjin, për shembull, “Kjo është Ajkuna. Jeton me dy vëllezërit dhe motrën. I pëlqen shumë të luajë futboll me ta dhe mbrëmë bëri një gol. I pëlqen ananasi, por nuk i pëlqen të lexojë libra.”

PLASTELINA E PADUKSHME: Uluni në rreth në heshtje. Pretendoni sikur keni pak plastelinë në duar. Pa folur, pretendoni sikur po i jepni forma një objekti që ata e njohin (për shembull, bëj një kapele, bëj sikur e ke mbaruar dhe vendose në kokë). Mos puno shpejt! Kur të mbarosh, të tjerët duhet të gjejnë se çfarë ke bërë. Më pas kaloja plastelinën imagjinare personit tjetër, që të bëjë të njëjtën gjë. Vazhdo me të gjithë (është një ushtrim interesant, sepse çdo person që ka radhën, do ta kuptojë se grupi po e shikon me vëmendje dhe interes).

FAQET AFIRMUESE: Për këtë të duhet një copë letër dhe një laps ose stilolaps, për t’ia dhënë çdokujt. Secili vendos në krye të faqes emrin dhe bën një vizatim të fytyrës së vet. Më pas letrat kalohen nga e majta. Secili duhet të shkruajë disa gjëra të këndshme për personin që ka emrin në letër, më pas kalohet te një tjetër, derisa fletët mbushen dhe i kthehen secila personit që i përket (Paralajmërim: nëse grupi është më i madh se 30 veta, do të të duhen më shumë se dhjetë minuta. Kur të kesh filluar duhet të presësh derisa të gjithë të kenë mbushur faqet.)

Përqendrimi tek ana pozitive

EMRI I FËMIJËS NË NJË KUTI: Bëj një tabelë në fund të klasës me emrin e çdo fëmije në kuti. Kërkoju fëmijëve të shkruajnë komplimente për çdo fëmijë. Ata mund të shkruajnë dhe diçka pozitive për veten. **Kjo i inkurajon nxënësit të theksojnë pikat e forta të gjithsecilit.**

MARIELA	DRITANI	ALKETA
E SJELLSHME	ARGËTUES	E QESHUR
FUTBOLLISTE E MIRË	TREGON BUKUR HISTORITË	AKTORE E SHKËLQYER

DY GJËRAT MË TË MIRA: Në fund të ditës, para se fëmijët të shkojnë në shtëpi, pyeti për dy gjërat më të mira që iu kanë ndodhur gjatë ditës. Kjo ju ndihmon juve dhe nxënësit e tjerë të largohen me përshtypje pozitive nga shkolla. Kjo nuk bëhet për të shpërfillur negativen, por për të kujtuar anët pozitive, që shpesh harrohen.

MBAJ SHËNIMET E TUA MBI PIKAT E FORTA TË FËMIJËS: Shëno të gjithë emrat në librin tënd të ushtrimeve, shkruaj të paktën pesë nga anët pozitive të fëmijës. Kjo të ndihmon të përqendrohesh në këto anë pozitive e të mbështetesh aty gjatë orës së mësimit.

KLUBI I PAQES: Përjetimi i disa problemeve si për shembull, rrëmbimi, kërcënimi, humbja e sendeve në mjediset e shkollës, i shtyn disa shkolla të vendosin të krijojnë “klubin e paqes”. Anëtarët e klubit janë vetë nxënësit.

Objektivat kryesore të klubit janë:

1. Të kapërcehet agresiviteti mes nxënësve.
2. Të krijohet frymë bashkëpunimi midis nxënësve.
3. Të ndihmohen anëtarët të zgjidhin problemet e tyre.
4. Të lejohen anëtarët të marrin pjesë në aktivitete që krijojnë frymë paqësore mes tyre, shkollës dhe komunitetit.
5. Të ndihmohen anëtarët të mbrojnë shëndetin dhe mjedisin.

6 Të trajnohen të bëhen drejtues të së sotmes dhe të së nesërmes, të aftë të drejtojnë njerëzit drejt zgjidhjeve paqësore në situata problematike.
7 T'i bësh të kuptojnë se, edhe pse janë djem dhe vajza, ata janë të barabartë dhe kanë nevojë për trajtim të njëjtë.
8 Të mbjellin tek ata ndjenjën e respektit për këdo që takojnë.
9 Të krijojnë tek ata shpirtin e ndihmës për këdo në nevojë.
10 T'i mundësojnë të kuptojnë përfitimet që ka arsimimi.
11 T'i ndihmojnë të shmangin praktikat e nepotizmit dhe izolimit.
12 T'i bashkojmë mësuesit, nxënësit dhe prindërit në një komunitet të vetëm.

Për të arritur objektivat e mësipërme, klubi i paqes e kupton se duhet t'i përfshijë nxënësit në aktivitetet e mëposhtme, për të mbjellur tek ata "frymën e paqes".

Aktivitetet përfshijnë:

1 Vjershat për paqen.
2 Poezitë e bëra për paqen.
3 Fjalimet për paqen.
4 Debatet e kryera për të nxjerrë në pah anët pozitive.
5 Aktrimi i dramave ku fundi rezulton në paqe.
6 Gjëagjëza dhe proverba që japin moral të mirë.
7 Biseda të bëra nga nxënësit për paqen.
8 Hartime të shkruara nga nxënësit.
9 Këngë të kënduara për paqen.
10 Lojëra për argëtim.
11 Kërcime për të kënaqur të gjithë.
12 Diskutim për studimin e rasteve (fakultative).

Përmbledhje

Këshillimet individuale të mësuesve dhe/ose seminaret trajnuese
Jepu mësuesve informacion se si të trajtojnë sa më vlefshëm problemet me të cilat fëmijët përballen në klasë.

Këshillat e përgjithshme që mund t'u jepen mësuesve, përfshijnë:

- × Dëgjojeni fëmijën. Mos i jepni leksion dhe këshilla menjëherë.
- × Vëzhgo sjelljen e fëmijës dhe përpiqu të identifikosh shkakun. Mos mendo se e di çfarë po ju ndodh.
- × Jepi mbështetje. Siguroji se kujdesesh për ta dhe se reagimi i tyre është normal.
- × Ndihmoji fëmijët të mendojnë për mundësitë e ndryshme për veten dhe si të zgjedhin më të mirën.
- × Ndihmoji fëmijët të kthehen në aktivitetet normale pas një ngjarje stresuese në jetë.
- × Inkurajoji fëmijët kur bëjnë përmirësime.
- × Përdor standardet minimale të sjelljes, pa përdorur ndëshkimet fizike.
- × Mos i shaj fëmijët që kanë vështirësi, për shembull, idiot, budalla.
- × Inkurajo fëmijët më të rritur të diskutojnë çështjet morale, si sjellja etike në mjedisin shkollor.
- × Jepi mundësinë fëmijëve të luajnë dhe të shprehen.

Pika kontrolli

Përpiqu t'ju përgjigjesh pyetjeve të mëposhtme. Për të kontrolluar nëse përgjigjet ishin të sakta, kthehu te kapitujt korrespondues.

1. Pse duhet punuar me mësuesit për ndërhyrjet në mbrojtje të fëmijëve?
2. Cilat janë metodat e duhura për të punuar me personelin pedagogjik? Si mund të motivohen ata të organizojnë aktivitete psiko-sociale në klasë?
3. Si do ta ndihmoje një mësues që kërkon mbështetjen tënde për klasën ose aftësitë e komunikimit?
4. Çfarë këshille do t'i jepje një mësuesi, i cili ka shumë nxënës që nuk sillen mirë në klasë?
5. Si mund të punojë një mësues për t'u mësuar nxënësve shprehitë e zgjidhjes së konfliktit në klasën e tij.
6. Si mund të mbështetesë një mësues Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijës në zhvillimin e vetëvlerësimit te një nxënës i ndrojtur?

8 Ndërhyrjet e përqendruara në komunitet

Kapitulli i tetë përqendrohet në metodologjinë e krijimit të një mekanizmi mbështetës, për dhe me fëmijët, në një komunitet, me qëllim që të përmirësohet mirëqenia e tyre dhe për të hedhur hapa drejt krijimit të një shoqërie më miqësore dhe të një mjedisi të interesant për fëmijët.

8.1 Hyrje

Krijimi dhe zbatimi i një plani veprimi për fëmijët në nevojë, ka të bëjë me ndërhyrjet specifike për një grup të caktuar. Por ky plan veprimi, duhet të mbështetet nga një mjedis mbrojtës dhe miqësor për fëmijën në shkollë dhe në komunitet. Ky seksion thekson se si shkolla mund të punojë me komunitetin për të fuqizuar rrjetin për mbrojtjen e fëmijëve në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

8.2 Edukimi i qytetarisë dhe përkrahja e të drejtave të fëmijëve

Mandati i shkollës nuk është vetëm për rritjen e ndërgjegjes së qyetarëve, por edhe rritjen e qytetarëve të shëndetshëm dhe të përgjegjshëm. Të gjitha aktivitetet që synojnë përkrahjen e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe komunitet duhet të ndihmojnë në krijimin e një shoqërie miqësore për fëmijët, ku fëmijët kanë të drejta dhe përgjegjësi dhe ku gjejnë nevojën për t'u shprehur dhe zërat e tyre të dëgjohen.

8.3 Mjediset miqësore për fëmijën

Mjedisi i shkollës është vendi ku pas shtëpisë, fëmijët kalojnë më të shumtën e kohës. Është edhe vendi ku duhet të jenë në gjendje të përjetojnë vetefikasitetin dhe vendi ku mendimi i tyre duhet të merret gjithmonë në konsideratë. Prandaj, fëmijët duhet të thonë fjalën e tyre, se si mjedisi shkollor të bëhet sa më miqësor, sa më stimulues për t'ju përgjigjur nevojave të tyre. Një mjedis pozitiv mësimor, ka një ndikim të rëndësishëm mbi procesin e të mësuarit dhe "hapësira" në shkollë duhet ndarë mes të rriturve dhe fëmijëve.

Klasat individuale ose shkolla si komunitet, mund të tregojnë se si ata e shndërrojnë shkollën në një vend miqësor (piktura muri, kopshte të vogla, organizimi i festivaleve shkollorë, etj). Komuniteti i shkollës mund të krijojë një task forcë për nxënësit dhe të rriturit (anëtarët e personelit mësimor, prindërit, etj), të cilët mund të punojnë mbi këtë çështje, duke ndërtuar një plan veprimi. Është e rëndësishme që fëmijët të përfshihen plotësisht në procesin e vendimmarrjes dhe të jenë të qartë për nivelin e pjesëmarrjes. Të krijohet një mjedis miqësor për fëmijët, me fusha lojërash dhe loje. Drejtuesit e komunitetit, duhet të angazhohen për të krijuar mjedise loje jashtë shkollës.

Rregullat e arta për një hapësirë/mjedis miqësor për fëmijën

Çdo i rritur që punon me fëmijët:

1. Duhet të jetë në dijeni se ai/ajo ndikon në mbarëvajtjen e fëmijës.
2. Duhet të jetë i angazhuar për të ndarë me të shqetësimet, sa herë që ka dyshime apo vë re keqtrajtim të fëmijës.
3. Duhet të jetë në dijeni se shkelja e të drejtave të fëmijës, do të thotë abuzim.
4. Duhet të respektojë të drejtat e fëmijës:
   - × të jetojë, rritet dhe të zhvillohet,
   - × të ketë mundësi të barabarta dhe,
   - × të marrë pjesë në vendimet që e prekin atë,
   - × çdo vendim të jetë për interesin e tij më të mirë.
5. Nuk duhet të kalohen kufijtë midis një fëmije dhe një të rrituri në asnjë formë marrëdhënie.
6. Duhet të jetë në dijeni të detyrimit të tij moral për t'i mbrojtur fëmijët nga çdo lloj abuzimi.

7 Nuk duhet të futet në shkollë me lëndë plasëse apo objekte të dëmshme, si thika dhe droga.

8.4 Ndërtimi i lidhjeve mes familjes, shkollës dhe komunitetit

Shkolla mund të jetë, gjithashtu, një katalizator i rëndësishëm për të aktivizuar dhe fuqizuar mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve në komunitet. Ndërtimi i urave lidhëse midis komunitetit dhe shkollës, është i rëndësishëm për të mobilizuar komunitetin në mbrojtje të fëmijëve të tyre.

Koncepti i mobilizimit të komunitetit, përfshin përdorimin e burimeve të komunitetit (njerëzore dhe materiale) dhe fuqitë (mekanizmat ekzistuese) dhe merr në konsideratë dëshirat e komunitetit dhe mendimet e tij për t'u zhvilluar më tej. Familja, shkolla dhe komuniteti, punojnë së bashku për të mbështetur mekanizmat ekzistuese ose të reja të mbrojtjes së fëmijëve në kushtet e dhëna. Që të arrihet ky objektiv, mund të përfshihen anëtarë të veçantë të komunitetit në kohë të ndryshme.

Objektivat specifike të mobilizimit të komunitetit janë:

× Të fuqizohet komuniteti nëpërmjet përforcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve sociale;
× Të krijohet një rrjet i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet përfshirjes së komunitetit.

Komuniteti mund të shërbejë për të identifikuar fëmijët në nevojë për mbrojtje, për të informuar komunitetet mbi rreziqet e mundshme (aktivitet parandaluese) dhe, së fundmi, për të fuqizuar dhe forcuar mekanizmat e komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve. Mobilizimi i komunitetit, mund të jetë një objektiv (një ndërhyrje e bazuar në aktivitete) ose një qëllim në vetvete.

Termi komunitet mund të kuptohet në tri mënyra të ndryshme:

1 Si njësi territoriale e shoqërisë – një fshat, qytet, rreth, qytezë, etj.
2 Si njësi organizimi social – një komunitet rezidencial ose akademik.

3 Si një lloj ndërveprimi social – për shembull, ndjenja e përkatësisë, objektivat e përbashkëta, bashkëpunimi, respekti reciprok.

Pas përkufizmit të termit "komunitet", është e rëndësishme të vendosim për mënyrat dhe mjetet për të përfshirë anëtarët e tij në procesin e mobilizimit për mbrojtjen e fëmijëve. Tre nivelet e ndryshme të pjesëmarrjes, përfshijnë aktivitete që variojnë nga ato me të thjeshtat deri tek ato më komplekse. Disa prej aktiviteteve ku mund të përfshihet komuniteti, janë përshkruar më poshtë.

Aktivitetet

Që të mund të sigurojmë pjesëmarrjen e komunitetit, mund të kryhen shumë aktivitete:

- Diskutime në grup;
- Aktivitete të strukturuar për fëmijë dhe të rinj (si, aktivitete verore, etj.);
- Mbështetja e grave dhe aktivitetet në grup;
- Fushata dhe avokati;
- Sporte dhe klube me të rinj, për shembull, për adoleshentët që rrezikohen të kenë probleme sociale dhe sjelljeje;
- Sesione të shkurtra trajnuese mbi çështjet psiko-sociale;
- Çështje të drejtësisë sociale dhe mundësi shërbimesh për grupet e diskriminuara;
- Grupe e vëzhgimit të komunitetit për mbrojtjen e fëmijëve (grupet task forcë);
- Festivale dhe aktivitete sociale;
- Grupi i task forcës për problemet e fëmijëve;
- Etj,.

Kush janë përfituesit e këtyre aktiviteteve?

Përfituesit e dretpërdrejtë të mobilizimit të komunitetit, janë fëmijët dhe familjet në komunitetin përkatës. Megjithëse në të përfshihet një numër i madh aktorësh, objektivi përfundimtar është të përmirësohet mirëqenia e fëmijëve dhe e familjes.

Kush janë partnerët e mundshëm?
Grupet që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin, si ata që shënohen më poshtë, janë partnerët më të përshtatshëm. Ata, jo vetëm e njohin mirë komunitetin, por kanë lidhje me të dhe me rrjetet ekzistuese:

- × Prindërit;
- × Mësuesit dhe personelin e shkollës;
- × Drejtuesit e komunitetit dhe ata fetarë;
- × Organizatat e bazuara në komunitet (si, grupet e të rinjve, grupet e nënave, OJF-të kombëtare);
- × Organizatat qeveritare, që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve (punët sociale, drejtësia, shëndetësia);
- × Organizatat ndërkombëtare (agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe OJF-të);

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e ndërhyrjeve të përqendruara në komunitet? Në varësi të shkallës së pjesëmarrjes së komunitetit, mund të priten rezultatet e mëposhtme:

- a Komuniteti forcohet me anë të fuqizimit të mundësive lokale dhe rrjeteve.
- b Mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve bëhen të qëndrueshëm, për shkak të nivelit të lartë të përfshirjes së komunitetit.

Si mund ta masim ne ndikimin (Treguesit)?
Bazuar në rezultatet e ndryshme dhe nivelet e përfshirjes, mund të vëzhgohen treguesit e mëposhtëm:

Komuniteti fuqizohet nëpërmjet përforcimit të kapaciteteve lokale dhe rrjeteve:

- × Komuniteti mund të identifikojë problemet e mbrojtjes së fëmijëve dhe e di ku t'i referojë;
- × Komuniteti bie dakord mbi procedurat bazë për kujdesin e fëmijëve në rrezik;
- × Komuniteti përfshihet në aktivitete që lidhen me mbrojtjen (fushata, aktivitete sociale edukative, festivale për fëmijë dhe të rinj, etj).

Masat mbrojtëse janë të qëndrueshme, për shkak të përfshirjes së lartë të komunitetit dhe konceptimit të problemeve të fëmijëve si probleme të komunitetit.

- Krijohen grupet e diskutimit të fokususar, për të vlerësuar nevojat dhe për të hartuar, zbatuar dhe vlerësuar fushatat në mbrojtje të fëmijëve (aktivitetet psiko-sociale, mjedise miqësore të fëmijëve dhe të rinjve, etj.)
- Rekrutohen në punë njerëz nga komuniteti si monitorues, punonjës socialë, vullnetarë, etj.
- Komuniteti merr pjesë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e qendrave për të rinj;
- Prindërit informohen rregullisht mbi zhvillimin e fëmijëve të tyre dhe përfshihen në aktivitete.

Përmbledhje

Nxit procesin e reflektimit të përbashkët në përfshirjen e aktorëve kyç ose grupeve të komunitetit në mbrojtjen e fëmijëve.

- Në një veprim sistemik (tërësor) në mbrojtje të fëmijëve, mund të përfshihen tre grupe kryesore masash ndërhyrjeje të ndryshme, që e vënë theksin te mbarëvajtja e fëmijëve; masa ndërhyrjeje që **përqendrohen te fëmija, te prindi dhe te shkolla/mësuesi**. Të gjithë veprimet i përgjigjen nevojave të fëmijës dhe synojnë të njëjtën objektiv. Aktivitetet mbështetëse, duhet të krijojnë lidhje me familjen dhe shkollën.
- Mekanizmat mbështetës mund të aktivizohen në **katër nivele të ndryshme**: **1)** Duke krijuar ambient mbrojtës në shtëpi, shkolla dhe komunitet; **2)** Me aktivitete psiko-sociale bazë **3)** Me aktivitete psiko-sociale të përparuara, dhe **4)** Duke iu referuar profesionistëve të shëndetit mendor. Një plan veprimi mund të përfshijë aktivitete në nivele të ndryshme.
- Në një **veprimtari të integruar për mbrojtjen e fëmijëve**, mund të përfshihen sektorë të ndryshëm. Sa më shumë aktorë të përfshihen, aq më mirë koordinohet plani i veprimit. SMF-ja duhet të bëjë detyrën si menaxher parësor i rastit dhe të ketë parasysh veprimet e ndryshme, aktorët dhe sektorët e përfshirë.

Pika kontrolli

Përpiqu t'i përgjigjesh pyetjeve të mëposhtme. Për të kontrolluar nëse përgjigjet ishin të sakta, kthehu te kapitujt përkatës.

1. Cili është roli i komunitetit në mbrojtjen e fëmijëve të tij?
2. Çfarë është një mjedis miqësor për fëmijët?
3. Si mundet shkolla dhe komuniteti të bashkëpunojnë mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve?
4. Cilët janë partnerët e mundshëm të komunitetit për shkollën në krijimin e një rrjeti mbrojtës të shkollës me bazë në komunitet?
5. Si mund të nxitet komuniteti të mbrojë vetë fëmijët?

9 Udhëzime mbi aktivitetet në mbrojtje të fëmijëve për çështje specifike

Seksioni i mëposhtëm përmban informacion për çështjet specifike të fëmijëve dhe udhëzime për aktivitetet në mbrojtje të fëmijëve. Ky seksion është strukturuar në përputhje me sistemin e klasifikimit të menaxhimit të rastit. A, për abuzim/dhunë, B, për çështje sociale, C, për probleme të lidhura me shëndetin dhe E, për çështje të tjera specifike në kushtet e shkollës. Është dhënë një shembull për çdo problem të diskutuar, është dhënë informacion si SMF-ja të njohë fenomenin dhe janë nënvizuar udhëzimet për masat që duhen marrë.

Statistikat botërore për fëmijët përfshijnë [1]:

- × 3 milion fëmijë janë jetimë si rezultat i AIDS;
- × 1 milion fëmijë në tërë botën jetojnë në qeli burgu;
- × 180 milion fëmijë janë të përfshirë në format më të rënda të punës;
- × 1.2 milion fëmijë trafikohen çdo vit;
- × 2 milion fëmijë shfrytëzohen nëpërmjet prostitucionit dhe pornografisë;

1 Gjendja e Fëmijëve në Botë, UNICEF 2004

- 2 milion fëmijë janë vlerësuar të kenë vdekur, si rezultat i konflikteve të armatosura që prej 1990;
- 300,000 fëmijë ushtarë.

9.1 Udhëzime për abuzimin (A i-iv)

A Hyrje

Fenomeni i abuzimit është shumë i gjerë. Ai nuk raportohet sa duhet aktualisht në Shqipëri, por të gjithë treguesit sugjerojnë se ndodh në po atë shkallë sa dhe në shumicën e shoqërive të tjera. Prandaj, ka gjasa që abuzimi kryesisht të mos raportohet dhe të mos ndërhyhet në këtë çështje.

Fakte nga e gjithë bota

- Dhuna fizike është shumë e përhapur, 50 për qind e fëmijëve raportojnë nivele të ndryshme dëmtimi, që u shkakton frikë!
- Në tërë botën 1 nga 3 vajza, dhe 1 nga 6 djem, vlerësohen të kenë përjetuar abuzim seksual;
- Abuzuesit janë në përgjithësi të njohur të fëmijës;
- Kërcënimi më i madh për sigurinë e fëmijës, vjen nga brenda familjes dhe komunitetit.

Dhuna
Si rezultat i shpërndarjes së pabarabartë ekonomike dhe ligjeve dhe strukturave të dobëta të rendit, fëmijët dhe të rinjtë kanë qenë gjithnjë e më shumë të ekspozuar ndaj dhunës (INSTAT, 2003b:9). Fëmijët janë si viktima, ashtu dhe shkaktarë të dhunës, me një raport të lartë fëmijësh në burg për vrasje (INSTAT, 2003b:10).

Shembull
Veziko është 9 vjeç. Të dy prindërit i punojnë gjatë ditës dhe i ati rri në lokale gjatë natës. Është pothuajse vetëm në shtëpi. Nuk kanë shumë për të ngrënë, kështu që ndonjëherë, pas shkolle, lyp në rrugë. Në shkollë nuk shkon rregullisht. Nxënësit e tjerë e tallin se rrobat i ka të pista dhe mësuesi e rreh me shkop kur nuk i shkruan germat në rendin e duhur. Ai ka probleme me përqendrimin dhe nuk e mban mend të tërë alfabetin. I

pëlqen të rrijë në rrugë, të paktën atje e lënë të qetë në liri. Kur i ati vjen në shtëpi i dehur në darkë, rreh shpesh të ëmën. Kur një natë Veziko u përpoq ta ndalonte, i ati e rrahu shumë keq me rrip dhe e shau. Veziko pati të nxira në të gjithë trupin dhe nuk vajti në shkollë për disa ditë. SMF-ja u shqetësua për shkak të mungesës në shkollë dhe bashkë me drejtorin kryen një vizitë në shtëpi, ku u vunë në dijeni për situatën e Vezikos. Ata u çuditën shumë se i ati i Vezikos është njeri i respektuar në komunitet. Të gjithë e dinin se kishte raste që pinte shumë, por kurrë nuk kishin menduar se familja jetonte në kushte të tilla të vështira dhe se për të nuk kujdesej njeri.

Çfarë duhet të dini për abuzimin e fëmijëve[2]

B Përkufizimet e abuzimit

Hyrje

"Abuzimi i fëmijës është një problem universal, që ka rrënjë të thella në praktika kulturore, ekonomike dhe sociale" (Organizata Botërore e Shëndetit OBSH 2002).

Ai ekziston në të gjitha vendet, komunitetet e shprehet me vlera, besime dhe praktika personale si edhe, nëpërmjet sistemesh dhe procesesh të përhapura shoqërore, kulturore dhe institucionale, që do të thotë se fëmijëve u mohohet e drejta për një fëmijëri të sigurtë, të lumtur dhe të shëndetshme.

Shkolla luan një rol kyç për punën në nivel lokal, për të mbështetur dhe mbrojtur fëmijët. Se deri në ç'masë janë në gjendje të përcaktojnë dhe të njohin rastet e abuzimit me fëmijë e të marrin masat e nevojshme, kjo varet nga kuptimi i problemeve të fëmijëve. Personeli i shkollës punon drejtpërsëdrejti ose jodrejtpërsëdrejti me fëmijë të neglizhuar dhe në nevojë; prandaj përballet me çështje shfrytëzimi dhe abuzimi. Këto çështje mund të jenë kryesisht jashtë mjedisit të shkollës, por disa të tjerë mund të lidhen drejtpërsëdrejti me të. Skenarët e rasteve të mëposhtme, tregojnë llojet e ndryshme të abuzimit, me çka mund të përballet fëmija:

× **SKENARI 1:** "Z. Bardhyl" është njëri nga mësuesit më të vjetër dhe është bujar. Ai ka ftuar disa fëmijë të cilëve u ka dhënë mësim të

2 Ky seksion bazohet mbi informacionin e siguruar në: www.keepingchildrensafe.org.uk

shkojnë në shtëpinë e tij. Prej njërit nga fëmijët që ka qenë atje mësohet se ai (mësuesi) ka imazhe pornografike fëmijësh.

- **SKENARI 2:** Në njërën nga vizitat në shkollë, një adoleshent ankohet se drejtori e ka prekur atë dhe djemtë e tjerë në mënyrë të papërshtatshme. Kur ia përmend këtë drejtorit, ai nxehet dhe të pyet kush ta tha. Ai përmend emrin e djalit, që ai mendon se ka folur dhe të paralajmëron se ai shpik gjithmonë trillime, sepse ka probleme mendore.
- **SKENARI 3:** Një anëtar i personelit mësimor kërkoi disa ditë leje për t'u martuar. Më pas u zbulua se nusja e tij ishte 14 vjeçe.
- **SKENARI 4:** Një anëtar i personelit mësimor në shkollën tuaj, po rreh një fëmijë. Përdor një shkop për të rrahur fëmijën, sepse nuk i ka bërë detyrat e shtëpisë.
- **SKENARI 5:** Një mësues dëgjon fjalë, se njëri nga anëtarë e rinj të personeli mësimor, i cili është caktuar drejtor, e la punën e parë në rrethana të dyshimta. Fjalët ishin për sjellje të papërshtatshme me djemtë nën moshë në fshatin ku punonte më parë.
- **SKENARI 6:** Një mësues të thotë se një mësues jetër në shkollë, u kërkon nxënësve lekë që të kalojnë klasën me nota të mira.

Është e vështirë të përpiqesh të përkufizosh abuzimin e fëmijës, si një fenomen botëror për shkak të ndryshimeve të gjera kulturore, fetare, sociale/politike, ligjore dhe ekonomike që përjetojnë fëmijët. Ajo çka duket abuzive në një shtet, mund të jetë e pranueshme në një tjetër. Shumica e kërkimeve mbi abuzimin e fëmijës, janë kryer nga vende ekonomikisht të zhvilluara prandaj nuk është e qartë se sa të vlefshme janë ato edhe për këta fëmijë, jetët e të cilëve janë krejt të ndryshme.

Kështu që, duket e pamundur të sigurohet një përkufizim i vetëm. Por, në mënyrë që metodat në mbrojtje të fëmijëve të jenë të dobishme për shkollat në Shqipëri, duhet që të ketë një përkufizim se çfarë është abuzimi dhe në çfarë rrethanash duhet të zbatohen politikat dhe procedurat e shkollës.

Shembuj të praktikave abuzive:

- × T'i bërtasësh fëmijës
- × Ta trajtosh fëmijën me përbuzje
- × Të kërkosh favore seksuale
- × Ta manipulosh një fëmijë
- × Të mos dërgosh vajzat në shkollë
- × Të mos e mbikqyrësh
- × Të shpërfillësh një fëmijë me aftësi të kufizuara
- × Ta dërgosh të lypë
- × Ta fyesh
- × Ta kritikosh padrejtësisht
- × Ta godasësh për ta disiplinuar
- × Ta shpërfillësh
- × Ta çosh të punojë
- × Ta braktisësh për t'u martuar
- × Të abuzosh seksualisht
- × Të martohesh me një fëmijë
- × Të qeshësh dhe tallesh me fëmijën
- × Etj.

Çdo përkufizim mbi abuzimin dhe shpërfilljen e fëmijëve, përfshin dhe përkufizimin e fëmijës. Një fëmijë sipas UNCRC është "çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç".

"Abuzimi dhe shpërfillja e fëmijës, shpesh të shprehur si keqtrajtim i fëmijës, janë përcaktuar në Raportin Botëror mbi Dhunën dhe Shëndetin, ashtu si të gjitha format e keqtrajtimeve fizike dhe emocionale, tregtare, seksuale ose forma të tjera shfrytëzimi, si rezultat i një kërcënimi aktual dhe të fuqishëm ndaj shëndetit të fëmijës, ndaj mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kushtet e një marrëdhënie përgjegjshmërie, besimi ose fuqie." (OBSH 1999 & 2002)

Prandaj, mund të themi pa frikë se shumë fëmijë në botë abuzohen, pasi atyre u mohohen të drejtat bazë dhe jetojnë në kushte shumë të vështira. Megjithatë, çdo përkufizim lidhur me abuzimin, duhet të mendohet dhe konsiderohet me seriozitet, pasi jo të gjitha politikat e mbrojtjes së fëmijëve, mund të nxjerrin në pah abuzimin ndaj tyre. Do të ishte jo efektive nëse do të merrnim në konsideratë vetëm politikat, pa u menduar mirë më parë për abuzimin.

Abuzimi i fëmijës është një term i përgjithshëm, që përdoret për të treguar se ku fëmija mund të përballet me kërcënimin, shpesh si rezultat i dështimit të prindit, kujdestarit ose organizatës/komunitetit, për të siguruar një kujdesje dhe mbrojtje standarde ose rezultat i veprimeve që synojnë lëndimin e tij. Studime të ndryshme dhe raporte rreth tyre, kanë zgjeruar ndërgjegjësimin tonë lidhur me abuzimin e fëmijëve nga bash-

këmoshatarët, vëllezërit dhe motrat dhe nga punonjësit e ngarkuar për t'u përkujdesur për ta, si në komunitet ashtu edhe në mjediset rezidenciale (UN IASC Task Force, 2002).

Mbrojtja e fëmijës, në kuptimin e gjerë, është një term që përdoret për të përshkruar veprime që individë, organizata, shtete dhe komunitete, ndërmarrin për të mbrojtur fëmijën nga aktet e keqtrajtimit (abuzimit) dhe shfrytëzimit, për shembull, dhuna në familje, puna, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, HIV, dhuna fizike. Përsa i përket SMF-së, mbrojtja e fëmijës lidhet me përgjegjësinë dhe detyrën që ka shkolla për të mbrojtur fëmijët me personat që kontaktojnë.

Brenda përkufizimit të gjerë të keqtrajtimit të fëmijës, dallojmë pesë nënlloje, që janë:

- × Abuzimi fizik;
- × Abuzimi seksual;
- × Abuzimi emocional
- × Neglizhimi dhe trajtimi neglizhent
- × Shfrytëzimi seksual dhe tregtar.

Kjo ndarje në nënkategori të keqtrajtimit dhe përkufizimet e tyre, u bë duke u mbështetur në analizën e përkufizimeve të vendeve të ndryshme mbi keqtrajtimin e fëmijës dhe të një konsultimi të bërë në vitin 1999 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) mbi parandalimin e abuzimit të fëmijëve.

ABUZIMI FIZIK është dëmi fizik aktual ose i mundshëm, nga një veprim ose mosveprim ndaj një fëmije, i cili është nën kontrollin e prindit ose personit që ka përgjegjësinë, fuqinë ose besimin. Mund të ketë incidente të vetme ose të përsëritura (OBSH, 1999).

ABUZIMI SEKSUAL I NJË FËMIJE është përfshirja e tij në aktivitete seksuale, që ai/ajo nuk i kupton, nuk është në gjendje të japë miratimin, ose për të cilën fëmija nuk është përgatitur nga ana e zhvillimit ose nuk mund të kuptojë, ose që dhunon ligjet ose tabutë sociale të shoqërisë. Abuzimi seksual i fëmijës, është evidentuar si një aktivitet midis fëmijës dhe një të rrituri ose një fëmije tjetër, i cili nga mosha apo zhvillimi, është në marrëdhënie përgjegjësie, besimi ose pushteti, dhe ky aktivitet ka si qëllim të plotësojë nevojat e personit tjetër. Kjo mund të përfshijë, por mund të mos kufizohet vetëm në, nxitjen ose detyrimin e fëmijës të përfshihet në akte seksuale të paligjshme, shfrytëzimin e fëmijës në praktika porno-

grafike ose seksuale, fotografitë dhe materialet në internet (OBSH, 1999). Përdorimi më i fundit i teknologjisë, si interneti nga të rriturit për të joshur fëmijët që t'i takojnë ose të marrin pjesë në seks virtual, është gjithashtu abuzim.

NEGLIZHIMI DHE TRAJTIMI NEGLIZHENT është mungesa e vëmendjes ose shmangia nga ana e kujdestarit nga detyra për t'i dhënë zhvillimit të fëmijës: kujdes shëndetësor, arsimim, zhvillim emocional, ushqim, strehë dhe kushte të sigurta jetese, në kontekstin e burimeve të disponueshme për familjen ose kujdestarin dhe që shkakton a ka mundësi të lartë të shkaktojë dëm në shëndetin e fëmijës ose zhvillimit të tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social. Kjo përfshin mospërmbushjen e detyrimit për të mbikëqyrur dhe mbrojtur si duhet fëmijët nga dëmtimet. (OBSH, 1999).

ABUZIMI EMOCIONAL përfshin mospërmbushjen e detyrimit për të ofruar një mjedis të përshtatshëm mbrojtës, duke përfshirë disponueshmërinë e një imazhi kryesor atashues, që fëmija të arrijë potencialin e plotë në kushtet sociale ku jeton. Mund të ketë edhe akte ndaj fëmijës, të tilla që shkaktojnë, ose kanë një mundësi të lartë t'i shkaktojnë, dëm zhvillimit fizik, mendor shëndetësor, moral, shpirtëror dhe social të fëmijës. Këto akte duhet të jenë nën kontrollin e prindërve ose personit përgjegjës. Në ato përfshihen: kufizimi i lëvizjes, degradimi, poshtërimi, kërcënimi, diskriminimi, tallja apo forma të tjera trajtimi armiqësor dhe lënia mënjanë (OBSH, 1999).

SHFRYTËZIMI SEKSUAL është abuzimi me një situatë dobësie, abuzimi me pushtetin apo me një situatë mirëbesimi, për qëllime seksuale; këtu përfshihen përfitimi monetar, social ose politik nga shfrytëzimi i dikujt tjetër. Prostitucioni i fëmijës dhe trafikimi për abuzim seksual, janë një shembull i kësaj.

Shfrytëzimi komercial apo shfrytëzim tjetër i fëmijës, ka lidhje me shfrytëzimin e punës apo aktiviteteve të tjera të fëmijës në interes të të tjerëve. Kjo përfshin, por pa u kufizuar në të, punën e fëmijëve. Këto aktivitete e dëmtojnë fëmijën nga ana fizike, mendore, arsimimi, zhvillimi moral apo socialo-emocional (OBSH, 1999). Edhe fëmijët e rekrutuar nga ushtria bëjnë pjesë në këtë kategori.

Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe abuzimi

Aftësia e kufizuar i bën fëmijët më të prekshëm se të tjerët, përsa i përket abuzimit. Ajo që ne konsiderojmë si të dëmshme ose abuzive, ndonjëherë

shihet si e rregullt për fëmijën e abuzuar, dhe kjo ndodh për shumë arsye. Kur diskutojmë për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, është e rëndësishme të marrim parasysh jo vetëm qëndrimin dhe vlerat personale, por edhe kushtet sociale ku jetojnë fëmijët si edhe çfarë qëndrimi ka komuniteti ndaj aftësisë së kufizuar. Ndërgjegjësimi për mënyrën se si shoqëria i trajton këta fëmija, është kritike për dy arsye:

- × Që individët të mos mbajnë qëndrime ose sjellje abuzive në praktikën e tyre.
- × Që personeli mësimor të përkrahë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Është e dobishme të mendojmë për abuzimin në dy mënyra. Njëra: Abuzimin me "a" të vogël, ku do të përfshiheshin të drejtat njerëzore të një fëmije, dhe tjetra: Abuzimin me "A" të madhe, që përputhet me përkufizimet e mëparshme. Përvoja dhe studimet tregojnë se trajtimi i abuzimeve të përditshme i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara ("a" e vogël), mund të luajë një rol të rëndësishëm për të reduktuar rrezikun e Abuzimit ("A" e madhe).

Ka shumë gjëra që njerëzit besojnë rreth fëmijëve me aftësi të kufizuara, që ndikojnë në gjykimin e tyre, nëse fëmijët janë ose jo në rrezik abuzimi. E vërteta është se, fëmijët me aftësi të kufizuara, janë më SHUMË të rrezikuar nga abuzimi dhe kjo dihet nga përvoja dhe studimet ndërkombëtare.

Treguesit e abuzimit japin të dhëna të rëndësishme se çfarë mund t'i ndodhë një fëmije apo personi të ri; ata nuk duhen parë të izoluar nga pjesa tjetër e jetës dhe e përvojës së fëmijëve.

Për fëmijët me aftësi të kufizuara, treguesit e abuzimit mund të maskohen apo ngatërrohen nga paaftësia e tyre. Njerëzit mund të thonë:

- × Dëmtimet janë të shkaktuara vetiu.
- × Sjellja është shenjë e aftësisë së tyre të kufizuar.
- × Deklaratat e një fëmije me aftësi të kufizuara, janë të rreme, sepse ata nuk kanë idenë se për çfarë po flasin.
- × Ata duhet ta trajtojnë fëmijën si t'u vijë mbarë, për shembull, duke i lidhur, duke mos i ushqyer, duke mos i veshur, etj.

Prandaj është e rëndësishme të pranohet se një fëmijë me aftësi të kufizuara, mund të abuzohet e dëmtohet dhe ndikimet e abuzimit mund të jenë më të dëmshme, për shembull, një fëmijë nuk mund të ushqehet vetë dhe duke mos e ushqyer e çon drejt vdekjes. Mbrojtja e fëmijëve me

aftësi të kufizuara, mund të kërkojë një diskutim dhe vëmëndje të veçantë, sidomos kur komuniteti dhe shoqëria nuk i njohin të drejtat njerëzore të kësaj kategorie fëmijësh.

Forma të tjera abuzimi

ABUZIMI NË INTERNET DHE IMAZHET ABUZIVE TË FËMIJËVE: Imazhet abuzive të fëmijëve (gjerësisht e njohur si pornografia e fëmijëve), përkufizohet si paraqitja, me çfarëdo lloj mjetesh qoftë, e një fëmije të përfshirë në aktivitete reale apo të simuluara qartazi seksuale apo shfaqja e pjesëve seksuale të fëmijës për qëllime seksuale. Teknologjia ka bërë që fëmijët të jenë tashmë të ekspozuar më tepër ndaj abuzimit me anë të internetit. Ekziston një tregti që transmeton imazhe abuzive të fëmijëve. Aparatet dixhitale dhe celularë, kanë bërë që imazhet e disa fëmijëve të shpërndahen nëpërmjet internetit pa dijeninë e tyre. Fëmijët janë në rrezik se mund të bien në kontakt me njerëz që duan t'i dëmtojnë, nëpërmjet përdorimit të internetit.

ABUZIMI ME MAGJINË E SHTRIGAVE/ABUZIMI ME ANË TË RITUALEVE TË NDRYSHME: Disa komunitete besojnë shumë se të rriturit dhe fëmijët, mund të kenë shpirt djallëzor, që i sjell fat të keq familjes. Këto besime çojnë në praktika që mund të jenë të dëmshme për fëmijën, për shembull: lidhja, rrahja, zhytja në ujë. Këto praktika mund të çojnë në mizori dhe në vdekje të fëmijës. Fëmijët me aftësi të kufizuara, rrallë shihen si bekim dhe sjelljet e tyre interpretohen shpesh si shenjë e shpirtit djallëzor. Komunitetet ose individë të tjerë, mund t'i përdorin apo abuzojnë me fëmijët nëpërmjet praktikave dhe ceremonive rituale.

Abuzimi shpirtëror ndodh kur një udhëheqës shpirtëror ose dikush që ka pozicion apo autoritet shpirtëror (qoftë kjo organizatë, institucion, kishë apo familje), e keqpërdor pushtetin që ka, besimin e krijuar për ta, me qëllim kontrollimin, përfshirjen, manipulimin ose dëmtimin e fëmijës. Abuzimi shpirtëror, është gjithmonë keqpërdorimi i pushtetit në kuadër të besimit ose praktikës shpirtërore, në mënyrë që të plotësohen nevojat e abuzuesit (ose të rritet pozicioni që ka) në kurriz të nevojave të fëmijës. Abuzimi shpirtëror rezulton në dëm shpirtëror të fëmijës dhe mund të lidhet me abuzime të tjera, si fizike, seksuale dhe emocionale (Shënim: Ky përkufizim zbatohet në mjedise kristiane dhe i duhet përshtatur problemeve specifike që lidhen me fetë e tjera.)

ABUZIMI I BESIMIT: Një marrëdhënie besimi duhet përshkruar si: Njëra palë është në pozicion pushteti ose ndikimi mbi tjetrin, për shkak të punës ose natyrës së aktivitetit. Abuzimi i besimit, mund të përfshijë një mësues, një punonjës humanitar apo punjonjës zhvillimi, trajneri i sportit, udhëheqës skauti, udhëheqës fetar. Është e rëndësishme që ata që janë në pozicion besimi, të kenë një botëkuptim të qartë të përgjegjësive, që të mos abuzojnë me pozicionin ose të vendosin veten në një pozicion ku do akuzohen për abuzim, qoftë të justifikuar apo jo. Kjo marrëdhënie mund të deformohet nga frika ose favori. Është thelbësore për të gjithë ata që janë në një pozicion të tillë, të kuptojnë se pushteti i dhënë nuk duhet të ketë pasoja mbi ata që kanë nën përgjegjësi. Kjo është veçanërisht me rëndësi në kontekstin e shkollës, për ata që janë në pozicion pushteti dhe që mbikëqyrin e ndihmojnë fëmijët.

VLERAT KULTURORE: Ka faktorë të njohur, si statusi i ulët ekonomik, dhuna në familje, abuzimi me drogën dhe alkoolin, që e rrisin mundësinë e abuzimit me një fëmijë. Disa prej faktorëve më të fuqishmëm janë specifikë për kulturën dhe shoqërinë ku jeton fëmija. Është e rëndësishme të përcaktohet se cilat praktika janë të pranueshme dhe ç'qëndrime mbahen në rajone dhe shtete të ndryshme ndaj fëmijës, qëndrimet ndaj besimit, gjinisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual. Kjo nuk bëhet për të ulur nivelin e shqetësimit, apo për të toleruar abuzimet, por për të kuptuar më mirë mjedisin ku ndodh dhe qëndrimin e komunitetit ndaj saj.

FAKTORË TË TJERË: Studimet kërkimore kanë rritur ndërgjegjësimin e ndikimit të dëmshëm mbi zhvillimin emocional të të rinjve, të cilët jetojnë në familje ku ka dhunë, probleme mendore, abuzim me alkoolin ose drogën. Fëmijët që kujdesen për prindërit me të meta mendore dhe fizike, mund të kenë nevoja të tjera, për të cilat duhen ndihmuar.

Ngacmimet e ushtruara nga fëmijët mbi fëmijët e tjerë, kanë një ndikim shumë të dëmshëm mbi fëmijët. Këto mund të kenë formën e dhunës fizike, duke përfshirë edhe etiketimet racore dhe seksiste, apo dhe formën e dhunës emocionale, për shembull, të izolosh ose përjashtosh dikë. Është e vështirë ta përkufizosh këtë fenomen, por gjithmonë përfshin një person më pak të fuqishëm, i cili e përjeton këtë armiqësi.

Ky seksion është përgatitur duke përdorur një sërë burimesh dhe materialesh origjinale. Mund të gjeni informacion të mëtejshëm në faqet e internetit www.nspcc.org.uk website and ww.who.int.

C Elementët e rrezikut për abuzimin e fëmijës

VARFËRIA: Për shkak të varfërisë, shumë fëmijë e gjejnë veten në situatë kompromentuese, për shembull, fëmijë në rrugë, të cilët mund të abuzohen nga kushdo që u premton ushqim. Neglizhimi i vazhdueshëm ose i ashpër ndaj fëmijës, mund të çojë në dëmtime të konsiderueshme të zhvillimit të fëmijës.

PUSHTETI: Autoriteti është diçka në çka fëmijët janë mësuar të binden qysh në foshnjëri. Ata mësohen të respektojnë të rriturit. Prandaj, të rriturit mund të përdorin pushtetin, për të detyruar fëmijët të bëjnë gjëra që nuk duan, pë shembull, i përfshijnë në një akt seksual.

ABUZIMI ME SUBSTANCA: Alkooli dhe droga mund të kenë ndikime negative mbi trurin e individit. Njerëzit që abuzojnë me alkoolin dhe drogën, normalisht bëjnë gjëra që nuk do t'i kishin bërë në gjendje të kthjellët, pasi mendja e tyre është e "paekuilibruar". Një fëmijë që ka prindër të alkoolizuar, ka më shumë gjasa të abuzohet seksualisht, fizikisht ose emocionalisht.

AGRESIVITETI: Njerëzit që kanë sjellje agresive, normalisht u shkaktojnë të tjerëve frikë. Një njeri agresiv mund të përdorë sjelljen e vet për të fituar përparësi ndaj fëmijës.

DHUNA NË FAMILJE: Dhuna në familje mund të çojë në dëmtime fizike apo vuajtje emocionale të fëmijës. Fëmijët më të vegjël, mund të futen në mes të prindërve që zihen dhe të dëmtohen gjatë grindjes. Fëmijët më të rritur vuajnë emocionalisht dhe fajësojnë veten për sherrin.

D Kush janë abuzuesit seksualë të fëmijës?[3]

Çfarë është abuzimi seksual te fëmija?

Abuzimi seksual i fëmijës është përfshirja e fëmijës në aktivitetet seksual që ai/ajo nuk i kupton, nuk është në gjendje të japë miratimin, për çka nuk është fizikisht i përgatitur ose që thyen ligjet dhe tabutë sociale të shoqërisë.

3 Referencë: Sullivan, J dhe Biç, Kriminelë profesionistë: Kriminelët e seksit që shfrytëzojnë punën e tyre për të abuzuar seksualisht me fëmijët me të cilët punojnë. Child Abuse Review (2003) ; Vol 11, numri 3 153-167.J. Uajli dhe Son Ltd.

Abuzimi seksual i fëmijës, përfshin një sërë sjelljesh seksuale:

- × Aktin seksual vaginal ose anal;
- × Prekje seksuale;
- × Masturbimin;
- × Seksin oral;
- × Përdorimin e fëmijës për filmime pornografike, fotografi në internet dhe materiale të tjera;
- × Përdorimi i fëmijës për prostitucion;
- × Përdorimi i një fëmije në internet për të joshur një fëmijë tjetër, që ta takojë ose marrë pjesë në seks virtual.

Profili i një abuzuesi seksual

Një abuzues seksual fëmije, është një term i përgjithshëm, që përcakton dikë që ka interes seksual te fëmija. Disa abuzues seksualë janë të interesuar për fëmijë dhe kërkojnë të futen në institucione dhe agjenci, ku mund të kontaktojnë fëmijë, sidomos duke fituar pozicionin e besimit. Të tjerë mund të jetojnë në rrethana ku e gjejnë veten në një kulturë, ku seksi me vajza nën moshë, është normal dhe nuk dënohet nga komuniteti. Ata nuk e shikojnë veten si abuzues dhe mund të mos e kenë parashikuar se do të silleshin kështu po të jetonin në kushte të ndryshme, duke mos e marrë parasysh rrezikun.

Abuzuesit seksualë nuk kanë një profil standard. Disa janë obsesivë, mbajnë detaje në ditarë apo ruajnë piktura të fëmijëve, si edhe katalogojnë çdo aktivitet dhe krijime të fantazisë. Disa të tjerë kanë preferencë për fëmijë të një moshe të veçantë, seksi apo paraqitjeje, ndërsa të tjerë për çdo lloj fëmije. Shumë të arrestuar raportojnë se u bënë të vetëdijshëm për joshjen e tyre seksuale nga fëmijët para moshës 18 vjeç.

Megjithëse femrat përbëjnë një përqindje të vogël të abuzuesve, një numër i madh i tyre, me dëshirë apo jo, i lehtësojnë vetë shkeljet seksuale, duke u krijuar kushte të tjerëve për t'i kontaktuar fëmijët e tyre ose duke mbyllur sytë para abuzimit. Kjo zakonisht ndodh kur vetë gruaja është e dobët, qoftë emocionalisht apo ekonomikisht.

Çfarë lloj njerëzish abuzojnë seksualisht me fëmijët?

Është e pamundur të përshkruash një lloj të vetëm abuzuesi. Vijnë nga të gjitha mjediset etnike dhe sociale dhe mund të gjenden në të gjitha profesionet dhe nivelet e shoqërisë, ndonjëherë kanë dhe pozicione të

fuqishme në komunitet, përfshirë ato fetare. Janë të çdo lloj race, mund të jenë të martuar, të mirënjohur e të besueshëm.

Disa abuzojnë me vetë fëmijët e tyre, thjeshtrit, ose fëmijë të familjes së tyre. Disa mund të kenë marrëdhënie seksuale me të rritur, mund të jenë heteroseksualë, biseksualë ose homoseksualë. Një numër abuzuesish, shfrytëzojnë fëmijët për përfitime financiare, nëpërmjet pornografisë ose duke ia ofruar të rriturve të tjerë për qëllime seksuale.

Si veprojnë abuzuesit në komunitetet lokale?

Abuzuesit seksualë të fëmijëve mund të veprojnë vetëm ose organizohen në grupe, që mund të veprojnë në komunitete lokale, organizata kombëtare, ndërkombëtare. Ata krijojnë rrjete komunikimi për të planifikuar, abuzuar dhe, ndonjëherë, rrëmbyer fëmijët. Në grupe të tilla, fëmijët dhe pornografia e fëmijëve, kalohen nëpër anëtarët.

Abuzuesit seksualë mund të jenë shumë të besueshëm dhe ata që i punësojnë, punojnë me ta, ose thjesht i njohin dhe mund të jenë të bindur se interesimi që tregojnë ata, është i pafajshëm. Ata përpiqen shumë për t'u afruar me fëmijën dhe janë shpesh të mirëorganizuar, manipulues dhe të sofistikuar për mënyrën se si lidhen me organizatat, komunitetet dhe familjet. Ata shpesh ndihmojnë prindërit e stresuar, apo kujdestarët, të cilët hasin vështirësi, duke u dhënë mbështetje emocionale, ndihmojnë me para ose duke u kujdesur për fëmijën. Mund të krijojnë lidhje me një prind ose kujdestar, i cili i çon në shtëpi. Në organizata, abuzuesit seksualë, përpiqen që të bëhen të pazëvendësueshëm. Mund të shkojnë në vende ku të tjerë nuk duan, punojnë me orë të zgjatura, me pak mbështetje dhe mund të tregohen të gatshëm të mbulojnë punën e të tjerëve.

Joshësi

Abuzuesit seksualë, sidomos ata të zotët, shpesh parashikojnë, përgatiten dhe i kontrollojnë viktimat e tyre, me anë të procesit të joshjes, për një periudhë të shkurtër kohe apo për vite të tëra. Joshësi ka qëllim dytësor atë të sigurimit të bashkëpunimit të viktimës dhe ndonjëherë të familjes, si dhe të reduktojë rrezikun e zbulimit ose të marrjes vesh, duke krijuar një atmosferë normale dhe të pranueshme. Por viktimat mund ta bëjnë punën e vështirë, kur shkeljet zbulohen, ato refuzojnë të bashkëpunojnë me hetuesit, duke menduar se abuzuesi nuk ka bërë asgjë të keqe. Disa abuzues u tregojnë fëmijëve imazhe të abuzimit me fëmijë dhe pornografi

të rriturish, që viktimat e tyre të mund ta pranojnë më lehtë abuzimin. Viktimave u kërkohet të përfshijnë persona të tjerë, përmes procesit të joshjes dhe abuzimit. Shumica e abuzuesve përpiqen t'i kontrollojnë viktimat, duke u dhënë ose mos u dhënë dhurata dhe duke treguar ose mostreguar kujdes. Disa përdorin dhunë ose kërcënime psikologjike për të siguruar bashkëpunimin.

Abuzuesi mund të joshë një fëmijë duke:

- × Formuar marrëdhënie miqësore me fëmijën dhe prindërit e tij/saj, ose kujdestarët;
- × U interesuar shumë për aktivitetet e fëmijës;
- × U ofruar fëmijëve para, dhurata, ushqim, ëmbëlsira, rroba, udhëtime ditore dhe pushime. Dhuratat e palejueshme mund të përfshijnë alkoolin, cigaret ose drogën;
- × I thënë fëmijës se ajo që po ndodh, nuk është e gabuar;
- × Përdorur kërcënime ose dhunë ndaj fëmijës ose anëtarit të familjes.
- × Ia ndërprerë ndihmën.

Joshja me anë të internetit

Disa abuzues seksualë fëmijësh, përdorin forumet në internet për të folur (ose ICQ/ komunikimin direkt me mesazhe), për të gjetur dhe joshur fëmijën, duke e bindur të japë imazhe të vetes, ose duke shkruar në mënyrë seksuale, derisa më në fund takohen.

Një numër shkelësish, e kanë treguar vetë mënyrën se si i manipulojnë fëmijët që kontaktojnë, si e fitojnë besimin e tyre, duke pretenduar se i kuptojnë dhe ndajnë me ta të njëjtat ndjenja dhe interesa. Anonimiteti i internetit i lejon abuzuesit e rritur të mashtrojnë, duke thënë se janë fëmijë apo adoleshentë, duke e bërë më të thjeshtë krijimin e lidhjeve. Në disa raste, fëmijët janë takuar me abuzuesit, të cilët janë përpjekur të abuzojnë seksualisht, ndonjëherë me sukses.

Imazhet e abuzimit të fëmijës

Ndonjëherë ekspertët besojnë se të shikuarit e imazheve me fëmijë të abuzuar, bën që abuzuesit të normalizojnë ndjenjat e tyre seksuale dhe të shkelin çdo kufi faji që mund të parandalonte abuzimet fizike. Cilado qoftë lidhja e saktë midis të parit të imazheve dhe kryerjes së akteve seksuale me fëmijë, thjesht, mbajtja e imazheve është në shumë vende, shkelje kriminale. Për më tepër, kërkesa për imazhe të reja, inkurajon

produktorët të gjejnë viktima të reja, ose të përsërisnin abuzimin e viktimave ekzistuese. Prodhimi i imazheve, zakonisht përfshin abuzimin me fëmijë, megjithëse disa imazhe të rriturish, modifikohen përmes kompjuterit. Interneti ka bërë të mundur një rritje të madhe të publikimeve të imazheve të abuzimit të fëmijëve në kompjuter dhe shpërndarjen e tyre anembanë. Imazhet kompjuterike të abuzimit, kanë zëvendësuar gjëresisht materialet e printuara.

Turizmi i seksit (ose njerëzit që udhëtojnë për të bërë seks me fëmijë)
Disa kriminelë seksi udhëtojnë që të mund të abuzojnë me fëmijët. Disa i marrin viktimat me vete, disa dihet që i organizojnë takimet qysh më parë me viktimat, zakonisht nëpërmjet internetit, por shumica kërkojnë vende ku mund t'i kontaktojnë fëmijët me lehtësi, përfshirë fëmijët prostituta. Duke bërë këtë, ata shpresojnë t'i shpëtojnë ndjekjes nga vendi i tyre. Tërheqja për vende të veçanta, lidhet me një sërë faktorësh, ku përfshihet pranimi apo tolerimit i seksit në mosha të vogla, legjislacioni i papërshtatshëm ose ligje të dobëta dhe një industri e zhvilluar e seksit. Varfëria është, gjithashtu, një faktor i rëndësishëm dhe vendet ku ka pasur fatkeqësi natyrore ose ekonomike, ka më shumë mundësi të tërheqin abuzues seksualë fëmijësh. Disa abuzues me lirshmëri gjejnë vende ku fëmijët janë më pak të zhvilluar fizikisht për moshën që kanë.

Çfarë është shkelja seksuale?
Shkelja seksuale është një sjellje që planifikohet qysh më parë dhe me paramendim. Këto sjellje bazohen shumë në perceptimet e shtrembëruara, që kanë lidhje me pushtetin dhe kontrollin e që më pas kthehen në qëndrime seksuale. Këto qëndrime shfaqen në cikle sjelljesh të përsëritura dhe obsesive.

Ka shumë teori dhe modele në përdorim dhe shumica ndajnë të njëjtat pikëpamje në lidhje me sekuencat e sjelljes.

Abuzuesi mund të ketë përvoja të kaluara ose karakteristika të personalitetit, që çojnë në fantazi seksuale, ku përfshihen fëmijë. Kjo mund të ndodhë se fëmija përmbush disa nevoja të rëndësishme emocionale ose burime të tjera të kënaqësisë seksuale, jo aq të disponueshme ose të perceptuara si jo të këndshme. Këto njihen si reagime **disfunksionale**. Diçka e shtyn personin për të vepruar mbi bazën e fantazisë dhe objektivi do të jetë viktima/fëmija.

Pas aktit abuziv, abuzuesi mund të ketë ndjenjë faji, megjithëse mendi-

met e ngatërruara mund ta ndihmojnë shpejt të shpjegojnë aktin e tyre si të "provokuar nga fëmija", të bërë nën influencën e pijes, ose që nuk është në natyrën e personit, thjesht "ndodhi", apo mohimin e faktit si abuzim. Pasi zhduket ndjenja e fajit dhe përgjegjësisë, rritet dëshira për të përsëritur sjelljen dhe kështu vazhdon cikli i abuzimeve.

Kriminelët profesionistë

Shfrytëzues profesionistë janë personat që kontaktojnë fëmijët nëpërmjet punës, për të abuzuar me to. Kjo lind pyetjen rreth motivimit të mundshëm të shfrytëzuesve profesionistë:

- × A e kërkojnë punën, thjesht, për të pasur mundësi të abuzojnë me fëmijët seksualisht apo i korrupton pozicioni i pushtetit?
- × A është manipulimi seksual i fëmijëve, një nga llojet e abuzimeve që depërton në mjedisin e punës?

Nga hetimet e kryera në institucionet ku abuzohet, del se abuzuesit i përdorin ato për të lehtësuar abuzimin dhe për të parandaluar zbulimin e tyre.

Në një studim në Mbretërinë e Bashkuar:

- × 90 për qind e shfrytëzuesve profesionistë ishin në dijeni të interesit të tyre për fëmijë qysh në moshën 21 vjeçare.
- × Rreth 2/3 e tyre kanë kryer shkelje seksuale ndaj një fëmije në moshën 21 vjeçare.
- × Mbi gjysma thanë se zgjedhjen e karrierës së tyre, e kanë bërë plotësisht ose pjesërisht, të motivuar nga dëshira për të kontaktuar fëmijë.

Është e nevojshme të ketë studime të mëtejshme për kriminelët profesionistë, për të kuptuar sa më mirë motivimin e tyre për të abuzuar seksualisht me fëmijët në ambientin e punës.

E Si të identifikohen rastet e abuzimit të fëmijëve?

Treguesit e abuzimit të fëmijëve:

- × Ndryshim ekstrem i sjelljes;
- × Ndryshim personaliteti;
- × Mbyllje në vetvete ose melankoli;
- × Pamundësi për t'u përqendruar;
- × Sjellje e shpërqendruar;

- × Sjellje destruktive;
- × Hidhërim/sjellje vetëshpërqendruese;
- × Shfaqje e një sjelljeje karakteristike për fëmijët e një moshe më të vogël;
- × Humbje oreksi/probleme ushqimi;
- × Probleme me gjumin;
- × Probleme në shkollë;
- × Tentativë për vetëvrasje;
- × Abuzim me drogë ose alkool;
- × Zemërim ndaj një personi të veçantë;
- × Frikë nga burrat ose djemtë (kur ka ndjenjë negative ndaj shfrytëzuesit);
- × Mospëlqim i të rriturve/dëmtim;
- × Urinim në shtrat;
- × Sjellje agresive;
- × Izolim;
- × Dhimbje koke;
- × Largimi nga shtëpia;
- × Shenja fizike në trup.

Shenja që tregojnë se problemi mund të jetë seksual

- × Humbje e njëhershme besimi te një i rritur i njohur, ose përpjekje për të shmangur të rriturin;
- × Frikë e re nga larja, apo ndërrimi i rrobave ose napave;
- × Sjellje e tepërt dhe e papërshtatshme seksuale për moshën e fëmijës;
- × Preokupim në aktivitete seksuale;
- × Mënyrë e çuditshme të ecuri e shkaktuar nga dhimbja dhe shqetësimi;
- × Shprehja e dashurisë në mënyrë të papërshtatshme;
- × Shenja rebelimi, sidomos kundër mamasë.

Simptoma të tjera mund të përfshijnë: Ankth, frikë, çrregullim i stresit postraumatik, makthe, probleme të përgjithshme, melankoli, tërheqje shoqërore, mendime për vetëvrasje, vetëvlerësim i ulët, ankesa trupore (tension i lartë gjaku, dhimbje koke, etj.), agresivitet, sjellje agresive antishoqërore, mizori, sjellje kriminale, sjellje e papërshtatshme seksuale, imoralitet, probleme shkollore/mësimore, probleme me sjelljen,

hiperaktivitet, regres/papjekuri, sjellje shkatërruese, abuzim me substanca, probleme me vetëlëndimet, simptoma të ndryshme komplekse, etj.

Kujdes!!!
Treguesit e sipërpërmendur, nuk janë specifikë. Kjo do të thotë se ato mund të jenë edhe shenja për shqetësime të tjera, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve!

F **Ndikimet e abuzimit seksual**

Ndikimet e abuzimit seksual te fëmijët, janë komplekse. Ndonjëherë ka mundësi të ketë mungesë shenjash. Në raste të tjera, fëmija mund të ketë manifestime të ndryshme. Por kemi edhe raste kur mund të ketë ndikime afatgjatë, duke e bërë fëmijën të dobët ndaj problemit.

Ndikimet afatshkurtër:
- × Ndjenjë pafuqie;
- × Inat;
- × Frikë;
- × Ankth në rritje;
- × Fobi (objekte ose njerëz);
- × Makthe;
- × Vështirësi në përqendrim (ëndërron me sytë hapur);
- × Kujtime lidhur me ndodhinë traumatike;
- × Vigjilencë e rritur ndaj mjedisit përreth, nga frika se mos takohet me abuzuesin.

Ndikimet afatgjatë:
- × Probleme psikologjike;
- × Depresion;
- × Ankth kronik ose i madh;
- × Vetëvlerësim i ulët;
- × Faji;
- × Shqetësime në gjumë;
- × Fenomene disociative;
- × Probleme me besimin dhe intimitetin në marrëdhënie (ndrojtje);

- × Të mbijetuarit e abuzimit seksual, ka mundësi që të bien prapë viktima të abuzimit seksual në moshën e rritur;
- × Abuzues potencialë;
- × Mungesë e besimit te vetja;
- × Agresivitet;
- × Probleme me sjelljen;
- × Vetëlëndim;
- × Përdorim droge;
- × Prostitucion;
- × Largim;
- × Lidhje dhe probleme seksuale;
- × Tërheqje sociale;
- × Imoralitet seksual;
- × Riviktimizim;
- × Paaftësi për të mësuar;
- × Çrregullime psikiatrike;
- × Çrregullime në ushqim;
- × Çrregullime trupore;
- × Çrregullime të stresit post-traumatik;
- × Çrregullime personaliteti.

G Raportimi

Kushdo që është i përfshirë në punën me fëmijë në një shkollë, duhet të njohë procedurat e raportimit për abuzimin e fëmijës (për më shumë informacion, lexo Manualin për Mbrojtjen e Fëmijëve për shkollat).

Procedura për raportim
Nuk ekziston ndonjë njësi për mbështetjen e viktimave në Drejtoritë Rajonale të Policisë në Shqipëri. Megjithatë, janë dy njësi specifike: Seksioni për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe Njësia Anti-trafik, brenda në strukturën e policisë. Rastet e abuzimit mund t'iu raportohen atyre përkatësisht.
Sipas Kodit Penal shqiptar "Moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet." Neni 300 i Kodit Penal.

Në kodin penal parashikohet cilësimi kriminal i një vepre kundër fëmijës. Kodi konsideron si shkelje penale akte të ndryshme si: abuzimin seksual ose kërcënimin për të; prodhimin, shpërndarjen, reklamimin, importin, shitjen dhe publikimin e materialeve pornografike për të mitur; lëndimin fizik; mosparandalimin real ose të mundshëm të tij; neglizhimin e rëndë ose të vazhdueshëm; mosmarrjen e masave në mbrojtjen e fëmijëve nga ekspozimi ndaj kërcënimit; abuzimi i vazhdueshëm dhe i rëndë emocional.

Kjo do të thotë se, nëse je në dijeni të ndonjë krimi të kryer ndaj fëmijëve, është detyra juaj të raportoni, përndryshe moskallëzimi quhet vepër penale.

Nëse nuk është e qartë kujt t'i raportosh në policinë e rrethit, mjafton të kontaktohet një polic dhe ai është në gjendje t'ju adresojë te personi përgjegjës, brenda strukturës përgjegjëse të policisë.

Mandati i policisë nuk është të mbrojë viktimat, por të sigurojë rendin publik, të parandalojë dhe të hetojë çdo vepër penale, që është kundër të drejtave të qytetarëve.

Besueshmëria në deklaratat e fëmijëve për abuzim seksual

Në varësi të moshës së fëmijës, denoncimi mund të ndikohet nga mosbesimi. Megjithatë, besohet se, në përgjithësi, denoncimi për abuzim nga vetë fëmija mjegullohet nga mosbesimi. Elementët që mund të ndikojnë në besueshmërinë e deklaratave të fëmijëve, janë:

- Aftësitë gjuhësore;
- Aftësitë e kujtesës;
- Koncepti i kohës;
- Fantazia;
- Njohuritë seksuale;
- Sugjerimet e fëmijës;
- Qëndrueshmëria në deklarata.

Profesionistët e përfshirë në intervistimin e fëmijës, nuk duhet të pranojnë domosdoshmërisht perceptimin e bazuar në "sytë e vëzhguesit" dhe duhet të mbajnë parasysh sugjestionimin e fëmijës. Në të njëjtën kohë, fëmijët mund të japin informacion të saktë sipas moshës dhe zhvillimit, nëse intervistohen në mënyrën e duhur.

Përveç kësaj, lind nevoja edhe për analiza mjekësore për të mbështetur raportimet verbale.

Treguesit mjekësorë:
- × Trauma gjenitale;
- × Anomalitete anale/gjenitale.

Treguesit përcaktues:
- × Sperma;
- × Gonorea;
- × Sifilizi.

H Reagimet e familjes ndaj abuzimit seksual

Familjet kalojnë nëpër 5 faza për të zbuluar nëse një anëtar i familjes së tyre është abuzuar seksualisht. Profesionistët duhet të kuptojnë se si reagimi i familjes ndikon në menaxhimin e rastit, se si e prezantojnë atë tek ju dhe se si kjo gjë ndikon në reagimin e tyre ndaj kërkesave që ju u drejtoni. (Për shembull, në plotësimin e formularëve, për të bërë vizitë në spital dhe në komisariatin e policisë, për të dhënë informacion të detajuar në një intervistë).

1. **TRONDITJA/PAFUQIA:** "Çfarë po ndodh?"
2. **MOHIMI:** "Nuk ka ndodhur!"
3. **INATI:** "Kush e bëri? Do ta vras!"
4. **TRISHTIMI:** "Vajza jonë, çfarë do të bëhet me të?"
5. **ZGJIDHJA:** "Do ndërmarrim veprimin e mëtejshëm."

Shënim: Në disa situata, familja nuk e kapërcen fazën 2, atë të mohimit. Që familja të kalojë në fazat e tjera, duhet që, ose një anëtar i familjes të mbështetesë arsyetimet e fëmijës, ose duhet të ketë një ndërhyrje të fuqishme nga komuniteti apo sistemi ligjor.

Si të bësh hetime për rastet e abuzimt seksual të fëmijëve?
Shumë rrethana të abuzimeve seksuale, nuk raportohen me një probabilitet prej 95 për qind. Mosraportimi ndodh për një sërë arsyesh. Viktimat e reja kanë më pak gjasa të raportojnë abuzimin, dëshmitarët e pavarur janë të rrallë dhe viktimat mund të kenë turp, ndjenja të ngatërruara faji dhe siklet. Fakti që viktimat shpesh raportojnë abuzimin pasi kalon një-farë kohe, kur rriten, do të thotë se krimineli seksual mund të jetë aktiv

për një kohë të gjatë, derisa të vihen në dijeni autoritetet. Kjo bën të mundur që abuzuesit të kryejnë shumë shkelje ndaj më shumë se një viktime, para se të ndalohen nga autoritetet.

Për profesionistët që punojnë në fushat e abuzimit të fëmijëve, është e rëndësishme të kuptojnë dinamikën e abuzimit. Nëse e kupton këtë, do të jesh më efikas në përgjigjen që do të japësh. Për shembull, nëse je duke hetuar një rast abuzimi seksual te fëmija, mund të ketë pasoja të rënda nëse nuk e kupton procesin, duhet të jesh shumë i kujdeshëm kur flet me një fëmijë, të mos ushtrosh presion, sepse kështu mund të shkaktosh situata abuzimi me fëmijën. Fëmijët mund të reagojnë me heshtje. Duhet të kesh shumë kujdes, të mos t'i sugjerosh fëmijës fjalë ose ide, bëj pyetje të hapura.

Për shembull: "Çfarë ndodhi më pas?"

Sigurohu të mos bësh pyetje të mbyllura. Për shembull: "Të preku te këmba?", pasi kështu mund të dëmtosh provat.

Kjo është sidomos e rëndësishme në kushtet e shkollave, pasi ka shumë gjasa që shqetësimet të hetohen nga brenda. Nëse hetimi dhe provat janë të besueshme, atëherë duhet të zbatohen procedura disiplinore dhe masa të tjera për të siguruar fëmijët.

Si të ndihmojmë në rastet e abuzimit?

Të njohim dhunën

- × Një fëmijë që ti njeh, apo djali ose vajza juaj, mund të jetë pikërisht personi që do të të kërkojë ndihmë.
- × Ji i qartë për ato që mund, dhe nuk mund, të bësh, për ndikimin e veprimeve të tua.
- × Një fëmijë që të kërkon ndihmë mbi abuzimin, të beson shumë prandaj ka nevojë për respektin tuaj. Mos reago në bazë të emocioneve. Respekto dëshirën e fëmijës.
- × Fëmijët e abuzuar përpiqen të marrin ndihmë nga të rriturit, por kur dështojnë, heqin dorë dhe heshtin.
- × Fëmijët nuk komunikojnë njësoj si të rriturit.

Çfarë të bësh nëse dikush të thotë se është abuzuar me të?

Parimi kryesor për t'iu përgjigjur çdo shqetësimi mbi abuzimin e fëmijës, është të vesh në plan të parë sigurinë dhe mbarëvajtjen e tij. Asnjë fëmijë nuk duhet të vihet në një rrezik më të madh, prej veprimeve të ndërmarra

prej jush. Nëse një i ri të informon se është i shqetësuar për sjelljen e dikujt dhe bën një deklaratë të drejtpërdrejtë, duhet të:

- × Reagosh me qetësi;
- × Risigurosh se bën mirë që treguan, por **mos premto konfidencialitet;**
- × Merre seriozisht atë që thonë, megjithëse përfshi dikë që ti mendon se nuk do të bënte keq. Dimë nga përvoja se duhet të dëgjojmë atë që na thonë, megjithëse mund të jetë e vështirë ta besojmë;
- × Shmang pyetjet drejtuese (thuaj "Çfarë ndodhi më pas?", por jo "A të preku te këmba?"). Përpiqu të kuptosh sa më qartë personin, pa bërë sugjerime;
- × Garanto sigurinë e fëmijës ose të të riut. Nëse ka nevojë për mjekim urgjent mjekësor, sigurohu që mjekët dhe personeli mjekësor të dinë se është një problem për mbrojtjen e fëmijës;
- × Prindërit dhe kujdestarët, duhet të kontaktohen vetëm pasi të kesh udhëzimin nga mbikëqyrësi yt, personelin e caktuar për mbrojtjen e fëmijës apo organizatat e tjera,si klinika ligjore për të mitur në Tiranë.

Pesë gjëra për t'i thënë fëmijës që beson tek TY

1. Të besoj.
2. Nuk është faji yt (fëmija nuk mund të jetë asnjëherë përgjegjës).
3. Më vjen mirë që më tregove.
4. Më vjen keq që të ka ndodhur.
5. Do të përpiqem të të ndihmoj.

Si mund të trajtohen rastet e abuzimit?

Hapat që ndërmerren zakonisht:

- × Siguria e fëmijëve të abuzuar dhe e ndonjë viktime tjetër të mundshme abuzimi në shtëpi, është e një rëndësie shumë të madhe. Zhvendosja e viktimave dhe vendosja në kujdestari mbrojtëse apo në streha, është shpesh e nevojshme.
- × Këshillimi i fëmijës, familjes dhe ndonjë tjetri të abuzuar, është i rëndësishëm për të trajtuar stresin dhe traumën emocionale e psikologjike.
- × Në rastet e neglizhimit, kërkohet të përcaktohen kërkesat dhe nevojat reale që ka fëmija.

- Duhet punuar për të korrigjuar sjelljet me rrezikshmëri të lartë të prindërve, si abuzimi me substanca/alkool.
- Pedofilët (njerëz që abuzojnë seksualisht me fëmijët), shpesh kanë nevojë për terapi intensive psikologjike dhe farmakologjike, para se të lihen të lirë në një komunitet, për shkak të shkallës së lartë të shkeljeve të përsëritura.

Si mund të parandalohet një abuzim fëmije?

Edhe kjo është një çështje delikate dhe përfshin këto masa:

- Është e nevojshme një strukturë për mbështetje në grup, për të përforcuar shprehitë prindërore dhe për të ndjekur nga afër mirëqënien e fëmijës.
- Infermiere që vizitojnë në shtëpi apo punjonjës socialë, për të vëzhguar dhe vlerësuar ecurinë e fëmijës dhe situatën e përkujdesësit të tij/saj. Strukturat e përkrahjes dhe punonjësit socialë apo infermierët që shkojnë në shtëpira, nuk e përjashtojnë njëritjetrin. Shumë studime kanë treguar se të dyja masat duhet të lidhen bashkë për të arritur rezultatin më të mirë të mundshëm.
- Programet e shkollës për fëmijë lidhur me “prekje të keqe … prekje të mirë”, mund t’u ofrojnë fëmijëve një forum ku ata të luajnë me role dhe të mësojnë të shmangin skenarët e dëmshëm.
- Si përkrahës të fëmijëve, duhet t’u kujtojmë prindërve rëndësinë që ka kujdesi shëndetësor parandalues, ku përfshihen përdorimi i sediljeve të përshtatshme dhe i rripit të sigurimit, përdorimi i skafandrave për biçikleta; siguria në ujë dhe pishina; siguria nga zjarri dhe parandalimi i helmimit.

9.2 Udhëzime për problemet sociale (Bi - Biv)

Ka mjaft probleme të ndryshme sociale, që mund të prekin një familje, që ndikojnë në mirëqenien dhe zhvillimin e shëndetshëm psiko-social të fëmijës. Seksioni i mëposhtëm ndalet në tre probleme të zakonshme për mbrojtjen e fëmijës.

9.2.1 Puna e fëmijëve (Bi)

Shembull[3]

Anisa është 10 vjeç. Ajo nuk mund të shkojë në shkollë rregullisht. Zakonisht ndihmon mamanë të kujdeset për vëllezërit dhe motrat, ose të shesë perime në treg. I ati mendon se nuk është e rëndësishme që një vajzë të shkojë në shkollë. Ai vetë nuk ka qenë asnjëherë në shkollë dhe mezi numëron deri në njëzet. Anisa ëndërron të mësojë shkrim e këndim dhe kërkon të dijë shumë gjëra. Një ditë ajo dëgjoi dikë që fliste një gjuhë krejt të panjohur për të. Ishin të huaj. Anisa ëndërron të mësojë ndonjë gjuhë të huaj dhe të udhëtojë në vende të largëta. Shpesh luan "mësuese", kur është vetëm ose me vëllain dhe motrat. Do të dëshironte të ndihmonte fëmijët si ajo të mësonin më shumë shkrim e këndim dhe të dinin më shumë për botën.

Çfarë duhet të dish?

Kalimi nga komunizmi në kapitalizëm, ka krijuar ekonomi informale, që ka kontribuar në shfrytëzimin e fëmijëve për punë. (INSTAT, 2003a:6). Ky është kryesisht pasojë e çrregullimit social dhe dobësimit të kontrollit ligjor dhe legjislativ, dhe për këtë arsye fëmijët mbetën të pambrojtur dhe të dobët ndaj shfrytëzimit (INSTAT, 2003a:6).

Ka faktorë të rëndësishëm sociale, që favorizojnë punën e fëmijëve në Shqipëri, pasi tradicionalisht shoqëria shqiptare e konsideron punën më shumë edukative, sesa të dëmshme për fëmijën dhe pasi mirëqenia materiale nuk shihet shumë e varur nga arsimimi, duke bërë kështu që punësimi të shihet si më përfitues (INSTAT, 2003a:7).

Si të ndihmojmë

- × Përkrah shkollimin e fëmijëve.
- × Mbështet aktivitetet e ndërgjegjësimit në komunitet për prindërit.
- × Udhëzo prindërit dhe kujdestarët parësorë të marrin ndihmë ligjore dhe ekonomike.

3 Ky rast tregon se pjesa më e madhe e problemeve, kanë lidhje mes tyre. Në rastin e Anisës kemi dy probleme – puna e fëmijëve dhe diskrimimi për shkak të seksit.

9.2.2 Gjakmarrja (Bxiii)

Eltoni është 10 vjeç dhe jeton me gjyshin në Durres. Është i ndarë nga pjesa tjetër e familjes, e cila jeton në një fshat në Shkodër, në veri të Shqipërisë. I ati vrau fqinjin para gjashtë muajsh dhe u arrestua për këtë krim. Por në fshatin e tyre, ekzistojnë akoma ligjet e Kanunit dhe gjaku kërkon gjak. Mamaja e Eltonit vendosi ta largonte, sepse i trembej gjakmarrjes. Eltoni është i vetmi mashkull i familjes. Ajo dhe dy motra të tjera të vogla, vazhdojnë ende të jetojnë në fshat. Të vrasësh një femër, nuk është gjakmarrje. Tani Eltoni jeton në kushte shumë të vështira, sepse e ardhura e vetme që kanë, është një pension i vogël prej 14.000 lekësh në muaj. Gjyshi është i sëmurë dhe një pjesë e mirë e shpenzimeve shkon për ilaçe. Eltoni punon si ndihmës në një lavazh pranë shtëpisë së gjyshit sa herë që mundet. Qëkur është larguar nga familja në Shkodër, ai e ka lënë dhe shkollën.

Çfarë duhet të dini për gjakmarrjen?
Gjakmarrja është një fenomen shoqëror, që ndodh kryesisht në veri të Shqipërisë. Por gjatë 15 viteve të fundit, me migrimin drejt qyteteve jugore, ky fenomen mori përmasa dhe më të mëdha. Sipas Kanunit, kur një mashkull vret dikë, familja e viktimës ka të drejtë të marrë hak, duke e vrarë personin ose një mashkull tjetër të familjes. Kështu gjakmarrja përsëritet. Vrasja e një femre nuk parashikohet në gjakmarrje. Për përballimin e këtij fenomeni të ashpër social në ditët e sotme, janë krijuar organizata për pajtimin e gjaqeve.

Si të ndihmojmë

1. Drejtoria Arsimore Rajonale duhet të informohet mbi rastin. Ata kanë programe të veçanta për fëmijët që janë në rrezik gjakmarrjeje. Është detyra e tyre të sigurojnë një mësues në shtëpi për fëmijën.
2. Rasti i duhet raportuar Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (ose shërbimeve sociale apo organizatave të specializuara, që ofrojnë ndihmë ekonomike dhe këshillime për shqetësimet e mbrojtjes së fëmijëve, nëse nuk ka Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve).
3. Rasti i duhet referuar organizatave që janë të specializuara për pajtimin në rastet e gjakmarrjes.

9.2.3 Diskriminimi i grupeve minoritare (Bxiv)

Shembull

Blerina është një 13 vjeçare nga komuniteti rom. Jeton bashkë me të ëmën, vëllain dhe motrën në një dhomë. I ati është në burg. Situata ekonomike e familjes, është e rëndë, e ëma është pa punë dhe nuk mund të gjejë një punë që të ushqejë fëmijët. Blerina vazhdoi shkollën deri në klasë të tretë dhe më pas e la. Mësuesit vunë re mungesat e saj të shpeshta dhe njoftuan drejtorin e shkollës, i cili informoi psikologun e shkollës. Psikologu bëri vizitë në familjen e Blerinës, për të vlerësuar dhe kuptuar situatën e familjes. Gjatë diskutimit me mamanë e Blerinës, psikologu mori vesh për situatën ekonomike të familjes, se Blerina ishte ndjerë shumë e diskriminuar dhe e vetmuar në klasë. Me anë të vizitave të shumta, psikologu i shkollës përpiqet të gjejë zgjidhje me Blerinën dhe të ëmën.

Në planin e përbashkët të ndërhyrjes, "Terre des hommes" ofroi ndihmë mujore familjare dhe një punë për mamanë në klubin e qëndistarisë të Korçës. Ndihma familjare do të shkurtohej për arsye të të ardhurave të mjaftueshme nga vetëpunësimi. Përveç kësaj, vajza u regjistrua në shkollë dhe shkonte rregullisht. Blerinën e ndiqte rregullisht psikologu i shkollës dhe ajo u nxit të merrte pjesë në aktivitete të ndryshme shkollore dhe komunitare, si kampet verore të organizuara nga "Terre des hommes". U bënë takime të ndryshme midis psikologut të shkollës, përfaqësues të "Terre des hommes", Blerinës dhe mamasë së saj. Blerina u ndoq për një periudhë gjashtëmujore dhe ajo vazhdon tani shkollën rregullisht. Mësuesit janë të kënaqur me mbarëvajtjen e saj.

Çfarë duhet të dini

Komuniteti evgjit në Shqipëri përbën rreth 10 për qind të popullsisë dhe megjithëse janë të ndryshëm nga ana etnike, shoqërohen shpesh me komunitetin rom (INSTAT, 2003a:24). Romët janë tradicionalisht endacakë dhe e kanë origjinën nga India (INSTAT, 2003:24). Kanë flamurin dhe ruajnë identitetin, gjuhën dhe traditat e tyre (INSTAT, 2003a:24). Besohet se komuniteti evgjit ta ketë origjinën nga Afrika Veriore, megjithatë me kalimin e kohës ata i humbën gjuhën, traditat dhe tiparet e tjera kulturore (INSTAT, 2003a:24).

Komuniteti rom dhe evgjit historikisht kanë përjetuar një përjashtim të madh shoqëror (IPEC, 2005:7; Tdh, 2006e:9). Këto grupe minoritare

kanë nivel të ulët arsimimi, punësimi dhe pamundësi, për të përfituar strehim dhe burime të tjera (Tdh, 2006e:9). Fëmijët e këtyre komuniteteve janë veçanërisht në nevojë, pasi shpesh ata janë të detyruar të punojnë përkrah prindërve në rrugë, duke u prekur nga trafikimi (IPEC, 2005:7; INSTAT, 2003a:12, 24).

Si të ndihmojmë?

- × Vizita të përbashkëta në familje (me mësuesin, punonjësit e NMF).
- × Bashkëbisedime me familjen për të gjetur zgjidhjen dhe për të përgatitur një plan veprimi të përbashkët.
- × Bashkëpunim me mësuesit, për të ndjekur mbarëvajtjen në shkollë.
- × Përfshirjen e të gjithë nxënësve në aktivitete, që synojnë vendosjen e barazisë dhe integrimin e grupeve minoritare, respektin për identitetin kulturor dhe traditat.

Është e rëndësishme që shkollat dhe komunitetet të bashkëpunojnë për të integruar fëmijët në mjedisin shkollor. Përveç kësaj, organizimi i aktiviteteve të ndryshme psiko-sociale në shkollë, si ato argëtuese dhe edukative, i ndihmojnë nxënësit të pranojnë ndryshimet e origjinës, kulturës dhe traditave.

9.2.4 Migrimi i brendshëm/zhvendosja (vi)

SHEMBULL: Migrimi

Juela është 13 vjeçe. Familja e saj ka ardhur në Tiranë para 3 vjetësh nga një fshat verior. Tani Juela është në klasën e shtatë në një shkollë në periferi. Ndjehet vetmuar dhe pa mbështetje në shkollë, sepse është nga veriu. Prindërit e saj kanë takuar mësuesit për të diskutuar mbi situatën, por përsëri shokët e klasës e diskriminojnë Juelën. Janë të ashpër me të dhe ndonjëherë e bëjnë për të qarë, duke e fyer si: kokëtrashë, maloke, fshatare, etj. Juela është nxënëse e mirë dhe është një nga vajzat më të zgjuara në klasë, por kjo nuk mjafton për t'u ndier mirë në shkollë.

Kur shokët e klasës organizojnë ditëlindje, nuk e ftojnë dhe kur shkojnë në ekskursione, nuk luajnë me të. I vetmi mik që ka Juela, është një djalë tjetër nga një fshat i Korçës, që ndjehet po aq i diskriminuar sa Juela.

Shpërngulja e familjes së saj nga një fshat i Tiranës, e ka ndryshuar jetën e përditshme të Juelës dhe po sfidon shumë gjendjen e saj psiko-sociale. Ajo është e vetmuar, e tërhequr dhe ka një vlerësim të ulët për veten e saj.

Çfarë duhet të dini

Migrimi nuk është fenomen i ri në Shqipëri, por ai është zgjeruar pas vitit 1990. Gjatë 1945–1990, migrimi ishte i vështirë. Kishte procedura të gjata për personat që donin të shkonin nga një vend në tjetrin dhe shpesh njerëzve nuk u lejohej të lëviznin. Lejet duhej të jepeshin nga institucionet shtetërore. Ndryshimet pas vitit 1990, sollën një valë migrimi drejt qyteteve të mëdha, si Tirana dhe Durrësi. Migrantët e brendshëm vinin nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë dhe sidomos nga zonat veriore. Një rritje tjetër e migrimit, ndodhi pas vitit 1997. Gjatë kësaj periudhe njerëzit migruan për arsye sigurie dhe për kushte më të mira ekonomike.

Është bërë pak për të dokumentuar migrimin në Shqipëri. Burimet e informacionit janë të rralla. Burimet më të sakta janë ato të INSTAT (Instituti i Statistikave) dhe disa raporte të organizmave joqeveritare.

Faktorët kryesorë të migrimit janë:

- Kushte të këqia jetese në vendin e origjinës;
- Migrimi i babait;
- Kushte më të mira ekonomike dhe një mënyrë e re të jetuari në zonën urbane;
- Papunësia;
- Gjakmarrja;
- Qytetet janë vende më të sigurta se ato nga ku vijnë.
- Zonat më të prekura nga migrimi në Shqipëri janë:
- Zonat veriore, dhe
- Zonat verilindore.

Ekziston një shkallë e lartë analfalbetizmi nga migrantët e brendshëm.

Familjet që migrojnë në zonat e destinacionit, përballen me probleme të ndryshme psiko-sociale. Procesi i tyre i integrimit në komunitet, është i vështirë, ata përballen shpesh me probleme ekonomike dhe papunësie, si dhe me kushte të vështira jetese. Fëmijët nuk mirëpriten në shkollën e re dhe paragjykohen nga mënyra e të folurit, rrobat që veshin, sjellja dhe traditat kulturore që kanë. Këta nxënës janë më pak të përfshirë në aktivitetet shoqërore, në klasë dhe shpesh keqtrajtohen nga shokët.

Si të ndihmojmë?

- Përfshirja e të gjithë nxënësve në aktivitetet shoqërore, ku vlerësohen traditat kulturore të njerëzve që migrojnë.

- Studimi i nevojave dhe krijimi i planit të veprimit për një strategji të përbashkët integrimi për popullsitë minoritare në shkollë dhe komunitet.
- Krijimi i një rrjeti përkrahjeje për familjet migruese, duke angazhuar personelin mësimor, shokët dhe komunitetin.

Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve, mund të mbështesë procesin e integrimit të të ardhurve në shkollë dhe komunitet në nivele të ndryshme. SMF-ja mund të takohet me familjen dhe fëmijën, për të vlerësuar nevojat psiko-sociale të të dyve. SMF-ja mund të caktojë gjithashtu një moshatar, për të mbështetur fëmijët e ardhur (sistemi i "shoqërimit dysh"), si dhe të aktivizojë strukturat mbështetëse për prindërit. Mund të organizohen takime ndërgjegjësuese dhe informative me mësuesit për përkrahje dhe ndihmë, sidomos në periudhën e parë të mbërritjes së tyre. Mund të organizohen dhe aktivitete parandaluese në shkollë dhe aktivitete për promovimin e barazisë dhe diversitetit.

9.3 Udhëzime për çështjet shëndetësore (Ci-iii)

Shëndeti i fëmijës

Qysh prej ndryshimit të rendit në fillim të viteve 90-të në Shqipëri, fëmijët dhe të rinjtë janë të ekspozuar para rreziqesh të reja. Këtu përfshihet edhe rritja e konsiderueshme e vdekjeve nga makinat apo armët e zjarrit, rritja e abuzimit me substanca dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme (INSTAT, 2003b:10).

Seksioni i mëposhtëm do të përqendrohet në çrregullimet mendore (Cii) dhe aftësitë e kufizuara (Ciii) si edhe të gjitha shqetësimet mjekësore që duhet t'i raportohen personelit mjekësor të shkollës (infermieres, mjekut të familjes ose të shkollës, etj.)

9.3.1 Shëndeti mendor (Cii)

SHEMBULL: Ankthi
Valbona është 12 vjeçe, është shumë e turpshme, e tërhequr dhe ka vështirësi të krijojë shoqëri me fëmijë të tjerë. Ajo ka frikë se thotë ndonjë gabim në klasë, prandaj nuk aktivizohet kurrë me gojë. Kur një ditë i duhej të bënte një prezantim para klasës, ajo u shtir si e sëmurë, sepse kishte frikë se nuk do të nxirrte asnjë fjalë nga goja dhe e gjithë klasa do të qeshte me të. Kur kontakton vetëm për vetëm me SMF-në, ajo me zor e shikon në sy. Ndjehet shumë shpejt nën presion. Kur flasim me mamanë e Valbonës, ajo shpjegon se qysh në fëmijëri, Valbona ka qenë e frikësuar nga fëmijët e tjerë, kur mamaja e detyronte të luante me të tjerë, ajo reagonte shumë emocionalisht, si me rrahje të shpeshta të zemrës dhe frymëmarrje të shpeshtuar, tensionohej e fillonte të qante.

SHEMBULL: Depresioni
Miqtë dhe të afërmit e braktisën Florën, sepse ajo ishte me aftësi të kufizuara. Flora ndjehej e pashpresë për situatën e saj. Humbi buzëqeshjen dhe ndjehej e trishtuar, ndonjëherë mendonte edhe për vetëvrasjen. Nuk ndalonte së menduari për Erkandin, i cili vdiq dhe e kishte shumë të vështirë të tregonte interes për të dy fëmijët.
Njeriu në depresion, nuk tregon interes për jetën. “Nuk ka më vlerë të bësh asgjë”, mendon. Nuk ka asnjë synim dhe nuk ka besim te njerëzit, është i tërhequr dhe i vetmuar. Njeriu nuk ka më shpresa se e ardhmja do të jetë më e mirë.

Çfarë duhet të dimë?
Së pari, sa herë që një fëmijë duket se nuk po sillet në përputhje me moshën e vet, duhet të shikojmë se çfarë nuk shkon. Kjo mund të jetë diçka e lindur ose shqetësim i shkaktuar nga një ndodhi, dhe në një numër të vogël rastesh, mund të jetë **çrregullim mendor**, që kërkon ndihmë profesionale. Në përgjithësi, anëtarët e familjes do të jenë në gjendje t’u thonë, nëse fëmija ka pasur gjithmonë vështirësi apo është diçka e re.

DEPRESIONI: Fëmijët e shfaqin shpesh melankolinë përmes irritimit dhe mërzisë. Ata nuk e dinë se janë të stresuar dhe mund të jetë e vështirë të dallosh melankolinë nga gjendjet e mërzisë së përkohshme. Ajo që mund t’iu udhëzojë më mirë, është nëse humori negativ do të zgjasë pak apo për një kohë të gjatë, dhe njerëzit që e njohin fëmijën, do të raportojnë se ai nuk merr pjesë në aktivitetet e zakonshme.

ANKTHI: Ka disa lloje ankthi dhe fëmijët mund të shfaqin lloje të ndryshme. Si rrjedhojë e një fatkeqësie, të gjithë frikësohen, prandaj ky nuk mund të konsiderohet si “çrregullim”, nëse nuk zgjat për një kohë të

gjatë, apo përkeqësohet me kalimin e kohës. Fëmijët, në veçanti, mund të përjetojnë ankth pas një vdekje ose fatkeqësie dhe do të duan të rrinë afër përkujdesësit, dhe kjo pritet të zgjasë disa muaj.

PSIKOZAT: Është e pazakontë, por jo e pamundur, që fëmijët të tregojnë se kanë humbur sensin e realitetit. Kur një fëmijë shikon, nuhat, apo dëgjon gjëra që nuk janë reale, ai duhet dërguar menjëherë tek shërbimet e kujdesit shëndetësor mendor. Simptomat psikotike shfaqen për herë të parë në moshën e adoleshencës. Çdonjëra nga simtomat që sapo përmendëm, ose një mbyllje e theksuar në vetvete, ose të qenit i preokupuar me mendiminin e vdekjes, janë arsye për të kërkuar konsulencë të menjëhershme mjekësore.

VETËVRASJA: Vetëvrasja është një rrezik i vërtetë në adoleshencë dhe duhet marrë seriozisht. Nëse keni dyshime, PYESNI! Nuk ka rrezik se mund t'u shtini në mendje idenë e vetëvrasjes, nëse ata nuk kanë menduar vetë më parë për të. Megjithëse rrallë, fëmijëve nën moshën 10 vjeç, u ka shkuar në mendje vetëvrasja dhe e kanë kryer atë. Çdo adoleshent ose fëmijë që përmend mungesën e dëshirës për të jetuar, duhet drejtuar te një specialist dhe nuk duhet lënë vetëm.

Si të ndihmojmë?

Çfarë mund të bëjë një Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve, për të ndihmuar fëmijët me shqetësime mendore?

Fillimisht, mund të ofrosh "ndihmën e parë psikologjike", duke zbatuar aftësitë bazë kur flet me fëmijë të stresuar dhe duke i dhënë mbështetje dhe ngushëllim.

Veprimet e thjeshta për të mbështetur fëmijët në ambientin e shkollës janë:

- × Krijimi i mundësive për të luajtur me fëmijët e tjerë në vend të sigurtë;
- × Organizmi i aktiviteteve jashtë mësimit që nxisin zhvillimin;
- × Ofrimi i një informacioni të përshtatshëm për moshën dhe çrregullimet.

Por, nuk është mandati i SMF-së të kryejë trajtim mendor shëndetësor. Këto raste i duhen referuar specialistëve. Megjithatë, mund të jetë e dobishme të njihni disa mënyra që përdoren nga profesionistët e shëndetit mendor. Është e rëndësishme të dini se mjekët kanë mjete të ndryshme

në dispozicion. Edhe profesionistët mendorë zotërojnë metoda të ndryshme. Bashkëpunoni me terapistët, nëse është e mundur për të mbështetur fëmijën në mjedisin e shkollës dhe për të përforcuar punën terapeutike të kryer individualisht.

Në këtë kapitull folëm për rëndësinë që ka loja në jetën e fëmijës. Kjo është gjithashtu, një metodë që profesionistët e shëndetit mendor e përdorin shpesh kur takohen me fëmijët, megjithëse, teknika më e zakonshme për afrimin e adoleshentëve, është biseda.

Metodat kryesore të punës psikologjike me fëmijë janë:

1. **TERAPIA KOGNITIVE:** Supozimi kryesor i terapisë njohëse, është se mendimet negative janë ato që ndikojnë në humor dhe në sjellje. Autori i kësaj metode, besonte se individët stresohen nëse kanë mendime negative për të ardhmen, veten dhe botën në përgjithësi. Në këtë trajtim, personi punon me terapistin për të praktikuar mendime të ndryshme, modifikim të mendimeve dhe, për rrjedhojë, ndryshimin e humorit.
2. **NDËRHYRJET NË SJELLJE:** Supozimi kryesor i trajtimit të sjelljes, është se kjo e fundit është e kushtëzuar, se çdo sjellje sjell një pasojë, e cila, ose e përforcon sjelljen (inkurajon që të vazhdojë), ose e dekurajon (e bën të zhduket). Çdo ditë ne praktikojmë ndërhyrje në qëndrimet e të tjerëve; shpërblejmë personat që pëlqejmë me lëvdata dhe reagojmë ndaj sjelljeve që nuk pëlqejmë me masa negative. Një pjesë e mirë e edukimit të fëmijës, bëhet me teknikat e sjelljes.
3. **BIOLOGJIKE/FARMACEOLOGJIKE:** Trajtimi biologjik e ka zanafillën te neurologjia, fiziologjia dhe farmakologjia. Ata janë zhvilluar shumë dekadën e fundit, si rezultat i zbulimeve të shumë mjekimeve të reja, që ndikojnë në humor si Ritualin për fëmijë me diagnozën e hiperaktivitetit. Megjithatë, fëmijët reagojnë ndryshe nga të rriturit prej mjekimeve dhe duhet të përdoren më pak për ta.
4. **TRAJTIMET PSIKO-DINAMIKE/TRAJTIMI I SHKURTËR PSIKO-DINAMIK:** Ky model bazohet në idenë se sjellja jonë i ka rrënjët në të kaluarën dhe se motivimet tona janë shpesh të pavetëdijshme. Ai e vë theksin te ndikimi ynë si prindër dhe përpiqet të kuptojë origjinën e pandehmave tona dhe mekanizmat për përballimin e problemeve të jetës.
5. **SISTEMET FAMILJARE/TRAJTIMI SISTEMIK (KOMPLEKS):** Kjo teori pëqendrohet në idenë se një familje është një “sistem”, ku sjelljet dhe emocionet e një pjese të anëtarëve të familjes, varen nga sjelljet dhe mendimet e pjesës tjetër të anëtarëve. Kështu që, trajtimi kryhet për

shumë anëtarë të familjes dhe përqendrohet në modelet tipike të sjelljes që ata shfaqin. Megjithëse një profesionist i shëndetit mendor, mund të punojë individualisht me fëmijën, puna e tij duhet të përfshijë edhe prindërit e tij.

Siç e shihni, ka shumë fusha ku mund të zbatohen këto teori dhe çdo metodë trajtimi mund të përmbajë elementë të metodave të tjera.

Për t'ju dhënë një ide se çfarë lloj ndihme mund t'i japë psikologu Valbonës, po ju japim një shembull:

HAPI 1 **Informacion mbi emocionet**
Psikologu do t'i shpjegonte Valbonës se është normale që, në rrethana të caktuara, të ndjesh frikë, se frika është një emocion normal për të gjitha qeniet njerëzore.

HAPI 2 **Si të pranojmë emocionet?**
Do të përpiqej t'i tregonte mënyrën se si e shfaqim frikën. Si mund të ndërgjegjësohemi për praninë e frikës në trupin dhe mendjen tonë? Valbona do të mësonte si t'i dallonte shenjat e frikës në një fazë të hershme dhe t'i përdorte ato si tregues për të përcaktuar strategjitë. Ajo do të mësonte se si të vlerësonte veten, kur t'ia dilte mbanë.

HAPI 3 **Mësimi i strategjive të përballimit të emocioneve**
Valbona do të mësonte strategjitë e përballimit të emocioneve, për shembull, si të identifikonte ndjenjat negative dhe t'i zëvendësonte me ato pozitive, teknika qetësimi për frikën, me komponent të fortë psikologjik, nëpërmjet lojërave me role, ku do të praktikonte këto teknika në kushte të sigurtë teraupetikë.

Hapi 4 **Këshillimi në grup, të flasësh për frikën**
Kur Valbona të ishte e përgatitur, terapisti do të organizonte shkëmbim përvoje për frikën me fëmijët e tjerë.

HAPI 5 **Përballja**
Valbona do të merrte detyra shtëpie se si të përballej me situata të frikshme, për shembull, do të ftonte dy, dhe pastaj, tre ose më shumë fëmijë (gradualisht) të luanin me të në shtëpinë e saj. Si një hap tjetër,

ajo do të shkonte në shtëpitë e fëmijëve të tjerë për të luajtur për periudha të shkurtra dhe pastaj të gjata, në fillim me mamanë, pastaj vetëm, etj.

HAPI 6 **Modifikimi i perceptimit dhe formimi i shprehive sociale**
Në rastet e ankthit dhe fobisë sociale, shpesh perceptimi dhe njohja falsifikohen, prandaj terapisti do të punonte mbi bazën e vëzhgimeve dhe interpretimeve të saj të situatave sociale, për të modifikuar atribuimet dhe skemat mendore. Ata punojnë së bashku për të formuar shprehi sociale, për të përmirësuar ndërveprimin e Valbonës me fëmijët e tjerë dhe sjelljet e përshtatshme sociale.

9.4 Udhëzime për çështjet psikologjike (Di – Diii)

Problemet psikologjike, janë të shpeshta në fëmijëri dhe në adoleshencë. Në të vërtetë, shumë çrregullime psikologjike ndodhin për herë të parë gjatë adoleshencës, por simptomat nuk identifikohen si të tilla. Nga ana tjetër, dikush duhet të jetë i matur të mos klasifikojë dhe paragjykojë fëmijët me diagnozë, pasi shumë vështirësi lidhen me fazat e zhvillimit dhe me anë të mbështetjes dhe ndihmës, fëmija do t'ia dalë mbanë të zhvillojë burimet dhe aftësitë suksesshme.

9.4.1 Problemet me sjelljen (Di)

SHEMBULL RASTI

Albani është 12 vjeç. Ka pasur vështirësi me përqendrimin në mësime dhe ndenjen ulur në karrike për një orë. Shpesh ai hutohej. Zhurma më e vogël, i tërhiqte vëmendjen. Sidomos kur detyra ishte e vështirë, ai fillonte të irritohej dhe të shqetësonte të tjerët. Shpesh ai flet pa ngritur dorën dhe nuk pret radhën e tij, prandaj futet në telashe. Kur bënte detyrat, dilte nga dhoma dhe harronte ç'kishte për të bërë. Sapo fillonte një aktivitet, i vinte diçka tjetër në mendje dhe harronte të parën. Ai është shumë impulsiv. Qëkur ishte fëmijë, kujton e ëma, qante shumë dhe irritohej lehtë. Kur përballet me një detyrë të vështirë, nuk reflekton në fillim, por merr vendime të rrezikshme, prandaj shpesh dështon dhe e kundërshtojnë. Edhe shokët i qëndrojnë larg. Por, ai ka edhe një cilësi të adhurueshme dhe krijuese, mund të jetë shumë argëtues dhe i bën njerëzit për të qeshur. Së fundmi, ka zbuluar pasionin e tij për universin dhe mund t'i shikojë yjet për një kohë të gjatë. Kur dëgjon ndonjë temë interesante, nuk e ka problem të përqendrohet për një kohë të gjatë. Prandaj e ëma mendon se sjellja e tij në shkollë, është e qëllimshme dhe se atij i duhet vetëm të përpiqet të sillet mirë.

… përfundimi i historisë, versioni dy: Niveli i Albanit në shkollë bie dhe më shumë. Mësuesit e rrahin shpesh, sepse ai flet me zë të lartë dhe shqetëson klasën. Mamaja i bërtet, se nuk di ç'të bëjë me sjelljen e tij. Albani ka një vlerësim shumë të ulët për veten dhe shpesh shokët i qëndrojnë larg.

… përfundimi i historisë, versioni një: Vështirësitë diskutohen me Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijëve në shkollë dhe krijohet një plan veprimi për të ndihmuar Albanin të kontrollojë vëmendjen dhe impulsivitetin e tij.

Çfarë duhet të dini

Ura midis zhvillimit normal dhe psikopatologjisë, është shumë e ngushtë. Probleme me sjelljen ndodhin në fëmijëri. Kur njihet herët dhe ofrohen masat mbështetëse, shumica e fëmijëve ndihmohen të mësojnë të kontrollojnë individualitetin e tyre. Vetëm pak fëmijë kanë çrregullime, si hiperaktiviteti (Çrregullimi i Defiçitit të Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit, shkurt ÇDVH). Ky është një term klinik dhe diagnostikohet nga psikologë dhe psikiatër të specializuar. Me këtë term është abuzuar shumë dhe duhet shmangur jashtë mjediseve të klinikës. Diagnoza e ÇDVH është e bazuar në listën e simptomave për fëmijë dhe adoleshentë. Kur një fëmijë me ÇDVH bëhet adoleshent dhe më pas i rritur, ai e fiton vetë kontrollin mbi simptomat e hiperaktivitetit.

Çfarë është ÇDVH?

Çrregullimi i Defiçitit të Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit (ÇDVH) karakterizohet nga një ose më shumë nga simptomat e mëposhtme:

- Vëmendje e ulët;
- Impulsivitet;
- Hiperaktivitet.

Cilat janë shenjat dhe simptomat e ÇDVH?
ÇDVH përfshin simptoma në dy fusha: **vëmendje e ulët dhe hiperaktivitet/impulsivitet**. Ndërsa çdokush mund të shfaqë këto shenja dhe simptoma herë pas here, një person me ÇDVH ka gjasa t'i shfaqë këto simptoma në mënyrë të vazhdueshme qysh në fëmijëri. Simptomat në përgjithësi:

- Janë të pranishme në, të paktën, dy vende (si shkolla dhe shtëpia), dhe
- Shkaktojnë dëmtim të konsiderueshëm në funksionin ditor.

Simptomat e mungesës së përqendrimit

- Shpërfill detajet, bën gabime nga pakujdesia;
- Vështirësi në përqendrim apo në dëgjim, kur i drejtohet dikush;
- Vështirësi për të ndjekur udhëzimet apo për të mbaruar detyrat;
- Duket i përhumbur, i çorganizuar, i hutuar.

Simptomat e hiperaktivitetit/impulsivitetit

- Nervozizëm, përpëlitje;
- Vështirësi në qëndrimin ulur;
- Në lëvizje konstante, shpesh vrapon dhe ngjitet në mënyrë të papërshtatshme;
- Shqetësime fizike, vështirësi në aktivitete të heshtura;
- E folur e shpeshtuar, kthen përgjigje pa përfunduar pyetja;
- Vështirësi për të pritur radhën, ndërpret ose ndërhyn te të tjerët.

Cilët janë ndikimet e ÇDVH ?
ÇDVH ka pasoja të rënda për individët, familjet dhe shoqërinë:

- ÇDVH e padiagnostikuar, çon në vlerësim të ulët për veten. Një jetë plot me kritika nga të tjerët si "dembel", "budalla" ose "i pamotivuar për ndryshim", mund ta bëjë personin me ÇDVH të ndjehet dështak, pa perspektivë përmirësimi.
- Nxënësit me ÇDVH të patrajtuar, kanë më shumë gjasa të kenë një ecuri të dobët në procesin mësimor, zihen me të tjerë, përdorin alkool ose drogë (shpesh si vetëmjekim), ndërpresin përkohësisht shkollën/ose lënë shkollën dhe përfundojnë në burg.

- Çiftet me fëmijë ÇDVH, shpesh divorcohen ose ndahen.
- Adoleshentët me ÇDVH përfshihen në më shumë aksidente me makinë dhe marrin më shumë gjoba se sa ata pa ÇDVH.
- Të rriturit me ÇDVH kanë më shumë vështirësi të bashkëpunojnë me kolegët, të ndjekin udhëzimet e mbikëqyrësit, të ruajnë vendin e punës si dhe të mbajnë një marrëdhënie të gjatë.

Përsëri shumë fëmijë mund të shfaqin shenja ÇDVH herë pas here, por kur kapen herët, SMF-ja mund t'i ndihmojë këta fëmijë të zhvillojnë strategji të suksesshme, të merren me sjelljen e tyre individuale dhe të zhvillohen normalisht.

Si të ndihmojmë?

Fëmijët që shfaqin probleme me sjelljen, si ato të Albanit, mund të ndihmohen. Këtu bëjmë disa sugjerime. Filloni duke parë këtë situatë si një ndryshim, më shumë se sa një paaftësi dhe pastaj vendosni të merreni me pasojat që sjell ky ndryshim.

Është shumë e rëndësishme që ju si SMF të punoni me **mësuesin dhe prindin,** për të krijuar një **plan sistemik (kompleks) veprimi**. Ndërhyrjet në sjellje kanë rezultuar të dobishme në fëmijë të tillë, por ato duhen zbatuar **në vijimësi.**

Të edukosh sjellje të reja

Kur ndihmon një fëmijë të mësojë sjellje të reja, siç janë shprehitë pozitive sociale, SMF-ja mund të përdorë dhe t'u tregojë prindërve dhe mësuesve një kombinim të teknikave të të mësuarit si:

- Modelimin;
- Praktikimin e sjelljes së dëshiruar;
- Lojën me role;
- Përforcimin e vazhdueshëm;
- Inkurajimin.

Ndërhyrja në sjellje është përforcimi i dretpërsëdrejtë negativ ose pozitiv, ndaj një ndryshimi të dëshirueshëm në sjellje. Për shembull, një ndërhyrje mund të jetë lëvdimi që mësuesi i bën një fëmije, i cili ka filluar të përmirësojë sjelljen, si ka filluar të ngrejë dorën në mësim, ndonëse fëmija mezi arrin të bëjë ndonjë koment. Synimi është që të shpërblehet çdo përpjekje që çon drejt një sjellje plotësisht të re.

Është e rëndësishme të vëmë re se fëmijët me vështirësi të njëjta me Albanin, shfaqin simptoma të ndryshme. Një ditë, fëmija mund të sillet mirë në një drejtim, ndërsa të nesërmen përsëriten simptomat e vjetra të papranueshme. Kjo e bën ndërhyrjen në sjellje, të vështirë, sepse duket sikur trajnimi nuk po funksionon. Megjithatë, me kalimin e kohës, përforcimi duket se çon në përmirësimin e sjelljes; një fëmijë thjesht mund të ketë më shumë ditë jo produktive, se individët e tjerë.

Disa udhëzime të rëndësishme që SMF-ja duhet t'u japë mësuesve dhe nxënësve:

- × Mos harroni se sjellja e një fëmije zakonisht nuk është e qëllimshme.
- × Mos u irritoni dhe mos mbani inat, që të jeni në gjendje të ndihmoni fëmijën të ndryshojë modelin e përditshëm.
- × Tregoni durim për të arritur ndryshimin; kujdesuni për përmirësimet dhe tregoni qetësi kur përsëritet një gabim.
- × Kërkoni ndihmë kur keni nevojë, qoftë nga SMF-ja apo kujdestarët e tjerë.
- × Bëni një listë me tiparet pozitive të fëmijës.
- × Zhvilloni dhe përsëritni aktivitetet gazmore, që bëjnë të mundur fëmijën të arrijë maksimumin e vet.
- × Inkurajoni aktivitetet atletike, nëse fëmija duket se po përfiton prej këtyre aktiviteteve.
- × Përforconi shpejt sjelljen pozitive; ndëshkoni menjëherë sjelljen negative.
- × Mos pretendoni që ata të rrinë gjatë pa lëvizur.
- × Kur jepni instruksione, rrini ose uluni pranë fëmijës dhe jepni sa më pak udhëzime.
- × Jini të qëndrueshëm.
- × Tregoni mënyrat se si duhet bërë diçka.
- × Përkraheni fëmijën, derisa ai të përkrahë veten.
- × Besoni te fëmija dhe mbështeteni atë.

Për vite me radhë, mësuesit kanë pasur rezultate pozitive në teknikat e menaxhimit të sjelljes, si përforcimi pozitiv, ai negativ dhe masat e tjera të ndërmarra.

Çelësi i suksesit, është të jesh i qëndrueshëm në përdorimin e përforcimeve dhe ndëshkimeve.

PËRFORCIMI POZITIV: Shumë fëmijë përfitojnë nga një sistem masash përforcimi. Jepini fëmijës të kuptojë se çfarë lloj sjelljeje shpërblehen. Përzgjidhni ato përforcime që janë në interes të fëmijës.

Objektet me të cilat mësuesi shpërblen nxënësit, nuk duhen medoemos të jenë të kushtueshme, për shembull, një imazh i vizatuar në letër, një fletë-lavdërimi, lodër që vendoset në bankën e fëmijës, ose një vizitë te drejtori, mund t'i pëlqejnë fëmijës së vogël. Fëmijët më të rritur vlerësojnë më shumë privilegje speciale, si kohën e lirë, apo lojën me kompjutera. Mos harroni se, sapo fëmijët bëhen të aftë të shfaqin sjellje të mira, ju mund të filloni të pakësoni përforcimet dhe shpeshtësinë e përdorimit së tyre

NDËSHKIMI: Kur duhet të përdorni ndëshkimet, për të pakësuar shpeshtësinë e një sjelljeje të pahijshme, për shembull, strategji si, injorimi i planifikuar, veçimi, heqja e privilegjeve, qortime, kini parasysh që praktika të tilla, duhet të jenë të shoqëruara me përforcime për një **sjellje të përshtatshme alternative**. Fëmijët duhet të dinë se çfarë u lejohet të bëjnë, por edhe çfarë nuk u lejohet të bëjnë.

EKONOMIA E XHETONAVE: Teknika e ekonomisë së xhetonave[4] (tallonave) përdoret gjerësisht në familje ose në menaxhimin e klasës dhe është efektive për shumë fëmijë. Një teknikë e tillë, bazohet në xhetona që mund të shkëmbehen me përforcues të ndryshëm. Në këtë lloj teknike, specifikohen kushtet në të cilat dikush mund të marrë ose mund të humbasë xhetonat, si dhe sa herë mund të përdoret një xheton, për t'u shkëmbyer me një përforcues. Shumë teknika të ekonomisë së xhetonave, përdorin sistemin e pikëve.

SHEMBULL I NJË TEKNIKE QË PËRDOR XHETONAT: Albani fiton çdo ditë pikë për sjellje pozitive, si respektimi i rregullave të qetësisë, të ndenjes në bangë, të qëndrimit ndaj shokëve, pjesëmarrje në mësime dhe plotësimin e detyrave. Pikët zbriten kur shfaqen sjellje të pahijshme. Kur Albani dallohet për sjellje pozitive, intervalet për marrjen e shpërblimeve, mund të rriten. Ky sistem shpërblimi në shkollë, administrohet nga mësuesi kujdestar i klasës në 20 minutat e fundit të ditës.

4 Xhetoni (talloni) është një copë e rrumbullakët metalike ose plastike, që mund të përdoret në disa makina lojërash në formën e pagesës (Shënim i redaktorit).

Të punosh së bashku me familjen

Komunikimi me familjen e fëmijës, është një nga elementët më kryesorë për çdo program, që synon në ndryshimin e sjelljes. Ftoni prindërit t'ju takojnë dhe t'ju ndihmojnë të planifikoni programet edukative të fëmijëve. Tregohuni të kujdesshëm ndaj frikës dhe irritimit që tregojnë prindërit. Riafirmoni angazhimin tuaj për të dhënë ndihmesën, që fëmija t'ia dalë mbanë me sukses.

FAMILJET NDIHMOJNË NË FORMIMIN E SJELLJES: Në suksesin e programit të menaxhimit të sjelljes në klasë, mund të ndihmojë edhe familja. Të njëjtat strategji të përdorura në klasë, mund të përdoren dhe në shtëpi, për përfshirjen e familjeve në arritjen e objektivave për një sjellje pozitive të fëmijës. Fëmija merr pikë çdo orë, për shfaqjen e aftësive pozitive në klasë, si dhe duke plotësuar detyrat, respekton rregullat dhe nuk lëviz nga banga. Pikët hidhen në një formular që i dërgohet familjes. Familjet bien dakord të shpërblejnë fëmijën, ose u krijojnë privilegje në shtëpi, në varësi të sjelljes së fëmijës në shkollë. Një procedurë e veçantë i lejon nxënësit të fitojnë pikë në shtëpi, nëse nuk kanë pasur një ditë të suksesshme në shkollë.

Sesionet e këshillimit individual

Një shembull konkret se si një SMF mund të ndihmojë Albanin në sesionet e këshillimit individual.

HAPI 1 Duke e udhëzuar hap pas hapi në kryerjen e detyrave të vështira, për ta ndihmuar atë të përqendrohet, duke ju ulur afër dhe duke punuar bashkë me të.

HAPI 2 Duke i mësuar strategji se si të kontrollojë impulset dhe si të organizojë sjelljet dhe veprimet e veta:

- **a** Cila është detyra ime? A e kam kuptuar?
- **b** Do të bëj një plan para se të filloj detyrën!
- **c** Si mund ta bëj?
- **d** A mos kam bërë diçka të ngjashme më parë? A e di këtë detyrë?
- **e** Kujdes? Ji imatur! Nuk është e rëndësishme shpejtësia, duhen marrë një e nga një …
- **f** Ndalo! Kontrollo pikët! Kthehu dhe njëherë…
- **g** Punë e bukur! E kam bërë si duhet!

Nëpërmjet këtyre hapave të thjeshtë, mund të mësosh Albanin të shikojë, të dëgjojë, të përshkruajë, të presë, të reflektojë me kujdes dhe të mësojë të udhëzojë veten. Duhet të jetë i ndërgjegjshëm për çdo hap.

Kjo mënyrë të punuari mund të zbatohet edhe në klasë nga vetë Albani, me mbështetjen e mësuesit të duruar, si dhe në shtëpi me ndihmën e prindërve.

Shpesh, fëmijët si Albani duan të bëjnë shumë gjëra në të njëjtën kohë dhe harrojnë rendin e detyrave apo të hapave që duhet të ndjekin dhe përfundojnë në kaos. Është e rëndësishme të trajnosh personelin edukativ dhe prindërit se si t'i mbështesin këta fëmijë. Është e rëndësishme të strukturosh jetën e fëmijëve si Albani, ata kanë nevojë për rutinën ditore. Sjellja e qëndrueshme e të rriturve, është shumë e rëndësishme për ta, u jep siguri. Gjithashtu, u duhen mësuar strategjitë si të menaxhojnë vështirësitë dhe të përjetojnë sa më pak probleme në jetën e tyre. Prindërit janë të lumtur, pasi kanë më pak telashe në shtëpi dhe mësuesit sepse do të kenë më pak zhurmë në klasë. Albani ka mësuar të kontrollojë sjelljen e tij, është rritur vetëvlerësimi i tij, ai është krenar dhe ka vetefikasitet, kontroll mbi veprimet e veta dhe mund të ndikojë te të tjerë. Lidhjet e tij sociale janë shtuar, ai nuk është më problematik.

Sjellja agresive

Aroni është 15 vjeç. Ai u kthye nga Greqia pas 9 muajsh punë në rrugët e Selanikut. Shpesh është agresiv dhe nxënësit e kanë frikë. Ishte shumë mirë vitin e kaluar, por tani niveli i tij ka rënë shumë. Shpesh tremb vajzat e vogla kur shkojnë në shkollë dhe mësuesit ankohen për sjelljen e tij të ashpër në klasë.

Çfarë duhet të dini

Ndonjëherë të rriturit dhe fëmijët, mund të reagojnë për ndjenjat e tyre, duke qenë agresivë me njerëzit përreth, qofshin miq, familjarë apo të huaj. Agresioni mund të jetë verbal ose joverbal, fizik ose jo, i drejtohet personit vetë apo dhe një personi tjetër. Disa njerëz sillen në mënyrë agresive vetëm në situata të caktuara, për shembull, pasi pinë, ose kur mendojnë se nuk vlerësohen nga njerëzit përreth, apo kur janë të lodhur dhe të mërzitur. Cilido qoftë shkaku i agresionit dhe në çfarëdo forme të shfaqet, ai gjithmonë krijon një sërë vështirësish. Këtu përfshihen rreziku fizik për veten dhe të tjerët, policinë apo autoritetet e tjera të përfshira, ndjenja e turpit, humbja e kontrollit, ndjenja e fajit dhe izolimi në rritje.

Në fillim, sjellja agresive mund ta ndihmojë personin që të arrijë atë që do apo të kontrollojë të tjerët. Megjithatë, kjo sjellje gradualisht, mund të duket e frikshme apo jashtë kontrollit, ai largon njerëzit nga vetja dhe ndjehet edhe më i vetmuar. Trishtohesh kur mëson se ai është bërë

agresiv, sepse ka qenë vetë viktimë e agresivitetit, mbase në të kaluarën e largët, është ngacmuar dhe lënduar nga moshatarët apo njerëzit e rritur, të cilët, në fakt, duhet të ishin kujdesur për të.

Si të ndihmojmë?
Si SMF ju mund t'i ndihmoni fëmijët të kuptojnë përse inatosen dhe si të përballen me ndjenjat agresive që dalin jashtë kontrollit. Me ndihmën tuaj, fëmija mund të mësojë se çfarë e shkakton agresivitetin e tij dhe si mund të ndryshohet, duke mësuar të jesh më i kujdesshëm, duke i thënë të tjerëve për çfarë ke nevojë, pa dëmtuar personin ose veten.

Nëse vë re që ndjenjat e fëmijës janë tepër të ndërlikuara për t'u menaxhuar nga ai vetë, atëherë foli rreth kësaj. Mund ta inkurajosh fëmijën të flasë në mënyrë konfidenciale gjatë sesioneve të këshillimit individual. Në raste më serioze, fëmija ose adoleshenti, duhet drejtuar te psikologu, policia ose Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Ndërhyrjet e përqendruar te fëmija mund të përfshijnë programin e mëposhtëm me 4 hapa:

1. **Ndihma për të IDENTIFIKUAR SHKAQET e problemit**
   Përpiqu të zbulosh me fëmijën se çfarë e shkakton agresivitetin e tij dhe, nëse është e mundur, si mund të shmangen këto situata, për shembull, pirja e alkoolit, ndjenja e të keqkuptuarit, paaftësia për t'u shpjeguar etj.
2. **NDALO–MENDO–VEPRO**
   Të mësosh se si të reflektosh mirë para se të reagosh, mund të të ndihmojë të kontrollosh sjelljen. Si SMF mund të ndihmosh fëmijën të zhvillojë aftësi të suksesshme për të kontrolluar sjelljen agresive. Një mundësi është t'i prezantosh fëmijës programin Ndalo-Mendo-Vepro. Përpiqu të numërosh me vete deri në 10, para se të bësh diçka apo largohu për një ose dy minuta. Përdor këtë kohë për të ndaluar dhe menduar se përse je kaq i inatosur, ç'mund të ndodhë nëse reagon i inatosur dhe çfarë do të doje të bëje (alternativa).
3. **Të mësuarit e teknikave të QETËSIMIT**
   Të mësosh disa mënyra të thjeshta çlodhjeje, që mund të të ndihmojnë për të menaxhuar stresin, pa shfryrë e zbrazur inatin. Po ashtu, edhe çlodhja totale, thjesht duke marrë frymë thellë apo duke u shtriqur, janë mënyra të shpejta për të ulur stresin në situata të vështira.

4 **Inkurajimi i SHPREHJES SË NDJENJAVE**
Nëse ndjenja të veçanta bëjnë që një fëmijë të jetë agresiv, ndihmoje duke folur me të për problemin. Për shembull, mund të ketë arsye të ndjehesh i zemëruar, por ato duhen shprehur në mënyrë të kontrolluar dhe të qetë. Të mësosh të kuptosh dhe menaxhosh ndjenjat e tua, mund të të ndihmojë të kontrollosh agresivitetin dhe të ndjehesh më mirë.

Ndërhyrjet e përqendruara te prindi përfshijnë:
- × Prindërit duhet të jenë të qartë dhe të prerë: "Ne nuk i tolerojmë sjelljet agresive në shtëpinë tonë!" Pasojat e sjelljes agresive duhet të jenë të qarta dhe të ndiqen gjithmonë;
- × Prindërit krijojnë hapësirë për shprehjen e çfarëdo lloj ndjenjash;
- × Prindërit janë modele se si të përballohen pozitivisht çfarëdo lloj emocioni.

Ndërhyrjet e përqendruara te mësuesi, mund të përfshijnë:
- × Ji i qartë dhe i prerë: "Nuk tolerojmë sjelljet agresive në këtë shkollë!" ose "Nuk tolerojmë sjelljet agresive në këtë klasë". Pasojat duhet të jenë të qarta për të gjithë dhe do të zbatohen gjithmonë.
- × Krijoni hapësira për shprehjen e çfarëdo lloj ndjenje;
- × Integroni fëmijën në aktivitete pro-sociale;
- × Kushtoji vëmendje sjelljes pozitive të fëmijës, jo vetëm asaj negative;
- × Jepi fëmijës përgjegjësi individuale dhe kolektive.

9.4.2 Problemet emocionale dhe trauma (Dii dhe Diii)

SHEMBULL RASTI: Babai i Erkandit vdiq vitin e kaluar në një aksident automobilistik. Ishte hera e parë që fëmija u përball me vdekjen. Humbja e të atit, i solli familjes edhe vështirësi ekonomike. Erkandi shikon të ëmën sa përpiqet e nuk ankohet kurrë dhe ndjen kështu njëfarë presioni për të ndihmuar edhe ai në të ardhurat e familjes. Por Erkandi e do shkollën, ka shumë shokë atje dhe ëndërron të bëhet avokat. Në moshën 15 vjeçare, i ati ka qenë një model sjelljeje për të. Erkandi humbet nteresin në aktivitete. Me zor ngrihet në mëngjes dhe kur shokët shkojnë ta zgjojnë të luajë futboll, një nga aktivitetet e tij të preferuara, ai nuk del nga shtëpia.
Motra e vogël e Erkandit është 5 vjeç. Që prej vdekjes së të atit, ajo është shumë e ngjitur. Mamaja nuk di çfarë të bëjë, ajo nuk del dot nga dhoma, sepse vajza fillon të qajë. Gjithë pavarësia që kishte më parë, duket se ka humbur dhe ajo sillet përsëri si bebe.

Çfarë duhet të dini

Në përgjithësi, sa herë punojmë me fëmijë, duhet të kemi parasysh fazën e zhvillimit në të cilën ndodhet fëmija. Ato na japin idenë se si fëmijët mund të reagojnë ndaj stresit dhe sa mirë po i përballojnë problemet. Sa herë që një fëmijë nuk po sillet siç duhet dhe në përputhje me zhvillimin e tij, duhet të pyesim Pse. Sa herë që një fëmijë përjeton tronditje ose traumë, në një fazë të caktuar të zhvillimit, aftësia e tij/saj për t'u zhvilluar, natyrisht, është në rrezik.

Është kritike të mbahet mend se ngjarje, siç janë streset ekstreme, si vdekja e të dashurve, mund të sjellë stres emocional, që nuk është "çrregullim", e që do të përmirësohet me kalimin e kohës dhe me mbështetje emocionale. Ndonjëherë fëmijët përjetojnë "simptoma" dramatike, që janë shenjat e një ngjarjeje të tmerrshme, por jo, domosdoshmërisht, të vijueshme. Sapo merret ndihma, ata vazhdojnë ciklin normal të zhvillimit.

Fëmijët dhe dhimbja

Megjithëse fëmijët mund të shfaqin të njëjtat reagime si të rriturit, dhimbjen ata shpesh e ndjejnë ndryshe. Disa prej reagimeve shfaqen përmes tronditjes, inatit, trishtimit, fajit, ankthit apo duke u kthyer prapa në sjellje, që janë karakteristike për një moshë më të vogël. Juve mund t'ju duken fëmijët "mirë", ata luajnë e qeshin, por kjo nuk tregon se dhimbja dhe humbja janë larguar. Dhimbja e fëmijëve ka prirjen të jetë më e gjatë se ajo e të rriturve. Duket sikur zhduket për një kohë të gjatë dhe papritmas, rishfaqet. Mos harroni se fëmijët më të vegjël, nuk e kuptojnë qartë vdekjen, ata mendojnë se njerëzit e tyre të dashur do të kthehen një ditë. Meqë kuptimi i tyre për vdekjen ndryshon me kalimin e kohës, ata mund të vuajnë sërish më vonë.

Ndonjëherë, të rriturit kanë frikë të flasin me fëmijët rreth vdekjes, por fëmijët duhet të kenë informacion mbi vdekjen, të bëjnë pyetje ose të shprehin ndjenjat. NUK është ndihmë t'u thuash fëmijëve histori se "iku në një udhëtim të largët dhe nuk do kthehet për një kohë të gjatë" ose "do të flerë në paqe". Fëmijët bëhen të paqartë, kanë frikë se edhe ata do të vdesin po të flenë gjumë, apo se dhe njerëzit e tyre të dashur të tjerë do të nisen në udhëtim. Ka rëndësi që t'i risigurojmë fëmijët se nuk është faji i tyre që njerëzit e tyre të dashur kanë vdekur. Shpesh fëmijët kanë frikë se inatet apo gabimet e tyre, mund t'i kenë shtyrë njerëzit e tyre të dashur të vdesin.

Fëmijët në stres dhe trauma

Fjala traumë ka fituar një vëmendje të veçantë. Ajo ndihmon të qartësohesh se çfarë duan të thonë njerëzit kur e përdorin këtë fjalë. "Trauma" i referohet, si një incidenti të tmerrshëm, kërcënues për jetën apo i frikshëm, ashtu dhe situatës që i bën njerëzit të frikësohen. Historikisht, trauma i referohet një përvoje aq të tmerrshme, saqë e tejkalon mundësinë e personit të përballet me të. Çdo ngjarje e tmerrshme, mund të jetë traumatike – nëse shkakton një përjetim terrori dhe paniku. Vdekja e një njeriu të dashur, mund të jetë traumatike, ashtu edhe rrënimi i personit të shkaktuar nga një divorc në familje, por në shumë raste "trauma" nënkupton reagimet që ne presim nga persona që u ka ndodhur një ngjarje tragjike. Trauma mund të përfshijë, gjithashtu, edhe përjetimin e të qenurit dëshmitar i një ngjarje tragjike – jo vetëm dëmtimin aktual të personit në këtë ngjarje tragjike. Për fëmijët dhe adoleshentët, përjetimi mund të jetë akoma më i tmerrshëm, për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre për të kuptuar ngjarjet. Gjithashtu, fëmijët dhe adoleshentët, janë shumë të traumatizuar nga ndarja me prindërit dhe ata me të cilët janë të lidhur më shumë, kështu që dëmtimi emocional nga kjo humbje, mund të jetë më i madh, se ç'mund të mendohet, edhe pse ata nuk e shfaqin atë.

Për të kuptuar ndikimin e ngjarjeve traumatike, që të shtyn të ndërmarrësh një veprim në mbrojtje të një fëmije, duhet hedhur dritë mbi nocionin e traumës dhe hidhërimit. Një ngjarje traumatike karakterizohet si:

- E menjëhershme dhe e papritur;
- Përvojë anormale apo jonormale jetësore;
- Kërcënim i jetës së personit;
- Frikë dhe pafuqi para një tmerri;
- Atak i shqisave (të dëgjuarit, psherëtimë, të nuhaturit, të shijuarit).

Simptomat traumatike përfshijnë rikthimet prapa në të kaluarën, kujtime, urinim gjatë natës dhe ripërjetim të përvojës. Të jetuarit e një traume, është një pasojë natyrore e një përvoje të dhimbshme, procesi i **hidhërimit** është një proces që lejon personin të rizbulojë "bazën e sigurtë" dhe të nisë të ndërtojë një të ardhme. Nocioni i hidhërimit ndihmon të kuptojmë sjelljet dhe ndjenjat, që janë reagime normale të një ngjarjeje traumatike.

A kanë të gjithë fëmijët gjasa të ndikohen nga ngjarjet traumatike?

Është e qartë se ngjarjet traumatike, kanë ndikim shumë të madh. Kërkimet kanë vërtetuar se fëmijët nuk ndikohen njësoj. Fëmijët kanë ndry-

shime në temperament, në burimet e mbështetjejes sociale, në moshë dhe aftësitë njohëse, mënyrat e përballimit të problemeve, në strese të mëparshme dhe histori të ndryshme të trajtimit të fatkeqësive. Ndërsa disa fëmijë janë shumë elastikë, të tjerë janë më të dobët. Ndjeshmëria e fëmijës dhe nevoja për ndërhyrje, mund të ilustrohet në piramidën e faqes vijuese[5].

Shtresa e dyshemesë, grupi më i madh (përfaqësojnë rreth 60 për qind), përbëhet nga fëmijë që reagojnë ndaj ngjarjes traumatike me tronditje, dhimbje dhe forma të tjera të stresit emocional, por që e marrin veten relativisht, jetojnë normalisht dhe përfitojnë nga aktivitetet që rikthejnë normalitetin në jetën e tyre, zhvillojnë aftësitë jetësore dhe ndihmojnë komunitetet të plotësojnë nevojat jetësore. Niveli i mesëm i piramidës, përbëhet nga një grup i madh fëmijësh (përafërsisht 30 për qind), të cilët janë relativisht funksionalë, por që ndikohen, të cilët rrezikohen të përkeqësohen, nëse nuk marrin mbështetje dhe nuk përfitojnë nga ndërhyrjet e komunitetit. Kjo pjesë e mesme, përfshin fëmijë në nevojë, si ata me prindër të ndarë, me aftësi të kufizuara, të cilët i kanë mbijetuar dhunës seksuale, si dhe ata që janë përfshirë ose janë në rrezik të përfshihen në trafikim ose shfrytëzim.

Niveli më i lartë i piramidës, përbëhet nga një pakicë fëmijësh (ata përfaqësojnë rreth 10 për qind), të cilët preken seriozisht. Ata përjetojnë trauma, melankoli dhe forma të tjera të sëmundjeve mendore; janë disfunskionalë e mund të kenë nevojë për ndërhyrje psikiatrike. Ky grup kërkon vëmendje intensive, sepse nuk janë në gjendje t'ia dalin mbanë vetë; ata kanë nevoja për vëmendje individuale, që të mund të kurojnë çrregullimet më të rënda. Në mënyrë që të kuptohet më mirë niveli teraupetik i ndërhyrjes (niveli i sipërm), mund t'i hidhet një sy lidhjes mes zhvillimit normal dhe psikopatologjisë. ÇSP (Çrregullimi i stresit posttraumatik) është një term klinik dhe diagnostikohet nga psikologu ose psikiatri. Ky term ka prirjen të keqpërdoret, ai duhet shmangur jashtë kontekstit të klinikës. ÇSP diagnostikohet zakonisht nëpërmjet përdorimit të simptomave të quajtura DSM-IV (Manuali diagnostik dhe statistik i çrregullimeve mendore) ose ICD-10 (Klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve). Në DSM-IV kemi një person të diagnostikuar me ÇSP, nëse ai ka qenë i ekspozuar ndaj një ngjarjeje traumatike, si rrezikimi i jetës, vdekja apo lëndimi i rëndë i një personi të dashur, ku reagimi i personit përfshin ripërjetimin, shmangjen dhe hiperaktivitetin. Personi shpalos një sërë

5 Piramida e IASC mbi Shëndetin Mendor dhe Ndihmën Psikologjike (www.who.int)

simptomash traume për më shumë se një muaj, dhe ç'është më e rëndësishmja, këto simptoma ndërhyjnë në jetën e përditshme, duke krijuar dhimbje shpirtërore të forta.

FIGURA 1



Pothuajse të gjithë fëmijët dhe adoleshentët, të cilët kanë përjetuar ngjarje traumatike, fillimisht do të tregojnë ndryshime në sjellje, emocione, mendime dhe lidhje sociale, si makthe, tërheqje, probleme përqendrimi, çështje besimi, faj, inat, etj. (shih më poshtë). Reagime të tilla janë normale dhe, me mbështetjen e përshtatshme shoqërore, shumica e fëmijëve e marrin veten pa mbështetje profesionale. Sapo të përmbushen nevojat bazë të jetesës, rikthehen siguria e garancia dhe rregullohen mundësitë e zhvillimit, brenda kushteve familjare, të komunitetit, **shumica e fëmijëve dhe adoleshentëve rifitojnë funksionin normal**.

Vetëm pak fëmijë, 10 në çdo 100 fëmijë, përjetojnë reagime ekstreme, që vazhdojnë për një kohë të gjatë; humbje shprese, ankth dhe melankoli.

Mund të ketë edhe një përqindje të vogël midis 1 dhe 3 në çdo 100 fëmijë, të cilët janë të sëmurë mendorë. Pas një ngjarjeje traumatike, disa prej njerëzve më të dobët, të cilët kanë pasur më parë probleme mendore, pas ndodhisë, janë përkeqësuar. Kujdesi për njerëzit me çrregullime mendore, duhet të integrohet në shërbimet ekzistuese shëndetësore dhe mendore.

Pse duhet bërë kujdes me terminologjinë kur përkufizohen ndikimet psiko-sociale?

Fjalët mund të kenë ndikim të fuqishëm në situata dhe etiketimet mund të jenë damkosëse. Përdorimi i idiomave dhe termave lokale, është thel-

bësor nëse duhet t'i komunikosh në mënyrë të efektshme dhe të kuptosh problemin që po përpiqesh të zgjidhësh. Duhet të jesh gjithmonë i kujdesshëm, të mos mbipërdorësh apo të keqpërdorësh termat që lidhen me problemet psiko-sociale. Fjala "traumë" kuptohet ndryshe nga njerëz të ndryshëm.

Si të ndihmojmë?

Ndihma e parë psikologjike

Ndihma e parë psikologjike, jepet sipas një metode praktike dhe njerëzore, bazuar në pikat e mëposhtme:

- × Dëgjo.
- × Shfaq simpati dhe dëshirë për ta ndihmuar fëmijën.
- × Mos i detyro të flasin.
- × Vlerëso nevojat e tyre dhe merr masa që të përmbushen nevojat bazë.
- × Inkurajo, por mos detyro persona të tjerë të rëndësishëm për fëmijën, që të shoqërohen me të.
- × Mbroji nga lëndimet e mëtejshme.
- × Shmang dhënien e ilaçeve me tepri, për të evituar varësinë prej tyre.

Çfarë duhet bërë për të ndihmuar fëmijët ose adoleshentët të marrin veten nga trauma ose humbja? Ki parasysh se shpesh, reagimet ndaj një ngjarje të tmerrshme, janë "reagime normale ndaj situatave anormale" dhe se fëmija ose adoleshenti, do të përmirësohet me kalimin e kohës në sajë të mbështetjes. Në të njëjtën kohë, mund të ndihmosh familjen dhe prindin, ose kujdestarët e tjerë, të ndihmojnë fëmijën, duke bërë gjëra të thjeshta. Fillimisht, duhet të përforcojnë rutinën e fëmijës. Kjo ndihmon të krijohet ndjesia se gjërat do t'i kthehen normalitetit. Mbështeti aktivitetet çlodhëse që pëlqen fëmija, sidomos aktivitetet me lojëra. Mësoje familjen të dëgjojë fëmijën. Tregoju që munden dhe duhet t'i japin fëmijës informacion të thjeshtë mbi traumën dhe se çfarë ndodhi. Duhet t'i tregojnë se ata nuk janë të këqinj dhe se nuk ishte faji i tyre. Dhe mos harro të inkurajosh të rriturit, që të mbështesin sa më shumë fëmijën.

Mbi shprehitë dhe mekanizmat e përballimit të situatave stresante
Edhe pse trauma ndërpret rrjedhën normale të jetës së një personi për një periudhë kohore të caktuar, nga përvoja e dimë se jeta vazhdon edhe në kohë të vështira. Shprehitë për të përballur vështirësitë, janë mënyra specifike, me çka individët dhe komunitetet rindërtojnë jetët e tyre.

Shembuj të shprehive të përballimit të situatave stresante:

- Fol për problemin tënd me dikë që beson.
- Merr këshilla nga të tjerët.
- Bë diçka që të duket e dobishme dhe e mirë.
- Prano problemin.
- Rri me shokë për t'u ndjerë i sigurtë.
- Ndrysho mjedisin, me qëllim që të mbrosh veten.
- Kërko ndihmë shpirtërore.
- Përfshihu në aktivitete zbavitëse.
- Merr pjesë në punë në grup.
- Ndiq aktivitete kulturore.
- Rikthehu në rutinën e përditshme: Gatim, punë shtëpie, shko në shkollë, etj.

Çdo individ ka mënyrën e tij për të përballur problemin. Ajo që mund të jetë e mirë për ju, nuk është e tillë për dikë tjetër.

Pjesë e aftësive përballuese është të SHPREHËSH ndjenjat, mendimet dhe besimet. Pas një ngjarjeje traumatike, ndjenjat dhe mendimet e dhimbshme, mbeten si një gjemb në këmbë. Njeriu do të vazhdojë të ndjejë dhimbje, derisa të heqë gjembin. Nëse gjembi rri për një kohë të gjatë, personi kalon në depresion. Por nëse shprehen ndjenjat e dhimbshme (nëse hiqet gjembi dhe infeksioni që ai ka shkaktuar), atëherë njeriu do të shërohet, megjithëse do të mbetet shenja.

Mbani parasysh: Ka shumë aftësi përballuese që njerëzit përdorin për të rindërtuar botën e tyre pas një ngjarje traumatike. Çdo njeri ka një mënyrë të veçantë të të përballurit me gjërat.

Duke shprehur ndjenjat, mendimet dhe besimet për një ngjarje traumatike, personi shërohet më me lehtësi.

Ndërhyrjet e përqendruara te fëmija, mund të përfshijnë:

- T'i flasësh fëmijës ose adoleshentit mbi emocionet dhe/ose traumat, duke përdorur informacionin e përshtatshëm për moshën e tij;
- Kryej aktivitete për t'i dhënë mundësinë të shprehet dhe të kalojë ngjarjen traumatike;

- Nëse fëmija tregon ankth, propozoji një të rrituri (vëlla, motër më e madhe) ta ndihmojë të ndjehet i sigurtë në shkollë.

Ndërhyrjet e përqendruara te prindi, mund të përfshijnë:

- Dashuri dhe mirëkuptim;
- Përforcim të rutinave dhe detyrave ditore;
- T'i flasësh fëmijës për stresin emocional dhe ngjarjen traumatike.

Ndërhyrjet e përqendruara te mësuesi, mund të përfshijnë:

- Të ofrosh informacion mbi llojin e stresit emocional ose traumës që fëmija po përjeton;
- Shumë përkushtim dhe mirëkuptim;
- Rutinë në klasë;
- Të japësh hapësirë për diskutim, nëse fëmija ndjehet gati për t'u shprehur artistikisht, si shkrime, ese ose pikturë;

Përmbledhje

Problemet e mbrojtjes së fëmijëve kërkojnë një botëkuptim të gjerë të fenomenit, si dhe plane të përshtatshme të ndërhyrjes profesionale shumëdimensionale.

- × Para se t'i përgjigjesh një problemi të mbrojtjes së fëmijës, aktivizo dijet e tua mbi çështjen dhe planifiko ndërhyrjen më të përshtatshme, në përputhje me studimet dhe përvojat e mëparshme;
- × Mbështet fëmijët, familjet dhe mësuesit me teknika dhe mjete të thjeshta, që fuqizojnë fëmijën, prindërit dhe kujdestarët e tjerë të fëmijës të menaxhojnë vetë vështirësitë.

Abuzimi me fëmijët është një fenomen i përhapur, që shumë herë nuk raportohet. Si një profesionist që merret me fëmijët, duhet të njohësh procedurat për raportim:

- a Raporto në rajonin më të afërt të policisë ose Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- b Raportoi personelit mjekësor problemin që ka të bëjë më mbrojtjen e fëmijës, nëse është i nevojshëm shtrimi në spital;
- c Diskuto me prindërit se çfarë do të ndodhë në gjyq.

Rrit nivelin e ndërgjegjësimit mbi detyrimin e raportimit të rasteve të abuzimit të fëmijës!

- × Është e detyrueshme të raportosh, nëse mëson për një rast abuzimi.
- × Çdo anëtar i komunitetit duhet t'i raportojë policisë.
- × Është shkelje të mos raportosh rastin e një abuzimi.

Pika kontrolli

Përpiqu t'u përgjigjesh pyetjeve të mëposhtme. Për të parë nëse përgjigjet janë të sakta, kthehu në kapitujt korrespondues.

1. Ju lutem bëni përkufizimin e fenomeneve: Abuzim seksual, emocional dhe fizik.
2. Cili është reagimi juaj i parë, nëse një fëmijë ju raporton se është abuzuar?
3. Si mund të parandalohet abuzimi me fëmijën?
4. Si mund të lehtësosh procesin e integrimit të familjeve dhe fëmijëve që kanë migruar?
5. Si do ta trajtonit ju problemin e barazisë dhe diversitetit në shkollën tuaj? Çfarë aktivitetesh do të organizoje?

Kapitulli 4 / 5 / 6 / 7 / 8 / 9

Udhëzime për ndërhyrjet

Moduli Praktik 3

Ushtrimet praktike të Modulit të tretë, do t'ju ndihmojnë të zhvilloni shprehitë dhe kompetencat në kryerjen e ndërhyrjeve profesionale, të përshtatshme për fëmijët, familjet dhe personelin pedagogjik, të cilët përballen me problemet e mbrojtjes së fëmijëve në punën e tyre të përditshme

1 Pyetësor mbi planin e aktiviteteve psiko-sociale me fëmijët

Plotësoni pyetësorin për të kontrolluar njohurinë tuaj teorike mbi organizimin e aktiviteteve psiko-sociale dhe rikrijuese bazë me fëmijët.

1 Cili është ndryshimi midis ndërhyrjeve psiko-sociale bazë dhe ndërhyrjeve psiko-sociale të avancuara?

.....

.....

.....

2 Cilat janë tre objektivat kryesore të aktiviteteve psiko-sociale? Shpjego me një shembull secilën prej tyre:

× **SHEMBULL:** .....

× **SHEMBULL:** .....

× **SHEMBULL:** .....

3 Çfarë është një mënyrë eksperimentale e të mësuarit?

.....

.....

4 Cilat janë 4 hapat në ciklin e të mësuarit të Kolb?

× .....
× .....
× .....
× .....

5 Cilat janë tri fazat e një aktiviteti psiko-social?

× .....
× .....
× .....

6 Cilat janë pesë parimet metodologjike për aktivitetet me fëmijët?

× .....
× .....
× .....
× .....
× .....

7 Cilat janë tre hapat e modelit të veprimit në hartimin e aktiviteteve psiko-sociale?

× .....
× .....
× .....

8 Cilët janë tre tipet e dejtuesit dhe cilin prej tyre do të zbatonit me fëmijët. Shpjegoni pse?

× .....
× .....
× .....

9 Cilat janë 5 këshillat që do t'i jepnit një animatori të ri për aktivitetet psiko-sociale?

× .....
× .....
× .....
× .....
× .....

10 Cilat janë parimet themelore të një loje bashkëpunuese?

.....
.....

11 Çfarë bëni ju, nëse fëmijët nuk janë të motivuar për të marrë pjesë në aktivitetin që ju u propozuat?

.....
.....

12 Cilat janë ndërhyrjet e nivelit I? Si lidhen ato me ndihmën psiko-sociale bazë dhe atë të avancuar?

.....
.....

Tani kthehu te **KAPITUJT 5.2.6** dhe kontrollo nëse përgjigjet ishin të sakta. Nëse po punon me një koleg, ndryshoni pyetësorin dhe korrigjoni përgjigjet e njëri-tjetrit.

2 Organizimi i aktiviteteve psiko-sociale me fëmijë

1. Organizo sesione 45 minutëshe me bazë psiko-sociale për fëmijët.
2. Zgjidh grupin e fëmijëve me të cilët do të punosh, vendin, kohën dhe qëllimin/objektivin e sesionit.
3. Planifiko aktivitete sipas metodologjisë së **KAPITULLIT 5.2.6**. Përdor listën e mëposhtme.
4. Kërkoji një kolegu të marrë pjesë në sesionet e tua, për të dhënë vlerësimin e tij/saj.
5. Përcakto objektivat e tua për sesionin.
6. Dorëzo tabelën e vëzhgimit, si dhe listën e kritereve për vëzhgimin e vlerësimit të kolegut.
7. Pas sesionit, kërkoji një kolegu të bëjë komentet e veta në një sesion përmbledhës.

Struktura e vlerësimit të punës

A Vetëvlerësimi

a. Plotëso tabelën e vetëvlerësimit.
b. Ndaj me kolegun që të vlerëson mendimet dhe përshtypjet e tua të përgjithshme se si të shkoi aktiviteti. Më pas, përgjigjju çdo pike në tabelën e vetëvlerësimit.
c. Bëj vlerësimin e dy objektivave personale që ke caktuar para aktivitetit. Vlerëso se deri në ç'masë i ke arritur ose përmbushur ato? Nëse po, si? Nëse jo, pse? Çfarë mund të bëjmë herën tjetër për t'i arritur?

B Komente nga shokët

a. Kolegu që të vlerëson, të jep përshtypjet e tij të përgjithshme dhe komentet e veçanta mbi pikat në tabelën e vetëvlerësimit.
b. Kolegu që ju vlerëson, reflekton tri pikat e forta dhe tri pika që kanë nevojë për përmirësim.
c. Kolegu ju jep mendimin e tij/saj mbi objektivat personale që ke caktuar.
d. Përcakto objektivat e tua personale për aktivitetin tjetër psiko-social dhe mbaj shënim tre mësimet që ke përfituar.

Pse është i rëndësishëm vetëvlerësimi?
Të njëjtat standarte që përdor për të dëgjuar të tjerët, janë të rëndësishme për të dëgjuar dhe veten tënde, mos gjyko, ji vigjilent dhe kurioz. Si një Specialist për Mbrojtjen e Fëmijëve, është e rëndësishme të dëgjosh veten dhe përvojat e tua, sepse, sa më i ndërgjegjshëm të jesh për aftësitë, kufizimet, pikat e forta dhe problemet e tua, aq më shumë do të jesh në gjendje të kuptosh dhe mbështesësh të tjerët. Vetëvlerësimi ndihmon për të përmirësuar aftësitë profesionale dhe personale, si dhe kompetencat te një person.

Pse është e nevojshme mbikëqyrja?
Shpesh bllokohemi te perceptimet tona dhe përvojat e mëparshme të punës. Është e rëndësishme të marrësh komente të jashtme të dobishme nga një instruktor ose mbikëqyrës për të zhvilluar dhe rritur rolin tuaj profesional.

Lista për të kontrolluar aktivitetet psiko-sociale:
PLANIFIKIM – ANIMIM – VLERËSIM

PLANIFIKIMI	TREGUESIT	DATA
Fëmijët janë pyetur lidhur me: × Tipin e aktiviteteve × Kohën, vendin dhe orarin × Objektivat, qëllimet	Numri dhe emrat e fëmijëve të këshilluar	

PLANIFIKIMI	TREGUESIT	DATA
Programimi: **1** Ekuilibër mes tre llojeve të aktiviteteve (fizike, kreative dhe edukative). **2** Aktivitetet bazohen në nevojat e zhvillimit, moshës dhe gjinisë. **3** Hapa progresivë nga aktivitetet më të thjeshta te më të vështira **4** Pjesëmarrje maksimale për të gjithë (puno në çifte ose në grupe të vegjël, që të gjithë të përfshihen dhe të kenë mundësi të mësojnë) **5** Objektiva të qarta janë vendosur për çdo aktivitet. **6** Zbatohet cikli i procesit të të mësuarit nga Kolb. **7** 3-pjesët e aktiviteteve: **8** prezantimi – pjesa kryesore – qetësimi (përmbledhje)	⁛ Përshkrim i programit	
Forma e lejes së prindit mbushet nga prindërit e fëmijëve	⁛ Fletët e aktiviteteve për çdo sesion	
	⁛ Dosje të fëmijës (për një ndjekje individuale)	
	⁛ Lista e grupit për aktivitetet	
	⁛ Orari i aktiviteteve	
	⁛ Firma e prindërve në formularët e lejës	
Fëmijët duhet të jenë të përfshirë në planifikimin e aktiviteteve	⁛ Emrat e fëmijëve	
	⁛ Data dhe koha e mbledhjes me fëmijët	
	⁛ Lista e përgjegjësive e firmosur nga fëmijët	
Identifikohet një ambjent miqësor për fëmijët për të kryer aktivitetet	⁛ Cito ku do të kryhen aktivitetet	
Mbledhjet mes animatorëve do të kryhen në mënyrë që të ndahen rolet dhe përgjegjësitë e gjithsecilit	⁛ Programet e mbledhjeve, vendimet e marra, përgjegjësitë dhe rolet caktuara	
Kodi i sjelljes firmoset nga i gjithë ekipi i animatorëve	⁛ Kodi i sjelljes, i firmosur	
Burime materiale dhe fizike që nevojiten për aktivitetet janë të mundëshme	⁛ Kontrolli i pajisjeve	

ANIMIMI	TREGUESIT	DATA
Fëmijët janë të përfshirë në animimin e aktivitetit	Fëmijëve u jepen përgjegjësi specifike dhe luajnë një rol aktiv në animimin e aktivitetit	
Bëhet një marrëveshje me fëmijët	Kopja e marrëveshjes firmoset nga të gjithë fëmijët dhe ekipi i animatorëve	
Duhet ujë që fëmijët të mund të lajnë duart dhe të mund të pijnë	Mundësi çezmash dhe uji të pijshëm	
Janë të nevojshme edhe tualetet – një për vajza dhe një për djem	Tualete	
Duhet të ekzistojë kutia e ndihmës së parë dhe fëmijët e dinë se kush është personi i ngarkuar për këtë	Kutia e ndihmës së parë	

VLERËSIMI	TREGUESIT	DATA
Vetëvlerësimi	Mbush formularin e vetëvlerësimit	
Vlerësimi i kolegëve	Mbush formularin e vlerësimit të kolegëve	
Vlerësim i mbikëqyrësit	Mbush formularin e komenteve dhe atë të diskutimit	
Vlerësimi/komente nga fëmijët	I shkruar ose i thënë me fjalë, varet nga metoda e përdorur	
Bëhen seanca përmbledhëse me animatorët e tjerë	Numri i seancave përmbledhëse	

Tabelat e vëzhgimit për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e kolegëve

1 KOMPETENCAT PERSONALE DHE SOCIALE: Drejtimi

Bashkëpunimi midis animatorëve

1 Animatorët ndajnë leksionet në mënyrë të qartë dhe të barabartë midis tyre.
2 Lidhja mes animatorëve është e saktë.

Komunikimi me fëmijët

1 Animatorët tregojnë vetëbesim.
2 Animatorët qëndrojnë në një vend, nga ku fëmijët mund t'i shohin dhe dëgjojnë.
3 Animatorët flasin me zë të lartë, të thjeshtë dhe të qartë.
4 Animatorët japin udhëzime të shkurtra dhe tregojnë se si vihen në praktikë.

Lidhja me fëmijët

1 Animatorët janë pozitivë, të qeshur, inkurajues, dhe motivues me fëmijët.
2 Animatorët dëgjojnë fëmijët dhe janë të hapur ndaj sugjerimeve të tyre.

2 KOMPETENCAT SOCIALE DHE PERSONALE: Autoriteti dhe rregullat

Vendosja e rregullave

1 Animatorët vendosin rregulla të qarta për fëmijët, që të respektohen në grup.
2 Animatorët menaxhojnë grupin kur ka çrregullime.
3 Animatorët përcaktojnë masat ndëshkimore, nëse rregullat nuk respektohen.
4 Animatorët reagojnë si duhet, nëse ka konflikt.

Respekti

1 Fëmijët respektojnë animatorët.
2 Fëmijët respektojnë njëri–tjetrin.
3 Fëmijët respektojnë rregullat e lojës së ndershme.
4 Fëmijët mirëmbajnë mjetet dhe ndihmojnë për t'i rregulluar në fund të leksionit.

3 KOMPETENCAT METODOLOGJIKE: Organizimi dhe planifikimi

Planifikimi

1 Animatorët e përgatisin leksionin (me shkrim), nuk improvizojnë.
2 Animatorët kanë përgatitur materialin e nevojshëm të gatshëm për përdorim.
3 Animatorët kanë zgjedhur një vend dhe materiale të sigurtë për fëmijët.

Ndarja e leksioneve

1 Animatorët i kanë ndarë të tri pjesët në mënyrë të qartë.
2 Animatorët kanë planifikuar që çdo pjesë të ketë ushtrimet dhe lojërat e përshtatshme.

Menaxhimi i kohës

1 Animatorët caktojnë një kohë të mjaftueshme për çdo pjesë dhe e respektojnë.
2 Animatorët respektojnë kohën (as më pak, as më shumë).

4 KOMPETENCAT METODOLOGJIKE: Pjesëmarrja, larmia dhe kreativiteti

Pjesëmarrja

1 Animatorët e kanë ndarë grupin e fëmijëve në grupe tjerë më të vegjël, që t'i mundësojnë fëmijët të jenë aktivë gjatë gjithë kohës.
2 Fëmijët janë gjithmonë aktivë në ushtrime, ka shumë pak kohë në pritje.
3 Fëmijët kanë mundësi të luajnë çdo rol në lojë.

Larmia

1 Animatorët ndryshojnë vendet e individëve, në çifte, grupe të vogla dhe aktivitete në grup.
2 Ushtrimet kanë një kohë zgjatjeje të mjaftueshme (as shumë të gjatë, sa fëmijët mërziten/as shumë të shkurtër, sa fëmijët të mos kenë kohë për të mësuar).

Natyra krijuese

1 Fëmijët janë të motivuar dhe argëtohen gjatë aktivitetit.
2 Animatorët përpiqen të gjejnë ushtrime dhe lojëra origjinale.

5 KOMPETENCAT METODOLOGJIKE: Objektivat dhe ecuria

Objektivat

1 Animatorët u kanë komunikuar fëmijëve objektiva të qarta në fillim të leksionit.
2 Animatorët kanë përcaktuar një objektiv të qartë fizik.
3 Animatorët kanë caktuar objektiva të qarta psiko-sociale.
4 Objektivat i përshtaten grupmoshës (jo shumë të lehtë, jo shumë të vështirë).
5 Objektivat mund të vëzhgohen si sjellje të qarta.

Ecuria

1 Ushtrimet vështirësohen gjatë mësimit.
2 Ka lidhje logjike midis ushtrimeve.
3 Fëmijët mësojnë me anë të hapave progresivë (asnjë formë përfundimtare pa përgatitje).

6 KOMPETENCAT METODOLOGJIKE: Procesi i të mësuarit

Procesi i të mësuarit

1 Animatorët respektojnë tre hapat e të mësuarit (eksperimentimi i parë, korrigjimi, eksperimentimi i dytë).
2 Animatorët bëjnë komente në grup dhe individualisht, gjatë dhe pas aktivitetit.
3 Animatorët ju japin kohë fëmijëve të përsërisin dhe të përmirësojnë ushtrimet dhe lëvizjet.

Cilësia

1 Animatorët u kërkojnë dhe korrigjojnë fëmijët, derisa arrijnë cilësinë e pritur.
2 Animatorët përshtasin aktivitetet për të arritur një cilësi të caktuar nëse nuk është e vështirë.

Komente

1 Animatorët pyesin fëmijët se çfarë është e vështirë dhe çfarë kanë mësuar.
2 Animatorët u bëjnë komente fëmijëve mbi pikat pozitive dhe se çfarë duhet të përmirësojnë herën tjetër.

6 **KOMPETENCA METODOLOGJIKE: Bashkëpunimi/konkurrenca**

Bashkëpunimi

1 Të gjithë fëmijët janë integruar dhe duhet të punojnë për të arritur objektivin kolektiv së bashku.
2 Animatorët organizojnë lojëra, ku nuk përjashtohet asnjë fëmijë.

Konkurrenca

1 Animatorët këmbëngulin më shumë në cilësinë e veprimeve dhe rëndësinë e të luajturit, sesa në idenë e fituesit dhe humbësit.
2 Animatorët vendosin fëmijët në situata të konkurrimit personal, sesa në konkurrimet në grup,
3 Animatorët arrijnë një ekuilibër midis lojërave që kërkojnë bashkëpunim (një grup i vetëm) dhe ato konkurruese (skuadra të ndryshme).

Tabelë vëzhgimi për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e kolegëve

PIKAT E VËZHGIMIT	VLERËSIMI NGA 1 TE 10	SUGJERIME PËR PËRMIRËSIME
.....	.....	.....

PIKAT E VËZHGIMIT	VLERËSIMI NGA 1 TE 10	SUGJERIME PËR PËRMIRËSIME

Vetëvlerësimi i pjesëve të ndryshme të organizimit të aktivitetit

FIGURA 1



Cilat janë 3 gjërat më të rëndësishme të mësuar nga ky seksion?

Ji i saktë/jep shembuj, jo çështje të përgjithshme …

1 .....

.....

2 .....

.....

3 .....

.....

Vetëvlerësimi i pjesëve të ndryshme të organizimit të aktivitetit

FIGURA 2



Cilat janë 3 sugjerimet kryesore për animatorin?

Ji i saktë/jep shembuj, jo çështje të përgjithshme …

1 .....

.....

2 .....

.....

3 .....

.....

3 Organizimi i seminareve trajnues me prindër dhe mësues

Qëllimi

× Për të përmirësuar kushtet e jetesës së fëmijëve, që ata të kenë një jetë të sigurtë, ne duhet të punojmë më parë me kujdestarët e tyre, të cilët janë prindërit dhe mësuesit.
× Për të rritur ndërgjegjësimin ndërmjet prindërve dhe mësuesve, Specialistët e Mbrojtjes së Fëmijëve, organizojnë seanca ndërgjegjësimi, të bazuara në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, si pjesë e planit të veprimit parandalues të shkollës.

Objektivat

× Të inkurajojmë pjesëmarrësit të zhvillojnë aktivitete për ndërgjegjësimin e prindërve dhe mësuesve.
× Të zhvillojmë aftësitë menaxhuese për mënyrat e organizimit, planifikimit, animimit dhe vlerësimit të këtyre seancave ndërgjegjësuese me prindërit dhe mësuesit.

Çështjet kryesore për t'u mbajtur mend

× Si të organizojmë seanca ndërgjegjësuese me prindërit dhe mësuesit, lidhur me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve.

Kohëzgjatja

× 45 minuta.

Materialet

× Një faqe në ditarin tuaj për mbrojtjen e fëmijëve.

Procesi

USHTRIMI: Organizo në vijim seminarin me mësues dhe prindër mbi probleme të mbrojtjes së fëmijëve, sipas hapave të përshkruara më poshtë.

Listë kontrolli për seminaret trajnues me prindër dhe mësues

UDHËZUES HAP PAS HAPI

1 Konsultim me drejtorin e shkollës, komitetin e prindërve, si edhe me mësuesit. Harto një pyetësor mbi çështjet që janë më me interes për ta.

2 Përcakto çështjen, datën dhe kohën, bazuar në mundësinë e pjesëmarrësve, përcakto kohëzgjatjen dhe vendin e takimit.

3 Përdor një ftesë për t'ia shpërndarë pjesëmarrësve, duke përfshirë në të programin e takimit. (shih **ANEKSIN 2** ku jepet një shembull ftese).

4 Reflekto mbi pyetjet dhe çështjet që dëshiron të diskutosh. Përcakto metodën për mbledhjen e mendimeve dhe përpiqu të jesh aktiv për të nxitur përfshirjen dhe reflektimin e pjesëmarrësve sa më shumë të jetë e mundur. Mos e kthej takimin tënd në një orë leksioni, por në një aktivitet gjithëpërfshirës dhe vend ku të shkëmbehen përvoja dhe mendime. Gjithashtu, shih pikat kyçe të përmendura më poshtë mbi mënyrën e paraqitjes së informacionit. Kërko mbështetjen e këshilluesit psiko-social të të fondacionit "Terre des hommes" gjatë takimit, nëse duhet ndihma e tyre.

5 Takimi (ji i përgatitur dhe korrekt me kohën, sigurohu që dhoma të mos jetë shumë e ftohtë, por as shumë e nxehtë dhe të ketë pije të ndryshme për pjesëmarrësit). Jepi një mbikëqyrësi ose një kolegu një pikë specifike vëzhgimi, që dëshiron ta përmirësosh (shih një formë vetëvlerësimi më poshtë). Mbaj parasysh qëllimet personale për këtë mbledhje dhe sigurohu që të bësh një hapje të qartë të takimit e një mbyllje të tij.

6 Fleta e vlerësimit që duhet të plotësohet nga çdo pjesëmarrës (shih formularin e vlerësimit).

7 Përcakto me mbikëqyrësin pikat e vetëvlerësimit, seancës përmbledhëse dhe rishiko e analizo qëllimet e tua të atij takimi.

Sa vështirësi parashikoni? Si do t'i referoni?

RENDISNI VËSHTIRËSITË	PËRSHKRUAJ HAPAT E STRATEGJISË PËR TË ZGJIDHUR ÇËSHTJEN PROBLEMATIKE.
.....	.....
.....	.....
.....	.....

Seanca ndërgjegjësuese me prindërit, lidhur me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve:

- × Bashkëpunoni me komitetin e prindërve dhe drejtorinë e shkollës për të realizuar këtë seancë;
- × Përpiquni të përcaktoni strategjitë për të përfshirë prindërit që janë më pak aktivë në shkollë;
- × Nxisni pjesëmarrjen e baballarëve në këto seanca;
- × Filloni me një çështje jo shumë të vështirë dhe interesante dhe më pas vijoni progresivisht me trajtimin e saj.

Seanca ndërgjegjësuese me mësuesit, lidhur me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve:

- × Sigurohuni që keni mbështetjen e drejtorit të shkollës;
- × Gjeni orarin e përshtatshëm dhe vendin e duhur për të bërë këtë takim;
- × Merr në konsideratë përvojën e mësuesve dhe përfito nga ekspertiza e tyre.

Udhëzime të rëndësishme për prezantim

PREZANTIMI I INFORMACIONIT	PREZANTIMI I VETES SUAJ
Organizo shënimet e tua dhe materialet e trajnimit, që ato të jenë të vlefshme gjatë trajnimit, takimit.	Fol me zë të ulët dhe të qartë
Shto shënime te materiali për të ndihmuar veten e t'i kesh parasysh dhe të kujtohesh lidhur me pikat kyçe të diskutimit	Mos pretendo se i di të gjitha; prano boshllëqet në njohuritë e tua. Nëse ka pyetje që nuk mund t'u përgjigjeni, kaloni në një pyetje tjetër të rendit pasardhës; **1** Rihidhe pyetjen sërish në tavolinën e diskutimit, ndoshta ndonjë nga pjesëmarrësit mund ta dijë; **2** Diskuto çështjen me anëtarët e grupit tënd pas trajnimit; **3** Kontakto këshilluesit psiko-social të një zyre tjetër; **4** Kontakto këshilluesen për çështjen e mbrojtjes së fëmijëve dhe çështjet psiko-sociale; Nëse çështja që u diskutua ishte shumë e rëndësishme, kujtohu ta sjellësh sërish në fillimin e takimit të ardhshëm.
Jepe informacionin thjeshtë dhe qartë	Nëse je në ankth lidhur me takimin, përjetoje atë ndjenjë, por përpiqu të qetësohesh dhe të ecësh përpara (frymëmarrja e thellë mund t'ju ndihmojë)
Shëno komentet lidhur me informacionin dhe respekto ndryshimin	Drejto sërish diskutimin në mesazhet kryesore!
Përpiqu të respektosh orarin e përcaktuar për diskutimin sipas programit	Dëgjo aktivisht
Inkurajo pjesëmarrje	Reflekto mbi takimin, përforco çështjet kryesore!

Ftesë **Datë**

I dashur zotëri/zonjë

Në emër të komitetit të prindërve dhe të drejtorisë së shkollës **(EMRI I SHKOLLËS)**, ju ftoj në takimin me prindër që do të bëhet më: (vendos datën, për shembull x shkurt, në x vend **(PËRCAKTO VENDIN)**. Mbledhja është pjesë e mbledhjeve mujore të prindërve. Çështjet për t'u diskutuar në këtë mbledhje janë … **(JEP NJË ÇËSHTJE)**.

Prania Juaj në këtë mbledhje, është shumë e rëndësishme. Nëse nuk do të merrni pjesë në mbledhje, na vini në dijeni më përpara.

Jeni të mirëpritur në këtë mbledhje!

Me Respekt,

(VENDOS EMRIN)
Psikologu i shkollës

(VENDOS EMRIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS)
Drejtori i shkollës

(FIRMA) **(FIRMA)**

Anekse:
- Programi i takimit
- Informacion mbi çështjen që do të diskutohet (për shembull Konventa e të Drejtave të Fëmijëve).

4 Trajnimi i mësuesve për të përmirësuar shprehitë e menaxhimit të klasës

Ju jeni përzgjedhur për të qenë shembull në këtë shkollë, shembull i trajtimit të problemeve nga ana psikosociale. Një nga hapat e parë, është të ndërgjegjësosh drejtorin, mësuesit dhe kolegët e tjerë mbi ato që ke mësuar. Sigurohu të punosh me specialistin tjetër të mbrojtjes së fëmijëve ose mësuesit e trajnuar në zonën tënde. Mund të jetë shumë e dobishme t'u bësh të ditur të tjerëve vështirësitë që ke hasur dhe shembuj se si ti i zbaton rregullat dhe zhvillon aktivitete. Kur bashkëpunon me të tjerë, detyra bëhet më e lehtë! Në grupin tuaj të specialistëve të mbrojtjes së fëmijëve ose mësuesve, mund të shkëmbehen këshilla, ide dhe inkurajime! Tani, fillo të japësh ato që di. Paç fat dhe kalofsh sa më mirë në rolin e mrekullueshëm që ke me fëmijët në shkollë!

1. Puno individualisht me mësuesit në shkollë, për të përmirësuar aftësitë e tyre në drejtimin e klasës.
2. Përdor fletën e mëposhtme të planifikimit në një sesion individual trajnues me çdo mësues, për t'i ndihmuar të përcaktojnë objektiva personale (shiko shembullin më poshtë).
3. Ndihmo mësuesit të vlerësojnë, nëse i kanë arritur objektivat e tyre. Nënvizo progresin dhe arritjet për t'i mbajtur të motivuar.

Shembull i një plani individual të mësuesit

EMRI: .....

SHKOLLA: .....

QYTETI: .....

SI MUND TA BËJ KLASËN NJË VEND MË TË MIRË PËR FËMIJËT?	ÇFARË HAPASH SPECIFIKE DO TË NDËRMARR?	KUR?	ÇFARË NDRYSHIMESH PRES TË SHOH TE NXËNËSIT E MI?
1 Cakto rregulla për klasën	× Diskuto me nxënësit si të hartosh rregulla për klasën × Përfshi nxënësit në hartimin e rregullave	Semestri tjetër	× Përmirësim i disiplinës në klasë × Dashuri dhe respekt për njëri-tjetrin
2 Lejo shprehjen e lirë me anë të: diskutimit, vizatimit, shkrimit	× Cakto kohë për diskutime × Ndaji nxënësit në grupe për diskutim × Udhëzoji në zgjedhjen e një teme × Kërkoju të shprehin me vizatime ndjenjat e tyre × Kërkoju të shkruajnë për idetë e tyre	Fillo në javën e dytë të semestrit tjetër	× Bashkëpunim × Respekt për tjetrin × Aftësitë e imagjinatës × Përmirësim i kujtesës
3 Mbaj shënime (tabela, modele vizatimi)	× Vendosi shënimet në klasë	-	-

Kujto çfarë ke planifikuar dhe si i ke përcaktuar objektivat e tua personale. Çfarë rezultatesh pozitive ke arritur? Me çfarë vështirësish je përballur? Mbaj shënime personale, për ato që duhet të bësh në praktikë, sukseset dhe vështirësitë. Do të të vlejnë për të përmirësuar aftësitë e tua.

Diskutoji këto vështirësi me Specialistin e Mbrojtjes së Fëmijëve në sesionin tjetër trajnues.

5 Seminar trajnues për mësuesit mbi profilin e pikave të forta dhe të dobëta

1. Organizo një seminar trajnues, me qëllim aftësimin e personelit pedagogjik.
2. Përdor mjetet dhe metodat e paraqitura më poshtë.
3. Vlerëso sesionin me anë të formularit të vlerësimit të seminarit si më poshtë.
4. Hidh përfundimet në ditarin tënd për mbrojtjen e fëmijëve dhe shkëmbeje me profesionistë të tjerë.

Disa mjete, ushtrime dhe udhëzime për të inkurajuar të mendosh rreth vetes tënde dhe përvojave të tua.

A **Për jetën time**

- × Një gjë që më pëlqen te vetja, është:
- × Diçka ku nuk jam i zoti, por që do të doja të isha, është:
- × Gjëja që më pëlqen më shumë te shtëpia ime është:
- × Nëse do të ndryshoja një gjë nga vetja ime, do të ishte:
- × Një person që ka qenë model në jetën time është:
- × Çfarë vlerësoj te ky model, është:
- × Një gjë e re që do të doja të mësoja është:
- × Një aftësi që mund të përmirësoj është:
- × Gjëja që më pëlqen më shumë në familjen time është:
- × Një gjë që më pëlqen nga jeta e përditshme është:
- × Dita e preferuar e javës është … sepse
- × Ora më e preferuar e ditës është … sepse
- × Ajo që më pëlqen më shumë te shokët e mi është :
- × Aktiviteti im i preferuar është:
- × Diçka ku besoj shumë është:

Mund t'i përdorësh gjithashtu këto mjete për të ndihmuar të njohësh të rriturit dhe fëmijët e tjerë.

B **Disa pyetje për të menduar dhe diskutuar në grup:**

- × Në rolin tim si mësues/SMF:
- × Si të punoj më mirë?
- × Çfarë është e lehtë për mua?
- × Çfarë është e vështirë për mua?
- × Çfarë dua të ndaj me të tjerët në një rast të vështirë?
- × Për ç'arsye ishte ky rast i vështirë për mua?
- × Çfarë kërkoj prej kolegëve të mi?
- × Çfarë nuk pres prej kolegëve të mi?
- × Me çfarë mund të ndihmoj këtë grup mësuesish të shkollës time?

C **Të dëgjosh fëmijët, të zbatosh rregullat dhe të organizosh aktivitete në klasë**

Përcakto nivelin tënd të shprehive/aftësive/qëndrimeve për secilën nga fjalitë në tabelën e mëposhtme. Ky informacion shërben që ti të vlerësosh fushat ku i ke pikat e fuqishme si mësues ose SMF, si dhe fushat ku duhet të zhvillohesh. Është e rëndësishme të jesh i ndershëm me veten dhe i hapur, për të mësuar gjëra të reja për veten. Ky informacion është vetëm për ty, askush nuk do ta kontrollojë. Duke bërë këto përcaktime, herë pas here do të ndihmojë të vësh re ecurinë tënde.

Për të gjykuar për veten, mendo sikur je një enë uji: Duke e vizatuar këtë enë dhe duke shënuar nivelin e ujit që ka kjo enë, ju do të tregoni se si po ecën puna juaj.

Bosh: Aktualisht nuk ka – duhet të mësoj këtë shprehi/qëndrim.
Ka pak shprehi/qëndrim – por duhet ta përmirësoj dhe zhvilloj.
Ka një sasi mesatare të kësaj shprehie/qëndrimi.
Ka arritur nivelin më të lartë në shprehi/qëndrime.

TË DËGJOSH FËMIJËN	MË PARË	SOT	NË TË ARDHMEN	NJË MËNYRË PËR T'U PËRMIRËSUAR/ZHVILLUAR NË KËTË FUSHË
Dëgjo fëmijën				
Përpiqu të kuptosh këndvështrimin e fëmijës				
Ndihmo fëmijën të shprehë mendimet dhe ndjenjat				
Ji i durueshëm				
Ofro alternativa				
Referoje në rrjetin e mbrojtjes sociale, nëse është e nevojshme				

PËRDORIMI I RREGULLAVE DHE KRYERJA E AKTIVITETEVE NË KLASË	MË PARË	SOT	NË TË ARDHMEN	NJË MËNYRË PËR T'U PËRMIRËSUAR/ZHVILLUAR NË KËTË FUSHË
Përcaktoji rregullat bashkë me fëmijët				
Zbato masa të përshtatshme, në vend të dënimit të ashpër				
Mos humb gjakftohtësinë, por ji i drejtë dhe i qëndrueshëm				
Shfrytëzo metoda gjithëpërfshirëse, për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mësim				

PËRDORIMI I RREGULLAVE DHE KRYERJA E AKTIVITETEVE NË KLASË	MË PARË	SOT	NË TË ARDHMEN	NJË MËNYRË PËR T'U PËRMIRËSUAR/ZHVILLUAR NË KËTË FUSHË
Përdor metoda të ndryshme në klasë, për të ndihmuar fëmijët të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre: shkrimin, vizatimin, diskutimin, muzikën, dramën, kërcimin Organizo diskutime me nxënësit menjëherë pas ngjarjeve të vështira Organizo aktivitete dhe diskutime për të nxitur bashkëpunimin midis nxënësve				

Forma e vlerësimit të seminarit/trajnimit
Formular i shkurtër me komente

Sa i kënaqur jeni ju me këtë seminar trajnues?

10 % 20% 30% 40% 50% 60 % 70% 80% 90% 100%

Aspektet më të vlefshme për mua ishin …

.....
.....
.....
.....
.....

Çfarë mund të ishte bërë ndryshe? Sugjerime për përmirësim

.....
.....
.....
.....
.....

Dy gjërat kryesore që kam mësuar nga trajnimi/seminari:

.....
.....
.....
.....
.....

Lutemi të plotësoni këtë formular përpara se të largoheni.
Faleminderit.

6 Reagimet sistemike (komplekse) dhe të integruara në mbrojtje të fëmijëve – shembuj

1. Lexo dy rastet e mëposhtme.
2. Përgatit një plan ndërhyrjeje për secilin nga rastet. Shkruaje në ditarin tënd për mbrojtjen e fëmijëve.
3. Vetëm atëherë kthe faqen dhe lexo shembullin e planit të veprimit në faqen tjetër. Krahaso planin tënd të veprimit, me rastin e dhënë. Përpiqu të vlerësosh çfarë veprimesh janë më të përshtatshme për këtë rast. Nuk ka përgjigje të saktë, apo të gabuar. Reagimet në mbrojtje të fëmijëve janë një mënyrë krijuese për zgjidhjen e problemit; janë të mundshme edhe ndërhyrje të tjera.

RASTI 1 **Mirela** është 13 vjeçe. Ajo humbi të atin para 4 vjetësh. E ëma duhet të punonte për të mbajtur familjen. Mirela dhe dy vëllezërit më të vegjël, njëri tetë vjeç dhe tjetri katër, nuk kanë të afërm ku të mbështeten. Për këtë arsye, Mirela duhet të merrte përgjegjësi në familje. Në shkollë shkonte vazhdimisht me vonesë, ikte shpesh nga mësimi dhe rrobat i kishte të vjetra. Niveli i saj ra shumë, por edhe sjellja e saj me shokët e shkollës ndryshoi tej mase.

Çfarë sjelljeje shfaq Mirela?
Ikën shpesh nga mësimi.
Vishet keq dhe i pëlqen të rrijë vetëm.
Është e zbehtë.
Vazhdon të mungojë shumë në shkollë.
Nuk është e kujdesshme.

Çfarë problemesh fshihen pas kësaj sjelljeje?
“Jam e pashpresë dhe jam e shqetësuar për vëllezërit. Ndjehem vetëm, askush nuk kujdeset për mua. Po e humbas shkollën, sepse duhet të ndihmoj mamin, ajo qan shpesh natën, duhet të kujdesem për ta.”

RASTI 2 **Agroni** është 15 vjeç. U kthye nga Greqia pas 9 muajsh, pasi kishte punuar në rrugët e Selanikut. Është shpesh agresiv dhe nxënësit e kanë frikë. Vitin e shkuar ishte shumë mirë, por tani niveli i tij ka rënë.

Çfarë sjellje shfaq Agroni?
Është bërë dembel dhe ka humbur interesin në studime. Është shpesh agresiv, i tremb nxënësit e tjerë dhe futet shpesh në telashe.

Çfarë problemesh fshihen pas kësaj sjelljeje?
"Të gjithë mendojnë se jam njeri i keq, nuk dua të zë shoqëri me asnjë. Askush nuk e kupton se çfarë kam kaluar."

Shembull ndërhyrjeje:
Zakonisht planet sistemike dhe shumëdimensionale të veprimit, janë më të vlefshme. Është e rëndësishme të krijohet lidhje logjike dhe të koordinohet me aktorë dhe veprime të ndryshme, sidomos kur janë të përfshirë ofruesit e shërbimeve shëndetësore dhe sektorëve të ndryshëm.

SHEMBULL: Mirela

AKSI A: Ndërhyrjet e përqendruara te fëmija

- × Përkrah pjesëmarrjen në aktivitete bazë zbavitëse dhe psiko-sociale të përshtatshme për moshën, brenda mjedisit të shkollës ku mund të jetë një 'fëmijë';
- × Kryej sesione individuale këshillimi, për të krijuar një "vizion optimist" për të ardhmen (Shtojca 2) me të, për të inkurajuar optimizmin rreth të ardhmes dhe vetëvlerësimit, zhvillimit të identitetit dhe vetëkonceptit.
- × Organizo aktivitete për të përforcuar lidhjen me shokët dhe për të zhvilluar shprehitë sociale, duke e angazhuar atë në aktivitetet e këshillit të nxënësve dhe/ose krijuar sistemin e "shoqërimit dysh".

AKSI B: Ndërhyrjet e përqendruara te mësuesi

- × Informo mësuesit për vështirësitë në familjen e fëmijës dhe krijo mirëkuptim për situatën;
- × Tregoju mësuesve mënyra të thjeshta se si të stimulojnë vetëvlerësimin dhe vetëbesimin e fëmijës;

- Caktoni bashkë me mësuesin një nxënës të zot, që mund të ndihmojë Mirelën të kapë orët e humbura.

AKSI C: Ndërhyrjet e përqendruara te prindërit

Vizitoni familjen e saj dhe mbështesni të ëmën të gjejë mbështetje ekonomike dhe komunitare.

Organizoni takime mujore koordinimi me drejtorin, mamanë dhe Mirelën, për të diskutuar arritjet.

SHEMBULL: Agroni

AKSI A: Ndërhyrjet e përqendruara te fëmija

- Ndihmoni Agronin të punojë mbi përvojën e vet dhe të zhvillojë një vizion optimist për të ardhmen e tij **(ANEKSI 6)**;
- Mbështet zhvillimin e shprehive sociale, duke e angazhuar në aktivitete sociale dhe duke i caktuar përgjegjësi në komunitetin e shkollës;
- Zhvillo aktivitetet sportive, për të çliruar agresivitetin dhe energjinë negative;
- Tregoji Agronit në sesionet individuale të këshillimit, teknika të thjeshta se si të përballet dhe rregullojë emocionet e t'i shprehë ato jodhunshëm, si të zgjidhë problemin;
- Praktiko me të lojërat me role dhe pasqyro analizimin e ndryshimit të perspektivës dhe shprehjen e ndjeshmërisë.

AKSI B: Ndërhyrjet e përqendruara te mësuesi

- Me mësuesin dhe Agronin, hartoni rregulla të sjelljes dhe pasojat për punën në klasë;
- Inkurajo mësuesit të punojnë në klasë për formimin e shprehive jetësore.

AKSI C: Ndërhyrjet e përqendruara te prindërit

- Me prindërit dhe Agronin, hartoni rregulla për sjelljen në familje dhe masat disiplinore;
- Diskutoni me prindërit shqetësimet në lidhje me adoleshencën (shiko **ANEKSIN 3**).
- Organizoni takime mujore koordinimi me drejtorin, mamanë dhe Agronin për të diskutuar ecurinë e tij.

7 Trajtimi i abuzimit të fëmijës me prindërit dhe mësuesit

1. Organizo një seminar për prindërit dhe/ose mësuesit mbi temën e abuzimit të fëmijës.
2. Përdor metodën e mëposhtme për të prezantuar temën e trajnimit.
   a. Kërko nga të gjithë pjesëmarrësit të plotësojnë tabelën në mënyrë individuale.
   b. Vendos në çdo cep të dhomës ndonjë shenjë, për shembull: shumë dakord, dakord, nuk jam dakord, nuk jam fare dakord.
   c. Lexo pyetjen e parë dhe kërkoju pjesëmarrësve të vendosen pranë shenjës që i korrespondon përgjigjes së tyre.
   d. Pyeti grupet e ndryshme të thonë pse e vendosën veten nën shenjën e dhënë. Kërko respektimin e opinionit dhe përpiqu të gjesh një temë që të vazhdojë diskutimin.
   e. Përsërit të njëjtën gjë në tabelë ose për ato pika që janë interesante për grupin që synon.
3. Vlerëso sesionin.

Lexo shprehjet e mëposhtme. Shëno kutinë që përshkruan më mirë ndjenjat e tua: shumë dakord, dakord, nuk jam dakord, nuk jam fare dakord.

	SHUMË DAKORT	DAKORT	JO DAKORT	ASPAK DAKORT
1 Rrahja e fëmijës është e gabuar dhe është një formë e abuzimit të fëmijës				
2 Abuzimi seksual nuk është një problem në këtë vend				
3 Të rrahësh fëmijën është një mënyrë e mirë për disiplinimin e tyre në shkollë				

		SHUMË DAKORT	DAKORT	JO DAKORT	ASPAK DAKORT
4	Raportimi i abuzimit mund të përkeqësojë situatën, kështu që është mirë të mos ndërhyjmë				
5	Është më e mundshme të abuzohet te fëmijët e paaftë, sesa te fëmijët normalë				
6	Nuk ka një sistem ligjor të drejtë, kështu që nuk ia vlen të raportojmë asgjë				
7	Nuk kam besim se policia mund të bëjë ndonjë gjë këtu				
8	Personeli që punësohet në punë me fëmijët, zor se mund të abuzojë mbi ta				
9	Fëmijët shpesh trillojnë histori sikur abuzohen				
10	Fëmijët nuk mund të abuzohen seksualisht				
11	Një drejtues i besueshëm nuk mund të abuzojë me një fëmijë				
12	Abuzohet vetëm me fëmijët meshkuj, vajzat janë më të sigurta				
13	Është e pranueshme që një vajzë 14 vjeçe të martohet, meqenëse partneri i saj punon dhe mund t'i sigurojë asaj kushte të mira jetese				
14	Është gjë e mirë në këtë vend që fëmijët të punojnë si shërbyes, në vend që të shkojnë në shkollë; anëtarët e familjes së tyre janë të varur nga fëmijët për sigurimin e ushqimit				
15	Që të mund të sigurojnë jetesën, vajzat e zonave rurale të moshës 12 vjeçare dërgohen në qytet për të fituar para nëpërmjet prostitucionit				

8 Të flasësh me prindërit dhe mësuesit për praktikat abuzive

1. Organizo një seminar me prindërit dhe/ose mësuesit për të folur mbi praktikat abuzive dhe të reflektosh me ta se si mund të zëvendësohen nga masa pozitive edukative.
2. Prezanto një temë, pjesëmarrësit të reflektojnë dy e nga dy se çfarë praktikash abuzive janë më të përhapura. Bëj një listë.
3. Prezanto teori dhe koncepte që lidhen me ndikimin negativ të praktikave abuzive.
4. Ndaji pjesëmarrësit në grupe dyshe. Kërko nga pjesëmarrësit të reflektojnë se cilat janë shkaqet e secilës praktikë abuzive dhe se si mund të zëvendësohet nga një masë më pozitive edukative. Caktoi secilit grup një praktikë abuzive.

Ka vende bosh poshtë, ku ju të mund të shtoni praktika abuzive që lidhen me situatën në vendin tuaj.

PRAKTIKA ABUZIVE

- × T'i bërtasësh një fëmije
- × Të trajtosh fëmijën me përbuzje
- × Të presësh përfitime seksuale
- × Të detyrosh fëmijën të qëndrojë në këmbë
- × Të mos i dërgosh vajzat në shkollë
- × Të lesh një fëmijë pa mbikqyrje
- × Të injorosh një fëmijë të paaftë
- × T'i detyrosh fëmijët të lypin
- × T'i bërtasësh një fëmije
- × Të kritikosh padrejtësisht një fëmijë
- × Të godasësh për të disiplinuar një fëmijë
- × Të injorosh një fëmijë
- × Të dërgosh fëmijën në punë
- × Të martosh një fëmijë
- × Të abuzosh seksualisht me një fëmijë
- × Të martohesh me një fëmijë
- × Të dërgosh fëmijët të punojnë
- × Të kritikosh padrejtësisht një fëmijë

5 Bëj të njëjtin ushtrim për shprehjen e dashurisë dhe të mbështetjes ndaj një fëmije. Gjej ide me një grup për shenjat konkrete dhe të veçanta të sjelljes dhe plotëso listën e mëposhtme. Sidomos prindërit që e kanë përjetuar vetë abuzimin, mund të mos dinë si t'ia shprehin dashurinë një fëmije në mënyrë pozitive.

T'I SHPREHËSH DASHURINË NJË FËMIJE

- × Prekje të ngrohta
- × Përqafo fëmijën
- × Bëj komplimenta
- × Inkurajo
- × Bëji pyetje për jetën, trego interes
- × Organizo një aktivitet që atij/asaj i pëlqen
- × Lëre fëmijën të zgjedhë
- × Gatuaj ushqimin e preferuar
- × Buzëqeshi fëmijës
- × Shtrëngoji duart, përqafoje

Seksioni C

Anekset

Lista e anekseve

ANEKSI 1	Raporti i mbrojtjes së fëmijëve **(INTRUMENTI 1)**	298
ANEKSI 2	Fletë bashkëshoqëruese për ndjekjen individuale të fëmijës nga mësuesit **(INTRUMENTI 2)**	305
ANEKSI 3	Fletë bashkëshoqëruese për ndjekjen individuale të fëmijës në vizitat në familje **(INTRUMENTI 3)**	307
ANEKSI 4	Lista e pyetjeve për shëndetin mendor	309
ANEKSI 5	Listë kontrolli për sjelljet e fëmijëve të moshës 6 deri në 18 vjeç	311
ANEKSI 6	Krijimi i një vizioni optimist për të ardhmen	315
ANEKSI 7	Fazat e zhvillimit të fëmijës	318
ANEKSI 8	Vizatimi, si një mjet për sesionet e këshillimit	323
ANEKSI 9	Shembull formulari për të marrë miratimin e prindërve	326
ANEKSI 10	Lista e shqetësimeve të prindërve për fëmijët 6 deri në 12 vjeç	328
ANEKSI 11	Lista e shqetësimeve të prindërve për fëmijët 12 deri 18 vjeç (adoleshentët)	339

1 Raporti për Mbrojtjen e Fëmijës – privat dhe konfidencial

(Intrumenti 1)

NUMRI I RASTIT: .....

1.1 Informacion i përgjithshëm

Emri dhe vendndodhja e SMF-së, i cili e plotësoi këtë raport (menaxheri parësor i rastit):

EMRI	.....
SHKOLLA	.....

Kush e raportoi këtë incident?

- ◌ Fëmijëve u jepen përgjegjësi specifike dhe luajnë një rol aktiv në animimin e aktivitetit
- ◌ Fëmija (i interesuar)
- ◌ Shokë
- ◌ Personeli pedagogjik, mësues, drejtor etj.
- ◌ Anëtar komuniteti
- ◌ Mjeku ose personel tjetër shëndetësor
- ◌ Polici i shkollës
- ◌ Prindërit ose anëtarët e komitetit të prindërve
- ◌ Specialisti për Mbrojtjen e Fëmijëve
- ◌ Tjetër: .....

Detajet e personit që raportoi – kush ju tregoi për këtë çështje?

EMRI	.....
MOSHA	.....
GJINIA	.....
SHTËPIA/VENDI I PUNËS	.....
EMRI I SHKOLLËS	.....

A DËSHIRON TË MBETET ANONIM PERSONI QË RAPORTOI: PO ◌ JO ◌

Emri i fëmijës

EMRI	.....
MOSHA	.....
GJINIA	.....
VENDNDODHJA	.....

A E KA DHËNË FËMIJA MIRATIMIN PËR TË PLOTËSUAR KËTË FORMULAR?:
PO ◌ JO ◌

Detaje të prindërve

EMRI I NËNËS	.....
VENDNDODHJA E NËNËS	.....
EMRI I BABAIT	.....
VENDNDODHJA E BABAIT	.....
ME KË JETON FËMIJA?	LIDHJA: .....
	ADRESA: .....

JANË NË DIJENI PRINDËRIT E FËMIJËS PËR RAPORTIMIN E RASTIT?: PO ◌ JO ◌

Siguria e menjëhershme e fëmijës

KU ËSHTË FËMIJA TANI?	.....
ME KË ËSHTË FËMIJA?	.....

ËSHTË FËMIJA NË VEND TË SIGURTË? PO ◌ JO ◌

ËSHTË KËRCËNUAR FËMIJA APO FAMILJA? PO ◌ JO ◌

Nevojat e menjëhershme mendore, fizike dhe sociale të fëmijës

- × Probleme shëndetësore: PO ◌ JO ◌
- × Nëse po, çfarë?
- × Është informuar familja për trajtimet e disponueshme mjekësore? PO ◌ JO ◌
- × Nëse po, ka kërkuar fëmija ndihmë mjekësore? PO ◌ JO ◌
- × Nëse po, kush ia dha trajtimin? Cila është diagnoza dhe prognoza?
- × Dëmtime aktuale: PO ◌ JO ◌
- × Gjendja fizike e fëmijës (të prera, të nxira, gërvishtje etj.): PO ◌ JO ◌
- × Nevojat shoqërore të fëmijës: PO ◌ JO ◌
- × Nëse po, çfarë (përshkruaj): PO ◌ JO ◌
- × Nevojat psiko-sociale: PO ◌ JO ◌
- × Nëse po, përshkruaj: PO ◌ JO ◌
- × Persona të tjerë të përfshirë në problemin e mbrojtjes së fëmijës

EMRI .....

MOSHA .....

VENDNDODHJA .....

LIDHJA ME FËMIJËN: BABAI, NËNA, VËLLAI, MOTRA, FQINJI, I HUAJ, MIK, I AFËRM (RENDITI) ..... **TJETËR** .....

Vlerësimi i rrezikut: Çështjet e identifikuara të mbrojtjes sipas përparësisë dhe nivelit të rrezikut:

ÇËSHTJA E MBROJTJES (S): Niveli i rrezikut nga 1 te 4
.....
.....
.....

1 **(ÇËSHTJA PARËSORE)** .....
2 **(ÇËSHTJA DYTËSORE)** .....
3 .....

× I duhej referuar policisë kjo çështje? **PO** ◌ **JO** ◌

× I duhej referuar Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve kjo çështje? **PO** ◌ **JO** ◌

× Nëse po, ka kërkuar fëmija ndihmë mjekësore? **PO** ◌ **JO** ◌

× I duhej referuar spitalit? **PO** ◌ **JO** ◌

× Ndonjë autoriteti tjetër? **PO** ◌ **JO** ◌

× Kujt? .....

Kjo pjesë është lënë bosh që ju të shënoni detaje të tjera për raportin. Kjo mund të përfshijë, por jo të kufizohet vetëm në përshkrimet fizike të lëndimeve, paraqitjen e përgjithshme fizike të fëmijës gjatë raportimit, komente të bëra nga palët e interesuar dhe fëmija.

Mos harroni të shënoni:

- × Datën dhe orën e veprimit.
- × Me kë fole dhe një vendndodhje për kontakte të mëtejshme.
- × Numra telefoni.
- × Emri i agjencisë së referimit dhe emër kontakti.
- × Veprimet që kryen.
- × Rekomandimet që bën dhe pse?

Raportet për mbrojtjen e fëmijëve u morën nga Koordinatori i Psikologut

DATA …….. **FIRMA** ……..

1.2 Intrumenti për monitorimin e vazhdueshëm të rastit (ndjekja)

Ndjekja (Informacion, ndryshime, ecuria, ngjarje specifike, veprime të ndërmarra, etj.)

DATA: ……..
VEPRIMI: ……..
NGA KUSH: ……..

1.3 Rishikimi i kësaj dosjeje në takimet e menaxhimit të rastit me mbikëqyrësin:

DATA	REZULTATET/QËLLIMET E ARRITURA	HAPAT E ARDHSHËM
.....	.....	.....
.....	.....	.....
.....	.....	.....

1.4 Mbyllja e rastit

OBJEKTIVAT E PLANIT TË VEPRIMIT	TREGUES	PËRSHKRUAJ SHKURTIMISHT FUSHAT KU PATI PËRMIRËSIME/ARRITJET
.....	.....	.....
.....	.....	.....
.....	.....	.....

Miratuar nga **KOORDINATORI I PSIKOLOGUT**

.....

FIRMOSUR: .....

2 Ndjekja individuale e fëmijës nga mësuesit

(Intrumenti 2)

NUMRI I RASTIT: .....

SHKOLLA	.....
VENDNDODHJA	.....

Emri i personelit pedagogjik:

EMRI I FËMIJËS	.....
MOSHA	.....
GJINIA	M ◌ F ◌

DATA DHE ORA E VËZHGIMIT: .....

Cili është qëndrimi/vështirësitë e fëmijës gjatë aktiviteteve?

- ◌ Agresivitet
- ◌ I izoluar/s'ka kontakt me fëmijë të tjerë
- ◌ Kontakt të vështirë me fëmijët e tjerë
- ◌ Shumë aktiv-nuk është i përqerndruar
- ◌ Shumë i turpshëm
- ◌ I trishtuar, melankolik
- ◌ Shumë i lidhur me të rriturit
- ◌ I pasjellshëm/nuk dëgjon kurrë të rriturit
- ◌ Mungesa/mospjesëmarrje në aktivitete
- ◌ Tjetër: .....

Shto detaje mbi qëndrimin e fëmijës/vështirësitë (nëse është e nevojshme)

.....
.....
.....
.....
.....

Mënyra e sugjeruar/strategjia për të ndihmuar fëmijën në shkollë (objektivat e mbështetjes):

.....
.....
.....
.....

DATA ..... **FIRMA** .....

3 Ndjekja individuale e fëmijës në vizitat në familje

(Intrumenti 3)

Emri i personelit pedagogjik:

EMRI I FËMIJËS	.....
MOSHA	.....
GJINIA	**M** ◌ **F** ◌
PRINDËRIT E PRANISHËM	**MAMAJA** ◌ **BABAI** ◌

DATA DHE KOHA E VIZITËS NË FAMILJE: .....

Cili është qëndrimi/vështirësitë e fëmijës në shtëpi?

- ◌ Agresivitet
- ◌ I izoluar/s'ka kontakt me fëmijë të tjerë
- ◌ Kontakt të vështirë me fëmijët e tjerë
- ◌ Shumë aktiv-nuk është i përqendruar
- ◌ Shumë i turpshëm
- ◌ I trishtuar, në melankolik
- ◌ Shumë i lidhur me prindërit
- ◌ I pasjellshëm/nuk dëgjon kurrë të rriturit
- ◌ Probleme me gjumin
- ◌ Ndryshime të sjelljes
- ◌ Probleme me të ngrënin dhe kujdesin personal
- ◌ Tjetër: .....

Shto detaje mbi qëndrimin e fëmijës/vështirësitë (nëse është e nevojshme)

.....
.....
.....
.....
.....

Mënyra e sugjeruar/strategjia për të ndihmuar fëmijën në shtëpi (objektivat e mbështetjes)

.....
.....
.....
.....

DATA ..... **FIRMA E PRINDËRVE:** .....

4 Lista e pyetjeve për shëndetin mendor

1 Ka probleme me gjumin fëmija? Nëse po …

- × Vështirësi për të fjetur
- × Zgjohet gjatë natës
- × Makthe/ëndrra të këqija
- × Laget në shtrat
- × Ka frikë të shkojë në shtrat
- × Ka frikë të flejë vetëm

2 A shfaq fëmija ndryshime/diferenca në sjellje? Nëse po …

- × Inat ose agresion ndaj të tjerëve
- × Agresiv ndaj vetes (dëmton veten)
- × Frikë të madhe nga situatat normale/njerëzit
- × I tërhequr/i turpshëm me të tjerët
- × Shpesh i trishtuar/qan
- × Mungesë interesi në aktivitetet e mëparshme zbavitëse
- × Mungesë interesi në aktivitetet edukative
- × Vështirësi në përqendrim
- × Vështirësi me kujtesën
- × Sjellje të çuditshme/të papërshtatshme

3 A ka probleme fëmija me kujdesin ndaj vetes, duke përfshirë edhe të ngrënin?

- × Mungesë urie
- × Shumë pak interes për pamjen/veshjen
- × Shumë pak interes për t'u larë
- × Higjenë e keqe personale

4 **A shfaq fëmija sjellje të shumta fëminore?**
- × Frikë të rrijë vetëm
- × Dëshiron të jetë gjithë kohën me prindin ose anëtarët e familjes
- × Probleme me kontrollin e emocioneve (si, shpërthime inati)
- × Xhelozi të madhe për të tjerët
- × Kërkon gjithë kohën vëmendjen e të tjerëve.

Kjo është një listë me pyetje që SMF-ja mund të përdorë kur bën vizita në familje. Ideja është që të bëhet pyetja e përgjithshme dhe nëse nuk ka probleme, të kalohet te pyetja tjetër. Nëse rezulton se Po, SMF-ja mund të bëjë pyetje dhe të përdorë edhe pikat e sipërpërmendura për të marrë informacion të mëtejshëm. Ky informacion shkruhet në fletët bashkëshoqëruese për familjen. Nëse identifikohen 3 ose 4 probleme, atëherë informacioni u kalon dhe të tjerëve. Shumë fëmijë mund të kenë pakësuar interesin për shkollën, etj, por zakonisht janë disa shenja që mund të vënë në dukje praninë e një problemi të shëndetit mendor (ankth, melankoli, çrregullimet psiko-somatike apo dhe psikozat).

Kujdes!
- × Mos u ngut të stigmatizosh fëmijën, duke i vënë një diagnozë!
- × Referoju standardeve të zhvillimit të fëmijës vetëm si udhëzime! Çdo fëmijë është unik dhe zhvillohet në ritmin e vet.
- × Përpiqu të kuptosh zhvillimin e fëmijës, duke u nisur nga historia e jetës së tij.

5 Listë kontrolli për sjelljet e fëmijëve të moshës 6-18 vjeç

1 Kryen sjellje të një moshe më të vogël, krahasuar me moshën që ka
2 Bën shumë zhurmë
3 Argumenton shumë
4 Dështon në përfundimin e gjërave që fillon
5 Nuk gjen shumë kënaqësi
6 Shpërfillës, ia kthen fjalën vazhdimisht personelit edukativ
7 Mburret, lavdërohet vazhdimisht
8 Nuk përqendrohet, nuk përqendron vëmendjen për shumë kohë
9 Nuk mund të heqë nga mendja mendime të caktuara; ka obsesione (përshkruaj…)
10 Nuk ulet në një vend, nuk i zë vendi vend, është shumë hiperaktiv
11 Ngjitet pas të rriturve, është shumë i varur prej tyre
12 Qahet se është i vetmuar
13 Është shumë konfuz
14 Qan shumë
15 Shprehet i shqetësuar, nervoz
16 Është shumë mizor ose shfaq ligësi ndaj të tjerëve
17 Fantazon gjatë ditës ose humbet në mendimet e tij
18 Dëmton e kërcënon veten shpesh ose shfaq përpjekje të vetëvrasjes

19 Kërkon shumë vëmendje
20 Shkatërron gjërat e tij/ të saj
21 Shkatërron gjërat që janë pronë e tjerëve
22 Shfaq vështirësi në ndjekjen e udhëzimeve
23 I pabindur në shkollë
24 Shqetëson nxënësit e tjerë
25 Nuk përparon me rimtin e nxënësve të tjerë
26 Nuk ndihet fajtor pas kryerjes së një sjelljeje jokorrekte
27 Bëhet shpejt xheloz
28 Thyen rregullat e shkollës
29 Ka frikë kafshët, situata ose vende të caktuara, përveç shkollës (përshkruaj …)
30 Ka frikë të shkojë në shkollë
31 Ka frikë se mendon gabim ose bën diçka gabim
32 Ndjen se duhet të jetë i përkryer
33 Ndjen ose shpreh se askush nuk e do
34 Ndjen se ka persona që duan ta kapin
35 Ndihet i pavlefshëm ose inferior
36 Vritet shpesh, i ndodhin shpesh aksidente
37 Përfshihet në shumë zënka/grindje
38 Përlotet shpesh
39 Shoqërohet me individë të tjerë, të cilët përfshihen në akte josociale
40 Dëgjon tinguj dhe zëra që nuk ekzistojnë (përshkruaj…)
41 Është shumë impulsiv ose vepron pa menduar
42 Pëlqen më shumë të qëndrojë vetëm, sesa në shoqërinë e të tjerëve
43 Gënjen ose mashtron
44 Kafshon thonjtë
45 Nervoz, i tensionuar
46 Lëvizje nervoze ose shfaq lëvizje të papritura të pakontrolluara të pjesëve të ndryshme të trupit (përshkruaj…)
47 Respekton rregullat më shumë se ç'duhet
48 Nuk pëlqehet nga të tjerët
49 Ka vështirësi në të mësuar
50 Është shumë i frikësuar ose ndjen ankth
51 Ndihet se përton ose sikur mezi shtyhet
52 Ndihet shumë fajtor
53 Flet pa radhë
54 Ndihet i tejlodhur pa ndonjë arsye të veçantë

55 Është nën peshë
56 Probleme fizike pa ndonjë shkak mjekësor:
- a Dhimbje (në stomak ose në kokë)
- b Dhimbje koke
- c I përzihet, ndihet i sëmurë
- d Probleme me sytë (nëse nuk janë shëruar edhe pas vendosjes së syzeve), përshkruaj …
- e Alergji/puçrra ose probleme të tjera të lëkurës
- f Dhimbje stomaku
- g Vjellje
- h Të tjera, përshkruaj …

57 Sulmon të tjerët fizikisht
58 Kap hundën, lëkurën ose pjesë të tjera të trupit, përshkruaj…
59 Fle gjatë aktiviteteve
60 Ndihet apatik ose jo i motivuar
61 Paraqitje të dobët
62 Koordinim të varfër muskulor ose i ngathët
63 Preferon të qëndrojë me fëmijë më të rritur ose më të vegjël se mosha e tij
64 Preferon të qëndrojë me fëmijë më të vegjël se mosha e tij
65 Refuzon të flasë
66 Përsërit veprime të caktuara në vazhdimësi, kompulsione (përshkruaj …)
67 Prish disiplinën e klasës
68 Qan shumë
69 I fshehtë, i ruan gjërat për vete
70 Shikon gjëra që nuk ekzistojnë, përshkruaj…
71 Shumë i vetëndërgjegjshëm ose turpërohet lehtë
72 I rrëmujshëm
73 Sillet në mënyrë të papërgjegjshme (përshkruaj…)
74 Mburravec/sillet si klloun
75 Shumë i turpshëm
76 Shfaq sjellje të paparashikuara, shpërthyese
77 Kërkesat duhet t'i plotësohen menjëherë, mërzitet lehtë
78 Jo i vëmendshëm ose shpërqendrohet lehtë
79 Probleme të të folurit, përshkruaj …
80 Vështrim i hutuar/i zbrazët
81 Lëndohet shpejt kur kritikohet

82 Vjedh gjëra të ndryshme
83 Mbledh shumë gjëra të panevojshme (përshkruaj …)
84 Sjellje të çuditshme, përshkruaj …
85 Ide të çuditshme, përshkruaj …
86 Kokëfortë, i vrazhdë ose i irrituar
87 Ndryshime të papritura në gjendjen e humorit ose të ndjenjave
88 Bëhet i zymtë shumë shpejt
89 Dyshues
90 Sjellje të pahijshme
91 Flet shpesh se do të vrasë veten
92 Është nën nivelin e duhur, nuk punon për të rritur potencialin e tij
93 Flet shumë
94 Qan shpesh
95 Gjaknxehtë
96 Ndihet i shqetësuar lidhur me çështjet e seksit
97 Kërcënon individë
98 Vjen me vonesë në shkollë ose në klasë
99 Pi duhan
100 Dështon në arritjen e detyrave që i janë caktuar
101 Largime nga mësimi ose mungesa të pajustifikuara
102 Jo shumë aktiv, lëvizje të ngadalta ose humbje të energjisë
103 Jo i lumtur, i trishtuar ose melankolik
104 Shfaqet i zhurmshëm
105 Përdor drogë për qëllime jomjekësore (mos përfshij duhanin), përshkruaj …
106 Përjeton ankth të tepërt
107 Nuk e pëlqen shkollën
108 Ka frikë se mos bëjë gabime
109 Ankohet gjithmonë
110 Një paraqitje të jashtme personale jo të pastër
111 I tërhequr, nuk përfshihet me të tjerët
112 Shqetësohet
113 Ju lutemi, të shkruani ndonjë problem tjetër që fëmija mund të ketë dhe nuk është në listën e mësipërme: ……..

6 Krijimi i një vizioni optimist për të ardhmen

DOSJA INDIVIDUALE E FËMIJËS	.....
EMRI I FËMIJËS	.....
DATA	.....
EMRI I SMF-SË:	.....
VENDI:	.....

Vizioni i fëmijës për jetën e tij
Marrëdhëniet e ndryshme të fëmijës

Shembulli i simboleve[1]:

× Marrëdhënie të rregullta
× Marrëdhënie të forta
× Marrëdhënie të distancuara
× Marrëdhënie konfliktuale
× Marrëdhie referimi/modeli i roleve

1 Simbolet mund të përcaktohen nga fëmijët dhe adoleshentët e projektit, ndaj nuk është e nevojshme të jenë të njëjta për të gjithë fëmijët.

Aktivitetet e fëmijës:

AKTIVITETI	KU	KUR DHE SA	NDJENJAT QË PËRJETON FËMIJA KUR BËN AKTIVITETIN* OSE RËNDËSIA QË FËMIJA I JEP AKTIVITETIT**
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....
.....	.....	.....	.....

* Të njëjtat simbole mund të përdoren, vizatime ose materiale
Trego me / ** aktivitetet që fëmija quan të rëndësishme

Identiteti

SI E SHIKOJ VETEN?

SI MË SHIKOJNË TË TJERËT?

7 Fazat e zhvillimit të fëmijës

MOSHA	ZONA E FUNKSIONIT	FAZA
0–2 muajsh	**Fizike**	Aktivitete të thjeshta reflektive (thithja/kapje me dorë)
2–4 muajsh	**Fizike/mendore**	Sjellja ndodh në sekuenca
	Social/ emocionale	Fillon t'u buzëqeshë njerëzve
4–8 muajsh	**Fizike/mendore**	Sjelljet përdoren për të shkaktuar një reagim (godasin një send për ta lëvizur)
8–12 muajsh	**Fizike/mendore**	Më shumë sjellje të qëllimshme (që synojnë diçka specifike)
1–2 vjeç	**Sociale/ emocionale**	Kalimi nga varësia totale në një pavarësi të thjeshtë
		Fëmijët janë të orientuar kryesisht drejt prindërve
		Mëson të zbulojë mjedisin
		Krijon lidhje të forta me prindërit
2 vjeç	**Sociale/ emocionale**	Të mësuarit si ta shohësh veten një qenie të ndarë nga të tjerët (qenie më vete)
		Thotë shpesh "jo"
		Mund të luajë me të tjerët, por nuk shkëmben gjëra
		Mendon se të tjerët mund t'ia lexojnë mendjen
		Të kuptuarit e botës është një përzierje e reales dhe imagjinares
		Nuk bën dallim midis gjërave që janë të gjalla dhe jo të gjalla

MOSHA	ZONA E FUNKSIONIT	FAZA
		Nuk mund ta shohë situatën nga këndvështrimi i të tjerëve/s'ka ndryshim perspektive
		E ka të vështirë të presë: Nuk mund të kontrollojë impulset
	Fizike	Mëson të ngjisë shkallët
		Fillon të vishet vetë
	Gjuha	Mund të përmendë shumë objekte
		Mund të thotë fjali të shkurtra
		Mund të ndjekë udhëzimet e thjeshta
3–4 vjeç	**Sociale/ emocionale**	Mëson se të tjerët kanë ndjenja/tregon ndjeshmëri
		Mund të presë për periudha të shkurtra kohe
		Mund të ketë frikë normale nga errësira, zhurma, etj
		Ka nevojë për batanije ose lodër të preferuar kur është larg shtëpisë
		Nuk e kupton që gjinia është e përhershme
	Fizike/aftësitë motorike	Mund të mbërthejë kopsat
		Mban laps ose stilolaps
		Rrotullon ose bën shuk topin
		Ngjit shkallët ose pemët
	Gjuha	Flet më qartë, por ndonjëherë flet si bebe
		Di rreth 1200 fjalë
		Mund të pyesë kush, çfarë, ku, pse?
	Sjellja	Ka qejf të pikturojë ose vizatojë
		Ka qejf t'i dëgjojë disa herë historitë
		Ka nevojë të paralajmërohet, kur ka një ndryshim aktiviteti
		Pëlqen librat me figura
5–6 vjeç	**Sociale/ emocionale**	Bashkëpunues dhe i gjindshëm
		Mund të mendojë vetëm për një subjekt
		Bëhet kokëfortë

MOSHA	ZONA E FUNKSIONIT	FAZA
		Qan kur i tërheq veshin
		Më pak frikacak se kur ishte 4 vjeç, por sheh shumë ëndrra
		Kurioz për bebet
		Luan me shokët, ka shpesh shokë të ngushtë
		Mer rolin e drejtuesit ose zihet me shokë
	Fizike	Më i koordinuar, ngjitet, vrapon etj,
		Ka ende nevojë për të bërë gati dhe për të sistemuar gjërat që i takojnë
		Mund të tregojë nëse përdor dorën e majtë apo të djathtë
	Mendore	Mund të fillojë të njohë shkronjat
		Përmirëson numërimin
		Nuk e thotë me saktësi kohën
		Fillon të kuptojë se njerëz të ndryshëm, kanë vlera të ndryshme
		Mund të rrijë larg shtëpisë për pak kohë
		Fillon t'i kushtojë rëndësi rregullave
		Do të jetë i mirë, thotë se është i rëndësishëm
6–9 vjeç	**Sociale/ emocionale**	Shumë i ndërgjegjshëm për rregullat, porositë
		Më i orientuar nga pikëpamja sociale
		Dëshirë e madhe për të t'u përshtatur dhe për të bërë diçka me të tjerët
		Ende nuk e ka konceptimin e të rriturve çfarë është e drejtë ose e gabuar
	Mendore	Fillon të jetë në gjendje të bëjë plane
		Fillon të shpjegojë shkakun dhe ndikimin
		I lexon vetes
		Nuk është në gjendje të përballojë shqetësimet e të rriturve

Aneksi 7

MOSHA	ZONA E FUNKSIONIT	FAZA
	Fizike	Vrapon, hidhet, rrëshket, godet topin, lëkundet
		Ka nevojë për 10 orë gjumë/natën
		Ka vështirësi të rrijë ulur më shumë se 20 minuta
10–12 vjeç	**Sociale/ emocionale**	Është i vetëdijshëm se bota është një vend i komplikuar
		Mund të bëhet më konkurues
		Mund të kënaqet nga të qenit anëtar i një klubi ose grupi shokësh
		Ka frikë nga ndryshimi i gjërave imagjinare në shkollë, shokët, etj.
		Bëhet më i pavarur
	Fizike	Koordinim i përmirësuar
	Mendore	Mendon më shumë për të ardhmen
		Fillojë të arsyetojë, të shohë botën si diçka më të madhe, të jetë i interesuar për universin dhe arsyet për ekzistencë
12–15 vjeç	**Sociale/ emocionale**	Periudhë e një ndryshimi të shpejtë
		Ankth për mbarimin e fëmijërisë dhe afrimin e moshës së rritur
		Mund të “testojë” prindërit ndonjëherë
		Grupet e moshatarëve janë shumë të rëndësishme
		Mund të ketë shumë ndryshime humori
		Ndonjëherë mund të jetë i tërhequr
		Mund të jetë shumë nervoz rreth ndryshimeve fizike
		Ecin më mirë nëse u thua një fjalë për gjërat nga të cilat ndikohen

MOSHA	ZONA E FUNKSIONIT	FAZA
	Mendore	Mund të arsyetojë në mënyrë abstrakte, ka një botëkuptim shumë të sofistikuar për botën Mund të jetë shumë i orientuar ndaj shkaqeve Mund të jetë impulsiv dhe t'u futet rreziqeve të panevojshme

UDHËZIME: Momentet e sipërshënuara, mund të përdoren si pikë referimi për të vlerësuar fazat e zhvillimit. Mbani mend: Treguesit e zhvillimit të moshave, nuk duhen parë në mënyrë shumë të ngushtë. Mund të ketë shumë variacione. Fëmijët nuk zhvillohen në mënyrë të njëkohshme në të gjitha aspektet.

8 Vizatimi si një mjet për sesionet e këshillimit

Kërkoji fëmijës të vizatojë. Duhet t'i lejosh çfarëdo që të kenë në mendje ose jepu një temë. Kjo mund të bëhet në sesione individuale këshillimi ose në grupe të vegjël me fëmijë, të cilët kanë nevojë për vëmendje të veçantë.

Pyetjet që mund t'i bësh për të inkurajuar fëmijën të shprehet:

- × Më trego për vizatimin tënd.
- × Çfarë ka ndodhur këtu?
- × Kush është në këtë vizatim?
- × Ku je ti në këtë vizatim?
- × Si ndjeheshe atëherë?
- × Si ndjehesh tani?

Mos jep interpretimin tënd për vizatimin, lejoje fëmijën të shprehet. Prano vlerat e mendimeve të tyre, ndjenjave dhe përvojave dhe trego vlerësim që ata e ndanë këtë me ty (ose të tjerët). Pyet nëse nuk kupton ndonjë gjë. Mos pretendo që fëmijët të kenë të njëjtat mendime dhe ndjenja si ty.

Ky ushtrim mund të bëhet me shkrim, vizatim, kërcim ose drama për të ndihmuar fëmijët të shprehen, të paktën një herë në jetën e tyre, për situatat më të vështira që kanë kaluar. Mund t'i ndihmojë të shprehen dhe të gjejnë një botëkuptim të ri. Mesazhi i këtij ushtrimi me katër sesione është:

- Megjithëse po kalon një situatë të vështirë, mund të sjellësh në mend gjërat e mira që ndodhin përreth teje.
- Edhe pse situata e vështirë mund të jetë problemi kryesor në mendimet dhe ndjenjat e tua, ti mund të kesh nevojë për ndihmë, që të mund të shohësh edhe gjërat e mira, që janë gjithashtu të pranishme në jetën tënde.
- Një pjesë tjetër e rëndësishme e këtij ushtrimi, është që t'u kërkosh fëmijëve të identifikojnë dhe të shprehin dëshirat dhe planet për të ardhmen. Kjo ndihmon për të rifituar shpresën, për t'i dhënë kuptim jetës dhe një drejtim për ta ndjekur.
- Të parit e vazhdimësisë së jetës, e ndihmon dikë të mos ngecë në një situatë të vështirë, që shoqërohet zakonisht me depresion dhe zemërim. Një situatë e dhimbshme, është vetëm një pjesë e jetës, por jo e gjithë jeta. Ju mund të zbuloni se fëmijët kanë ngecur në një situatë të vështirë. Ju mund t'i ndihmoni ata të rimarin veten, duke i udhëzuar që t'i shohin gjërat në një mënyrë të re.

SESIONI 1: Gjej kohë gjatë sesioneve për të folur për të kaluarën. Kërkoi fëmijëve të shprehin se si ka qenë jeta e tyre në të kaluarën, çfarë gjërash të mira kishte. Mund të diskutosh në klasë, ti bësh të vizatojnë, shkruajnë, kërcejnë, ose këndojnë, sipas ndjenjave dhe mendimeve të tyre. Mund të vësh re se disa fëmijë kanë gjëra të hidhura nga e kaluara. Kjo është koha kur mund të kuptoni gjithçka që ata kanë trashëguar nga e kaluara dhe të vini në dukje se të këqijat e kaluara, tregojnë se ata kanë qenë në gjendje për t'i përballuar vështirësitë dhe të mbijetonin. Aftësia e tyre për të përballuar të kaluarën, është një pikë e fortë për të përballuar edhe me vështirësitë aktuale.

SESIONI 2: Në vazhdim në sesionin tjetër, pyeti për situatat më të vështira të jetës. Kërkoju të vizatojnë, shkruajnë, kërcejnë, ose këndojnë sipas ndjenjave dhe mendimeve të tyre. Kjo mund të jetë një pjesë emocionuese për një fëmijë që mund t'i kujtojë gjëra të dhimbshme. Ndihmoji të shprehen se çfarë duan të bëjnë për këto raste dhe bëjuani të ditur se nuk janë vetëm në dhimbjen dhe trishtimin e tyre.

SESIONI 3: Në një tjetër sesion, kërkoi që fëmijët të diskutojnë për të tashmen. Si ndjehen për situatat që janë tani. Cilat janë anët pozitive? Disa prej tyre mund të shikojnë vetëm ato negative (varfërinë, divorcin e

prindërve, humbjen e prindërve, etj,). Lejoji të shprehen dhe tregoju se i kupton. Më pas, ndihmoji të mendojnë diçka pozitive: shokët, të afërmit, shkollën, kishën, anët pozitive të gjithësecilit, etj. (Një nxënës mund të japë një shembull specifik, si për shembull, i ati i ka vdekur dhe tani jeton me gjyshen, gjë që nuk e kupton.) Dëgjo historinë e tij dhe ndihmoje të kuptojë gjërat e mira që vazhdojnë të ekzistojnë, nuk është i braktisur, ka të afërm, miq dhe shkon në shkollë. E gjyshja mund të ketë pika të dobëta, por është në gjendje t'i japë diçka pozitive. Përpiqu të identifikosh gjërat pozitive te fëmija. Situata, mbase, nuk është ajo që ata duan, por ka edhe anë të mira në të. Kjo mund të jetë e rëndësishme për t'u përballur. Kërko nga ata të diskutojnë, të shkruajnë, të këndojnë, të vizatojnë, ose të aktrojnë.

SESIONI 4: Më në fund, gjej kohën për të kuptuar se çfarë shpresojnë ata për të ardhmen. Diskuto shpresat dhe ëndrrat e tyre. Dëgjoji dhe poho dëshirat e tyre, më pas diskuto me ta se ç'duhet të bëjnë sot për ëndrrat e së ardhmes. Përdor Aneksin 6 për të strukturuar këtë reflektim. Shpesh dëshirat e fëmijëve për të ardhmen, lidhen me dikë, të cilin ata e konsiderojnë si model për të ndjekur (dua të bëhem mësuese si zonja Kupe). Mund t'i ndihmosh fëmijët të identifikojnë cilësitë dhe vlerat që pëlqejnë te kjo mësuese dhe si duan t'i përdorin për jetën e tyre.

Nëse një fëmijë ka vështirësi të përballet me vdekjen e një personi të afërt në familje ose ndarjen e pjesëtarëve të familjes, shokëve, puno me të për gjërat e mira të së kaluarës. Mund të pyesësh si ishte jeta me njerëzit e dashur, shembuj të karakteristikave dhe vlerave që të dashurit u kanë dhënë. Folu për procesin e trashëgimisë dhe se si këto karakteristika dhe vlera, mund të bëhen pjesë e tyre. Mund të inkurajosh, gjithashtu, t'i shkruajnë një letër personave të dashur për të shprehur atë që dëshirojnë të thonë ose përdorin metafora që i ndihmojnë të shprehin mendimet dhe ndjenjat.

9 Shembull formulari për të marrë miratimin e prindërve

Formular për dhënie leje për përfshirjen në aktivitet të personave nën 18 vjeç

1

EMRI I SHKOLLËS/KLASËS/ PROJEKTIT	.....
VENDI/AKTIVITETI	.....
DATA/ORA	.....
EMRI I MËSUESIT	.....

2

EMRI I FËMIJËS/TË RIUT	.....
ADRESA	.....
NR. TEL.	.....
DATËLINDJA	.....

Jep detaje për çdo problem mjekësor lidhur me fëmijën, për të cilën shkolla duhet të jetë në dijeni, ju lutem, përfshini detaje të mjekimeve që mund të jenë marrë dhe kërkesat mbi dietat (ky informacion do të mbetet konfident).

.....

.....

3 Kam lexuar të gjithë informacionin përsa i përket programit për aktivitetet e mësipërme. Prandaj i jap leje djalit/vajzës/të miturit tim, të marrë pjesë në aktivitetin e sipërm.

4 **Shkolla** pranon vetëm detyrimin ose përgjegjësinë për ndonjë incident ose aksident shkaktuar nga pakujdesia apo shkeljet ligjore të bëra nga punonjësit e shkollës dhe personat e tjerë që janë ngarkuar nga shkolla për aktivitetet.

DATA ..... **FIRMA** (Prindi/Kujdestari) .....

Ndonjë numër të disponueshëm telefoni gjatë periudhës së aktiviteteve.

10 Lista e shqetësimeve të prindërve për fëmijët 6 deri 12 vjec [1]

Hyrje

Nga kopshti e deri në shkollën e mesme, çdo prind do të dijë “Si po shkon fëmija im?”. Të gjithë fëmijët kanë fuqi dhe aftësi të ndryshme dhe asnjë fëmijë nuk zhvillohet njësoj. Shëndeti, personaliteti dhe përvojat e mëparshme, janë të rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës; familja, komuniteti dhe traditat kulturore luanë po ashtu rol të rëndësishëm. Për shembull, në kushte të caktuara, fëmijët kanë më pak kufij dhe bëhen më të pavarur në moshë më të hershme.

Megjithëse çdo fëmijë është ndryshe, të gjithë fëmijët përballen me sfida sociale dhe emocionale në moshën e fëmijërisë së mesme:

- Zhvillimin e vetëvlerësimit dhe rritjes së besimit tek vetja;
- Gjetja e shokëve të rinj dhe përmbushja e detyrime të reja të vështira në shkollë;
- Mësojnë të marrin përsipër rreziqe të arsyeshme, të përballin dështimin dhe të marrin sërish veten.

1 Kjo listë kontrolli eshtë përshtatur nga ky burim: www.brightfutures.org

Si prindër ju bëheni ekspert në njohjen dhe plotësimin e nevojave në ndryshim të fëmijës suaj që rritet.

Nëse ke pyetje apo shqetësime për fëmijën, pyet. Pyet një shok të besuar, anëtar familjeje apo anëtar të komunitetit tënd fetar ose kulturor; fol me ofruesit e përkujdesit shëndetësor të fëmijës tënd apo kontakto me psikologun e shkollës ose personelin arsimor të shkollës së fëmijës suaj.

Lista me pyetje: Fëmija fillon të shfaqë veten

Çfarë pritet

Fëmija:

- × Fillon të shprehë idetë dhe kryejë veprimet e veta.
- × Punon shumë për të mësuar shprehi të reja, ndjehet krenar dhe do të tregojë se çfarë mund të bëjë.
- × Zotëron shprehitë për të arritur sukses në shkollë (mbledhja, zbritja shumëzimi, aftësitë gjuhësore, etj).
- × Shpreh personalitetin e vet unik në lidhje me të tjerët, përball përvojat.
- × Ka më shumë kontroll të brendshëm mbi impulset, emocionet dhe sjelljen.
- × Bëhet më i pavarur dhe i përgjegjshëm në zgjedhjet e veta.
- × Bëhet më i vetëdijshëm se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe (zhvillimi i koshiencës).

Prindërit:

- × Pranojnë personalitetin unik të fëmijës.
- × Inkurajojnë sjelljet e shëndetshme dhe të ekuilibruara (siç, ofrojnë përvoja sociale për fëmijë të turpshëm; aktivitete të qeta të strukturuara për fëmijë impulsivë ose shumë aktivë).
- × Mbështesin interesin, idetë dhe aktivitetet e fëmijës.
- × Japin modele të sjelljes së përgjegjshme, ndihmojnë fëmijën të marrë përgjegjësi të reja.
- × Ndihmojnë fëmijën të ekuilibrojë kohën për veten dhe atë për aktivitetet e strukturuara.

- Janë në dijeni të aktiviteteve të fëmijës brenda dhe jashtë shtëpisë.
- U mësojnë fëmijëve të marrin përsipër rreziqe të arsyeshme dhe kufijtë e sigurisë.
- Flasin me fëmijën për rreziqet e të eksperimentuarit me duhan, alkool, drogë (8-10 vjeç).

Kur të kërkojmë ndihmë?

Nëse fëmija juaj:

- Është i trishtuar, shqetësuar ose frikësuar.
- Ngjitet pas prindit ose do të rrijë në shtëpi të shumtën e kohës.
- Duket i shqetësuar ndaj dështimeve dhe gabimeve.
- Pret që t'i thonë se çfarë të bëjë, nuk shpreh interesin apo idetë e veta.
- Shmang detyrat e reja, përvojat dhe sfidat.
- Duket shpesh jashtë kontrolli, është impulsiv, bën zgjedhje të gabuara.
- Ndërmerr rreziqe të pasigurta (me biçikletë, trafik, lojëra, sport).
- Shfaq shenja të përdorimit të duhanit, alkoolit ose abuzimit me drogën.

Ose, nëse ju si prindër:

- Ju duket e vështirë të inkurajoni pavarësinë dhe të vendosni limite të sigurta.
- Jeni shumë mbrojtës dhe keni frikë ta lini fëmijën të provojë gjëra të reja.
- Mendoni se fëmija, ose është shumë agresiv, ose shumë i varur (bën çfarë i thonë të tjerët).
- Keni nevojë për ide për të ndihmuar fëmijën t'i rezistojë presionit për të pirë duhan, alkol apo të përdorë drogë.

Lista me pyetje: Fëmija është duke u rritur dhe ndryshuar

Çfarë pritet

Fëmija:

× Mëson të kujdeset për trupin (lahet, kujdeset, vishet, ushqehet shëndetshëm, bën aktivitete fizike).
× Ndjehet mirë për mënyrën si duket.
× Ka energji dhe ndjenjë mirëqenieje.
× Krenohet dhe kënaqet me aftësitë e reja fizike.
× Zhvillon identitetin e gjinisë (afërsisht 5 vjeç).
× Është në dijeni të ndryshimeve që do të ndodhin gjatë pubertetit (8-10 vjeç).

Prindërit:

× Inkurajojnë zakonet e sigurta, të shëndetshme (ushqime të shëndetshme, aktivitete fizike, rripin e sigurimit).
× Flasin me fëmijën për seksualitetin dhe pubertetin; japin informacionin e përshtatshëm, i përgjigjen pyetjeve me ndershmëri.
× Risigurojnë fëmijën për ndryshimet pozitive të pubertetit.
× Flasin së bashku me fëmijën për ndryshimet e imazhit të trupit dhe si t'i rezistojnë presionit për t'u dukur "të përkryer" (format, pesha, gjatësia).

Kur të kërkosh ndihmë?

Nëse fëmija juaj:

× Urinon në shtrat.
× Ka probleme me gjumin ose do të flejë shumicën e kohës.
× I mungojnë zakonet bazë të kujdesit për veten (të larët, larja e dhëmbëve, të veshurit).
× I kthehet zakoneve të foshnjave ose sjelljeve qesharake.

- × Shfaq shenja të zhvillimit të hershëm seksual (para 9 vjeç).
- × Duket i pavetëdijshëm ose i frikësuar nga puberteti dhe seksualiteti (mosha nga 9 në 10).
- × Ka një imazh të shtrembëruar për trupin (mendon se është i shëndoshë, kur në të vërtetë nuk është).
- × Përdor ushqimin për të qetësuar ose për t'u arratisur nga ndjenjat e pakëndshme.

Ose, nëse ju si prindër:

- × Shqetësoheni se fëmija juaj ha shumë ose pak.
- × Vini re se fëmija nuk ka përshtatshmëri fizike me të tjerët e së njëjtës moshë.
- × Jeni të shqetësuar se fëmija juaj nuk flet qartë ose nuk komunikon mirë me të tjerët.
- × Keni nevojë për udhëzime si të flisni me fëmijën për seksin dhe pubertetin.
- × Mendoni se fëmija është shumë i shqetësuar për peshën dhe imazhin e trupit.

Lista me pyetje: Të respektosh veten dhe të tjerët

Çfarë pritet

Fëmija

- × Ndjehet mirë për veten dhe të tjerët apo aftësitë e tyre.
- × Është në gjendje të kalojë dhe të kthehet pas nga zhgënjimet.
- × Mëson nga gabimet e dështimet dhe përpiqet përsëri.
- × Respekton të drejtat dhe ndjenjat e të tjerëve, ka ndjenjën e ndershmërisë.
- × Ka aftësi për të kuptuar gjithnjë e më shumë këndvështrimin e një personi tjetër.
- × Zgjidh konfliktet ose problemet duke folur, jo duke luftuar.

Prindërit:

- × Flasin dhe dëgjojnë fëmijën me respekt.
- × Janë modele të mira (tregojnë mirëkuptim, janë të sjellshëm dhe të durueshëm).
- × Mësojnë fëmijën të pranojë dhe respektojë ndryshimet e njerëzve (etnike, kulturore, fetare).
- × E përballin inatin me kujdes.
- × Ndihmojnë fëmijët të kapërcejnë dhe përballen me stresin.
- × Ndajnë ndjenjat dhe historitë e tyre mbi përballjen e frikës dhe të problemeve.
- × Respektojnë nevojat dhe jetën private të fëmijëve.
- × Kufizojnë ekspozimin e fëmijës ndaj dhunës në media.

Kur të kërkosh ndihmë?

Nëse fëmija:

- × Ndjen se i mungojnë shprehitë ose aftësitë bazë.
- × Thotë shpesh gjëra negative për veten dhe të tjerët.
- × Ka probleme të përballet me ndjenjat e inatit.
- × Shqetësohet për filmat e dhunshëm, televizorin, lojërat në kompjuter.
- × Është agresiv ose bëhet “trimosh” me të tjerët.

Ose nëse ju si prindër:

- × Shqetësoheni për mënyrën se si fëmija e sheh veten.
- × Shpesh kritikoni ose fajësoni fëmijën.
- × Vini re se fëmija duket i shqetësuar nga dhuna.
- × Keni shqetësime lidhur me ekspozimin e fëmijës ndaj abuzimit (fizik, verbal, seksual).
- × Ju mungon besimi ose keni dyshime për aftësitë tuaja.

Lista me pyetje: Familja

Çfarë pritet

Fëmija:

× Të kuptojë se e duan, të ndjehet i pranuar dhe vlerësuar në familje.
× Ndan ndjenjat dhe përvojat me anëtarët e familjes.
× Shkon mirë me vëllezërit dhe motrat të shumtën e kohës.
× Ndan ose i bën gjërat me radhë (lojëra, lodra, televizorin, kompjuter).
× I pëlqen të jetë pjesë e familjes dhe të bëjë gjëra të bukura bashkë.
× Ndihmon për gjëra të vogla, ndjek rregullat e familjes.

Prindërit:

× Shfaqin dashuri, ndjenjë dhe respekt.
× Gjejnë kohën çdo ditë për të folur dhe luajtur me fëmijën.
× Mbështesin dhe mbikëqyrin aktivitetet e fëmijës.
× Lëvdojnë sjelljet e mira, përpjekjet dhe arritjet.
× Hanë së bashku si familje sa më shpesh.
× Organizojnë aktivitete familjare.
× Vendosin rregulla dhe ndëshkime të arsyeshme.
× Ndihmojnë fëmijën të zgjidhë problemet me vëllezërit dhe motrat.
× I mësojnë fëmijës të vlerësojë dhe të festojë trashëgiminë familjare e kulturore.

Kur të kërkosh ndihmë?

Nëse fëmija juaj:

× Është shpesh i heshtur dhe nuk ndan ndjenjat me familjen.
× Nuk do të bashkohet në aktivitetet familjare.
× Qëndron në dhomë të shumtën e kohës, duket shpesh i trishtuar dhe i tërhequr.
× Sillet me inat dhe mosrespekt me anëtarët e familjes.
× Refuzon të ndihmojë me punët ose të ndjekë rregullat e rutinës familjare (koha e gjumit, e të ngrënit).

Ose, nëse ju si prindër:

× E keni të vështirë të flisni me fëmijët ose të kaloni kohë së bashku.
× Ndjeheni shpesh të inatosur dhe mërzitur me fëmijën.

- × Ndjeni se personaliteti i fëmijëve nuk "përshtatet" me familjen.
- × Keni nevojë për ndihmë për zgjidhjen e konflikteve në familje.
- × Po përballeni me ndryshime dhe strese të ndryshme (divorci, humbja e punës, përdorimi i substancave, etj.).

Lista me pyetje: Krijimi i miqësisë

Çfarë pritet

Fëmija:

- × Ka shokë, ndjehet i pranuar prej tyre.
- × Shkon mirë me të tjerët, i pëlqen të kalojë kohë me shokët.
- × Shkëmben mendime me të tjerët, i bën gjërat me radhë.
- × Sjell shokë në shtëpi për të luajtur, ftohet në shtëpitë e shokëve.
- × Mbron veten kur lëndohet nga shokët, di të përballë ngacmimet apo përqeshjet.

Prindët:

- × Mbështesin miqësinë e shëndetshme (njeh shokët e fëmijës dhe familjet tyre, fton shokët në shtëpi).
- × Mbikëqyrin aktivitetet e fëmijës.
- × Flasin me fëmijën për shokët, shkollën, interesin.
- × Inkurajojnë aktivitetet e fëmijës, kufizojnë kohën duke parë televizorin.
- × Ndihmojnë fëmijën të gjejë mënyra si ta zgjidhë konfliktin me shokët a lojtarët.
- × Mësojnë fëmijën si të jetë i sigurtë pranë të huajve (shtëpi, lagje, makinë, fusha).
- × Janë vigjilentë për shenjat e abuzimeve dhe sulmeve të mundshme seksuale.
- × I mësojnë aftësitë për t'i rezistuar presionit të shokëve dhe dinë të përballen me ngacmimet.

Kur të kërkosh ndihmë:

Nëse fëmija:

- × Nuk ka shokë.
- × Nuk do të ndajë gjërat apo të luajë me të tjerë.

- × Duket shumë nervoz ose i turpshëm me të tjerët, i pëlqen të rrijë vetëm të shumtën e kohës.
- × Është agresiv ose ngacmon fëmijët e tjerë (godet, ngacmon, fyen, etj).
- × Ndjen presion nga të tjerët për të bërë gjëra që nuk do.
- × Lëndohet shpesh nga shokët.

Nëse jeni prindër:

- × Shqetësoheni që fëmija juaj nuk shkon mirë me të tjerët ose ka probleme të qëndrojë me shokët.
- × Vini re se fëmija duket i tërhequr ose vetëm të shumtën e kohës.
- × Merrni telefonata nga prindërit ose fqinjët për sjelljen e fëmijës tënd.
- × Keni nevojë për udhëzime që fëmija juaj të ndërtojë aftësi të mira shoqërore.
- × Shqetësoheni për llojet e miqve dhe aktiviteteve që zgjedh fëmija juaj.
- × Vini re se fëmija duket i frikësuar me të rriturit e njohur, ose shumë miqësor me të huajt.

Lista me pyetje:

Marrëdhëniet në shkollë

Çfarë pritet:

Fëmija:

- × Ndjehet mirë me shkollën.
- × Pranohet nga shokët e klasës dhe mësuesit.
- × Përfshihet në aktivitetet në grup.
- × Merr pjesë në klubet e shkollës, skuadrat dhe aktivitetet e tjera shkollore.
- × Bashkëpunon për zbatimin e rregullave apo rutinave në shkollë.
- × I përgjigjet pozitivisht udhëzimeve të mësuesve.
- × Kërkon ndihmë kur është e nevojshme.

Prindërit:

- × Ndihmojnë fëmijët të ndjehen të sigurtë në shkollë (vizitojnë klasën, takojnë mësuesit para se të fillojë shkolla, etj).
- × Presin që fëmija të bëjë aq sa ç'është në gjendje të bëjë.
- × Japin ndihmë dhe udhëzime për detyrat në shkollë.
- × Inkurajojnë interesin e fëmijëve në aktivitete shkollore.
- × Përfshihen në shkollë (udhëtime, aktivitete psiko-sociale, etj.).
- × Flasin rregullisht me mësuesit.
- × Inkurajojnë fëmijët të vizitojnë shokët e klasës në shtëpi, që të luajnë ose bëjnë detyrat së bashku.

Kur të kërkosh ndihmë:

Nëse fëmija:

- × Shqetësohet ose ka frikë nga shkolla; refuzon të shkojë në shkollë.
- × Ka shpesh dhimbje koke apo stomaku në mëngjes para se të shkojë në shkollë.
- × Ka probleme me shokët e klasës, mësuesit ose punën në shkollë.
- × Ndjehet "ndryshe", "i refuzuar" ose i lënë pas dore.
- × Nuk vepron mirë në klasë ose në lojë.
- × I pëlqen të "dalë" më shokë që futen në telashe ose që janë më të mëdhenj.
- × Ngacmohet në shkollë ose në lojë.
- × Refuzon të ndjekë rregullat e shkollës dhe rutinën.
- × Humbet interesin në shkollë (notat, shokët, aktivitetet).

Nëse jeni prindër:

- × Vini re se fëmija nuk ka shokë në shkollë.
- × Merrni telefonata ose raporte nga mësuesit për shqetësime mbi sjelljen e fëmijës.
- × Prisni që fëmija të arrijë më shumë nga ç'është në gjendje të bëjë.
- × Vini re një ndryshim në përparimin e fëmijës në shkollë, për shembull, marrjen e nota të ulëta.

Pyetjet dhe shqetësimet e tua

EMRI: ..... **MOSHA:** .....

FËMIJA FILLON TË SHFAQË VETEN:

.....
.....

FËMIJA RRITET DHE NDRYSHON:

.....
.....

RESPEKTIMI I VETES DHE I TË TJERËVE:

.....
.....

FAMILJA:

.....
.....

NDËRTIMI I SHOQËRISË:

.....
.....

MARRËDHËNIET NË SHKOLLË:

.....
.....

Ju lutem, i diskutoni shqetësimet me Specialistin e Mbrojtjes
së Fëmijëve në shkollën tuaj!

11 Lista e shqetësimeve të prindërve për fëmijët 12 deri 18 vjeç

(adoleshentët)

Hyrje

Kur fëmijët bëhen adoleshentë, prindërit kanë shumë pyetje për mënyrën se si t'i ndihmojnë që të përballen me një sërë ndryshimesh.

Megjithëse adoleshenca është unike, të gjithë adoleshentët përballen me ndryshime emocionale dhe sociale gjatë adoleshencës. Kjo është koha e rritjes dramatike, qysh prej viteve të adoleshencës së hershme (11–14) e deri në adoleshencën e vonë (18–21). Sfidat më të mëdha përfshijnë:

- Të mësosh si të menaxhosh ndjenjat dhe humorin;
- Përjetimi i zhvillimit seksual dhe ndryshimet në imazhin për trupin;
- Të mësosh të jesh i sigurtë dhe të shmangësh sjelljet e rrezikshme;
- Të bëhesh më i vetëdrejtuar dhe i përgjegjshëm.

Ndërsa adoleshenti juaj po përballet me sfida të reja, të njëjtën gjë po kaloni edhe ju si prindër. Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim për adoleshentin tuaj, pyesni. Pyesni një mik të besuar, anëtar të familjes,

hidhini një sy listës me shqetësimet e prindërve ose flisni me një profesionist. Duke gjetur përgjigjet e pyetjeve tuaja, ju do ta ndihmoni fëmijën të rritet dhe zhvillohet shëndetshëm.

Kjo listë ofron një udhëzues mbi zhvillimin e shëndetshëm të adoleshentit dhe rolin e prindit.

Lista

Ndjenjat

Çfarë të presësh

Adoleshenti

- × Mund të ketë ndryshime të shpeshta humori ose ndryshim të ndjenjave (njëherë i trishtuar, më pas i gëzuar).
- × Ka një kuptim më të mirë të emocioneve të vetes dhe të të tjerëve.
- × Ka ndjenja pozitive shumicën e kohës.
- × Po mëson të pranojë zhgënjimin dhe kapërcejë dështimet.
- × Kupton se trishtimi dhe ndjenjat e "këqija" janë të përkohshme e do të kalojnë.
- × Zakonisht shkon mirë në shkollë ose në punë.

Prindërit:

- × Mbështesin përpjekjet e adoleshentëve dhe lëvdojnë arritjet.
- × Dëgjojnë dhe flasin hapur me fëmijën.
- × Shmangin kritikat, gjykimin dhe ngacmimet.
- × Janë të gatshëm për të ndihmuar e dhënë këshilla kur janë të nevojshme.
- × Ndihmojnë adoleshentët të zgjidhin konfliktet, problemet.
- × Pranojnë që ndjenjat e adoleshentëve janë reale, janë të kujdeshëm të mos i minimizojnë apo lënë pas dore.
- × U japin mundësi fëmijëve të përdorin gjykimin e tyre.

Kur të kërkosh ndihmë?

Nëse adoleshenti:

- × Është i trishtuar, stresuar dhe me humor të keq të shumtën e kohës.
- × Duket shumë i trishtuar dhe në ankth.
- × Ka shumë ndryshime humori.
- × Ha ose fle më pak (ose shumë) se më parë.
- × Nuk është më i interesuar në gjërat që i pëlqenin më parë.
- × Ka mendime ose opinione negative për veten.
- × Dekurajohet lehtë nga zhgënjimet dhe dështimet.
- × Ndjehet i pashpresë, i paaftë t'i bëjë gjërat si duhet.
- × Flet për të lënduar dhe vrarë veten; është përpjekur ta bëjë.
- × Përdor alkool ose drogë, për t'iu shmangur ndjenjave negative.
- × Ka vështirësi në shkollë ose në punë,

Nëse prindërit:

- × Kanë shqetësime për ndryshimet e adoleshentit:
  - a humorin dhe emocionet;
  - b zakonet e të ngrënit dhe të fjetjes;
  - c arritjet në shkollë;
  - d zakonet në punë.
- × E kanë të vështirë të flasin me adoleshentin.
- × Kanë konflike të shpeshta me adoleshentin.
- × Mendojnë se adoleshenti po abuzon me alkoolin dhe drogën.
- × Janë të shqetësuar që adoleshenti mund të lërë shkollën ose të lërë punën.
- × Mendojnë se adoleshenti mund të përpiqet të lëndojë ose vrasë veten.
- × Janë të shqetësuar se adoleshenti mund të gjejë armë zjarri ose armë të ftohta.

Miqtë dhe familja

Çfarë pritet

Adoleshenti:

- × Shkon mirë me familjen, prindërit dhe miqtë të shumtën e kohës.
- × Dëgjon prindërit, megjithëse duket se shpërfill shpërfill udhëzimet dhe këshillat e tyre.
- × Bëhet më i pavarur.
- × Krijon objektiva dhe punon për t'i arritur.
- × Zakonisht vishet dhe sillet si adoleshent, por gradualisht krijon shijet dhe stilin e vet.
- × Ka një ose më shumë shokë të ngushtë dhe marrëdhënie të mira me të tjerë të moshës së tij.
- × Respekton opinionin dhe vlerat e shokëve dhe të të tjerëve.
- × Ka përmirësuar vlerat shoqërore.
- × Pranon rregullat e familjes, plotëson detyrat e përditshme dhe përgjegjësitë e tjera.

Prindi:

- × Respekton fshehtësinë e adoleshentit e inkurajon dëshirën e tij për pavarësi.
- × Kupton nevojat e adoleshentit për të qenë si adoleshentët e tjerë dhe ndikimin prej tyre.
- × Toleron (arsyeshëm) shijet në zhvillim të adoleshentit për rrobat, modelin e flokëve dhe muzikën.
- × Vazhdon të japë udhëzime dhe mbështetje.
- × Shfaq interes në lidhjet dhe aktivitetet e adoleshentit.
- × Vendos rregulla të drejta dhe është këmbëngulës në zbatimin e tyre (shkollë, punë, orare, përdorim makine, detyra etj.).
- × Inkurajon objektivat e adoleshentit, planet për të ardhmen (shkollë, karrierë).
- × Planifikon aktivitete që familja dhe adoleshenti të kënaqen së bashku.

Kur të kërkosh ndihmë?

Nëse adoleshenti:

- × Është i parespektueshëm, provokues, nuk do të bëjë kompromis.
- × Zihet shpesh dhe krijon konflikte në familje.
- × Duket shumë i varur, nuk ka vullnet të marrë vetë vendimet.
- × Është vetëm të shumtën e kohës, nuk duket i lumtur me të tjerët.
- × Tërhiqet nga familja dhe miqtë.
- × Shpërfill rregullat e familjes (përdorimin e makinës, orarin, telefonin, kompjuterin).
- × Ndikohet shpejt nga shokët, të cilët nuk kanë vlera të mira ose kryejnë sjellje negative ose të dëmshme.

Nëse prindërit:

- × Kanë probleme, t'u japin liri fëmijëve në kohën që adoleshentët bëhen më të pavarur.
- × Kanë nevojë për udhëzime disipline dhe vendosje kufijsh për adoleshentin.
- × Ndjehen të pasigurtë rreth ndryshimeve në sjelljen e adoleshentit (çfarë është dhe çfarë nuk është tipike).
- × Janë të shqetësuar për shokët që zgjedhin adoleshentët dhe për ndikimin e tyre.
- × Shpesh përjetojnë strese ose konflikt në shtëpi.
- × Do të dëshironin të merrnin pjesë në grupet e prindërve për të diskutuar problemet e adoleshencës.

Parandalimi i dëmtimeve dhe sjelljeve të rrezikshme

Çfarë pritet

Adoleshenti:

- × Ka zhvilluar zakone të sigurta dhe të shëndetshme (nget makinën me kujdes, përdor rripin e sigurimit, zbaton shpejtësinë e lejuar në qarkullimin rrugor, s'përdor drogë dhe alkool).
- × Shmang hipjen në makinë me dikë që ka pirë apo përdor drogë.

- Di si t'i rezistojë presionit të shokëve për të pirë duhan, pije, drogë, për të ecur shpejt me makinë dhe sjelljeve të tjera të rrezikshme.
- Ka miq që nuk pinë dhe shmangin alkoolin dhe drogën.
- Është në gjendje të qetësohet dhe di si ta menaxhojë zemërimin.
- Është i sigurtë pa qenë agresiv.

Prindi:

- Jep një shembull të mirë (përdor rripin dhe skafandrën, shmang pijen ndërsa i jep makinës, kontrollon inatin).
- Bën festa joalkoolike për adoleshentë, mbikëqyr fëmijët në këto festa.
- Lëvdon adoleshentët që i rrinë larg alkoolit dhe drogës.
- I flet adoleshentit për rreziqet, që janë pasojë e përdorimit të drogës dhe alkoolit, gjykimit të shpejtuar, përplasjeve me makinë, seksit të pambrojtur, sjelljeve të dhunshme, mbytjeve).
- Përcakton rregulla për drejtim të sigurtë makine (numrin e pasagjerëve, ngarjen e makinës natën, kufijtë e shpejtësisë, mospërdorimin e alkoolit dhe drogës).
- Ka plan "shpëtimi" (adoleshentët mund kërkojnë të marrin makinën; prindërit nuk e lejojnë të përfshihet në një situatë të tillë të pasigurtë).

Kur të kërkosh ndihmë

Nëse adoleshenti:

- Përfshihet në sjellje të dëmshme, shpërfill rreziqet.
- E lëshon veten ndaj presioneve të shokëve.
- Përfshihet në banda, merr pjesë në aktivitetet ilegale.
- Inatoset, bëhet i dhunshëm ose abuziv.
- Bën si trimosh dhe dëmton të tjerët, është rrahur ose dëmtuar.
- Mban armë (pistoletë, thikë) për mbrojtje.
- Ka të dashur që abuzon.
- Ka përjetuar ose dëshmuar dhunë në shtëpi ose lagje.
- Është i ekspozuar ndaj dhunës në filma, video, televizion dhe muzikë.

- Është duke provuar ose është i varur nga alkooli, duhani ose format e tjera të drogës.
- Duket sikur ka para nga burime të panjohura.
- Drejton makinën në mënyrë agresive, me shpejtësi, pi dhe nget makinën.

Nëse prindërit:

- Kanë nevojë për ndihmë, me qëllim që të njohin shenjat e përdorimit apo abuzimit me alkoolin dhe drogën.
- Kanë probleme me alkoolin dhe drogën.
- Zihen me adoleshentin të shumtën e kohës, humbasin kontrollin, zemërohen.
- Ndjehen të pasigurtë në shtëpi ose lagje.
- Duan informacion për rregullat e mbajtjes së armëve, ruajtjen dhe përdorimin e armëve.
- Kanë frikë se adoleshenti mund të të dëmtojë ty dhe të tjerët.
- Kanë nevojë t'i mësojnë mënyrat e sigurta të ngarjes së makinës.

Imazhi i trupit dhe zakonet e të ngrënit

Çfarë pritet

Adoleshenti:

- Harxhon shumë kohë dhe përpjekje për paraqitjen fizike.
- Është shumë i shqetësuar për peshën, format dhe masat trupore.
- Ndjehet shumë i vetëndërgjegjshëm, krahason paraqitjen fizike me adoleshentët e tjerë dhe persona të njohur.
- Do të ketë një rritje fizike gjatë adoleshencës.
- Zakonisht ha ushqim të shëndetshëm dhe është fizikisht aktiv.
- Fillon të zhvillojë një identitet dhe vetëvlerësim përtej imazhit trupor dhe paraqitjes fizike.

Prindi:

- Flet me adoleshentët rreth ndryshimeve fizike dhe pubertetit, që ndikon në peshë, gjatësi dhe formën trupore.
- Inkurajon adoleshentin të hajë vaktet me familjen dhe të jetë i çlodhur gjatë kohës së vaktit.

- Këshillon adoleshentin të hajë ushqim të shëndetshëm dhe të jetë fizikisht aktiv.
- Shmang deklaratat kritike apo ankesat për ushqimin, peshën apo paraqitjen.
- Nëse adoleshenti është mbi peshë, inkurajon humbjen e saj nëpërmjet ushqimit të shëndetshëm, aktivitetit fizik dhe mbështetjes sociale.
- Ndihmon adoleshentin të identifikojë dhe të vlerësojë pikat e forta (mirësinë, kurajën, talentin), jo vetëm paraqitjen.

Kur të kërkojmë ndihmë?

Nëse adoleshenti:

- Nuk tregon shenja rritjeje apo ndryshimi fizik, në krahasim me adoleshentët e tjerë të të njëjtës moshë.
- Nuk është i lumtur për peshën, gjatësinë apo imazhin.
- Mendon se është mbipeshë (kur nuk është) ose ka frikë se mos shëndoshet.
- Mban shumë dieta, sidomos kur nuk është mbipeshë.
- Nuk ka oreks, nuk ha ushqim të shëndetshëm, i harron vaktet të shumtën e kohës.
- Ka episode kur:
  - Ha sasi të mëdha ushqimi.
  - Nuk ka kontroll mbi ushqimin.
- Ha shumë, por nuk merr shëndet (mund të vjellë).
- Refuzon të hajë në sy të të tjerëve.
- Bën shumë ushtrime ose stërvitet shumë në sport.
- Fiton shumë peshë dhe ka shumë pak ose aspak aktivitete fizike.
- Përdor steroide për të zhvilluar muskujt.

Nëse prindi:

- Është i shqetësuar se adoleshenti po piqet para kohe (në moshën 9-10 vjeç apo vonë në moshën 17 vjeç apo më shumë).
- Shqetësohet për peshën e adoleshentit (humbet ose fiton shumë peshë).
- Kërkon në mënyrë të prerë që të gjithë anëtarët e familjes të hanë së bashku.

- Ka nevojë për ndihmë të flasë me adoleshentin për imazhin e shëndetshëm trupor, zakonet e të ngrënit dhe aktivitetet fizike.
- Ka nevojë të dijë më shumë për shenjat e mundshme të çrregullimit të të ngrënit, si anoreksia apo bulimia.

Seksi dhe seksualiteti

Çfarë pritet

Adoleshenti:

- Zhvillohet seksualisht (mund të jetë herët ose vonë në adoleshencë).
- Shqetësohet për "zhvillimin" në të njëjtën mënyrë si adoleshentët e tjerë.
- Ka nevojë për kohë për të asimiluar ndryshimet e shpejta fizike.
- Mund të ndjejë presion për të eksperimentuar seksualisht.
- Mund të eksplorojë seksualitetin me shokë të të njëjtit seks.
- Zhvillon gradualisht identitetin seksual si dhe orientimin seksual (heteresoksual, homoseksual dhe biseksual).

Prindi:

- Flet me adoleshentin për zhvillimin seksual që ndodh gjatë pubertetit.
- Dëgjon shqetësimet e adoleshentëve dhe i përgjigjet pyetjeve mbi seksualitetin, janë të qartë dhe të respektueshëm.
- Inkurajon adoleshentët të shtyjnë presionin për seks.
- Shpjegon rreziqet e aktivitetit seksual, si sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe shtatzaninë te të rinjtë.
- Diskuton "praktikat e seksit të sigurtë" profilaktikët, planifikimin familjar, partnerët e kufizuar.
- Inkurajon adoleshentin të konsultohet me personat e specializiuar në shërbimet shëndetësore ose me SMF-në për seksualitetin dhe shëndetin seksual.
- Është vigjilent për shenjat e abuzimeve dhe sulmeve seksuale.
- U ofron adoleshentëve materiale të qarta, të lehta për t'u kuptuar, nëse ata kanë dëshirë të mësojnë më tepër për këto probleme.

Kur të kërkojmë ndihmë

Nëse adoleshenti:

- × Nuk tregon shenja të zhvillimit seksual deri në mes të adoleshencës.
- × I bëhet presion për të kryer marrëdhënie seksuale.
- × Është aktiv seksualisht a në rrezik për t'u përfshirë në aktivitet të hershëm seksual.
- × Bën seks të pasigurtë ose me një numër personash.
- × Duket i mërzitur ose i shqetësuar për orientimin seksual.
- × Është i interesuar të ketë të dashur qysh në moshë të vogël.

Nëse prindërit:

- × Kanë nevojë për informacion se si të flasin me adoleshentët për seksin (vlerat, presionin, seksin e sigurtë).
- × Janë të shqetësuar për adoleshentët që dalin çift.
- × Mendojnë se adoleshenti kryen marrëdhënie në një moshë të vogël.
- × Mendojnë se adoleshentja mund të jetë shtatzënë ose në rrezik të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.
- × Mendojnë se adoleshenti mund të jetë abuzuar ose sulmuar seksualisht.
- × Duan të dinë si të mbështesë zhvillimin e shëndetshëm seksual të fëmijës dhe orientimin e tij seksual.

Pyetjet dhe shqetësimet

EMRI: ..... **MOSHA:** .....

NDJENJAT:

.....

.....

MIQTË DHE FAMILJA

.....

.....

PARANDALIMI I DËMTIMEVE DHE SJELLJEVE TË RREZIKSHME:

.....

.....

IMAZHI I TRUPIT DHE SJELLJET E TË NGRËNIT:

.....

.....

SEKSI DHE SEKSUALITETI:

.....

.....

Ju lutem, diskutoni shqetësimet tuaja me Specialistin për Mbrojtjen e Fëmijëve në shkollën e fëmijës suaj.

Seksioni D

Referencat

CHILD PROTECTION MANUAL FOR INTERVENTION IN HUMANITARIAN CRISIS, Terre des hommes, Lausanne, 2007.

CLAEYS BOUUAERT, M. Pratique de l'éducation émotionnelle, 2004, Le souffle d'or.

COCHRANE REVIEË, Psychological debriefing for preventing post traumatic stress disorder.

COMMUNITY MOBILIZATION. IN: ACTION FOR THE RIGHTS OF CHILDREN (ARC). Stockholm, Save the Children, 2001. (www. savethechildren.net/ arc/files/main.html).

FLAMMER A., ALSAKER F., ENTWICKLUNGSPSYCHOLOGIE DER ADOLESZENZ, 2002, Hogrefe Verlag.

GUIDELINES TO LISTENING AND TALKING WITH CHILDREN WHO ARE PSYCHOLOGICALLY DISTRESSED.

Save the Children Jorway.

HANDBOOK FOR TEACHER'S, AVSI Uganda, 2003.

IASC GUIDELINES ON MENTAL HEALTH AND PSYCHOSOCIAL SUPPORT, 2006 (www.who.int).

KLEBER H., KONFLIKTE GEËALTFREI LÖSEN. 2003, Cornelsen Verlag..

LE GAL J., LES DROITS DE L'ENFANT À L'ÉCOLE. Pour une éduction à la citoyenneté, 2002, De Boek Verlag. .

MOVEMENT, GAMES AND SPORT MANUAL. Lausanne, Terre des hommes, 2006.

OERTER R., MONDADA L., ENTWICKLUNGSPSYCHOLOGIE, 2002, Belz Verlag.

OBSERVATION, LISTENING AND COMMUNICATION: PREREQUISITES FOR INTERVENTION. In: instructor's Guide Geneva, Terre des hommes, 2005.

PARTICIPATORY LEARNING AND ACTION: A TRAINER'S GUIDE. London, International Institute for Environment and Development, 1995.

PROJECT CYCLE HANDBOOK. Lausanne, Terre des hommes, 2001

SITUATION ANALYSIS. In : Action for the Rights of Children (ARC), Stockholm, Save the Children Sweden, 2001 (www. savethechildren.net/arc/files/main.html)

SULLIVAN, J AND BEECH, A (2003) PROFESSIONAL PERPETRATORS: Sex Offenders Who Use Their Employment To Target And Sexually Abuse The Children With Whom They Work: Child Abuse Review; Vol 11, Issue 3 153-167.J.Ëiley and Son Ltd.

VISION OF THE CHILD ON HIS OWN LIFE, Terre des hommes, Brasil.

VLERËSIM I SITUATËS SË NDIHMËS LIGJORE NË SHQIPËRI, Korrik 2006 – Mars 2007, Qendra për Shërbime të Integruara Praktike dhe Ligjore

WHO (WORLD HEATH ORGANIZATION) 1999, 2002 WORLD REPORT ON VIOLENCE AND HEALTH CHAPTER 3, Child Abuse and Neglect by Parents and Other Caregivers.

WORKING WITH CHILDREN, AN INTRODUCTION TO PSYCHOSOCIAL SUPPORT, Unicef Pakistan.

YATCHIJOVSKY A., L'APPROCHE SYSTÉMIQUE, 1999, ESF, Paris.

Burime në internet

LEGJISLACIONI SHQIPTAR
www.mpcs.gov.al/dshb/images/stories/raporte-publikime-artikuj/raporti_i_i-re_dhe_fillestar-_cedaw.pdf

www.legjislacionishqiptar.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%209669%20Dat%C3%AB%2018-12-2006.htm

ARC ACTION FOR RIGHTS OF CHILDREN
www.savethechildren.net/arc

BRIGHT FUTURE
www.brightfutures.org

KEEPING CHILDREN SAFE COLLATION
www.keepingchildrensafe.org.uk

NATIONAL ASSOCIATION FOR SCHOOL PSYCHOLOGISTS (USA)
http://www.nasponline.org

TRIPLE P, POSITIVE PARENTING PROGRAM
www.pfsc.uq.edu.au/02_ppp/ppp.html

UNICEF
www.unicef.org

WORLD HEATH ORGANIZATION (WHO)
www.who.int

Seksioni E

Fjalorth me përkufizimin e termave dhe koncepteve

Ky fjalorth shpjegon disa nga fjalët dhe frazat që janë përdorur më shpesh në këtë trajnim dhe në manual. Do të jetë një referencë e mirë, nëse keni vështirësi për gjuhën e përdorur. Fjalët janë vënë si emër, mbiemër ose folje.

Kuptimi i fjalës/përkufizimi

- **AUTORIZOJ** (folje) T'i japësh dikujt; ose të bësh të mundur dikë të ketë pushtet ose kontroll, ose të shprehë ndjenjat dhe opinionet, për shembull, si mund të autorizojmë fëmijën të flasë, nëse ka qenë abuzuar? Si mund t'u japin fëmijëve konfidencë dhe vetëbesim të flasin?
- **"DETYRË PËRKUJDESI"** Detyrë për t'u kujdesur, për shembull, të gjitha organizatat që bien në kontakt me fëmijën, kanë detyrë për t'u kujdesur për këta fëmijë, nuk është zgjedhje, kanë përgjegjësi për t'u kujdesur.
- **DËSHMI** (emër) Evidencë, deklaratë.
- **DISKRIMINIM** (emër) Trajtimi i padrejtë i një personi ose grupi.
- **FËMIJË** Sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijëve: Çdo individ nën moshën 18 vjeç. Ky është përkufizimi edhe në terma të brendshme të vendeve kur një fëmijë arrin moshën e maturisë.
- **GJINI** (emër) Nëse dikush është mashkull ose femër.
- **KRITER** (emër) Standardet, masat ose pritshmëria e përdorur për të vlerësuar dikë apo diçka, për shembull, i dhashë kriteret e përzgjedhjes për punën, informacion se çfarë aftësish dhe eksperiencash kërkojmë te një punonjës.
- **KUJDESTARI KRYESOR** Personi që ofron kujdesin më të madh, ose ka përgjegjësi. Për shembull, pasi i vdiqën prindërit, tani është tezja kujdestarja kryesore.
- **LEHTËSOJ** (folje) Udhëheq, bëj diçka të ndodhë, për shembull, trajnuesi lehtëson kursin.
- **MASA** (emër) Hapa, plane veprimi, shënime mbi procedurën. Për shembull, duhet të marrim të gjitha masat e nevojshme për të mbajtur fëmijët të sigurtë.
- **MBROJTJA E FËMIJËVE** Çfarëdo që individët, organizatat, shtetet dhe komunitetet bëjnë për të mbrojtur fëmijën nga abuzimi dhe

shfrytëzimi. Ky abuzim mund të përfshijë dhunën në familje, punën e fëmijës, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual, HIV/AIDS dhe dhunën fizike.

- **MIRËQENIE** Siguri, garanci, kënaqësi, mbarëvajtje.
- **NEVOJA MATERIALE** Nevoja jetësore fizike, për shembull, strehim ushqim, shërbim mjekësor, para etj.
- **NË FUQI** Ndodh, prezent, ekziston. Për shembull, është shumë e rëndësishme të kesh politika dhe procedura në fuqi, para se të ndodhë ndonjë rast emergjent.
- **PARAGJYKIM** (emër) Një gjykim i bërë para se të merret informacioni ose përvoja e duhur, zakonisht negative. Për shembull, njerëzit me aftësi të kufizuara flasin çdo ditë për paragjykimet që përjetojnë nga njerëz që mendojnë se ata janë të paaftë të bëjnë diçka për veten, ose mendojnë se të gjithë ata njerëz mendojnë njësoj.
- **PARTNER** (emër) Kushdo që ka përgjegjësi ose rol, ose do të preket nga një program i veçantë, politikë, ngjarje. Për shembull, organizata organizoi një takim për të gjithë partnerët, për të vendosur mbi objektivat e vitit të ardhshëm.
- **PJESËMARRJE** (emër) Përfshirje.
- **PJESËMARRËS** (mbiemër) Përfshirës, inkluziv.
- **PROAKTIV** (mbiemër) Pozitiv, inkurajon veprimet para se të ndodhë problemi ose veprimi.
- **PROMOVOJ** (folje) Bëj të njohur dhe të rëndësishme. Për shembull, “Organizata promovoi përkujdesin shëndetësor dhe arsimimin për fëmijët në rajon”.
- **RUAJ** (folje) Të sigurosh.
- **SISTEMATIKE** Do të thotë se zhvillimi i fëmijës, mirëqenia dhe mbrojtja, shihen si një fenomen kompleks në ndërveprim konstant midis individëve, familjeve dhe elementëve shoqërorë në kushte të veçanta.
- **SPECIFIKE PËR POZICIONIN** Diçka që është specifikiksht e lidhur me punën tënde.
- **ZBATOJ** (folje) Të vesh në praktikë, të bësh diçka të ndodhë. Për shembull, ai zbatoi politikën, ata kishin një politkë dhe e vunë në realitet, e vendosën në praktikë.